



MANUAL

për aplikimin e alternativave
të dënimit me burgim

osce

MANUAL PËR APLIKIMIN E ALTERNATIVAVE TË DËNIMIT ME BURGIM

Ky manual është përgatitur me nismën e Departamentit të Ligjit dhe të të Drejtave të Njeriut pranë Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, për gjyqtarë dhe prokurorë në lidhje me aplikimin e alternativave të dënimit me burgim sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar në nëntor të vitit 2008



2010

© Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, 2010
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Autorët Prof. Dr. Arta MANDRO-BALILI, Drejtuese e Programit të
Formimit Vazhdues, Shkolla e Magjistraturës

Marsida XHAFERLLARI, Magjistrate, Drejtore e Përgjithshme,
Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit, Ministria e Drejtësisë

Gerd HOXHA, Gjyqtar-Magjistrat, Gjykata e Rrethit Gjyqësor
Tiranë

M.A. Admir BELISHTA, Gjyqtar-Magjistrat, Kryetar i Gjykatës
së Rrethit Gjyqësor Korçë

Redaktimi shkencor dhe letrar Alba JORGANXHI

Përgatiti për botim Alba JORGANXHI

Design & Layout Miranda IKONOMI

Kopertina Klevis JANKO

ISBN: 978-92-9235-221-9

Shtëpia botuese & shtypshkronja



Shtëpia botuese: Tel: 048 810 179 cel: 069 40 075 02 pegi@icc-al.org
Shtypshkronja: Tel: 048 810 179 Cel: 069 40 075 01 shtypshkronjapegi@yahoo.com

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE

6

KREU I

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I STANDARDEVE DHE NORMAVE QË PARASHIKOJNË DËNIMET ALTERNATIVE

1.	Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë mbi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut	11
1.1	Parimet kryesore të drejtësisë penale sipas Kushtetutës	11
1.2	Lidhja ndërmjet Kushtetutës dhe standardeve ndërkombëtare	13
2.	Standardet ndërkombëtare lidhur me sanksionet dhe masat komunitare	14
2.1	Konteksti ligjor ndërkombëtar. Karakteri detyrues, rekomandues dhe politik i normave të së drejtës ndërkombëtare	15
2.2	Burimet e së drejtës ndërkombëtare	17
2.3	Rëndësia e standardeve dhe jurisprudencës për profesionistët	17
2.4	Niveli i Kombeve të Bashkuara	18
2.4.1	<i>Konventa për të Drejtat e Fëmijës</i>	18
2.4.1.1	Udhëzimet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara	20
2.5	Niveli i Këshillit të Evropës	23
2.5.1.	<i>Konventa Evropiane për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht</i>	24
2.5.2	Konventa e Këshillit të Evropës “Për transferimin e personave të dënuar”	26
2.5.3	Konventa e Këshillit të Evropës “Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale”	27
2.5.4	Konventa e Këshillit të Evropës “Për vlefshmërinë ndërkombëtare të gjyqimeve penale”	28
2.5.5	Konventa e Këshillit të Evropës “Për transferimin e procedimeve në çështjet penale”	28
2.5.6	Rekomandime dhe rezoluta të Këshillit të Evropës	30
2.6	Niveli i Bashkimit Evropian	36

KREU II

KUADRI LIGJOR LIDHUR ME ALTERNATIVAT E DËNIMIT ME BURGIM SIPAS KODIT PENAL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

1.	Risitë e alternativave të dënimit me burgim pas ndryshimeve të Kodit Penal me ligjin nr. 10 023, datë 27.1.2008	37
2.	Kuptimi i alternativave të dënimit me burgim. Rëndësia e zbatimit të tyre në praktikë dhe problemet e hasura gjatë zbatimit	43
2.1	Gjysmëliria (Neni 58 i Kodit Penal)	44
2.2	Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë (Neni 59 i Kodit Penal)	46
2.3	Qëndrimi në shtëpi (Neni 59/a i Kodit Penal)	51
2.4	Detyrimet të dënuarit të vënë në provë (Neni 60 i Kodit Penal)	56
2.5	Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik (Neni 63 i Kodit Penal)	66
2.6	Lirimi me kusht (Neni 64 i Kodit Penal)	67

KREU III

SHËRBIMI I PROVËS NË SHQIPËRI

1.	Instituti i Shërbimit të Provës, organizimi dhe funksionimi i tij. Modelet e standardizuara të Shërbimit të Provës	79
1.1	Instituti i Shërbimit të Provës	79
1.2	Organizimi i Shërbimit të Provës	81
1.3	Funksionimi i Shërbimit të Provës	83
1.4	Bashkëpunimi i Shërbimit të Provës	86
1.5	Modelet e standardizuara të Shërbimit të Provës	88
2.	Statistika të zbatimit të alternativave të dënimit me burgim	91

KREU IV

ROLI DHE POZITA PROCEDURALE E SHËRBIMIT TË PROVËS

1.	Roli dhe pozita procedurale e Shërbimit të Provës gjatë fazës së hetimeve paraprake	99
2.	Roli dhe pozita procedurale e Shërbimit të Provës gjatë gjykimit	104
3.	Roli dhe pozita procedurale e Shërbimit të Provës gjatë ekzekutimit të vendimeve që përmbajnë dënime alternative	106
3.1	Roli dhe pozita procedurale e Shërbimit të Provës gjatë mbikëqyrjes së ekzekutimit të dënimit alternativ të “ <i>gjysmëlirisë</i> ”, parashikuar nga neni 58 i Kodit Penal	110
3.2	Roli dhe pozita procedurale e Shërbimit të Provës gjatë mbikëqyrjes së ekzekutimit të “ <i>pezullimit të ekzekutimit të dënimeve me burgim dhe vënia në provë</i> ”, parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal	114
3.3	Roli dhe pozita procedurale e Shërbimit të Provës gjatë mbikëqyrjes së ekzekutimit të dënimit alternativ të “ <i>qëndrimin në shtëpi</i> ”, parashikuar nga neni 59/a i Kodit Penal	119
3.4	Roli dhe pozita procedurale e Shërbimit të Provës gjatë mbikëqyrjes së ekzekutimit të dënimit alternativ me “ <i>punë në interes publik</i> ”, parashikuar nga neni 63 i Kodit Penal	121
3.5	Roli dhe pozita procedurale e Shërbimit të Provës gjatë mbikëqyrjes së ekzekutimit të “ <i>lirimit me kusht</i> ”, parashikuar nga neni 64 i Kodit Penal	127
4.	Shkelja e kushteve dhe detyrimeve gjatë ekzekutimit të dënimit alternativ	132
5.	Raportet e përgatitura nga Shërbimi i Provës	135

SHTOJCA I

1.	Konventa të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë në fushën e dënimeve alternative	156
	Ligji nr. 8724, datë 26.12.2000 “ <i>Për ratifikimin e ‘Konventës Europiane për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht</i> ”	157

	Ligji nr. 8499, datë 10.6.1999 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për transferimin e personave të dënuar”	167
	Ligji nr. 8498, datë 10.6.1999 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale”	177
	Ligji nr. 9068, datë 15.5.2003 “Për ratifikimin e ‘Konventës Europiane për vlefshmërinë ndërkombëtare të gjykimeve penale”	193
	Ligji nr. 8497, datë 10.6.1999 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për transferimin e procedimeve në çështjet penale”	214
	Ligji nr. 8499, datë 10.6.1999 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për transferimin e personave të dënuar”	229
2.	Vendim Nr. 302, datë 25.03.2009 “Për miratimin e rregullores ‘Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës dhe për përcaktimin e standardeve e procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative”	239
3.	Rregullore “Për bashkëpunimin e Shërbimit të provës me OJF-të dhe Shërbimin e Ndërmjetësimit”, miratuar me Urdhrin nr. 6325, dt. 31.07.2009 të Ministrit të Drejtësisë.	264

SHTOJCA II

1.	Modelet e standardizuara të raporteve të përgatitura nga Shërbimi i Provës për fazat para dhënies së dënimit dhe pas dhënies të dënimit	274
1.1	Raport vlerësimi për personin nën hetim/të pandehurin	275
1.2	Raport vlerësimi për të dënuarin	278
1.3	Raport përfundimtar	283
1.4	Shembull raport vlerësimi të përgatitur nga Shërbimi i Provës për personin nën hetim / të pandehurin	285
1.5	Shembull raport vlerësimi të përgatitur nga Shërbimi i Provës për të dënuarin	288

PARATHËNIE

Ioana VAN NIEUWKERK
Këshilltare e Lartë Ligjore
Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

Që prej miratimit të Kodit Penal në vitin 1995, gjyqtarët në Shqipëri kanë pasur në dispozicion një sërë sanksionesh si alternativa të dënimit me burgim, të cilat mund t'i jepnin në fazën e dënimit. Në praktikë, alternativat e dënimit me burgim janë përdorur shumë rrallë dhe prirja ka qenë kryesisht drejt dënimit me burgim. Faktet tregojnë se burgjet jo vetëm rrallëherë rehabilitojmë, por kanë edhe tendencën për të kriminalizuar individët duke çuar kështu në përsëritjen e veprave penale. Për më tepër, rritja e popullsisë në burgjet e Shqipërisë gjatë dekadës së fundit është një çështje tepër shqetësuese. Sipas sondazhit të vitit 2006 të botuar në Statistikat Penale të Këshillit të Evropës SPACE I, numri i të burgosurve (përfshirë të paraburgosurit) në Shqipëri pothuajse është trefishuar, nga 1467 në vitin 2000 në 3884 në vitin 2006 dhe ka vazhduar të rritet gjatë periudhës 2007-2009. Mbipopullimi është bërë një problem tepër serioz.

Mbipopullimi i burgjeve është problem jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për shumë vende evropiane. Në Evropë gjejmë përcaktime të ndryshme të këtij koncepti, të shkallës së mbipopullimit dhe ndërhyrjeve administrative dhe gjyqësore për të prekur këtë problem. Mbipopullimi në burgje është një fenomen që përcaktohet nga faktorë demografikë, ekonomikë, shoqërorë dhe politikë. Është një çështje që shkakton shumë probleme administrative dhe shpeshherë ndikon në sjelljen, shëndetin dhe moralin e të burgosurve.

Një nga arsyet kryesore për mbipopullimin e burgjeve është mungesa e politikës penale. Kjo vlen edhe për Shqipërinë, ku politika penale përcaktohet nga faktorë të jashtëm, nga tendenca të ndryshme, ndikime për arsye elektorale dhe institucione juridike. Fatkeqësisht, nuk ka asnjë departament apo agjenci përgjegjëse për zhvillimin e politikës penale bashkëkohore në Shqipëri, për bashkërendimin e kërkimeve kriminologjike, hartimin e filozofisë së dënimeve apo parimeve të zhvillimit.

Në Shqipëri janë përdorur edhe amnistia dhe falja si masa për të ulur mbipopullimin. Presidenti i Republikës së Shqipërisë zakonisht fal një numër të vogël të burgosurish dy herë në vit. Amnistitë janë masa efektive të luftës kundër mbipopullimit dhe përdoren në shumë vende. Për fat të keq, ato janë efektive vetëm për një periudhë të shkurtër kohe, pasi praktika ka treguar se shumë prej të burgosurve të liruar kthehen shpejt në burg. Kjo gjë ndodh veçanërisht në vendet ku jo vetëm mungon një sistem mbikëqytjeje apo ky sistem është i dobët, por ku mungon njëkohësisht edhe përkrahja sociale e ofruar nga

OJF-të dhe komuniteti pas lirimit. Përkrahja pas lirimit është thelbësore për gjetjen e strehimit, punës, përshtatjes në jetën jashtë burgut dhe rivendosjes së lidhjeve familjare. Në Shqipëri është e nevojshme të zhvillohet përkujdesja efikase pas daljes nga burgu. Ka nevojë për krijimin e agjencive shtetërore apo private të cilat janë në gjendje të japin mbështetjen dhe ndihmën e duhur për të burgosurit e liruar. Në të njëjtën kohë, nevojitet një politikë penale afatgjatë për të shmangur përdorimin e amnistive si masa afatshkurtra për uljen e popullimit të burgjeve në Shqipëri.

Për të adresuar problemin e mbipopullimit në burgje ka një zgjidhje që është në përputhje me rekomandimet e përvijuara në instrumentet ndërkombëtare dhe ka si qëllim ndryshimin e praktikës së dënimit duke rritur numrin e alternativave të dënimit me burgim. Qëllimi i prezantimit të alternativave të dënimit me burgim është jo vetëm adresimi i problemit të mbipopullimit në burgje apo gjetja e një sistemi efikas ndëshkimi, por përdorimi i alternativave pasqyron një ndryshim thelbësor në qasjen e krimin, të autorëve të veprave penale dhe vendin e tyre në shoqëri duke ndryshuar fokusin e ndëshkimit, nga izolimi në drejtësinë restauruese dhe riintegrimin.

Në vitin 2007, Departamenti i Ligjit dhe i të Drejtave të Njeriut pranë Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, bëri një studim vlerësimi të këtij aspekti të veçantë të sistemit të drejtësisë penale në Shqipëri, pra të aplikimit të alternativave të dënimit me burgim. Vlerësimi u krye në përputhje me objektivat e OSBE-së për të siguruar mbrojtjen e grupeve vulnerabël në shoqëri, për të adresuar çështjet e të drejtave të njeriut në lidhje me kushtet e burgjeve e ambienteve të paraburgimit dhe kohëzgjatjes së paraburgimit si dhe për të forcuar strukturat e shtetit.

Me anë të këtij vlerësimi u kërkua të gjendeshin arsyet përse aplikimi i dënimeve alternative nuk u zbatua në mënyrë efektive në Shqipëri dhe të identifikoheshin mundësitë për përmirësim. Në këtë punim shqyrtohet kuadri ligjor i kësaj fushe, përdorimi i masave dhe sanksioneve alternative në fazën e paraburgimit dhe në atë të dënimit, menaxhimi i alternativave të dënimit me burgim dhe burimeve të siguruar nga shteti për zbatimin e tyre, sikurse edhe partneritetet dhe bashkërendimi ndërmjet agjencive të drejtësisë penale.

Nga studimi u arrit në konkluzionin se në vitin 2007 në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë ekzistonin një sërë alternativash të dënimit me burgim. Ato nuk janë zbatuar për shkak se nuk kishte asnjë agjenci të ngarkuar me mbikëqyrjen e të dënuarve gjatë ekzekutimit të dënimit alternativ. Në vitin 2007 në Shqipëri nuk ekzistonte Shërbimi i Provës. Sipas kësaj analize, u arrit në përfundimin se ishte e nevojshme të krijohej Shërbimi Kombëtar të Provës për të mbikëqyrur të dënuarit në komunitet, në mënyrë që të ulej krimi si dhe kostot dhe pasojat e burgimit të panevojshëm. Po kështu ishte e nevojshme të shkohej drejt dënimit të individualizuar, gjë e cila kërkon që në dhënien e dënimeve alternative në vend të burgimit, gjykatat të kenë më tepër informacion për autorin e veprës penale. Shërbimi i Provës mund të përgatisë për gjykatën raporte të vlerësimit të rrethanave shoqërore të autorit të veprës penale.

Që prej vitit 2007, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, së bashku me organizata të tjera ndërkombëtare, ka punuar me autoritetet shqiptare për të inkurajuar përdorimin më të shpeshtë e më të gjerë të alternativave të dënimit me burgim në vend të burgimit. Ky projekt kishte si qëllim të mbështeste zhvillimin e Shërbimit të Provës në Shqipëri si një institucion i specializuar që siguron zbatim të drejtë dhe efikas të alternativave të dënimit me burgim. Për organizimin dhe funksiononim e Shërbimit të Provës nevojitej kuadri përkatës ligjor. Për të zbatuar mekanizmat për fleksibilitet dhe diskrecion në dhënien e dënimit dhe për të bërë të mundur përdorimin më të gjerë të dispozitave ligjore lidhur me dënimet alternative, u pa e nevojshme të bëheshin ndryshime në Kodin Penal dhe në Kodin e Procedurës Penale.

Më datë 27 nëntor 2008, Kuvendi i Shqipërisë votoi ndryshimet në ligj për të rritur numrin e alternativave të dënimit me burgim në Kodin Penal dhe për të krijuar Shërbimin e Provës. Sipas legjislacionit të miratuar, modeli i Shërbimit të Provës i zgjedhur nga Ministria e Drejtësisë është ai i një shërbimi shtetëror të centralizuar. Sikurse në pjesën më të madhe të vendeve të Evropës Lindore, Shërbimi i Provës në Shqipëri u krijua si organ shtetëror i financuar nga buxheti i shtetit dhe i kontrolluar nga pushteti qendror, me kontroll të ushtruar nga Ministria e Drejtësisë.

Në maj të vitit 2009 u krijua Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës dhe katër zyra rajonale të saj në Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Fier me një numër të përgjithshëm punonjësish prej 50 vetësh. Në muajt shtator-dhjetor 2009, Prezenca në bashkëpunim me EURALIUS-in organizoi seminare trajnuese për të gjithë specialistët e sapoemëruar. Pak përpara emërimit të specialistëve të parë të Shërbimit të Provës nga Ministria e Drejtësisë, OSBE-ja botoi një Manual për punonjësën e Shërbimit të Provës. OSBE gjithashtu dha përkrahjen e saj në hartimin e akteve nënligjore lidhur me standardet për mbikëqyrjen e të dënuarve dhe për bashkëpunimin e Shërbimit të Provës me OJF-të dhe Shërbimin e Ndërmjetësimit.

Më tej, duke qenë se bashkëpunimi i ngushtë dhe komunikimi i mirë ndërmjet Shërbimit të Provës, gjykatave dhe prokurorive konsiderohet i rëndësishëm për një punë efektive dhe efikase të Shërbimit të Provës, janë informuar më tepër se 100 gjyqtarë dhe prokurorë mbi ndryshimet ligjore në lidhje me alternativat e dënimit me burgim dhe rolin e Shërbimit të Provës në zbatimin e tyre. Në tetor-nëntor 2009, Prezenca e OSBE-së në bashkëpunim të ngushtë me Shkollën e Magjistraturës dhe UNICEF Albania, organizoi katër seminare për gjyqtarë dhe prokurorë lidhur me alternativat e dënimit me burgim.. Seminaret u organizuan në kohën e një reforme të rëndësishme të legjislacionit penal. Në ndryshimet që iu bënë Kodit Penal në nëntor të vitit 2008, u parashikuan alternativa të reja të dënimit me burgim dhe roli mbikëqyrës i Shërbimit të Provës në zbatimin e tyre, duke i bërë edhe alternativat ekzistuese më tepër efikase.

Diskutimet gjatë seminareve shpalosën nevojën e gjyqtarëve dhe prokurorëve për të mësuar më tepër rreth aplikimit të dënimeve të reja alternative dhe atyre ekzistuese të ndryshuara dhe rreth detyrave dhe punës së Shërbimit të sapokrijuar të Provës. Shumë

prej pjesëmarrësve shprehën shqetësimin e tyre lidhur me mungesën e qartësisë dhe boshllëqet në legjislacion, të cilat shumë herë krijojnë pasiguri për gjyqtarët dhe prokurorët në marrjen e vendimeve. Për shembull, nga gjyqtarët u ngrit shqetësimi nëse mund t'i kërkonin ata vetë Shërbimit të Provës raporte vlerësimi për të pandehurit. Ka pasur debate rreth pozitës procedurale të Shërbimit të Provës, natyrës së raporteve të përgatitura nga ky Shërbim, mundësisë dhe kohës kur këto raporte mund të paraqiten në gjykatë dhe prokurori, veçanërisht në rastet e gjykimit të shkurtuar. Nga diskutimi doli se legjislacioni nuk është i qartë se cila gjykatë është kompetente (gjykata e shkallës së parë apo ajo e apelit) për t'i dërguar prokurorit vendimin për ekzekutimin e një dënimi alternativ. Si përfundim doli se ligji nuk shprehet qartë për momentin kur prokurori duhet t'i kërkojë Shërbimit të Provës fillimin e mbikëqyrjes së personit të dënuar.

Si rezultat i këtyre shqetësimeve, së bashku me të tjera të ngritura nga pjesëmarrësit, OSBE-ja dhe Shkolla e Magjistraturës panë nevojën e hartimit të një manuali/udhëzuesi për gjyqtarët dhe prokurorët lidhur me aplikimin e alternativave të dënimit me burgim. Në Shqipëri nevojitet një praktikë e njësuar për zbatimin e alternativave të dënimit me burgim për të shmangur sa më tepër që të jetë e mundur pabarazinë në dhënien e dënimit dhe trajtimin e të dënuarve.

Kësisoj, bazuar në materialet dhe diskutimet e seminarit, ky *Manual për aplikimin e alternativave të dënimit me burgim* është përgatitur nga specialistë vendas të cilët kanë marrë pjesë si lektorë trajnues dhe moderatorë gjatë trajnimeve të zhvilluara. Ai paraqet dispozitat e reja të dënimit lidhur me alternativat e dënimit me burgim të përfshira në Kodin Penal në vitin 2008. Çdo alternativë komentohet nga autorët, duke theksuar problemet që kanë dalë ose që mund të dalin gjatë zbatimit të tyre në praktikë me mendime ose rekomandime për interpretimin e tyre bazuar në të kuptuarit e autorëve dhe/ose në konkluzionet e seminareve. Në fillim të manualit paraqitet një vështrim i përgjithshëm i standardeve ndërkombëtare mbi aplikimin e dënimeve dhe masave komunitare me shpresën që gjyqtarët dhe prokurorët do të udhëhiqen nga parimet dhe masat e parashtruara në këto rekomandime në dhënien e dënimit dhe në procesin e tyre të vendimmarrjes.

Në manual paraqiten me hollësi edhe organizimi, funksionimi, kompetencat, objektivat dhe detyrat e Shërbimit të Provës në Shqipëri. Po kështu prezantohet edhe roli dhe pozita procedurale e Shërbimit të Provës në të gjitha fazat e sistemit të drejtësisë penale, çështje kjo e debatuar shumë gjatë seminareve. Një kre i veçantë i dedikohet një prej detyrave më të rëndësishme të Shërbimit të Provës, mbikëqyrjes së të dënuarve me dënime alternative. Ai paraqet një vështrim me vlerë të punës së Shërbimit të Provës në të gjitha fazat e procesit penal. Në të përshkruhet se si veprimtaritë e zhvilluara nga Shërbimi i Provës mund të ndihmojnë të dënuarit të riintegrohen në shoqëri, të ulin barrën në sistem, e të kursejnë përdorimin e panevojshëm të burimeve duke ndihmuar kështu zhvillimin e sistemit të drejtësisë penale dhe pakësimin e problemeve sociale të shkaktuara nga përdorimi i papërshtatshëm dhe i tepruar i burgimit si dënim.

Manuali nuk ka si synim të jetë një komentari i padiskutueshëm i ligjit. Siç u përmend, qëllimi i tij është të informojë gjyqtarët dhe prokurorët për zgjerimin e gamës së dënimeve alternative që janë tani në dispozicion dhe të shërbejë si udhërrëfyes kur ata marrin në konsideratë një dënim alternativ ose kur kanë përpara një raport të Shërbimit të Provës dhe kur legjislacioni nuk është i qartë. Manuali ka gjithashtu si qëllim të përmirësojë komunikimin ndërmjet Shërbimit të Provës, gjykatave dhe prokurorëve, i cili është thelbësor për një ekzekutim efikas të alternativave të dënimit me burgim.

Shpresojmë që manuali të jetë një botim i vlefshëm për gjyqtarët dhe prokurorët në Shqipëri.

1 KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË MBI TË DREJTAT DHE LIRITË THEMELORE TË NJERIUT

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të drejta që lindin bashkë me çdo qenie njerëzore dhe kanë karakter universal. Mbrojtja dhe promo vimi i tyre është detyrimi parësor i çdo shteti dhe qeverie. Ka një sërë arsyesh që na shtyjnë ta nisim analizën e të drejtave të njeriut pikërisht nga Kushtetuta. Kushtetuta është ligji suprem me anë të së cilit deklarohen politikat dhe vlerat më të larta të shtetit shqiptar. Sipas nenit 3 të Kushtetutës: “... *Dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij..., janë baza e këtij shteti, i cila ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë*”. Gjithë sistemi ligjor shqiptar është bazuar në rregullimet dhe parimet kushtetuese. Kjo do të thotë se parimet e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut janë pjesë integrale e të gjithë legjislacionit në përgjithësi dhe e çdo ligji e akti nënligjor në veçanti. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nuk trajton në mënyrë të veçantë çështje që kanë të bëjnë me alternativat e dënimit me burgim, por duke qenë një dokument sa politik aq edhe normativ, në mënyrë telegrafike ajo i ka gjetur vendin e duhur drejtësisë penale dhe standardeve kryesore që lidhen me të.

Pjesa e dytë e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë u kushtohet “*Të drejtave dhe lirive themelore të njeriut*”. Kjo pjesë është e ndarë në katër krerë. “Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik”. Kufizimet e të drejtave dhe lirive kushtetuese mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Asnjëherë kufizimet nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave të njeriut.

1.1 Parimet kryesore të drejtësisë penale sipas Kushtetutës

Për efekt të këtij manuali vlen të ndalemi shkurtimisht në kreun e dytë (pjesa e dytë) të Kushtetutës ku trajtohen liritë dhe të drejtat vetjake, ndër të cilat përmendim se veç të drejtave të tilla si e drejta e jetës; e drejta e informimit; ndalimi i torturës; dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruar; e drejta e ankimit, në këtë pjesë një vend të rëndësishëm zënë disa të drejta dhe garanci procedurale të cilat ndikojnë në pozitën e subjektit në një procedim penal. Kushtetuta paraqet në mënyrë të përmbledhur parimet kryesore të drejtësisë penale dhe garancitë procedurale të të pandehurit. Në këtë kategori përfshihet:

➔ **Prezumimi i pafajësisë** (neni 30): kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë.

➔ **Fuqia prapavepruese** (neni 29): askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një vepër penale, e cila nuk konsiderohej e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj. Nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se sa ai që ka qenë parashikuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës penale; ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese.

➔ **E drejta për një proces të rregullt ligjor**: gjykim të drejtë publik brenda afateve të arsyeshme dhe prej një gjykate të pavarur e të paanshme të caktuar me ligj (neni 42): Liria, dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

➔ **E drejta për integritet moral e fizik** (neni 25): Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose degradues.

➔ **Heqja dhe kufizimi i lirisë** (neni 27): askujt nuk mund t’i hiqet dhe/ose kufizohet liria përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara nga ligji. Në rastin e të miturve, kufizimi i lirisë lidhet me mbikëqyrjen e tij për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent.

➔ **Të drejtat dhe garancitë procedurale penale “kushtetuese”** të personit të cilit i është hequr ose kufizuar liria gjatë procesit penal (nenet 28, 31, 32, 33 dhe 34) të tilla si: njoftimi mbi shkaqet e marrjes së masës dhe ngritjes së akuzës dhe të drejtave ligjore të garantuara; gjykimi brenda një afati të arsyeshëm i të paraburgosurit; dërgimi për gjykim brenda 48 orëve të personit të cilit i është hequr liria sepse ka pasur dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale, ose për të parandaluar kryerjen e një veprë penale, ose largimin e tij pas kryerjes së saj; e drejta e ankimit kundër vendimeve gjyqësore; e drejta e mbrojtjes; e drejta për të pasur një përkthyes; e drejta e bërjes së pyetjeve dëshmitarëve; e drejta për t’u dëgjuar para gjykimit; mosdeklarimi fajtor mbi bazën e mbledhjes së të dhënave në mënyrë të paligjshme; dhe mos dënimi më shumë se një herë për të njëjtën vepër; parimi i gjësë së gjykuar.

Pa dyshim që shtjellimi i çështjeve të tilla më në detaje është detyrë kryesisht e legjislacionit në fushën penale, por nisur nga rëndësia e këtyre garancive dhe të drejtave, vëmë re kujdesin e veçantë të ligjit më të lartë që vepron në territorin e Republikës së Shqipërisë, Kushtetutës. Këto të drejta dhe garanci nuk janë të njohura vetëm për shtetasit shqiptar, por në mënyrë të barabartë edhe për të huajt edhe për personat pa shtetësi.

1.2 Lidhja ndërmjet Kushtetutës dhe standardeve ndërkombëtare

Shqipëria ka ratifikuar një pjesë të konsiderueshme të instrumenteve ndërkombëtare. Kushtetuta ka përcaktuar vendin që zënë instrumentet ndërkombëtare në sistemin e brendshëm si edhe mënyrën e zbatimit të tyre.¹

→ *Vini re:* pavarësisht një tërësie instrumentesh të rëndësishme ndërkombëtare të ratifikuar, vihet re se niveli i njohjes dhe i zbatimit të tyre prej profesionistëve të ligjit dhe të drejtësisë është tepër i kufizuar. Kjo është arsyeja që në këtë manual e vlerësuam me vend një trajtesë të standardeve ndërkombëtare të cilat janë të lidhura me alternativat e dënimit me burgim, rehabilitimin dhe drejtësinë restauruese. E meqë do të ndalemi në të shkurtimisht është me vend të dimë se cili është pozicionimi i tyre në raport me kuadrin ligjor “të brendshëm” që vepron në territorin e Republikës së Shqipërisë si edhe mënyrën e zbatimit të tyre.

Atëherë, çfarë vendi zënë standardet ndërkombëtare dhe cili është statusi i tyre? Këtu vlen të nënvizojmë:

➤ Karakterin e vetëzbatueshëm ose jo të së drejtës ndërkombëtare:

Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar bëhet pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji.

Edhe nëse nuk është bërë përqasja dhe përfshirja e parimeve të së drejtës ndërkombëtare në të drejtën kombëtare, në rrethana të caktuara është e mundshme që një normë që përfshihet në të drejtën ndërkombëtare të ketë fuqi në një rend ligjor të një shteti. I tillë është rasti kur një normë e tillë mundet të përmendet në një çështje gjyqësore, në të cilin është bërë ankesë se shteti apo individët kanë shkelur të drejtat e njeriut. Në gjuhën ligjore kjo quhet “vetëzbatim” apo efekt i drejtpërdrejtë i së drejtës ndërkombëtare.

Shumica e konventave ndërkombëtare nuk janë të vetëzbatueshme. Ato kanë nevojë për dispozita shtesë më të sakta për t’u zbatuar drejtpërdrejtë. Por nëse Kushtetuta parashikon që instrumentet ndërkombëtare të ratifikuara hyjnë dhe bëhen pjesë e sistemit ligjor kombëtar, siç është rasti i vendit tonë, qeveria mund të mos ketë nevojë të bëjë përshtatje të ligjeve kombëtare në mënyrë që detyrimet ndërkombëtare të sjellin pasoja. Në këtë rast gjykatat dhe gjyqtarët vendas mund të zbatojnë këto norma, pavarësisht nëse ato janë përfshirë në dispozita kombëtare.

➤ Epërsinë e marrëveshjeve ndërkombëtare ndaj ligjeve të vendit:

Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të. Normat e nxjerra prej një organizate ndërkombëtare kanë epërsi, në rast konflikti, mbi të drejtën e vendit, kur në marrëveshjen e ratifikuar nga Republika

¹ Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të (neni 5 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë).

e Shqipërisë për pjesëmarrjen në atë organizatë, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i normave të nxjerra prej asaj. Për shkak të këtyre karakteristikave gjyqtarët dhe aktorët e tjerë të sistemit të drejtësisë duhet të zbatojnë këto norma pavarësisht faktit nëse ato janë “kopjuar” ose jo në dispozitat e brendshme.

Ratifikimi i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)² reformoi dhe përqasi gjithë legjislacionin shqiptar me standardet dhe praktikën ligjore të vendeve anëtare të Këshillit të Evropës.

Në nenin 17 të Kushtetutës nënvizohet se edhe kur ka raste të kufizimit të të drejtave dhe lirive të parashikuara nga Kushtetuta, këto kufizime mund të vendosen vetëm me një ligj për interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Gjithashtu këto kufizime duhet të jenë të tilla që të mos cenojnë thelbin e lirive dhe të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara nga KEDNJ. Në këtë mënyrë vetë Kushtetuta jonë i ka dhënë kësaj Konvente një vend tepër të veçantë.

2 STANDARDET NDËRKOMBËTARE LIDHUR ME SANKSIONET DHE MASAT KOMUNITARE

Në këtë pjesë do të gjeni të përshkruara normat ndërkombëtare lidhur me çështjet e drejtësisë penale në përgjithësi dhe alternativave të dënimit me burgim e drejtësinë restauruese në veçanti.

→ *Vini re:* Në këtë manual e kemi të pamundur që këto çështje t’i trajtojmë në mënyrë shteruese. Profesionistët e interesuar mund t’i drejtohen çdo dokumenti dhe të bëjnë një nënvizim të çështjeve nisur nga rasti konkret që kanë në shqyrtim.

Analiza e instrumenteve ndërkombëtare do të bëhet duke i renditur këto norma nisur nga organizata ndërkombëtare e cila e ka hartuar dokumentin normativ. Kështu, trajtimi i standardeve ndërkombëtare do të bëhet në tri nivele të ndryshme: në atë të Kombeve të Bashkuara (KB), të Këshillit të Evropës (KE) dhe të Bashkimit Evropian (BE). Ndonëse Shqipëria nuk është vend anëtar i BE-së, nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit prodhon një sërë detyrimesh në drejtim të njohjes, harmonizimit, koordinimit të kuadrit ligjor dhe të strukturave të sistemit të drejtësisë me këto standarde.³

² Ligji nr. 8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e Konventës evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”.

³ Burimet kryesore të së drejtës komunitare janë traktatet dhe direktivat. Mekanizmi zbatues i së drejtës komunitare është Komisioni Evropian. Gjykata Evropiane e Drejtësisë ka juridiksion mbi rastet e paraqitura nga një shtet anëtar kundër një shteti tjetër anëtar për shkelje të traktatit prej një institucioni të Bashkimit Evropian kundër një shteti dhe prej qytetarëve të veçantë ose organizatave kundër institucioneve të Bashkimit Evropian. Gjykata Evropiane e Drejtësisë nuk arbitron ankesat e sjella nga individë kundër shteteve anëtarë. Megjithatë, një gjykatë kombëtare mund të kërkojë mendim prej Gjykatës Evropiane të Drejtësisë lidhur me zbatimin e drejtë të së drejtës komunitare në një rast të veçantë.

Është për t'u nënvizuar se pavarësisht organizatës ndërkombëtare, parimet dhe standardet e vendosura janë unike, plotësim ose detajim i atyre që gjenden tek instrumenti i miratuar prej organizatës tjetër. Kjo është shumë e rëndësishme sepse tregon se ka një qëndrim unik dhe harmoni të qartë në mbrojtjen e këtyre të drejtave, çka bën që edhe nëse shtetet anëtare (Shqipëria) i ratifikojnë këto instrumente, kjo nuk sjell instalimin e qëndrimeve të ndryshme për të njëjtën. Përkundrazi, përforcim të mëtejshëm të parimit dhe të shtrirjes së tij.

Ndërkohë standardet ndërkombëtare përcaktojnë detyrime të cilat konsistojnë në standardet minimum. Kjo nënkupton se çdo shtet nuk mund të ulë këtë nivel në kuadrin e tij ligjor dhe në zbatimin e së drejtës, por nga ana tjetër është plotësisht i inkurajuar për një standard më të lartë se sa përcaktohet në konventë.

Kur flasim për “të drejtën ndërkombëtare” kryesisht mendojmë për ato norma që vendosin një lloj detyrimi ligjor mbi një shtet. Kuptohet që shteti është përgjegjës për plotësimin dhe zbatimin e rregullave të së drejtës ndërkombëtare për shkak të anëtarësimit në të dhe për shkak të ratifikimit të instrumentit përkatës. Dy ose më shumë shtete mund të bashkohen në një organizatë të nivelit rajonal, ndërkombëtar ose ndërshtetëror dhe të përcaktojnë rregulla të përbashkëta me qëllim rregullimin e marrëdhënies së tyre në bashkësinë rajonale/ndërkombëtare, përfshirë këtu edhe çështje të së drejtës penale. Këto rregulla krijojnë rendin ligjor ndërkombëtar në një fushë të caktuar ose në përgjithësi.

2.1 Konteksti ligjor ndërkombëtar. Karakteri detyrues, rekomandues dhe politik i normave të së drejtës ndërkombëtare

E drejta ndërkombëtare është tërësia e rregullimeve ligjore që zbatohen në një shtet që ka aderuar në të, si edhe ndërmjet shteteve sovrane dhe entiteteve të tjera të tilla të cilave u është dhënë personaliteti ndërkombëtar prej shteteve sovrane.⁴ Ndryshe nga e drejta e brendshme e shtetit që rregullon sjelljet e individëve dhe entiteteve të tjera ligjore brenda juridiksionit të këtij shteti, e drejta ndërkombëtare zbatohet vetëm ndërmjet entiteteve që kanë personalitet ndërkombëtar (kryesisht shtetet sovrane ose organizatat ndërkombëtare dhe ndërshtetërore të tilla si Bashkimi Evropian). Në të përcaktohen standardet bazë që duhet të garantojë çdo shtet përmes legjislacionit dhe mekanizmave të tij.

Në të drejtën ndërkombëtare një vend të veçantë zënë standardet lidhur me të drejtat e njeriut. Këto janë të drejtat që çdo njeri ka dhe gëzon thjesht për shkak të qenies së tij/saj njerëzore.

⁴ Përkufizim i dhënë prej ONP (ILO) (Organizatës Ndërkombëtare të Punës). http://www.ilo.org/actrav/telearn/global/ilo/law/lablaw.htm#Definition_of_international_law

Ato bazohen në parimin themelor se të gjitha qeniet njerëzore kanë një dinjitet njerëzor të trashëguar dhe se ata janë të barabartë në gëzimin e të drejtave dhe lirive të tyre themelore pavarësisht nga seksi, raca, ngjyra, gjuha, origjina kombëtare, moshë, klasa, apo besimet politike ose fetare.⁵ Të drejtat e njeriut janë universale, të zbatueshme njëjloj dhe pa diskriminim për të gjithë njerëzit.

Në konceptin dhe përmbajtjen e të drejtës ndërkombëtare ka shumë lloje normash. Disa norma ndërkombëtare janë më detyruese se sa të tjerat. Në përgjithësi, normat ligjore janë më detyrueset, rekomandimet e ekspertëve janë normat më të dobëta dhe normat politike janë diku aty ndërmjet tyre. Instrumentet ligjërisht të detyrueshme krijojnë të drejtën, e cila mund të kërkojë ndërmarrjen e veprimeve ligjore nëse nuk ka përputhshmëri. Ky është qëndrimi edhe i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përderisa në sistemin normativ që vepron në territorin e Republikës së Shqipërisë, në hierarkinë e normave konventat ndërkombëtare të ratifikuara janë renditura menjëherë pas Kushtetutës. KEDNJ përmban norma ligjore detyruese, të mbikëqyrura prej një gjykate siç është Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) (në Strasburg të Francës) dhe të aplikueshme prej qytetarëve. Instrumentet ligjërisht jo detyruese krijojnë angazhime, gjithashtu edhe detyrime politike ose morale, ose të ashtuquajturat “*instrumente rekomanduese*” (*soft law*)⁶. Ky nuk është aspak ligj në një kuptim strikt të fjalës, por ndërkohë ka një ngacmim dhe pritshmëri të fortë që këto dispozita do të respektohen dhe ndiqen nga shtetet. Kjo është arsyeja që në këtë manual do të ndalemi shkurtimisht edhe në disa prej rekomandimeve të cilat ndonëse janë “*instrumente rekomanduese*” kanë një rëndësi dhe ndikim të veçantë të zbatuesit e së drejtës.

Normat politike janë në përmbajtjen e rekomandimeve, rezolutave ose deklaratave të organizmave të ndryshëm ndërkombëtarë (të tilla si Këshilli i Evropës apo Parlamenti Evropian) dhe nuk kanë fuqi ligjore detyruese. Ndonëse nuk janë ligjërisht të detyrueshme, këto norma mund të jenë shumë të dobishme në ndërtimin e një argumenti të fortë për të kërkuar masa të caktuara apo për të sjellë një rast përpara një gjykatë.

Ndërkohë edhe interpretimet e normave ligjore të detyrueshme dhe dokumenteve politike prej ekspertëve dhe prej organizatave ndërkombëtare nuk janë aspak detyruese, por mund të jenë shumë të dobishme në ndërtimin e një argumenti të fortë për të kërkuar masa të caktuara apo për të sjellë një rast përpara një gjykatë.

Ekziston një korpus i madh i normave të së drejtës ndërkombëtare përfshirë edhe ato në fushën penale. Në ditët e sotme, standardet e të drejtës ndërkombëtare dhe të të drejtave të njeriut ndalojnë qartë në çështje të drejtësisë penale, rehabilitimit dhe drejtësisë restauruese.

⁵ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, nenet 1 dhe 2, miratuar dhe shpallur nga Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 217 A(III), 10 dhjetor 1948. *Karta e Kombeve të Bashkuara*, neni 55 (c), nënshkruar në datën 26 qershor 1945 në San Francisko, hyrë në fuqi në datën 24 tetor 1945.

⁶ *Soft law* (instrumente rekomanduese) në të drejtën ndërkombëtare janë udhëzimet, rekomandimet, deklaratat ose kodet e sjelljes të cilat vendosin standardet e sjelljes por nuk janë të detyrueshme ligjërisht (përkufizim sipas *Black's Law Dictionary*, Eighth Edition, Thomson West) [shënim i redaktorit].

2.2 Burimet e së drejtës ndërkombëtare

Për zbatuesit e të drejtës është shumë e rëndësishme të dinë në parim se cilat janë burimet e së drejtës ndërkombëtare dhe cili është vendi, roli dhe efekti i këtyre burimeve në sistemin e brendshëm të së drejtës.

Këto burime janë forma në të cilat rregullat e të drejtës ndërkombëtare vijnë në jetë, dhe janë të renditura përkatësisht në nenin 38 (1) të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë si më poshtë vijon:

- Konventat ndërkombëtare ose traktatet, të cilat janë të detyrueshme vetëm për palët në to.
- Zakoni ndërkombëtar, i cili përmban rregullën që rrjedh nga praktika e përgjithshme, bazuar mbi perceptimin e një kërkesë ligjore, ndërmjet shteteve në marrëdhëniet ndërkombëtare; këto, me pak përjashtime, janë të detyrueshme për të gjitha shtetet.
- Parimet e përgjithshme të së drejtës, të tilla si “mirëbesimi” i njohur nga kombet e civilizuar, të cilat gjithashtu janë të detyrueshme për të gjitha shtetet.
- Vendimet gjyqësore, për shembull, ato të gjykatave ndërkombëtare dhe shkrimet e akademikëve të shquar; këto ndihmojnë në përcaktimin e ekzistencës së interpretimeve të këtyre normave detyruese.

2.3 Rëndësia e standardeve dhe jurisprudencës për profesionistët

Konstatohet se standardet ndërkombëtare dhe jurisprudenca e GJEDNJ-së është pothuajse e panjohur për gjyqtarët shqiptarë dhe për profesionistët e tjerë në fushën e ligjit dhe të së drejtës, e për rrjedhojë, e pazbatueshme. Me gjithë kujdesin e vazhdueshëm të përkthimit dhe të publikimit të tyre në gjuhën shqipe nga Këshilli i Evropës, Komisioni Evropian, Qendra Evropiane në Tiranë dhe Qendrës së Publikimeve Zyrtare, përdorimi dhe referimi në të është tepër i kufizuar.⁷ Mosnjohja e tyre ka bërë që kohët e fundit gjithnjë e më shumë Shqipëria të “penalizohet” përmes vendimeve të GJEDNJ-së.

Për juristët, avokatët, prokurorët, gjyqtarët, oficerët e policisë gjyqësore, etj., njohja me instrumentet ndërkombëtare është njëra anë e medaljes e cila nuk është e plotë nëse nuk shoqërohet me zbatimin e tyre. Ka disa mënyra të njohura lidhur me mënyrat e përdorimit të kësaj të drejte. Si të tilla mund të renditim:

- zbatimin e drejtpërdrejtë të së drejtës ndërkombëtare. Zbatimi i drejtpërdrejtë i së drejtës ndërkombëtare lejon që të mënjanohet rregulli kombëtar i një vlere më të ulët (shih nenin 122/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë);
- interpretimin e së drejtës kombëtare në dritën e së drejtës ndërkombëtare;
- referimin e së drejtës ndërkombëtare për të mbështetur një zgjidhje të bazuar në të drejtën kombëtare.
- krijimin e një parimi nga një gjykatës (shih vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë dhe natyrën e tyre) i frymëzuar nga e drejta ndërkombëtare.⁸

⁷ Ledi Bianku, *Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut*, Tiranë 2005 dhe *Përmbledhje e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut kundër Shqipërisë*, Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare, nëntor 2009.

⁸ Shih Kristaq Traja, *Natyra juridike e vendimeve të Gjykatës së Lartë*, “Jeta juridike”, revistë juridike shkencore e Shkollës së Magjistraturës, nr.1, Tiranë 2005, fq. 5-26.

2.4 Niveli i Kombeve të Bashkuara

Lidhur me qëndrimin e kësaj organizate, sugjerojmë aktorët e sistemit të drejtësisë të konsultohen me sa është trajtuar në këtë manual por edhe me gjerë me instrumente të tilla si:

- Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (1989), ratifikuar nga Republika e Shqipërisë më 27 shkurt 1992⁹
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ) (1948)
- Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Mitur (Rregullat e Pekinit, 1985)
- Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Rinjve të cilëve u është hequr liria (Rregullat e Havanës, 1990)
- Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Kriminalitetit të të Rinjve (Udhëzimet e Riadit, 1990)
- Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Masat Alternative të Dënimit me Burgim (Rregullat e Tokios, 1990)

2.4.1 Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF)

Shqipëria ka ratifikuar Konventën e OKB-së për të drejtat e fëmijës më 27 shkurt 1992. KDF është një instrument sintetik ku në mënyrë gjithëpërfshirëse gjenden parimet kryesore për mbrojtjen e të drejtave të të miturve në tërësi, por dhe standardet bazë për zbatimin e drejtësisë penale për të miturit.¹⁰ Mesazhi që vjen prej këtyre dokumenteve është se duke qenë ndryshe, pikërisht sepse është një qenie në zhvillim e sipër, fëmija, ka ende kohë e mundësi për t'u rehabilituar, ka nevoja të ndryshme prej të rriturve dhe terapitë që sistemi do të përdorë për "shërimin" e tyre janë dhe duhet të jenë krejt të ndryshme e të veçanta prej atyre të të rriturve. Në këtë rast, prioritet kanë trajtimet ambulatorë dhe jo ato institucionale. Me çdo fëmijë duhet të merresh në mënyrë të individualizuar. Ka një interes të fortë publik për mbrojtjen e veçantë të të miturve, interesi parësor dhe mirëqenia e të miturve janë substanciale.

Çështjet që lidhen me drejtësinë penale për të miturit janë kryesisht ato të përfshira në nenet 37, 39 dhe 40 të KDF-së. Në të vërtetë KDF parashtrohet një listë të tërë të detyrimeve për t'u ndërmarrë nga shtetet palë. Ndonëse neni 40 iu referohet drejtpërdrejtë çështjeve të drejtësisë penale për të miturit, kjo nuk do të thotë se ky nen trajtohet në mënyrë të izoluar. Nenet e KDF-së janë të ndërvarura nga njëra-tjetra dhe të gjitha së bashku formojnë të tërën.

Neni 40 i KDF-së duhet parë i lidhur ngushtë me parimet e përgjithshme të parashtuara lidhur me fëmijët përkatësisht në: nenin 2 të KDF-së ku nënvizohet se të gjitha të drejtat

⁹ Ligji për ratifikimin e Konventës si dhe teksti zyrtar i përkthimit të Konventës nuk është i botuar ende në Fletoren Zyrtare.

¹⁰ *Shih* Arta Mandro, *Drejtësia për të miturit në Shqipëri, një analizë e sistemit të administrimit të drejtësisë për të miturit dhe gjendjes së të miturve në konflikt me ligjin në Shqipëri*, Botim i Qendrës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA) http://www.dci-is.org/db/nl/up_files/Juvenile_Justice_in_Albania_Publishing_version.pdf

u njihen të gjithë fëmijëve *pa asnjë lloj diskriminimi*; nenin 3(1) mbi *interesin më të lartë të fëmijës* si konsiderata parësore; nenin 6 mbi *të drejtën e jetës*; nenin 12 mbi respektimin e të drejtës *për të shprehur* lirisht pikëpamjet, dhe duke i vlerësuar ato në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë. E drejta e fëmijës që të dëgjohet në çdo procedurë gjyqësore ose administrative, qoftë drejtpërdrejt, qoftë nëpërmjet një përfaqësuesi ose të një organi të përshtatshëm, në përputhje me rregullat e procedurës së legjislacionit kombëtar.

Neni 40 mbulon në mënyrë më specifike të drejtat e të gjithë fëmijëve të akuzuar për shkeljen e legjislacionit penal. Prandaj, ai mbulon trajtimin e fëmijës nga momenti kur bëhet një akuzë, përmes hetimit, arrestimit, akuzimit, periudhës para gjyqit, gjykimit dhe dënimit. Neni kërkon që shtetet palë të promovojnë një sistem të ndarë të drejtësisë për të mitur me qëllime specifike pozitive dhe jo dënuese. Ai detajon një listë me garanci minimale për fëmijën (të drejtat e një procesi të rregullt ligjor) dhe kërkon që shtetet palë të vendosin një moshë minimale të përgjegjësisë penale dhe të japin masat për trajtimin e fëmijëve që mund të kenë shkelur ligjin penal, pa iu drejtuar procedurave gjyqësore, si dhe masa alternative ndaj kujdesit institucional.

Neni 39 njeh të drejtën e rehabilitimit dhe të riintegrit social të fëmijëve që janë viktimat të pakujdesisë, shfrytëzimit dhe keqtrajtimit.

Të lidhura ngushtë me zbatimin e nenit 40 të KDF-së janë: neni 16 - e drejta për jetë private; neni 19 – mbrojtja nga çdo lloj dhune; neni 20 – përkujdesja alternative; neni 25 – ekzaminimi periodik i trajtimit; neni 39 - përkujdesja për rehabilitimin e viktimave. Sa më sipër dhe të tjera, japin formatin e disa standardeve kryesore lidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Neni 37 i KDF-së ka në përmbajtjen e tij ndalimin e torturës dhe trajtimit mizor, degradues, çnjerëzor. Nuk duhet të ketë *as dënim kapital as dënim me vdekje, dhe as burgim të përjetshëm për fëmijët; arrestimi, ndalimi ose burgimi* i një fëmije duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe *të përdoret vetëm si një masë e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër*; çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të *trajtohet në mënyrë njerëzore*, duhet të jetë i veçuar nga të rriturit dhe duhet të jetë gjithnjë në kontakt me familjen e tij; fëmijët e privuar nga liria kanë të drejtë për *asistencë juridike* dhe të drejtë për të kundërshtuar privimin e lirisë dhe të merret një *vendim i shpejtë* në lidhje me çështjen, etj.

Neni 40 i KDF-së parashikon disa garanci standarde lidhur me të miturit në drejtësinë penale: *Standardi i trajtimit të veçantë dhe dinjitoz* të çdo fëmije të dyshuar, akuzuar ose për të cilin është thënë se ka kryer shkelje të ligjit penal, me qëllim për të ndihmuar në riintegrimin e tij/saj në shoqëri dhe në mënyrë që ai/ajo të luajë një rol konstruktiv në gjirin e saj (neni 40/1 i KDF-së); *Standardi i pasojave jo prapavepruese të ligjit penal; Garancitë procedurale* për fëmijët në procesin penal të cilat përfshijnë: prezumimin e pafajësisë, të drejtën e informimit; shqyrtimin pa vonesë; trajtimin e fëmijëve në përputhje me mirëqenien e tyre, etj.

Një ndër rekomandimet e Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve për Shqipërinë është pikërisht sigurimi i një zbatimi të plotë të standardeve të përcaktuara në dokumentet e

sipërpërmendura e veçanërisht nenet 37, 40 dhe 39 të KDF-së, si edhe Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Miturit (Rregullat e Pekinit, 1985), Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Kriminalitetit të të Rinjve (Udhëzimet e Riadit, 1990), Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Rinjve të cilëve u është hequr liria (Rregullat e Havanës, 1990), Udhëzimet e Vjenës lidhur me Veprimin për Fëmijët në Sistemin e Drejtësisë Penale dhe duke pasur parasysh ditën e diskutimit të Komitetit në 1995 mbi administrimin e drejtësisë për të rinjtë.¹¹

Në mënyrë të përmbledhur dokumentet e sipërcituar vendosin theksin mbi:

- Mirëqenien e të miturit duke siguruar që çdo reagim ndaj të miturve të dënuar të jetë gjithmonë në përputhje me rrethanat e të dënuarit dhe të veprës penale;
- Nxitjen e riintegrit të të miturit dhe rifitimin e një roli konstruktiv të tij në shoqëri;
- Zhvillimin e alternativave ndaj trajtimit me burgim ose institucional ose të kujdesit (edhe në rastet kur çështja është në gjykim e sipër) për të parandaluar kryerjen dhe përsëritjen e krimin dhe që të dënuarit e mitur të trajtohen sipas të drejtave që gëzojnë;
- Sigurimin që të miturit të trajtohen në komunitetin e tyre sa më shumë të jetë e mundur. Në rastet kur ata mbahen në paraburgim, të miturit duhet të veçohen nga të rriturit, duhet të ndërmerren të gjitha masat dhe mjetet për të siguruar që ata të mbajnë lidhje me familjet e tyre; duhet të merren të gjitha masat për të përgatitur riintegrimin e tyre dhe që kur ata të rikthehen në komunitetin e tyre t'u sigurohet ndihma dhe përkrahja e duhur;
- Domosdoshmërinë e një stafi të kualifikuar dhe të trajnuar në të gjithë pjesët dhe komponentët e sistemit;
- Nënvizojnë se parandalimi i kriminalitetit të të miturit kërkon përpjekje nga tërë shoqëria (familja dhe komuniteti). Mirëqenia e të rinjve që nga fëmijëria e tyre e hershme duhet të jetë në vëmendjen e çdo programi parandalimi. Duhet të hartohen programe dhe shërbime të orientuara drejt komunitetit për të parandaluar kriminalitetin të të miturit.

2.4.1.1 Udhëzimet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara

1. Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Masat Alternative të Dënimit me Burgim (Rregullat e Tokios)

Përmes këtyre rregullave vendosen një sërë parimesh që kanë për qëllim promovimin e masave të tjera të sigurisë përveç arrestit në burg, si edhe disa standarde minimale lidhur me personat të cilët janë në kushtet e vuajtjes së alternativave të dënimit me burgim.

¹¹ Rekomandimet përfundimtare të vëzhgimeve të Komitetit të të Drejtave të Fëmijës. Komiteti i të Drejtave të Fëmijëve, Sesioni 38.

Rregullat nënvizojnë se nuk duhet të ketë diskriminim në zbatimin e tyre për sa i përket moshës (Rregulli 2.2). Këto rregulla promovojnë sanksionet në komunitet dhe ndalen kryesisht në:

- Sistemi i drejtësisë duhet të përmbajë në masë të konsiderueshme sanksionet në komunitet si në fazën para procedimit gjyqësor ashtu edhe pas dhënies së dënimit;
- Shmangia sa më shumë nga dënimi me burgim në rastet e panevojshme;
- Autorët e veprave penale duhet të kenë përgjegjësi ndaj shoqërisë;
- Inkurajimin në rritje të sanksioneve në komunitet dhe shmangien nga proceset formale kur kjo është e mundur (drejtësia restauruese);
- Inkurajimi i përfshirjes së komunitetit në zbatimin e sanksioneve në komunitet.

2. Udhëzimet e Riadit¹²

Këto udhëzime i dedikohen parandalimit të kriminalitetit të të miturit bazuar në këto parime themelore:

1. Parandalimi i kriminalitetit të të miturve është pjesë esenciale e parandalimit të krimit në shoqëri. Të rinjtë mund të zhvillojnë qëndrime jo kriminale nëpërmjet përfshirjes në aktivitete të ligjshme e të dobishme për shoqërinë dhe nëpërmjet mbajtjes së një qëndrimi humanist ndaj shoqërisë dhe këndvështrimit mbi jetën.
2. Parandalimi i suksesshëm i kriminalitetit të të miturve kërkon përpjekje nga e gjithë shoqëria për të siguruar një zhvillim harmonik të adoleshentëve, duke respektuar dhe mbrojtur personalitetin e tyre që në fëmijërinë e hershme.
3. Për interpretimin e këtyre Udhëzimeve duhet ndjekur një orientim që në qendër të vendoset fëmija. Të rinjtë duhet të kenë një rol aktiv dhe partneritet brenda shoqërisë dhe nuk duhen trajtuar thjesht si objekte shoqërizimi ose kontrolli.
4. Në zbatimin e këtyre Udhëzimeve, në përputhje me sistemin ligjor kombëtar, mirëqenia e të rinjve duke filluar që nga fëmijëria e hershme duhet të jetë fokusi i gjithë programeve parandaluese.
5. Duhet të njihet dhe të vlerësohet nevoja dhe rëndësia e politikave të parandalimit progresiv të kriminalitetit dhe të studimit sistematik e përpunimit të masave të nevojshme. Këto duhet të shmangin inkriminimin dhe penalizmin e fëmijës për sjellje që nuk i shkaktojnë dëme të rëndësishme zhvillimit të tij apo nuk dëmtojnë të tjerët. Këto politika dhe masa duhet të përfshijnë:

¹² Adoptuar dhe shpallur nga Asambleja e Përgjithshme me rezolutën 45/112, datë 14 dhjetor 1990.

- Sigurimin e mundësive, në mënyrë të veçantë të atyre edukuese, për të plotësuar nevojat e ndryshueshme të të rinjve dhe të shërbejnë si një kuadër mbështetës për sigurimin e zhvillimit personal të të gjithë të rinjve, veçanërisht të atyre që janë të rrezikuar në mënyrë të dukshme ose ndodhen në një rrezik social dhe kanë nevojë për përkujdesje dhe mbrojtje të veçantë;
- Filozofinë dhe mënyrat e specializuara për parandalimin e kriminalitetit në bazë të ligjeve, proceseve, institucioneve, lehtësive dhe të një rrjeti që siguron shërbime me qëllim të reduktimit të motivimit, nevojës dhe mundësive apo kushteve që inkurajojnë shkeljen e ligjit;
- Ndërhyrjen zyrtare që duhen ndjekur vetëm për/dhe në interesin e përgjithshëm të të rinjve duke u udhëhequr nga drejtësia dhe barazia;
- Ruajtjen e mirëqenies, zhvillimit, të të drejtave dhe interesave të të gjithë të rinjve;
- Faktin që sjelljet ose veprimet e të rinjve që nuk përputhen me normat dhe vlerat e përgjithshme shoqërore janë shpesh pjesë e procesit të rritjes e pjekurisë dhe kanë prirje të zhduken spontanisht në pjesën më të madhe të individëve gjatë kalimit në moshën e rritur;
- Ndërgjegjësimin që në masën më të madhe të opinionit të ekspertëve, përcaktimi i një të riu si “devijant” ose “delinkuent” shpesh i atribuohet zhvillimit të një karakteristike të padëshirueshme të sjelljes së të rinjve.

6. Duhet të zhvillohen shërbime dhe programe të bazuara në komunitet për parandalimin e kriminalitetit të të miturve, në mënyrë të veçantë aty ku ende nuk ka agjenci. Agjencitë formale të kontrollit social zakonisht duhen përdorur vetëm si mjet i fundit.

3. Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Miturit (Rregullat e Pekinit)¹³

Standardet minimale synojnë krijimin e një sistemi të specializuar të drejtësisë për të miturit dhe krijimin e një legjislacioni të posaçëm. Këtu veçojmë:

- përjashtimin e të miturit prej dënimit kapital dhe prej ndëshkimeve trupore;
- trajtimin e paanshëm dhe njerëzor;
- mbajtjen parasysh të mendimeve të të miturit;
- burgimi të jetë mundësia e fundit dhe qëndrimi në burg të jetë sa më i shkurtër që të jetë e mundur;
- heqja e lirisë duhet të aplikohet për raste shumë të rënda;
- dhënia e vendimeve sa më shpejt që të jetë e mundur;
- specializimi i organeve të drejtësisë;
- riintegrimi i të miturit.

¹³ Miratuar nga Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 40/33, datë 29 nëntor 1985.

4. Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Rinjve të cilëve u është hequr liria (Rregullat e Havanës)¹⁴

Në tekstin e këtij dokumenti nënvizohen disa nga parimet për mbrojtjen e të rinjve të cilëve u është hequr liria të tilla si:

- heqja e lirisë është masa e fundit dhe kjo duhet të ketë kohëzgjatje të kufizuar;
- heqja e lirisë për të miturit nuk mund të bëhet pa një motiv juridik objektiv;
- të jetë prioritet krijimi i njësisë të institucioneve të hapura;
- përgatitja e të miturve të cilëve u është hequr liria për rikthimin e lirisë dhe rikthimin në komunitet. Rëndësia e programeve edukuese për ta;
- mbajtja e kontakteve me familjen;
- trajnimi i personelit të institucioneve ose të qendrave.

2.5 Niveli i Këshillit të Evropës

Këshilli i Evropës, si një organizatë ndërqeveritare rajonale, e ka drejtuar vëmendjen e vet që nga themelimi në vitin 1948, në mbrojtjen e të drejtave njerëzore. Sistemi i të drejtave të njeriut në Këshillin e Evropës bazohet në konventa të cilat përcaktojnë detyrime për shtetet anëtare dhe në dokumente jo të detyrueshme, si direktiva, rekomandime dhe rezoluta. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka një peshë të veçantë. Konventa ka efekt të drejtpërdrejtë në ligjet e brendshme dhe si rrjedhojë, gjyqësori në nivel kombëtar mund të mbështetet në dispozitat e Konventës Evropiane.

Konventa Evropiane përmban një mekanizëm zbatimi relativisht të fortë me një Gjykatë të veçantë (Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e vendosur në Strasburg), me një procedurë ankimesh individuale dhe me Këshillin e Ministrave që mbikëqyr nëse shteti ndjek në të vërtetë vendimet e Gjykatës.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në Strasburg nuk është një zëvendësim i gjykatave kombëtare, por është shtesë për sistemet kombëtare që mbron të drejtat njerëzore. Si individët ashtu edhe OJQ-të e shteteve anëtare kanë të drejtë t'u drejtohen Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, por atyre u kërkohet që së pari të ezaurojnë mjetet e brendshme përpara se rasti të mund të konsiderohet si i pranueshëm nga Gjykata. Vendimet përfundimtare të Gjykatës janë ligjërisht të detyrueshme për shtetin në fjalë.

Dokumentet e të drejtave të njeriut në Këshillin e Evropës referojnë përvijimin e parimeve të traktateve të Kombeve të Bashkuara dhe të dokumenteve të tjera. Neni 14 i Konventës Evropiane shpreh se “gëzimi i të drejtave dhe lirive të vendosura nga kjo Konventë duhet të sigurohen pa diskriminim...”. Konventa garanton të drejtën për jetën (neni 2), të drejtën për lirinë dhe sigurinë e personit (neni 5) dhe të drejtën për të qenë i lirë nga tortura, trajtimi çnjerëzor ose degradues (neni 3).

¹⁴ Miratuar nga Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 45 / 113, datë 14 dhjetor 1990.

Në këtë kontekst si me rëndësi rendisim:

- **Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut¹⁵ dhe Protokollet nr. 1; 2; 4; 6; 5; 11;7**
- **Karta Sociale Evropiane (e ndryshuar)¹⁶**
- **Konventa Evropiane “Për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues”¹⁷ dhe Protokollet nr. 1 dhe 2**
- **Konventa Evropiane për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht¹⁸**
- **Konventa e Këshillit të Evropës “Për transferimin e personave të dënuar”¹⁹**
- **Konventa e Këshillit të Evropës “Për ndihmën e ndërsjellë juridike në çështjet penale”²⁰**
- **Konventa e Këshillit të Evropës “Për vlefshmërinë ndërkombëtare të gjykrimeve penale”²¹**
- **Konventa e Këshillit të Evropës “Për transferimin e procedimeve në çështjet penale”²²**

2.5.1 Konventa Evropiane për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht - ligji nr. 8724, datë 26.12.2000²³

Kjo Konventë është ratifikuar nga Republika e Shqipërisë në vitin 2000 dhe përbën një instrument të rëndësishëm në kontekstin e lirimit me kusht si edhe të mbikëqyrjes së personave të dënuar. Nga vetë emërtimi i këtij instrumenti, del i qartë ridimensionimi i drejtësisë penale në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Konventa evidenton rëndësinë që ka rehabilitimi social i autorëve të veprave penale të dënuar apo të liruar me kusht, si edhe nga ana tjetër vënia në ekzekutim e sanksioneve të vendosura nga gjykata në rastin kur kushtet e parashikuara prej saj nuk janë përmbushur.

Përmes këtij instrumenti nënvizohet edhe një herë rëndësia e bashkëpunimit në luftën kundër kriminalitetit si edhe qëllimi unik sa i përket respektimit të vendimeve (përfundimtare dhe të ekzekutueshme) të ndërmarra nga autoritetet gjyqësore qoftë edhe në njërin prej shteteve anëtare dhe kur përmbushja e tyre bëhet në territorin e një shteti tjetër (çështje kjo e diskutuar pothuaj në të gjitha aktivitetet trajnuese të zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës në bashkëpunim me OSBE-në dhe UNICEF Albania).

Konventa është e ndarë në pesë tituj. Në titullin e parë trajton parime themelore dhe termat e referencës si keqbërës dhe dënim. Konventa është e aplikueshme vetëm për vendime të cilat janë përfundimtare dhe të ekzekutueshme, si edhe kur bëhet fjalë për vepra penale

¹⁵ Konventa garanton të drejtën për jetën (neni 2), të drejtën për lirinë dhe sigurinë e personit (neni 5) dhe të drejtën për të qenë i lirë nga tortura, trajtimi çnjerëzor ose degradues (neni 3). KEDNJ ka efekt të drejtpërdrejtë në ligjet e brendshme dhe gjyqësori duhet të mbështetet në dispozitat e Konventës Evropiane dhe jurisprudencën e gjykatës së Strasburgut. Nënshkruar më 13.7.1995, ratifikuar dhe hyrë në fuqi më 2.10.1996 me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996.

¹⁶ Karta Sociale Evropiane (e ndryshuar), nënshkruar më 21.9.1998, hyrë në fuqi më 1.01.2003 me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.

¹⁷ Nënshkruar më 02.10.1996, ratifikuar më 02.10.1996 dhe hyrë në fuqi 1.01.1997 me ligjin nr. 8135, datë 31.7.1996.

¹⁸ Ligji nr. 8724, datë 26.12.2000.

¹⁹ Ligji nr. 8499, datë 10.6.1999.

²⁰ Ligji nr. 8498, datë 10.6.1999.

²¹ Ligji nr. 9068, datë 15.5.2003.

²² Ligji nr. 8497, datë 10.6.1999.

²³ Një listë e konventave të analizuar në këtë manual të cilat janë ratifikuara nga Republika e Shqipërisë gjendet në Shtojcën I të këtij manuali, fq. 156.

të cilat janë të dënueshme nga legjislacioni i të dy shteteve që bashkëpunojnë në këtë drejtim. Në këtë instrument janë renditur të gjitha modalitetet e paraqitjes së kërkesës (prej shtetit që ka dhënë vendimin e dënimit) e të përmbajtjes së saj dhe të reagimit ose mënyrave të pranimit të kësaj kërkesë (prej shtetit në territorin e të cilit “keqbërësi”²⁴ ka vendbanimin e zakonshëm).²⁵ Konventa parashikon gjithashtu detyrimin për refuzim si edhe mundësinë e refuzimit të mbikëqyrjes, ekzekutimit ose zbatimit të plotë. Shteti kërkues dhe shteti i kërkuar informojnë, kur është e nevojshme, reciprokisht njeri-tjetrin për çdo rrethane që ka të bëjë me përmbushjen e masave të mbikëqyrjes në territorin e shtetit të kërkuar ose vënien në ekzekutim të dënimit në këtë shtet.

Në titullin e dytë trajtohen çështje që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen. Shteti kërkues i bën të njohur shtetit zbatues kushtet që i janë caktuar keqbërësit dhe, kur është rasti, masat e mbikëqyrjes, të cilave ky është i detyruar t’u nënshtrohet gjatë periudhës së provës. Në këtë rast, shteti zbatues ka diskrecion që mbikëqyrjen ta përshtatë me legjislacionin e vet duke mos rënduar asnjë masë qoftë në drejtim të llojit qoftë në drejtim të kohëzgjatjes. Konventa i kushton një rëndësi të veçantë rregullave lidhur me komunikimin ndërmjet shteteve në çdo fazë të mbikëqyrjes dhe bërjen transparente të çdo veprimi nga ana e shtetit zbatues, kjo sepse është në kompetencë të shtetit kërkues nëse “keqbërësi” ka përmbushur kushtet.

Titulli III trajton çështje që lidhen me ekzekutimin e dënimeve. Edhe në këtë aspekt, vënia në lëvizje e shtetit zbatues varet nga shteti kërkues. Ekzekutimi behet në përputhje me ligjin e shtetit të kërkuar por duke respektuar sa më shumë të jetë e mundur parimin e analogjisë në kuptimin e llojit dhe masës së dënimit, etj. Shteti zbatues është kompetent në çështje të lirit me kusht.

Autoriteti përgjegjës për zbatimin e kësaj Konvente është Ministria e Drejtësisë. Në raste urgjente, komunikimet mund të transmetohen nëpërmjet Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (INTERPOL).

²⁴ Termi “keqbërës” i referohet të “dënuarit”. Në variantin e përkthyer të Konventës, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 50/2000, është përdorur termi “keqbërës” dhe jemi të detyruar ta përdorim këtë term [shënim i redaktorit].

²⁵ *Shih* nenin 5: “Çdo kërkesë për mbikëqyrje, ekzekutim, etj., formulohet me shkrim. Ajo përmban:

(a) autoritetin që e ka nxjerre; (b) objektin e saj; (c) identitetin e keqbërësit dhe vendbanimin e tij në shtetin e kërkuar. (2). Kërkesa për mbikëqyrje shoqërohet me origjinalin ose me kopjen autentike të vendimit që përmban arsyet që kanë motivuar mbikëqyrjen dhe që specifikon masat që i vihen keqbërësit. Ajo saktëson, me aq sa është e mundur, rrethanat e veprës penale që ka motivuar vendimin e mbikëqyrjes, kohën dhe vendin e kryerjes, cilësimin ligjor të saj, dhe kur kjo është e nevojshme, kohëzgjatjen e sanksionit për ekzekutimin. Ajo jep të gjitha të dhënat për natyrën dhe kohëzgjatjen e masave të mbikëqyrjes që kërkohen për t’u ekzekutuar. Ajo përmban referenca në dispozitat ligjore të zbatueshme dhe të dhënat e nevojshme mbi personalitetin e keqbërësit dhe mbi sjelljen e tij në shtetin kërkues para dhe pas dhënies së vendimit për mbikëqyrje. Kërkesa për ekzekutim shoqërohet me origjinalin ose me një kopje autentike të vendimit që ka konstatuar revokimin e kushtit pezullues të dënimit ose të ekzekutimit të tij, si dhe vendimin e dënimit. Karakteri i ekzekutueshëm i këtyre dy vendimeve vërtetohet në format e parashikuara nga ligji i shtetit që i ka dhënë. Kur vendimi për t’u ekzekutuar zëvendëson një tjetër të mëparshëm pa bërë një paraqitje të fakteve, do t’i bashkëngjitet një kopje autentike e vendimit që përmban këtë paraqitje”.

2.5.2 Konventa e Këshillit të Evropës “Për transferimin e personave të dënuar” - Ligji nr. 8499, datë 10.6.1999

Qëllimi i Konventës është arritja e unitetit dhe zhvillimi i një bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e së drejtës penale; çuarja më tej e qëllimeve të drejtësisë dhe rehabilitimi shoqëror i personave të dënuar; mundësia që të huajve të dënuar me heqje lirie, duke i transferuar në vendet e tyre, t’u jepet mundësia të vuajnë dënimin në shoqërinë e tyre.

Rezervat:

Shqipëria deklaron moszbatimin e procedurave të parashikuara në nenin 9 pika 1 shkronja “a” të kësaj Konvente; Konventa do të shtrihet edhe mbi personat pa shtetësi që kanë banim të përhershëm në Shqipëri, si dhe ata që mbajnë dy shtetësi, kur njëra është shqiptare; rezerva gjuhësore: Republika e Shqipërisë deklaron se i pranon kërkesat për transferimin e personave të dënuar dhe të dokumenteve shoqëruese, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me një kopje të përkthimit në gjuhën shqipe ose në njërën nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Evropës.

Konventa jep kuptimin e një sërë termave që përdoren në të²⁶ dhe ndalet në parimet e përgjithshme të tilla si: parimi i bashkëpunimit; parimi i vlerësimit dhe respektimit të të drejtës së të dënuarit; e drejta reciproke e kërkitimit të transferimit. Veç sa më sipër, në këtë instrument do të gjejmë në mënyrë më të detajuar rregulla të cilat përmbledhtas po i japim në vijim, lidhur me:

Kushtet për transferim (neni 3, shih rezervat e bëra); detyrimin për të dhënë informacion ose detyrimin për respektimin e të drejtës së informimit të të dënuarit; rregullat lidhur me kërkesat dhe përgjigjet ndërmjet shteteve në rastet e transferimit të të dënuarve; detyrimin për paraqitjen e dokumenteve shtese dhe rregullat lidhur me to; rëndësinë për marrjen e pëlqimit të të dënuarit për transferim; efektet e transferimit, reciprokisht, për të dy shtetet qoftë parë në këndvështrimin e atij dënues dhe zbatues; rregullat lidhur me vazhdimin e ekzekutimit të dënimit në kuptimin që shteti zbatues është i detyruar t’i përmbahet natyrës ligjore dhe kohëzgjatjes së dënimit, siç është përcaktuar në shtetin dënues. Këtu përcaktohet se për nga natyra ose kohëzgjatja, ai nuk duhet të rëndojë sanksionin e dhënë nga shteti dënues dhe nuk duhet të kalojë maksimumin e parashikuar nga shteti zbatues.

Gjithashtu në Konventë gjejmë norma lidhur me konvertimin e dënimit ku ndër të tjera gjejmë disa rregulla si: nuk mund të konvertohet një dënim me burgim në një dënim me gjobë; ndalimin e rëndimit të dënimit, etj., (shih nenin 11). Gjithashtu, Konventa parashikon të drejtën e faljes, amnistisë e zëvendësimit si një të drejtë e çdo shteti dhe të rishikimit të vendimit si e drejtë vetëm e shtetit dënues i cili ka të drejtën për të vendosur mbi çdo kërkesë për rishikimin e vendimit. Sa i përket përfundimit të ekzekutimit, shteti zbatues përfundon ekzekutimin e dënimit menjëherë sapo të informohet nga shteti dënues për çdo vendim ose masë si rezultat i të cilit dënimi duhet të përfundojë.

²⁶ Të tilla si “dënim”, “vendim”, “shtet dënues”, “shtet zbatues”.

Gjithashtu, Konventa ka parashikuar rregullime edhe lidhur me kalimin tranzit të personave të transferuar, duke përfshirë në këtë mënyrë një rregullim gjithëpërfshirës.

2.5.3 Konventa e Këshillit të Evropës “Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale” - ligji nr. 8498, datë 10.6.1999

Konventa është e ndarë në tetë tituj. Në këtë manual ne po e trajtojmë këtë Konventë në mënyrë telegrafike sepse rregullimet e saj nuk janë të lidhura me çështje të dënimeve alternative. Qëllimi i përfshirjes në këtë analizë ka të bëjë me dhënien më të plotë të kuadrit të konventave në çështjet penale.

Rezervat:

➤ Kushtet lidhur me sekuestrimet, konfiskimet e sendeve dhe ekzekutimin e kërkesave vetëm sipas nenit 5 pika 1 shkronja “a” dhe “c”. Republika e Shqipërisë do të refuzojë dhënien e ndihmës juridike në fushën penale:

(a) për vepra penale të cilat nuk parashikohen si të tilla nga legjislacioni penal shqiptar në fuqi;

(b) për ato vepra penale të cilat janë në proces hetimi në territorin e Republikës së Shqipërisë ose në një shtet tjetër.

➤ Autoriteti përgjegjës: Ministria e Drejtësisë

➤ Gjuha: përkthim në njërën nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Evropës, në rastet kur për këtë nuk ka një marrëveshje të ndryshme reciprociteti.

Në titullin e parë trajtohen çështje të përgjithshme duke përfshirë këtu angazhimin për bashkëpunimin gjyqësor dhe mos zbatimin e konventës gjatë ekzekutimit të masës së arrestit dhe të dënimeve, si edhe për krimet ushtarake që nuk përbëjnë krime të së drejtës së përgjithshme. Konventa rendit rastet e refuzimit të ndihmës juridike: rastet e krimeve politike ose krime që lidhen me krimet politike ose krimet fiskale; në rastet kur gjykohet se ekzekutimi i kërkesës mund të sjellë cenim të sovranitetit, të sigurisë, të rendit publik ose të interesave esenciale të vendit përkatës.

Në titullin e dytë gjen vend normimi i çështjes së letërporosisë. Në titullin e tretë trajtohet pranimi i akteve procedurale dhe të masave paraprake gjyqësore, dalja e dëshmitarëve, ekspertëve dhe personave që i nënshtrohen procesit penal. Në vijim (titulli 4) trajtohen çështje që kanë të bëjnë me gjendjen gjyqësore; titulli 5 ndalet në procedurën e rasteve të ndihmës juridike; titulli 6 në denoncimet me qëllim procedimi penal.

Protokolli shtesë i Konventës së Këshillit të Evropës për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale (ETS Nr. 99) në nenin 3/b nënvizon se Konventa zbatohet për masën që rregullojnë pezullimin e shpalljes së një dënimi ose ekzekutimin e tij, lirimin me kusht, shtyrjen e fillimit të ekzekutimit të një dënimi ose ndërprerjen e një ekzekutimi të tillë.

2.5.4 Konventa e Këshillit të Evropës “Për vlefshmërinë ndërkombëtare të gjyqimeve penale” - ligji nr. 9068, datë 15.5.2003

Konventa nënvizon nevojën e ndjekjes së një politike penale të përbashkët në nivel evropian me qëllim mbrojtjen e shoqërisë dhe ndërmarrjen e përdorimit të mënyrave moderne dhe efikase në luftën kundër kriminalitetit duke nënvizuar respektimin e dinjitetit njerëzor dhe nxitjen e rehabilitimit të autorëve të veprave penale. Për këtë dokument gjejmë me vend të nënvizojmë:

- Kapitulli I - përmban përkufizimet
- Kapitulli II - trajton ekzekutimin e vendimeve penale evropiane. Është për t'u theksuar se në nenin 5/b, veç të tjerave renditet se “Shteti dënues mund t'i kërkojë një shteti tjetër palë të ekzekutojë sanksionin vetëm nëse është përmbushur “se ekzekutimi i sanksionit në shtetin tjetër duket se do të sjellë shtimin e mundësive për rehabilitimin social të personit të dënuar”. Pasojat e transferimit të ekzekutimit; Dispozita të ndryshme lidhur me tranzitimin, shpenzimet, etj. Po këtu, trajtohet me detaje kërkesa për ekzekutim në aspektin formal dhe substancial dhe të autoritetit përgjegjës; gjykimet në mungesë dhe vendimet penale; masat e përkohshme.
- Kapitulli III - pasojat ndërkombëtare të gjyqimeve penale evropiane

Rezervat:

- Gjuhësore: Republika e Shqipërisë rezervon të drejtën të kërkojë që kërkesat dhe dokumentet mbështetëse të tyre të shoqërohen me përkthimin e tyre në gjuhën shqipe.
- Refuzimet: në nenin 3 të instrumentit të ratifikimit janë renditur një sërë refuzimesh nga ana e shtetit shqiptar.

2.5.5 Konventa e Këshillit të Evropës “Për transferimin e procedimeve në çështjet penale” - ligji nr. 8497, datë 10.6.1999

Qëllimi i kësaj Konvente është arritja e një uniteti më të madh midis anëtarëve si edhe sigurimin, me frymën e një mirëbesimi reciprok të organizimit të procedimeve penale në nivel ndërkombëtar dhe në veçanti, duke shmangur disavantazhet që rezultojnë nga konfliktet e kompetencave si edhe synimin e arritjes së sanksioneve më të drejta dhe më frytdhënëse;

Shteti ynë lidhur me këtë Konventë ka paraqitur rezervat e mëposhtme:

- Rezerva gjuhësore: kërkesat duhet të paraqiten në një nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Evropës, përndryshe nëse paraqiten në një gjuhë tjetër duhet të shoqërohen me një përkthim në gjuhën shqipe ose në një të tjetër nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Evropës.
- Rezerva lidhur me shtetësinë: me “shtetas” do të kuptohen edhe personat

pa shtetësi që kanë banim të përhershëm në Shqipëri, si dhe ata që mbajnë dy shtetësi, ku njëra është shqiptare.

➤ Rezerva lidhur me refuzimin e procedimit në rastet: a) e një ankese për procedime, ne qofte se konsiderohet që vepra penale është thjesht e një natyre fetare; b) e një ankese për procedime për një akt sanksioni për të cilin, sipas ligjit shqiptar, mund të kërkohet të zbatohet vetëm nga një autoritet administrativ; g) për të mos zbatuar nenet 30 dhe 31²⁷ në lidhje me një akt për të cilin sanksionet, sipas ligjit shqiptar ose të ndonjë shteti tjetër të interesuar, mund të kërkohen të zbatohen vetëm nga një autoritet administrativ.

➤ Republika e Shqipërisë refuzon të zbatojë nenet 22 dhe 23 të Konventës.²⁸

Konventa është e organizuar në pesë pjesë. Në pjesën e parë jepen termat e referencës ose përkufizimet e termave të përdorur prej saj. Pjesa e dytë (nenet 2-5) trajton çështje të kompetencës duke nënvizuar se çdo shtet kontraktues në pajtim me një kërkesë për procedime të paraqitura nga një shtet tjetër kontraktues do të ketë kompetencën të ndjekë penalisht sipas ligjit të tij penal çdo vepër penale ndaj së cilës është i zbatueshëm ligji i një shteti tjetër kontraktues. Këtu gjithashtu zënë vend çështje të heqjes dorë nga ndjekja penale ose ndërprerja e procedimit deri në një vendim përfundimtar në shtetin tjetër kontraktues; moskufizimit të kompetencës që i jepet një shteti të kërkuar prej ligjit të tij të brendshëm për sa i përket ndjekjes penale. Pjesa e tretë (nenet 6-29) trajton gjithë problematikën e transferimit të procedimeve të realizuar në pesë seksione.

1. Konventa në seksionin e parë të kësaj pjese ndalet në çështje të tilla si: Kërkesa për procedime dhe vlerësimi i kësaj nga shteti tjetër lidhur me mundësinë ose jo për nisjen e procedimit si edhe mosfillimin e procedimit (shih nenet 7, 10, etj); rastet e kërkesës për fillimin e procedimit të cilat parashikohen nga neni 8 i Konventës;²⁹ pranimin/refuzimin e pjesshëm apo të plotë të kërkesës; rastet e tërheqjes së pranimin të kërkesës nga shteti kërkuar.

2. Në seksionin 2 të kësaj pjese trajtohet çështja e procedurave të transferimit si: rregullat e transmetimit përfshijnë: kërkesa duhet me shkrim; autoriteti përgjegjës është Ministria e Drejtësisë (për të dy shtetet); rastet e përfshirjes së INTERPOL-it; komunikimet duhet të jenë të shpejta; rastet e kërkesës për informacion shtesë; origjinali ose kopje e vërtetuar e dosjes dhe dokumenteve të tjera është e detyrueshme (koha e dorëzimit mund të variojë);

²⁷ Neni 30 parashikon: (1) rastin kur shteti kontraktues vlerëson që të heqë dorë ose të ndërpresë procedimet e tij gjyqësore, ose t'i transferojë ato tek shteti tjetër sepse është në dënim të procedimeve që presin zgjidhje në një shtet tjetër kontraktues kundër te njëjtit person në lidhje me të njëjtën vepër penale dhe (2) detyrimin për të njoftuar sa më parë shtetin tjetër në rast se gjykon për të mos hequr dorë ose pezulluar procedimet e tij gjyqësore. Neni 31 detajon këta dy paragrafë të nenit 30.

²⁸ Shih përmbajtjen e konventës lidhur me këto rezerva.

²⁹ Të tilla si (a) kur personi i dyshuar është banues i përhershëm në shtetin e kërkuar; (b) kur personi i dyshuar është shtetas i shtetit të kërkuar ose nëse ky shtet është shteti i tij i origjinës; (c) kur i dyshuari është duke vuajtur ose duhet të vuajë një dënim që përfshin heqjen e lirisë në shtetin e kërkuar; (d) në qoftë se procedimet për të njëjtën ose vepra penale të tjera janë ndërmarrë kundër personit të dyshuar në shtetin e kërkuar; (e) në qoftë se ai e konsideron që transferimi i procedimeve është i justifikuar në interes të arritjes së të vërtetës dhe në veçanti, që çështjet më të rëndësishme që lidhen me provat janë në shtetin e kërkuar; (f) ai e konsideron që detyrimi për zbatimin e një dënimi që mund të jetë dhënë në shtetin e kërkuar ka të ngjarë që të përmirësojë perspektivat për rehabilitimin shoqëror të personit të dënuar; (g) në qoftë se ai e konsideron që prania e personit të dyshuar nuk mund të sigurohet në seanca e procedimeve në shtetin kërkuar dhe që prania e tij vetjake në këto seanca të procedimeve mund të sigurohet në shtetin e kërkuar; (h) në qoftë se ai e konsideron që ai vetë nuk mund të kërkojë zbatimin e një dënimi që mund të jetë dhënë edhe nëpërmjet kërimit të ekstradimit dhe se shteti i kërkuar mund ta bëjë këtë gjë.

çdo informim duhet të bëhet me shkrim dhe të shoqërohet me dokumentet përkatëse; njoftimi i personit të dyshuar; nuk ka nevojë për njëjtësim të dokumenteve të transmetuara në zbatim të kësaj Konvente; rregullimi i shpenzimeve ndërmjet shteteve.

3. Seksioni 3 trajton pasojat e një kërkesë për procedim gjyqësor në shtetin kërkues të tilla si: rregullat lidhur me ndjekjen penale të personit të dyshuar (mosndjekja penalisht dhe kthimi i kësaj të drejte); pasoja në zgjatjen e afatit prej gjashtë muajsh për procedimet.

4. Seksioni 4 ndalet në pasojat në shtetin e kërkuar në lidhje me një kërkesë për procedimin gjyqësor

5. Seksioni 5 trajton masat e përkohshme në shtetin e kërkuar, të tilla si: rastet e mbajtjes në arrest; konfiskimin e pasurisë. Periudha e ndalimit, e zbatuar në bazë të nenit 27, në asnjë rast nuk do të zgjasë më tepër se 40 ditë.

Konventa ndalet gjithashtu edhe në shumëllojshmërinë e procedimeve penale (pjesa 4, *shih* nenet 30-34) si edhe në rëndësinë që ka kujdesi për respektimin e parimit “jo dy herë për të njëjtën vepër penale” [*ne bis in idem*] që zë vend në pjesën e 5-të të saj. Pjesa e gjashtë i dedikohet dispozita përfundimtare dhe këtu trajtohen çështje të nënshkrimit, ratifikimit dhe miratimit; shtrirja territoriale e Konventës; e drejta e rezervës; raportin me konventat e tjera në fushën penale.

2.5.6 Rekomandime dhe rezoluta të Këshillit të Evropës

Në kuadër të Këshillit të Evropës janë miratuar një sërë aktesh jodetyruese-rekomanduese, si p.sh.:

- ➔ Rekomandimit Nr. R (92) 16 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare në lidhje me Rregullat Evropiane mbi Sanksionet dhe Masat Komunitare;
- ➔ Rekomandimi R (2000) 22 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare në lidhje me Përmirësimin e Zbatimit të Rregullave Evropiane mbi Sanksionet dhe Masat komunitare;
- ➔ Rekomandim R (2003) 22 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare në lidhje me lirin me kusht (parole);
- ➔ Rekomandim R (97)12 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare për personelin i cili merret me zbatimin e dënimeve dhe masave;
- ➔ Rekomandimi Nr. R (82) 16 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare në lidhje me dhënien e lejes së burgosurve;
- ➔ Rekomandimi Nr. R (87) 3 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare në lidhje me Rregullat Evropiane të Burgjeve;
- ➔ Rekomandimit Nr. R (89) 12 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare në lidhje me edukimin në burgje;
- ➔ Rekomandimit Nr. R (92) 17 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare në lidhje me njëtrajtshmërinë (konsistencën) në dënime;
- ➔ Rekomandimit Nr. R (99) 22 në lidhje me Mbipopullimin e Burgjeve dhe Rritjen e Popullsisë në Burgje;
- ➔ Rekomandim R (2008)11 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare

mbi Rregullat Evropiane për të Dënuarit e Mitur që u nënshtrohen sanksioneve dhe masave;

➤ Rezoluta (65) 1 në lidhje me pezullimin e dënimit, vënien në provë dhe alternativave të tjera të dënimit me burgim;

➤ Rezoluta (70) 1 në lidhje me organizimin praktik të masave për mbikëqyrjen dhe kujdesin e mëpasshëm të të dënuarve apo të liruave me kusht;

➤ Rezoluta (76) 2 e Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare në lidhje me trajtimin e të dënuarve me afate të gjata burgimi;

➤ Rezoluta (76) 10 e Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare në lidhje me disa masa alternative ndaj dënimit me burgim.

Për efekt të këtij manuali, po analizojmë disa prej tyre.

Rekomandimi Nr. R (92) 16 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare në lidhje me Rregullat Evropiane mbi Sanksionet dhe Masat Komunitare

Vetë emërtimi i këtij rekomandimi nënkupton se në të do të gjenden dhe renditen një paketë e plotë rregullash lidhur me sanksionet dhe masat komunitare. Ka 90 rregulla dhe një fjalorth me 14 përkufizime lidhur me termat e përdorur. Në këto rregulla të renditura në tri pjesë³⁰ dhe të shtrira në 11 kapituj, gjejmë parimet kryesore lidhur me sanksionet dhe masat në komunitet. Kështu, sipas pjesëve rendisim:

Pjesa e parë: Parime të përgjithshme, përfshin:

- Kuadrin ligjor lidhur me sanksionet dhe masat në komunitet (kapitulli 1, rregulla 3-11);
- Garancitë gjyqësore dhe procedurat e ankimit (kapitulli 2, rregulla 12-19)
- Respektimi i të drejtave themelore të autorit të veprës penale (kapitulli 3, rregulla 20-29)
- Bashkëpunimi dhe dhënia e miratimit nga ana e autorit të veprës penale (kapitulli 4, rregulla 30-36)

Pjesa e dytë: Burimet njerëzore e financiare, përfshin:

- Personeli mbikëqyrës i specializuar (kapitulli 5, rregulla 37-41);
- Çështje lidhur me burimet financiare (kapitulli 6, rregulla 42- 43);
- Përfshirja dhe pjesëmarrja e komunitetit (kapitulli 7, rregulla 44-54);

Pjesa e tretë: Aspektet e menaxhimit të sanksioneve dhe masave

- Kushtet e zbatimit (kapitulli 8, rregulla 55- 69);
- Metodat e punës (kapitulli 9, rregulla 70-75) ;
- Zbatimi i sanksionit ose masës dhe pasojat e mospajtit nga ana e autorit të veprës penale (kapitulli 10, rregulla 76 -88);
- Puna kërkimore dhe vlerësimi i sanksioneve e masave (në interes) të komunitetit (Kapitulli 11, rregulla 89 -90).

³⁰ Pjesa e parë përmban parimet e përgjithshme, pjesa e dytë trajton burimet njerëzore e financiare dhe pjesa e tretë aspektet e menaxhimit të sanksioneve dhe masave.

→ *Vini re:* legjislacioni penal shqiptar i referohet “alternativave të dënimit me burgim” dhe jo “sanksioneve dhe masave në komunitet”. Në shumë vende evropiane këto janë sanksione tërësisht më vete. Ndoshta kapitulli VII i Kodit Penal duhet riparë në këtë këndvështrim. Gjykatat kanë diskrecionin të zgjedhin drejtpërdrejtë sanksionin që është më i përshtatshëm për llojin e veprës dhe karakteristikat e autorit.

Sikurse nënvizuam, një rëndësi të veçantë në këtë dokument merr fjalorthi i termave. Vlerësojmë që për efekt të këtij manuali të veçojmë disa prej tyre.

⇒ *Çfarë kuptojmë me sanksione dhe komunitare?*

“Sanksione dhe masa komunitare” janë sanksionet dhe masat e dhëna nga gjykata përmes një vendimi gjyqësor, të cilat e mbajnë të dënuarin në komunitet, por me disa kufizime të lirisë së tij nëpërmjet vendosjes së kushteve dhe/ose detyrimeve, të cilat zbatohen nga organet e përcaktuara në ligj për këtë qëllim. Me masë do të kuptojmë çdo veprim të ndërmarrë përpara ose në vend të një vendimi mbi një sanksion si dhe mënyrat e hyrjes në fuqi të një vendimi për burgim jashtë institucionit të burgut. Kështu për shembull “*lirimi me kusht*” është një masë përderisa është një mënyrë e zbatimit të dënimit me burg në komunitet.

⇒ *Çfarë kuptojmë me mbikëqyrje?*

“Mbikëqyrja” i referohet si aktiviteteve ndihmëse të kryera në emër të një autoriteti zbatues që kanë si qëllim të mbajnë të dënuarin në shoqëri, ashtu edhe veprimeve që ndërmerren për të siguruar që i dënuari të përmbushë çdo kusht ose detyrim të dhënë. Shërbimi i mbikëqyrjes (Shërbimi i Provës sipas legjislacionit shqiptar) është agjencia që sipas ligjit realizon mbikëqyrjen.

⇒ *Çfarë kuptojmë me kontroll?*

Termi “kontroll” u referohet aktiviteteve që kufizohen me përcaktimin nëse përmbushen detyrimet apo kushtet e vëna, si dhe aktiviteteve për të siguruar përmbushjen duke përdorur procedurat e disponueshme në rast mospërmbushjeje. Nocioni i kontrollit është më i ngushtë se ai i mbikëqyrjes.

⇒ *Çfarë kuptojmë me pjesëmarrje të komunitetit?*

Me këtë do të kuptojmë të gjitha format e ndihmës, me ose pa pagesë, të kryer me orë të plota ose të pjesshme, ose në mënyrë sporadike, që vihen në dispozicion të autoritetit zbatues (Shërbimit të Provës) ose organizatave publike ose private dhe individëve të komunitetit.

Rekomandimi R (2000) 22 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare në lidhje me Përmirësimin e Zbatimit të Rregullave Evropiane mbi Sanksionet dhe Masat komunitare

Siç vihet re, Këshilli i Evropës e ka ndjekur me konsekuencë përmes rekomandimeve të tjera çështjen e zbatimit të rregullave evropiane lidhur me sanksionet dhe masat komunitare duke bërë edhe përmirësimin e tyre. Në përmbajtjen e tij rekomandimi paraqet nevojën për evoluim të disa rregullave (të paraqitura në rekomandimin R (92) 16), siç është rasti i

modifikimit të rregullit 5 lidhur me kohëzgjatjen e masave dhe sanksioneve (Shtojca 1 e rekomandimit) si edhe nevojën për disa “Parime udhëzuese për të arritur një përdorim më efektiv e të gjerë të sanksioneve dhe masave komunitare” duke i parë këto në disa drejtime (Shtojca 2) të tilla si:

- Legjislacioni;
- Praktika e dënimeve;
- Kërkesat bazë për zbatimin efektiv të sanksioneve e masave komunitare;
- Përmirësimi i kredibilitetit të sanksioneve dhe masave komunitare (me autoritetet gjyqësore, agjencitë përkatëse, publikun e gjerë dhe politikëbërësit;
- Krijimi i programeve e ndërhyrjeve efektive;
- Puna kërkimore për sanksionet e masat komunitare.

Rekomandim R (2003) 22 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare në lidhje me lirimin me kusht (parole)

Rekomandimi nënvizon se lirimi me kusht është një nga mënyrat më efektive dhe konstruktive për të parandaluar përsëritjen e veprës penale dhe për të promovuar risistemimin, duke i bërë të burgosurit një integrim të planifikuar, të asistuar dhe të mbikëqyrur në shoqëri. Por efikasiteti varet shumë nga përshtatja me kushtet individuale të të dënuarit dhe në përputhje me parimet e një procesi të rregullt dhe të drejtë ligjor. Në këtë mënyrë në Shtojcën e këtij rekomandimi gjenden parimet nga të cilat duhet të udhëhiqet legjislacioni, politikat dhe praktikat në lidhje me lirimin me kusht.

Lind pyetja: a mund të përfitojnë recidivistët nga lirimi me kusht?

Parimi 4/a i Rekomandimit (2003) 22 në lidhje me lirimin me kusht e parashikon këtë mundësi edhe për recidivistët, ku shprehimisht parashikohet: « Për të zvogëluar pasojat e dëmshme të burgimit dhe për të promovuar risistemimin e të burgosurve nën kushte që kërkojnë të garantojnë sigurinë e komunitetit të jashtëm, ligji duhet të parashikojë lirimin me kusht për të gjithë të burgosurit, përfshirë edhe ata me burgim të përjetshëm”.

Por pavarësisht se çfarë thotë rekomandimi, sipas nenit 64 të Kodit Penal të Shqipërisë, nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje.

Në rekomandim gjejmë:

- Përkufizimin e lirimimit me kusht
- Parimet e përgjithshme lidhur me lirimin me kusht
- Përgatitja për lirim me kusht
- Dhënia e lirimimit me kusht: (Sistem diskrecional i lirimimit dhe Sistemi i lirimimit të detyrueshëm)
- Vendosja e kushteve
- Zbatimi i lirimimit me kusht
- Mosrespektimi i kushteve të vendosura
- Garancitë procedurale
- Metoda për të përmirësuar vendimmarrjen
- Informimi dhe konsultimi për lirimin me kusht
- Studime dhe statistika

Rekomandim R (97)12 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare për personelin i cili merret me zbatimin e dënimeve dhe masave

Pa dyshim që një zbatim i kënaqshëm i sanksioneve dhe masave të komunitetit mund të arrihet vetëm përmes koordinimit ndërinstitucional, bashkëpunimit të niveleve të ndryshme hierarkike dhe një personeli të dedikuar, të kualifikuar dhe me një kompetence të lartë por njëkohësisht bashkëpunues. Pikërisht rekomandimi u kushton kujdes cilësive morale e profesionale që duhet të gëzojë personeli që do të angazhohet në këtë veprimtari. Rekomandimit i janë bashkangjitur dy shtojca të rëndësishme. Në Shtojcën I gjenden parimet për rekrutimin, përzgjedhjen, trajnimin, kushtet e punës dhe lëvizjen e personelit që merret me zbatimin e sanksioneve dhe masave, ndërsa në Shtojcën II jepen udhëzime etike për këtë personel duke përfshirë kërkesa të përgjithshme etike; kërkesa etike në lidhje me të dyshuarit ose të dënuarit. Rekomandimi është një instrument i rëndësishëm për të orientuar mirë dhe drejt institucionet që rekrutojnë dhe trajnojnë personelin e tyre përkatës si edhe hartimin e rregullave etike specifike për këtë kategori.

Rekomandimi nr. R (99) 22 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare në lidhje me Mbipopullimin e Burgjeve dhe Rritjen e Popullsisë në Burgje

Çështja e mbipopullimit të burgjeve vë gjithnjë në dilemë disa standarde të rëndësishme lidhur me respektimin e të drejtave themelore të njeriut dhe sistemin e drejtësisë penale në tërësi. Rekomandimi lidhet ngushtësisht me rekomandimet e tjera të renditura në këtë manual (dhe të tjera) dhe ka për qëllim të nxisë marrjen e masave të duhura gjatë rishqyrtimit të legjislationit dhe praktikave në lidhje me mbipopullimin e burgjeve dhe rritjen e popullsisë së burgjeve, çka nënkupton një kujdes edhe më të madh ndaj sanksioneve dhe masave komunitare.

Rekomandim R (2008)11 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare mbi Rregullat Evropiane për të Dënuarit e Mitur që u nënshtrohen sanksioneve dhe masave

Në këtë rekomandim me interes të veçantë gjejmë të renditura një tërësi rregullash nga më të rëndësishmet që kanë të bëjnë me të miturit të cilët kanë kryer vepra penale dhe ndaj të cilëve jepen sanksione ose masa. Qëllimi i këtij rekomandimi është interesi më i lartë i fëmijës duke garantuar mirëqenien fizike, mendore dhe sociale të tyre.

Rekomandimi është i ndarë në tetë pjesë. Në secilën prej tyre trajtohen institute të rëndësishme që kanë të bëjnë me një trajtim me perspektivë të miturit. Ka rreth 142 rregulla në këtë rekomandim. Është shumë e rëndësishme që profesionistët të lexojnë me kujdes përmbajtjen e këtij rekomandimi i cili në fakt është hartuar në harmoni të plotë me një sërë instrumentesh ndërkombëtarë të OKB dhe të Këshillit të Evropës qoftë të nivelit të atyre të detyrueshme qoftë të nivelit të rekomandimeve.

Të gjitha janë përmendur në pjesën e parë të rekomandimit dhe ndihmojnë në të njëjtën kohë për të identifikuar më lehtësisht instrumentet që trajtojnë këto çështje. Në vijim po bëjmë një paraqitje thjesht skematike të rekomandimit me qëllim që cilido që ka interes të dijë paraprakisht se çfarë do të gjejë në të.

Kështu, sipas pjesëve rendisim:

Pjesa e parë: Parime të përgjithshme, qëllimi dhe përkufizime, përfshin:

➔ Parimet e përgjithshme si: trajtimi me respekt dhe respektimi i të drejtave të njeriut; mosha minimale, interesi më i lartë i fëmijës, anti-diskriminimi, inkurajimi i ndërmjetësimit dhe drejtësisë restauruese, etj.

➔ Qëllimi dhe përkufizimet përfshijnë: përkufizime si i mitur autor i veprës penale, i ri autor i veprës penale, vepër penale, masë dhe sanksion komunitar, heqje lirie, institucion.

Pjesa e dytë: masat dhe sanksionet komunitare, përfshin:

➔ Kuadrin ligjor (rregullat 23.1-30.2);

➔ Kushtet për zbatimin dhe pasojat për mospërbushjen e masave dhe sanksioneve (rregullat 31.1- 48.5);

Pjesa e tretë: Kufizimi i lirisë

➔ Pjesa e përgjithshme përfshin: trajtim gjithëpërfshirës, strukturat institucionale, vendosja në institucione, pranimi në institucione, akomodimi, higjiena, veshmbathja dhe fjetja, ushqimi, shëndeti, regjimi i aktiviteteve, kontaktet me botën e jashtme, liria e mendimit, besimit dhe ndërgjegjes, mbajtja e rregullit (kontrollet, përdorimi i forcës, armëve, veçimi për arsye sigurie dhe mbrojtjeje, disiplinimi dhe ndëshkimi, transferimi ndërmjet institucioneve), përgatitjet për lirim, të huajt e mitur, të miturit e minoriteteve etnike dhe gjuhësore në institucione, të miturit me paaftësi, (rregullat 49.1- 107.2);

➔ Pjesa e posaçme: këtu përmbahen rregulla lidhur me paraburgimin, mbajtjen e polici, etj., përpara dhënies së dënimit; institucionet e mirëqenies; institucionet e shëndetit mendor; (rregullat 108 -119);

Pjesa e katërt: këshillimi dhe ndihma ligjore;

Pjesa e pestë: procedurat e ankimit. Inspektimi dhe monitorimi;

Pjesa e gjashtë: Personeli;

Pjesa e shtatë: Vlerësimi, puna kërkimore, media dhe publiku;

Pjesa e tetë: përditësimi i rregullave.

2.6 Niveli i Bashkimit Evropian

Bashkimi Evropian është një organizëm specifik mbikombëtar me 27 shtete anëtare. Parimet e së drejtës së Bashkimit Evropian, të njohura si e drejta komunitare, kanë ndikim të drejtpërdrejtë në rendin ligjor kombëtar sepse e drejta komunitare në vendet anëtare të Bashkimit Evropian ka përparësi ndaj të drejtës kombëtare. Burimet kryesore të së drejtës komunitare janë traktatet dhe direktivat. Mekanizmi zbatues i së drejtës komunitare është Komisioni Evropian. Bashkimi Evropian lejon individët dhe grupet t'i paraqesin Komisionit Evropian dhe Parlamentit Evropian ankesa dhe peticione rreth shkeljeve specifike të të drejtave të njeriut dhe mospërputhjeve me të drejtën komunitare. Megjithatë, Komisioni Evropian nuk mund të japë vendime detyruese që do të siguronin lehtësimin e dhunimit të të drejtave të një individi. Gjykata Evropiane e Drejtësisë ka juridiksion mbi rastet e paraqitura nga një shtet anëtar kundër një shteti tjetër anëtar për shkelje të traktatit, prej një institucioni të Bashkimit Evropian kundër një shteti dhe prej qytetarëve të veçantë ose organizatave kundër institucioneve të Bashkimit Evropian. Gjykata Evropiane e Drejtësisë nuk arbitron ankesat e sjella nga individë kundër shteteve anëtarë. Megjithatë, një gjykatë kombëtare mund të kërkojë mendim prej Gjykatës Evropiane të Drejtësisë lidhur me zbatimin e drejtë të së drejtës komunitare në një rast të veçantë.

Hyrja në BE nuk është thjeshtë një dëshirë pa detyrime të caktuara. Procesi i integritimit është një rrugë e cila imponon detyrimisht përmbushjen e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe të drejtësisë për të miturit. Megjithëse instrumentet e BE-së janë të lidhura vetëm me shtetet anëtare, vendet evropiane jo-anëtare siç është rasti i vendit tonë, që dëshiron të aplikojnë për anëtarësim duhet të harmonizojnë legjislacionin me standardet e BE-së. Plani Kombëtar për përafrimin e legjislacionit me atë të BE-së dhe zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA)³¹ parashikon një sërë masash legjislative lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut. Kjo do të thotë që një kuadër i tërë ligjor do të jetë në një proces analize për t'u harmonizuar me standardet e BE-së.

Në këtë drejtim, në kuadër të Bashkimit Evropian një instrument i rëndësishëm për t'u përmendur është **Vendimi i Këshillit të BE-së 2008/947/JHA, datë 27 nëntor 2008 “Për zbatimin e parimit të njohjes reciproke të gjykimeve dhe vendimeve për vënien në provë me qëllim mbikëqyrjen e masave për vënien në provë dhe sanksioneve alternative”**³². Teksti tregon rëndësinë dhe konsideratat nisur nga perspektiva e BE-së dhe leximi i tekstit të Vendimit mund të shërbejë për një kuptim më të drejtë të rëndësisë që ka bashkëpunimi dhe ndihma e ndërsjellët juridike në fushën penale, përfshirë edhe çështje të alternativave të dënimit me burgim dhe të rolit të Shërbimit të Provës.

³¹ Nënshkruar më 12 qershor 2006. *Shih*: <http://mie.gov.al/skedaret/1191399573-SAA%20Final%20Shqip%2002.06.06-1.pdf> MSA-ja hyri në fuqi më 1 prill 2009

³² Teksti anglisht i këtij vendimi mund të gjendet në: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2008:337:0102:0122:EN:PDF>, ndërsa një përmbledhje e tij në: http://www.cep-probation.org/default.asp?page_id=65&news_item=159


**KUADRI LIGJOR LIDHUR ME
ALTERNATIVAT E DËNIMIT ME
BURGIM SIPAS KODIT PENAL
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

1 RISITË E ALTERNATIVAVE TË DËNIMIT ME BURGIM PAS NDRYSHIMEVE TË KODIT PENAL ME LIGJIN NR. 10 023, DATË 27.11.2008

Alternativat e dënimit me burgim u përcaktuan për herë të parë në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, të miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, në Kreun VII të Pjesës së Përgjithshme të tij, duke zënë vend jashtë Kreut V që trajton llojet e dënimeve penale, përpara Kreut VIII - shuarja e ndjekjes penale, të dënimeve dhe mosekzekutimi i tyre. Interesant është fakti, që titulli i tyre flet për alternativa të dënimit me burgim dhe jo për alternativa të dënimeve penale, ndonëse në doktrinë njihen si dënime alternative apo masa alternative. Megjithatë, emërtimi i tyre mund të shpjegohet duke analizuar përmbajtjen e secilës prej tyre, në të cilën bie në dukje se kërkesa bazë është që gjykata të ketë caktuar një dënim me burgim ndaj të dënuarit.

Në formën fillestare Kodi Penal parashikonte katër lloje alternativash:

- i. copëzimin e dënimit me burgim (neni 58);
- ii. pezullimin e dënimit me burgim dhe vënia në provë - i njohur si dënimi me kusht (neni 59);
- iii. pezullimi i ekzekutimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik (neni 63); dhe
- iv. lirimi para kohe me kusht (neni 64).

Mirëpo, prezantimi i këtyre alternativave nuk u shoqërua me strukturën ekzekutive të nevojshme për mbikëqyrjen e zbatimit të tyre dhe as me procedurën e detajuar të caktimit e mbikëqyrjes së tyre. Kjo mungesë është përcaktuar si faktori dominues në zbatimin e varfër praktik të këtyre masave alternative në jurisprudencën e gjykatave shqiptare. Për shkak të mungesës së strukturës mbikëqyrëse, masat alternative perceptoheshin të barabarta nga efektet me vendimet e pushimit të procedimit penal apo me vendimet e pafajësisë.

Madje, prej rrethit prej katër lloje masash, alternativat e përdorura kanë qenë pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim e parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal dhe lirimi para kohe me kusht, i parashikuar nga neni 64 i Kodit Penal (e cila në fakt përbën një alternativë të llojit disi të veçantë në drejtim të momentit të caktimit të saj dhe të kushteve që duhen plotësuar).

Nga statistikat zyrtare³³ rezulton se vetëm një apo dy dispozita përdoren nga gjykata në një numër relativisht të madh, ndërsa dispozitat e tjera ose janë zbatuar shumë pak ose aspak. Kështu, në vitin 2003 *pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë* sipas nenit 59 të Kodit Penal është zbatuar nga gjykata për 796 të dënuar; në vitin 2004 për 1300 persona; dhe për vitin 2005 për 1102 persona.

Për ilustrim më të detajuar gjatë vitit 2006, në pesë gjykata të rretheve gjyqësore:³⁴

- aplikimi i alternativave të dënimit me burgim është kërkuar në 44 çështje penale;
- vetëm në 11 prej tyre gjykata ka dhënë vendim për pezullim të ekzekutimit të dënimit me burgim të parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal;
- në 11 prej rasteve, ku është pezulluar ekzekutimi i dënimit, të pandehurit kanë qenë të mitur nën moshën 18 vjeç;
- në 23 raste, në të cilat gjykata ka refuzuar pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, në 4 prej tyre të pandehurit kanë qenë të mitur;
- në asnjë rast të vitit 2006 gjykata nuk ka aplikuar kryesisht (pa kërkesë të palëve) alternativa të dënimit me burgim.

Në këtë terren praktik lindi nevoja për ndryshimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor të alternativave të dënimit me burgim. Me qëllim ndryshimin e këtij realiteti, Ministria e Drejtësisë ndërmori nismën për reformimin e masave alternative, që u finalizua me miratimin dhe hyrjen në fuqi të dy ligjeve:³⁵

(1) ligji nr. 10 023, datë 27.11.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 ‘Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë;’” dhe

(2) ligji nr. 10 024, datë 27.11.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 ‘Për ekzekutimin e vendimeve penale.’”

Nisma ligjore gjente nxitje në programin e qeverisë 2005-2009, të miratuar në Kuvend në datën 08.09.2005 në të cilin parashikohej garantimi i procesit të drejtë ligjor për çdo qytetar, akses të lehtë në drejtësi, drejtësi për të gjithë dhe barazi para ligjit të kujtdo, trajtim njerëzor në paraburgim dhe shndërrimin e dënimit penal në një mundësi ri-educimi.

Në procesin hartues të paketës ligjore për reformimin e alternativave të dënimit me burgim u zhvillua një analizë e përqendruar në:

- kuadrin ligjor ekzistues dhe tendencat bashkëkohore të të drejtës penale;
- prioritetet që kërkohej të adresoheshin;
- thelbin e alternativave të dënimit me burgim;

³³ Sipas vjetarit statistikor të botuar nga Ministria e Drejtësisë, bazuar në ligjin nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, që parashikon se Ministria e Drejtësisë drejton shërbimin e unifikuar statistikor në fushën e drejtësisë.

³⁴ Tiranë, Fier, Vlorë, Shkodër dhe Kavajë.

³⁵ Të shoqëruara edhe me një sërë aktesh nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatimin e këtyre dy ligjeve.

- parimet që përshkojnë alternativat e dënimit me burgim;
- qëllimet dhe objektivat e alternativave të dënimit me burgim.

Nga një vështrim krahasues për ndryshimin e Kodit Penal në vite, rezulton se kreu i alternativave të dënimit me burgim është kreu që ka pasur edhe numrin më të paktë të ndërhyrjeve legjislative ndër vite. Dënimet alternative zënë një vend të rëndësishëm në politikat penale që ndjekin shtetet evropiane dhe më gjerë, dhe posaçërisht vitet e fundit ato kanë gjetur një shtrirje shumë të gjerë edhe në vendet e Evropës Lindore. Mjafton të përmendet fakti se Kosova ka qenë nga vendet e fundit të rajonit që nisi projektin e aplikimit të alternativave të dënimit me burgim në vitin 2003 me ndihmën e një projekti të Këshillit të Evropës.

Nisma për përmirësimin e kuadrit ligjor, që përbënte edhe reformën më të rëndësishme të sistemit penitenciar dhe të drejtësisë penale, adresonte prioritetin qeveritar për funksionimin efektiv të alternativave të dënimit me burgim për arsyet e shumta ekonomike, sociale shoqërore, humane dhe sidomos uljen e fenomenit të mbipopullimit në burgje. Është e vërtetë që dënimi me burgim e mban të dënuarin në kontroll të sigurt, e ndëshkon duke i hequr lirinë, e ruan që ai të mos kryejë vepra të tjera gjatë kohës së qëndrimit në burg dhe e rehabiliton atë gjatë periudhës së burgimit. Megjithatë, studimet dhe analizat tregojnë që pikërisht ky objektivi i fundit i burgimit ‘rehabilitimi’ nuk arrihet prej tij. Statistikat tregojnë që burgjet, jo vetëm që rehabilitojnë rrallë, por nxisin individët në kriminalitet të mëtejshëm, duke krijuar një proces zinxhir lirimi dhe burgimi të të dënuarit. Burgimi shkakton edhe fillimin e ciklit të varfërisë, humbjes së vendeve të punës, dobësimin e mundësive për punësim, dëmtimin e marrëdhënieve ndërpersonale dhe shtimin e rreziqeve shëndetësore për shkak të mbipopullimit në burgje. Madje, mbipopullimi evidentohet edhe si faktor që nxit dhunën në burgje. Zgjidhja e mbipopullimit në burgje realizohet në dy mënyra:

1) nëpërmjet ndërtimit të burgjeve të reja. Kjo zgjidhje nuk konsiderohet më si shumë e përshtatshme sepse ngritja dhe mirëmbajtja e tyre është e kushtueshme dhe rëndon në financat e shtetit, në analizë të fundit rëndon te qytetarët dhe mënyra e përdorimit të taksave të tyre.

2) nëpërmjet reformimit të drejtësisë penale me prezantimin e masave dekriminalizuese për vepra të caktuara, zbutjen e masave të dënimit me burgim për vepra të lehta dhe shtimin e dënimeve alternative.

Megjithatë, dënimet alternative nuk shërbejnë vetëm për të adresuar çështjen e mbipopullimit në burgje. Thelbi i tyre është ndryshimi i fokusit të dënimit nga ndëshkim dhe izolim, në drejtësinë restauruese dhe riintegruese për individin. E drejta penale bashkëkohore është duke u shkëputur gjithnjë e më shumë nga efekti ndëshkues apo shpagues i dënimit, duke u orientuar drejt drejtësisë restauruese. Tashmë edhe nën ndikimin e parimit të humanizmit që përshkon legjislacionin penal, pranohet gjerësisht

se dënimi penal³⁶ ndjek qëllimin e edukimit, risocializimit dhe riintegrit të autorit të veprës penale paralelisht me rehabilitimin/zhdëmtimin e të dëmtuarit prej saj.

Nga analiza e vendimeve gjyqësore penale konstatohet se gjykata, në caktimin e dënimit individual penal në mënyrën e përcaktuar në nenin 47 të Kodit Penal dhe pas vlerësimit të rrethanave të përcaktuara në nenet 48-50 të të njëjtit Kod, evidenton në vendimet e saj dy efekte kryesore:

- efektin e parandalimit të posaçëm, ndaj të dënuarit konkret që synon në edukimin dhe riintegrimin social të tij. Në këtë drejtim, pritishtëritë janë që i dënuari të mos kryejë në të ardhmen vepra të tjera penale, duke vazhduar një jetë normale pas kryerjes së dënimit;
- efektin e parandalimit të përgjithshëm, duke dhënë mesazhin në shoqëri që vepra e kryer nga i dënuari arrin të zbulohet dhe procedohet penalisht nga shteti, si dhe rasti i veprimit të kryer nga autori i veprës penale nuk është një model për t'u ndjekur nga shoqëria.

Kodi Penal parashikon në nenin 1/c³⁷ të tij se ai bazohet në parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, të barazisë para ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, si dhe të humanizmit. Parimet e përgjithshme të së drejtës gjenden në të gjitha sistemet ligjore dhe funksioni i tyre është padyshim të ndihmojë gjetjen e zgjidhjes konkrete aty ku burimet e shkruara të së drejtës nuk mjaftojnë të japin një zgjidhje sepse këto burime të shkruara nuk mund të mbulojnë të gjitha çështjet që shtrohen për zgjidhje përpara gjykatave. Nën këtë analizë, instituti i alternativave të dënimit me burgim përshkohet nga këto parime, të cilat duhet të mbahen gjithnjë në konsideratë nga zbatuesit e ligjit gjatë interpretimit të normave penale.

Dënimet alternative funksionojnë në përputhje të plotë me tendencën e të drejtës penale për nga drejtësia restauruese, si dhe me parimet e legjislacionit penal. Në doktrinë dënimet apo masat alternative i referohen vendimeve penale gjyqësore, me të cilat caktohen alternativa të dënimit me burgim, si dhe programeve rehabilituese të të dënuarve, që synojnë vendosjen e një ekuilibri midis interesave të shoqërisë për t'u mbrojtur nga kriminaliteti dhe nevojave të autorit të veprës penale që është në konflikt me ligjin.

Dënimet/masat alternative përshkohen edhe nga fleksibiliteti (për t'u përshtatur nevojave të një rasti konkret) si në vendimin e caktimit të tyre (nisur nga lloji i detyrimeve që cakton gjykata), ashtu edhe në drejtim të metodës me të cilën realizohen (programet e ofruara nga Shërbimi i Provës).

Qëllimi i masave alternative është të reduktojë dëmin e ardhur nga vepra penale dhe të reduktojë përfshirjen e individit në sistemin e drejtësisë penale. Për realizimin e këtij qëllimi, ato ndjekin këto objektiva:

³⁶ Një përjashtim bën dënimi me burgim të përjetshëm, i cili ndjek qëllimin e izolimit të përjetshëm të të dënuarit për shkak të rrezikshmërisë shoqërore të theksuar të të dënuarit.

³⁷ Dispozitë e shtuar me ligjin nr. 8733, datë 24.01.2001 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal".

Rivendosja e harmonisë, kur është e mundur, midis autorit të veprës penale dhe atyre që janë prekur nga vepra penale;

- ▣ Nxitja e nivelit të përgjegjësisë dhe të llogaridhënies të autorit të veprës penale për veprimet e kryera prej tyre;
- ▣ Mbrojtja e shoqërisë nëpërmjet shmangies së autorit të veprës penale nga sjellja e mëtejshme kriminale;
- ▣ Rritja e përfshirjes së komunitetit, duke përfshirë edhe të dëmtuarit/viktimat në sistemin e drejtësisë penale.

Doktrina pranon që masat alternative paraqesin një dënim të zbutur të autorit të veprës penale dhe njihen edhe me termin “shmangie” (diversion). Ato u drejtohen autorëve të veprave penale që shkelin për herë të parë ligjin, të cilët e pranojnë akuzën dhe kur vepra penale në ngarkim të tyre nuk është shumë e rëndë.

Në përfundim të kësaj analize të vendosur në problematikën e evidentuar në jurisprudencën e gjykatave, u identifikuan dispozitat ligjore të sistemit të drejtësisë penale që kishin nevojë për përmirësim dhe reformim. Në hartimin e ligjit nr. 10023/2008 janë mbajtur parasysh rekomandimet e Këshillit të Europës (R(92) 16, R (97)12 dhe R (2000)22 të cilat fokusohen në fushën e alternativave të dënimit me burgim. Në hartimin e tij kanë dhënë kontribut të rëndësishëm si Misioni EURALIUS, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Këshilli i Europës, Komisioni i Reformës Ligjore, UNICEF Albania, si dhe janë organizuar gjatë dy viteve të fundit një sërë tryezash të rrumbullakëta në lidhje me të.

Me anë të ndryshimeve të prezantuara me ligjin nr. 10 023/2008 tashmë ka pesë alternativa: “gjysmëliria” (neni 58’); “pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë” (neni 59); “qëndrimi në shtëpi” (neni 59/a); “pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik” (neni 63); dhe “lirimi me kusht” (neni 64). Pra, janë prezantuar dy alternativa të reja, njëra prej të cilave zëvendësoi alternativën e copëzimit të dënimit, si dhe është ndryshuar edhe përmbajtja e tri alternativave ekzistuese (pavarësisht faktit se mbeten si alternativa po të njëjtat).

Konkretisht, është ndryshuar neni 58 i Kodit Penal “copëzimi i dënimit me burgim”, duke u shndërruar në “gjysmëliria”. Alternativa e re synon përjasjen me rekomandimet e Këshillit të Evropës dhe traditat më të mira të legjislacioneve penale të vendeve evropiane. Termi “Gjysmë-liria” është huazuar nga legjislacionet evropiane, në të cilat përdoret “semi-liberty”. Një terminologji dhe formulim i përafërt i tij përdoret edhe në Kodin Penal të Kosovës. Neni 58 i riformuluar parashikon ekzekutimin e vendimit gjyqësor gjer në një vit burg me “gjysmëliri”, për shkaqet e renditura në paragrafin e parë të këtij neni. Detyrimet kryhen në kohën e përcaktuar nga gjykata jashtë burgut dhe me mbarimin e tyre në përputhje me vendimin e gjykatës, shtetasi i dënuar kthehet në burg.

Ndryshimet e prezantuara në nenin 59 të Kodit Penal e kanë bazën në përvojën e marrë në legjislacionet penale të vendeve të tjera si kodet penale në Greqi, Itali, Gjermani, Spanjë, Britaninë e Madhe të cilët përcaktojnë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim deri në 5 vjet. Ky nen është riformuluar në mënyrë më të qartë mbi bazën e dispozitave të kodeve penale të vendeve të sipërcituara. E njëjta bazë ka shërbyer edhe për ndryshimin e rregullit të kryerjes së veprës penale po aq të rëndë apo më të rëndë gjatë periudhës së provës. Të gjitha legjislacionet penale të studiuara e konsiderojnë si kusht moskryerjen e ndonjë veprë penale tjetër gjatë periudhës së provës, pavarësisht nga rëndësia e saj (qoftë edhe një vepër të kryer nga pakujdesia dhe me masë dënimi më të vogël). Mbi bazën e praktikës së gjetur në kodet penale të vendeve të tjera si dhe praktikës e formulimit aktual të Kodit Penal është bërë gjithashtu edhe një renditje më e zgjeruar e shkaqeve se kur gjykata mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë të personit të dënuar. Për sa kohë është një urdhërim i dhënë nga gjykata me vendim gjyqësor, shkelja e tij sjell pasoja mbi personin e dënuar posaçërisht, zëvendësimin, zgjatjen e afatit të provës brenda afatit të përgjithshëm ose revokimin e tij. Ky nen realizon dy qëllime të rëndësishme: përgjegjësinë e Shërbimit të Provës në këtë drejtim dhe detyrimin e personit të dënuar për të mbajtur kontakte me të.

Mbi bazën e legjislacioneve penale më të mira dhe rekomandimeve të dhëna nga Këshilli i Evropës është prezantuar edhe një alternativë e re e dënimit me burgim. Neni 59/a i Kodit Penal parashikon alternativën e emërtuar “*qëndrimi në shtëpi*”. Kjo dispozitë në zbatimin e saj është përjashtimore dhe personat e ndryshëm mund të përfitojnë zbatimin e saj vetëm në rastet kur të dënuarit janë gra shtatzëna ose nëna me fëmijë nën moshën 10 vjeç që jetojnë me të, me kushte të rënda shëndetësore që kërkojnë kujdes të vazhdueshëm nga shërbimi shëndetësor jashtë burgut, mbi 60 vjeç dhe që janë të paaftë nga ana shëndetësore apo të rinj nën moshën 21 vjeç me nevoja të dokumentuara shëndetësore studimore, të punës apo përgjegjësiive familjare. Kur këto kushte nuk ekzistojnë më dhe në rast se ndodhin shkelje të tyre apo moszbatim të përcaktuar nga shërbimi i provës, dispozita parashikon edhe pasojat përkatëse që rrjedhin prej këtyre shkeljeve.

Ndryshimet në nenet 60 dhe 61 të Kodit Penal kanë të bëjnë me aspekte teknike të formulimeve të dispozitave aktuale. Ato përshkohen nga ideja për një kuptim më të mirë dhe zbatim më të lehtë nga prakticienët e së drejtës. Një prej parimeve të procesit legjislativ është edhe përdorimi i gjuhës së përshtatshme për të përputhur qëllimin e ligjvënësit me atë të zbatuesit të ligjit si një aspekt i rëndësishëm që garanton respektimin e sigurisë juridike.

Në nenin neni 64 të Kodit Penal synimi ka qenë rregullimi teknik i një prej instituteve më të njohura të drejtësisë penale “*Parole*”, e cila në kuptimin e saj të vërtetë konsiderohet si “*lirim me kusht*”.

Lidhur me pritshmëritë e ligjvënësit për zbatimin në praktikë të alternativave të reformuara mund të thuhet kjo nismë përpiket të përmirësojë dispozitat përkatëse të kreut të dënimeve alternative duke i përqsaur ato me praktikat më të mira të kodeve penale të tjera dhe duke iu përshtatur realitetit shqiptar njëkohësisht.

Ndërsa gjatë diskutimit të tij në Komisionet Parlamentare janë vënë në dukje se ndryshimet e Kodit Penal kanë të bëjnë me dënimet alternative ndaj dënimit me burgim, një nga reformat më të mëdha që u referohen standardeve të trajtimit të të dënuarve me burgim. Kjo reformë nuk është vetëm një kërkesë e Këshillit të Evropës, Komitetit kundër Torturës, por është nevojë e domosdoshme dhe e vonuar tashmë. Janë tri pika në të cilat kjo reformë ligjore referon. E para është komponenti social, pra, si do të trajtohen dhe konsiderohen të dënuarit – ata nuk do të jenë më si kategoria që duhen të ndëshkohen nga pjesa tjetër e shoqërisë dhe shoqëria duhet t’i risocializojë. Komponenti i dytë është ai ligjor – ndryshimet bëjnë të mundur që të gjitha këto ndryshime që ofrojnë alternativa të jenë të aplikueshme nga sistemi gjyqësor, prokuroria, si dhe nga ata që do merren me ekzekutimin. Komponenti i tretë është një komponent praktik, financiar. Nga të gjitha përllogaritjet, kostoja që të dënuarit mbahen në burgje shkon deri në 3 000 lekë në ditë. Vendosja e këtyre alternativave do të sjellë uljen e kostos, por dhe përfitime të mëdha shoqërore. Gjithashtu këto ndryshime sjellin lehtësi në aplikimin e ligjit, ulin marzhin e diskrecionit që mund të ketë sistemi i drejtësisë, japin siguri juridike, parashikueshmëri juridike. Këto ndryshime ecin paralel me ndryshimet në ligjin për ekzekutimin e vendimeve penale, krijohet Shërbimi i Provës, si institucion me përgjegjësi të plotë në shërbim të pushtetit gjyqësor.

Këto dispozita kërkojnë që Kodin Penal ta bëjnë të aplikueshëm në të gjitha ato pjesë ku ka dështuar dhe kjo pjesë është aplikimi i dënimeve alternative. Shqipëria ka mbajtur qëndrim drastik, ka mbajtur njerëz në burg me afate më të gjata seç do t’i takonin, ka refuzuar të aplikojë dispozitat që lehtësonin dënimin penal sepse shteti nuk ka funksionuar sipas qëllimeve që i ka vendosur vetes. Nuk ka pasur Shërbimin e Provës, instrument i rëndësishëm për zbatimin e dispozitave të Kodit. Me anë të këtyre ndryshimeve synohet të saktësohen dispozitat që kanë të bëjnë me dënimet alternative dhe këto ndryshime në Kodin Penal shoqërohen me ngritjen e strukturës që do të zbatojë këto dispozita.

Miratimi i paketës ligjore mbi alternativat e dënimeve alternative dhe Shërbimin e Provës përbën një zhvillim cilësor të legjisllacionit penal shqiptar dhe një hap të rëndësishëm në drejtim të përafrimit të legjisllacionit të brendshëm me atë ndërkombëtar. Megjithatë, tanimë i përket sistemit të drejtësisë (mbrojtësve, organit të prokurorisë dhe gjykatave) të luajnë rolin e rëndësishëm në zbatimin e këtyre zhvillimeve ligjore, duke i dhënë jetë atyre.

2 KUPTIMI I ALTERNATIVAVE TË DËNIMIT ME BURGIM. RËNDËSIA E ZBATIMIT TË TYRE NË PRAKTIKË DHE PROBLEMET E HASURA GJATË ZBATIMIT

Në kreun VII, nenet 58, 59, 59/a, 60, 61, 62, 63, 64 dhe 65 të Kodit Penal parashikohen “*Alternativat e dënimit me burgim*”. Këto alternativa janë njohur në Kodin Penal me miratimin e kodit të ri në vitin 1995. Nisur nga vetë fjalët e përdorura nga ligji, të krijohet përshtypja se kemi të bëjmë me lloje të reja dënimesh. Por kjo përshtypje është e gabuar.

Rastet që parashikojnë nenet e sipërpërmendura nuk janë llojet të reja dënimesh.³⁸ Në këto raste, dënimi është vetëm një: burgimi. Nenet 59 – 65 të Kodit Penal parashikojnë format apo mënyrat e veçanta të vuajtjes së këtij dënimi.

Këto forma alternative të vuajtjes së dënimit synojnë :

- *Shmangien e pasojave të dëmshme e të pariparueshme jo vetëm për të dënuarin por, edhe për komunitetin ku ai jeton;*
- *Çlirimin e të dënuarit nga vuajtja e dënimit nëse vërtetohen rrethana të caktuara, shumica e të cilave janë të parashikuara nga ligji;*
- *Edukimin dhe rehabilitimin e të dënuarit;*
- *Parandalimin e humbjes së cilësive edukuese dhe parandaluese të dënimit;*
- *Edukimin e shoqërisë;*
- *Parandalimin e kriminalitetit.*

Format e alternativave me burgim janë të përcaktuara shprehimisht nga ligji por nuk janë detyruese për gjykatën. Gjithmonë është gjykata organi që ka kompetencën ekskluzive për të vendosur nëse, i dënuari duhet të vuajë dënimin me burgim jo në formën e tij klasike (izolimi nga shoqëria) por, në një formë tjetër. Sipas Kodit Penal format alternative të vuajtjes së dënimit me burgim janë :

2.1 Gjysmëliria (Neni 58 i Kodit Penal)

Gjysmëliria është forma e parë e alternativave të dënimit me burgim e parashikuar në nenin 58 të Kodit Penal, me ligjin e ri nr. 10 023, datë 27.11.2008. Në këtë nen parashikohet se :

“Për dënimin deri në një vit burgim, gjykata, për shkak të detyrimeve të personit të dënuar për punën, arsimin, kualifikimin ose aftësimin profesional, përgjegjësitë thelbësore familjare apo për nevojën për trajtim ose rehabilitim mjekësor, mund të vendosë ekzekutimin e vendimit me burgim me gjysmëliri.

Personi i dënuar, që vuan dënimin me gjysmëliri, është i detyruar të kthehet në burg, pasi të ketë kryer detyrimet jashtë burgut, brenda periudhës kohore të përcaktuar nga gjykata.

Kur personi i dënuar nuk përmbush detyrimet, sipas këtij neni, zbatohet neni 62 i këtij Kodi”.

Nisur nga interpretimi i kësaj dispozite arrijmë në përfundimin se kjo formë e vuajtjes së dënimit me burgim aplikohet nga gjykata kur plotësohen dy kushte:

Së pari : Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor gjykata çmon se i pandehuri duhet të dënohet jo më shumë se një vit burgim;

³⁸ Llojet e dënimeve janë të përcaktuara në nenin 29 të Kodit Penal dhe nuk ka të tjerë.

Së dyti : Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezulton se ekziston një nga rrethanat në vijim: *i pandehuri ka detyrime për punën, arsimin, kualifikimin ose aftësimin profesional, përgjegjësitë thelbësore familjare, ose për trajtim apo rehabilitim mjekësor.*

Këto dy kushte duhet të ekzistojnë në të njëjtën kohë pra, janë kumulative, për ndryshe gjykata nuk mund të aplikojë nenin 58 të Kodit Penal. Sa i përket kushtit të dytë – rrethanë e posaçme, sipas formulimit të nenit 58 të Kodit Penal rezulton se rrethanat e posaçme përfshijnë tre drejtime kryesore:

a detyrimin e të pandehurit ndaj punës, arsimit, kualifikimit ose aftësimin profesional. Kjo nënkupton faktin që i pandehuri të jetë i angazhuar në një punë, e cila ka rëndësi të madhe jo vetëm për të, por edhe për komunitetin ku ai jeton. P.sh., nëse i pandehuri është mjek në një zonë ku prania e tij është e domosdoshme për të siguruar asistencën e nevojshme mjekësore ndaj komunitetit, apo është specialist i një fushe të caktuar me interes të veçantë për shoqërinë.

b përgjegjësitë thelbësore familjare të të pandehurit. Kjo rrethanë nënkupton faktin se i pandehuri ka nën kujdesin e tij fëmijë të mitur; ka nën kujdesin dhe përgjegjësinë e tij prindërit e tij apo persona të tjerë të paaftë për të punuar; kur i pandehuri është i vetmi person që siguron të ardhurat për jetesë të familjes së tij, apo kur pesha e të ardhurave që sigurohet nga puna e tij është vendimtare për jetesën e familjes së tij.

c nevojën e të pandehurit për trajtim apo rehabilitim mjekësor. Kjo nënkupton faktin se i pandehuri vuan nga një sëmundje e cila nuk mund të kurohet në kushtet e burgut, apo kushtet e burgimit e vështirësojnë së tepërmi mjekimin e saj; kur i pandehuri është nën një terapi të vazhdueshme kundër varësisë ndaj alkoolit ose lëndëve narkotike dhe izolimi i tij në burg do të passillte ndërprerjen e kësaj terapie dhe për pasojë përkeqësimin e shëndetit të të pandehurit.

Gjykata në vendimin e saj, pas identifikimit të rrethanës së posaçme, cakton kohën në të cilën i dënuari përmbush detyrimin, përgjegjësinë familjare apo trajtimin rehabilitues në liri, si dhe kohën në të cilën duhet të kthehet në institucionin e ekzekutimit të dënimit penal. Periudha kohore brenda së cilës do të përmbushet ky detyrim, përgjegjësi apo trajtim mjekësor do të shqyrtohet nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rëndësisë dhe kompleksitetit të veprimeve që realizojnë këtë detyrim, përgjegjësi apo trajtim mjekësor. Sipas nenit 58 të Kodit Penal nuk parashikohet një periudhë të përcaktuar me saktësi dhe për pasojë, gjyqtari mund të vendosë lirisht për afatin e përmbushjes së detyrimit, përgjegjësisë apo trajtimit mjekësor, i cili mund të jetë nga disa orë deri në disa ditë.

Mbikëqyrja e ekzekutimit të këtij dënimi, realizohet nga Shërbimi i Provës, në përputhje me nenet 35, 36 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 25.03.2009. Për këtë arsye, ky shërbim harton dhe zhvillon një program individual për ekzekutimin e dënimit me “gjysmëliri”.

2.2. Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë (Neni 59 i Kodit Penal)

I njohur ndryshe si “*dënimi me kusht*”, sipas nenit 59 të Kodit Penal parashikohet se:

“Për shkak të rrezikshmërisë së paktë të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burg deri në pesë vjet, mund të urdhërojë që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale.

Gjykata urdhëron që i dënuari të përmbushë një apo më shumë detyrime, të parashikuara në nenin 60 të këtij Kodi.

Afati i provës është 18 muaj deri në 5 vjet.

Nëse i dënuari nuk mban kontakte me shërbimin e provës apo nuk përmbush detyrimet e parashikuara në nenin 60, siç është urdhëruar nga gjykata, gjykata vendos zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër, zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes, brenda periudhës së provës, ose revokimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit”.

Kjo formë alternative e vuajtjes së dënimit me burgim aplikohet nga gjykata kur plotësohen njëkohësisht dy kushte:

Së pari: Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor gjykata çmon se i pandehuri duhet të dënohet jo më shumë se pesë vjet burgim;

Së dyti: Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezulton se ekziston një nga rrethanat në vijim :

- *I pandehuri paraqet rrezikshmëri të pakët shoqërore;*
- *I pandehuri është i mitur apo i moshuar;*
- *I pandehuri ka kushte mendore apo shëndetësore të veçanta;*
- *I pandehuri ka detyrime për punën, arsimimin, kualifikimin ose aftësimin profesional;*
- *I pandehuri ka përgjegjësi thelbësore për familje;*
- *I pandehuri e ka kryer veprën në kushtet e disa rrethanave lehtësuese;*
- *I pandehuri ka patur një sjellje shumë të mirë pas kryerjes së veprës penale.*

Sa i përket kushtit të dytë – rrethanë e posaçme, edhe sipas formulimit të nenit 59 të Kodit Penal (sikundër parashikohet edhe në nenin 58 të Kodit Penal) rezulton se rrethanat e posaçme përfshijnë tre drejtime kryesore :

1. *detyrimin e të dënuarit ndaj punës, arsimit, kualifikimit ose aftësimin profesional;*
2. *përgjegjësitë thelbësore familjare të të dënuarit;*
3. *nevojën e të dënuarit për trajtim apo rehabilitim mjekësor.*

Nga formulimi i nenit 59 të Kodit Penal rezulton se këto rrethana janë të pavarura nga njëra-tjetra dhe nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën.

Për të aplikuar në mënyrë sa më të drejtë nenin 59 të Kodit Penal, gjykata gjatë gjykimit ka për detyrë të identifikojë rrethanën e posaçme që ekziston në jetën e përditshme të të pandehurit. Nga një interpretim i dispozitave të ndryshuara në Kodin Penal, të cilat bëjnë fjalë për alternativat e dënimit me burgim në harmoni me dispozitat e ligjit nr. 10 024, datë 27.11.2008 rezulton se gjykata në përmbushjen e detyrës së saj për identifikimin e rrethanave të posaçme e ka të domosdoshëm mendimin e specializuar të Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës. Për rrjedhojë, nëse gjatë gjykimit i pandehuri apo prokurori paraqet një kërkesë për aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal, gjykata është e detyruar (nëse një raport i tillë nuk është kryer nga Shërbimi i Provës gjatë fazës së hetimeve paraprake) që të thërrasë në gjykim një përfaqësues të Shërbimit të Provës dhe t'i caktojë si detyrë kryerjen e raportit përkatës, i cili do të identifikojë në mënyrë të specializuar rrethanën e posaçme, të pretenduar nga palët. Gjithashtu, në këtë raport Shërbimi i Provës i sugjeron gjykatës aplikimin e një detyrimi të parashikuar nga neni 60 i Kodit Penal. Ky detyrim duhet të jetë i përshtatshëm me një nga rrethanat e veçanta si më poshtë vijon:

- *Rrezikshmërinë e të pandehurit;*
- *Moshën e të pandehurit;*
- *Kushtet shëndetësore apo mendore të të pandehurit;*
- *Mënyrën e jetesës së të pandehurit dhe familjes së tij;*
- *Nevojën konkrete për rehabilitimin shëndetësor apo trajtimin mjekësor të të pandehurit;*
- *Nevojën apo detyrimin e të pandehurit për t'u arsimuar;*
- *Detyrimet apo përgjegjësitë thelbësore të të pandehurit kundrejt familjes apo personave në ngarkim;*
- *Detyrimet thelbësore të të pandehurit kundrejt punës.*

Ky veprim i gjykatës mund të kryhet në çdo fazë të shqyrtimit gjyqësor, qoftë edhe pas paraqitjes së pretendimeve të fundit nga palët. Një veprim i tillë është në përputhje të plotë me nenet 378/5 dhe 367 të Kodit të Procedurës Penale.

Kur aplikohet dënimi me kusht, gjykata mund të urdhërojë që i dënuari të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës dhe të vihet në provë për një periudhë nga 18 muaj deri në 5 vjet. Kushti i vënies në provë është që i dënuari të mos kryejë asnjë vepër tjetër penale gjatë kohës së provës. Nëse gjykata çmon se i dënuari duhet të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës, atëherë ajo është e detyruar të urdhërojë të dënuarin të plotësojë një nga detyrimet e përcaktuara në nenin 60 të Kodit Penal.

Nëse këto detyrime nuk plotësohen apo nëse shkelet kushti, gjykata urdhëron sipas rastit:

a **zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër alternativ më të rëndë** i cili, nuk duhet të jetë revokim i dënimit të parë. Kjo do të thotë që i dënuari të mos e kryejë dënimin me burgim në kushtet e izolimit nga shoqëria, në formën klasike burgim. Nisur nga përmbajtja e dispozitave të Kodit Penal, me dënim më të rëndë do të kuptojmë shtimin e detyrimeve ndaj të dënuarit. Pra, nëse ndaj një të dënuari është vendosur

si detyrim p.sh.: mosshoqërimi me persona të dënuar apo bashkëpunëtorë në veprën penale, në varësi të kushteve dhe rrethanave konkrete në të cilat është vënë në zbatim ky dënim, gjykata mund të urdhërojë, p.sh.: edhe detyrimin e të dënuarit për të qëndruar në shtëpinë e tij gjatë natës, apo/dhe detyrimin e të pandehurit të mos frekuentojë lokale ku shërbehen pije alkoolike, etj.... Sipas nenit 59 të Kodit Penal dënimi i dhënë mund të zëvendësohet me një tjetër më të rëndë nëse:

- *i dënuari gjatë kohës së provës kryen një vepër penale;*
- *i pandehuri gjatë kohës së provës nuk mban kontakte me shërbimin e provës;*
- *i dënuari gjatë kohës së provës nuk përmbush një nga detyrimet e parashikuara në nenin 60 të Kodit Penal, sikundër është urdhëruar nga gjykata.*

b) zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes. Në këtë rast gjykata vendos të zgjasë kohën e mbikëqyrjes nga Shërbimi i Provës brenda afatit të provës. Nga përmbajtja e nenit 59 nuk rezulton që ligjvënësi të ketë përmendur termin “mbikëqyrje”. Për pasojë, kohë e “mbikëqyrjes” do të kuptohet koha e vënies në provë e të pandehurit nga gjykata ndërsa, togfjalëshi “brenda periudhës së provës”, do të kuptohet periudha e përgjithshme e provës, e parashikuar nga ligjvënësi në nenin 59 të Kodit Penal, e cila është nga 18 muaj deri në 5 vjet. Çdo interpretim tjetër do të ishte i palogjikshëm dhe i pabazuar në ligj. Kështu p.sh.: nëse gjykata në vendimin e saj ka urdhëruar vënien në provë (nën mbikëqyrje) të të pandehurit për një periudhë 18 mujore, me kusht që gjatë kësaj kohe i pandehuri të mos kryejë vepër tjetër penale, nisur nga rrethanat konkrete, gjykata mund të urdhërojë që ky afat prove ose ndryshe afat mbikëqyrjeje, të zgjatet edhe për disa muaj të tjerë, gjithnjë brenda afatit 5 vjeçar. Nëse gjykata vendos zgjatjen e afatit të provës rrjedhimisht do të zgjatet edhe afati i detyrimit të parashikuar nga neni 60 i Kodit Penal, nëse gjykata ka vendosur një detyrim të tillë. Sipas nenit 59 të Kodit Penal, gjykata vendos ndryshimin e vendimit të saj duke zgatur periudhën e mbikëqyrjes brenda afatit të provës. Kjo masë mund të ndërmerret nga gjykata në rastet kur nga Shërbimi i Provës shihet e nevojshme dhe e domosdoshme zgjatja e detyrimit për shkak se koha e vënë në dispozicion nga gjykata nuk arrin të plotësojë qëllimin për të cilin është vendosur detyrimi nga gjykata. Për shembull, në rastin e një të dënuari, i cili është përdorues i lëndës narkotike dhe gjykata ka caktuar ndaj tij si detyrim – “mjekim ose rehabilitim në një institucion shëndetësor”, parashikuar nga pika 11 i nenit 60 të Kodit Penal. Nëse koha që i nevojitet të dënuarit për t’u rehabilituar është më e madhe se koha që ka përcaktuar gjykata në vendimin e saj, atëherë me kërkesë të prokurorit (i cili është vënë në lëvizje nga Shërbimi i Provës), gjykata, pasi analizon të gjitha provat mund të vendosë që të zgjasë periudhën e provës apo të mbikëqyrjes sikundër parashikohet në nenin 59 të Kodit Penal. Në këtë rast kërkesa e prokurorit për ndryshimin e vendimit duhet të jetë e shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm: raportet përkatëse të Shërbimit të Provës; raportet mjekësore që vërtetojnë nevojën e të dënuarit për të vazhduar terapinë rehabilituese, etj. Prokuroria është e detyruar që kërkesën e saj t’u shoqërojë edhe me dokumentacionin përkatës, i cili do t’i nënshtrohet më pas shqyrtimit gjyqësor mbi bazën e parimit të kontradiktorialitetit. Në rast të kundërt, gjykata duhet të vendosë rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në prova. Ndërkohë që në praktikë është vërejtur fenomeni që prokuroria paraqet kërkesën të pashoqëruar me prova duke i kërkuar gjykatës të marrë provat e nevojshme nga Shërbimi i Provës. Kjo është një

praktikë e gabuar dhe e pabazuar në parimet e një gjykimi akuzator. Të vetmet prova që mund të marrë gjykata janë ato që mund të paraqiten nga i dënuari për të kundërshtuar tërësisht apo pjesërisht kërkesën e prokurorit.

■ revokimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit dhe dërgimin e të dënuarit në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale (I.E.V.P.). Ky lloj vendimi është masa më ekstreme që gjykata është e detyruar të marrë ndaj të dënuarit nën mbikëqyrje për shkak se, asnjë nga dy masat e mësipërme nuk rezultojnë efikase për të garantuar : a) *të drejtën e të dënuarit*; b) *të drejtën e të dëmtuarit, dhe c) interesin e shoqërisë*. Pra, kjo masë do të aplikohet kur është e pamundur që dënimi alternativ të arrijë qëllimin e tij edukues për shkak të sjelljes shumë të keqe apo/dhe rrezikshmërisë shoqërore të lartë të të dënuarit. Sipas nenit 59 të Kodit Penal dënimi i dhënë mund të revokohet tërësisht apo pjesërisht duke dërguar të dënuarin në I.E.V.P. për vuajtjen e pjesës së mbetur të dënimit me burgim. Sikundër thamë më sipër, kjo është masa më e rëndë që mund të marrë gjykata edhe sipas nenit 62 të Kodit Penal. Sipas nenit 59 dhe 62 të Kodit Penal rastet e revokimit të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim janë :

- *I dënuari gjatë kohës së provës nuk përmbush në mënyrë të përsëritur detyrimet e vendosura nga gjykata;*
- *I dënuari në mënyrë të përsëritur nuk mban kontakte me shërbimin e provës;*
- *I dënuari kryen një vepër tjetër penale.*

Sikundër shihet edhe nga formulimi i nenit 59 të Kodit Penal, ligjvënësi ka dëshiruar që ndryshimi i vendimit të mëparshëm nga gjykata të bëhet në mënyrë graduale, në përputhje me shkallën e moszbatimit nga i dënuari të detyrimeve të vendosura në vendimin e dhënë më parë nga gjykata. Për këtë arsye, në rast të kërkesës së prokurorit për ndryshimin e vendimit, gjykata duhet të vlerësojë: *së pari*, nëse ekzistojnë kushtet e zëvendësimit; *së dyti*, nëse ekzistojnë kushtet e zgjatjes së afatit të mbikëqyrjes dhe *së treti*, si masë më ekstreme të vendosë ndryshimin e vendimit, duke bërë revokimin e tij – urdhërimin e dërgimit të të dënuarit në I.E.V.P.

Mbikëqyrja e ekzekutimit të këtij dënimi, realizohet nga Shërbimi i Provës, në përputhje me nenet 37–44 të VKM-së nr. 302, datë 25.03.2009. Për këtë arsye, ky shërbim harton dhe zhvillon një program individual për ekzekutimin e vendimit të gjykatës, i cili ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë të të dënuarit. Një ndër detyrat e Shërbimit të Provës është edhe inkurajimi dhe mbështetja e të dënuarit të vënë në provë për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara nga gjykata në vendimin e saj. Gjithashtu, ky shërbim verifikon dhe njofton prokurorin për rregullsinë e përmbushjes së këtyre detyrimeve.

Një çështje e diskutueshme që ka dalë në praktikën gjyqësore është çështja nëse do të aplikohet neni 59 i Kodit Penal edhe për të pandehurit me shtetësi të huaj dhe që kanë vendbanimin e tyre jashtë territorit të Shqipërisë. Sipas Kushtetutës së Shqipërisë,³⁹

³⁹ Neni 16 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 i cili parashikon se: “*Të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejnë njëllëj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të liritë të caktuara*”.

personat e huaj të cilët nuk janë nënshtruar shqiptarë gëzojnë të njëjtat të drejta me shtetasit shqiptarë. Për pasojë, ata duhet të gëzojnë edhe të drejtën për të kërkuar dhe përfituar nëse plotësojnë kushtet dhe kriteret e parashikuara nga nenet 58, 59, 59/a, 63 apo 64 të Kodit Penal. Mbikëqyrja e këtyre dënimeve do të realizohet nga Shërbimi i Provës, mbi bazën e përcaktimeve dhe rregullimeve të parashikuara nga Konventa Evropiane “Për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht”, nga akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar, si dhe nga neni 60 i VKM-së nr. 302, datë 25.03.2009.

Gjithashtu, është për t’u diskutuar çështja nëse gjykata është e detyruar që të vendosë ndaj të pandehurit një ose më shumë nga detyrimet e parashikuara në nenin 60 të Kodit Penal në rastet kur vendos aplikimin e nenit 59 të tij.

Një mendim është se duke u bazuar edhe në frymën e përgjithshme që përshkon dispozitat aktuale mbi alternativat me burgim si dhe frymën që përcjell ligjbërësi në ndryshimet e fundit të Kodit Penal dhe ligjeve të tjera të cilat parashikojnë dhe rregullojnë ekzekutimin e dënimit me burgim me qëllim riintegrimin social të të dënuarit, në çdo rast gjykata, kur aplikon nenin 59 të Kodit Penal, si rregull, duhet të urdhërojë të pandehurin të përmbushë një ose disa nga detyrimet e parashikuara nga neni 60 i Kodit (*varet nga rrethanat e çështjes*). Ky përfundim bazohet edhe në paragrafin II të nenit 59 të Kodit Penal. Megjithatë, sikundër do ta theksojmë edhe më poshtë, duke qenë se sistemi ynë është një sistem i përzier me prirje akuzatore, ka edhe raste përjashtimore kur gjykata nuk ka përse të urdhërojë të pandehurin të përmbushë një nga detyrimet e nenit 60 të Kodit Penal. Për shembull, nëse një i pandehur i moshës mbi 70 vjeç deklarohet fajtor dhe dënohet me kusht për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, është e vështirë të gjendet një detyrim të përshtatshëm për t’u përmbushur nga ky i pandehur gjatë kohës së provës.

Gjithsesi, në përfundim mund të thuhet se është gjyqtari që në kushte dhe rrethana të caktuara vendos nëse është e përshtatshme t’i caktojë të dënuarit sipas nenit 59 të Kodit Penal, të përmbushë një nga detyrimet e parashikuara nga neni 60.

Gjykata nuk është e detyruar të shprehet që ky i pandehur (i dënuar), gjatë kohës së provës të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës, pasi ky kontakt është i detyrueshëm në bazë të ligjit (nenit 61) dhe jo në varësi të të dënuarit apo të gjykatës. Nga ana tjetër mbajtja e kontakteve me Shërbimin e Provës nuk është ndër ato detyrime të parashikuara nga neni 60 i Kodit Penal, por është mënyrë për të kontrolluar përmbushjen e këtyre detyrimeve nga i dënuari. Megjithatë, në shumë vendime gjyqësore shprehet urdhërimi i të dënuarit të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës gjatë periudhës së provës. Në këtë rast, gjykata nuk ka vepruar në kundërshtim me ligjin duke urdhëruar të dënuarin të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës, por ka patur si qëllim t’i bëjë të qartë të dënuarit se kontakti me Shërbimin e Provës është i detyrueshëm.

2.3 Qëndrimi në shtëpi (Neni 59/a i Kodit Penal)

“Qëndrimi në shtëpi” është një formë e re e vuajtjes së dënimit me burgim, e panjohur më parë në Shqipëri, e parashikuar nga neni 59/a i Kodit Penal, shtuar me nenin 2 të ligjit nr. 10 023, datë 27.11.2008. Sipas nenit 59/a të Kodit Penal parashikohet se:

“Për dënimet me burgim deri në dy vjet ose kur kjo kohë është pjesë e mbetur e dënimit, sipas një vendimi për një periudhë më të gjatë burgimi, gjykata mund të vendosë vuajtjen e dënimit të dhënë me qëndrimin në shtëpi të të dënuarit, në një shtëpi tjetër private apo në një qendër të kujdesit dhe të shëndetit publik, kur ekzistojnë rrethanat e mëposhtme:

a) Për gratë shtatzëna ose nëna me fëmijë, nën moshën 10 vjeç, që jetojnë me të.

b) Për baballarët, që kanë përgjegjësi prindërore për fëmijën, që jeton me të, nën moshën 10 vjeç, kur nëna e tij ka vdekur apo është e pazonja për t’u kujdesur për të.

c) Për persona, në kushte të rënda shëndetësore, që kërkojnë kujdes të vazhdueshëm nga shërbimi shëndetësor, jashtë burgut.

ç) Për personat mbi 60 vjeç, që janë të paaftë nga ana shëndetësore.

d) Për të rinj, nën moshën 21 vjeç, me nevoja të dokumentuara shëndetësore, studimore, të punës apo përgjegjësive familjare.

Gjykata mund të lejojë personat e dënuar me qëndrim në shtëpi të largohen nga vendbanimi, për plotësimin e nevojave të domosdoshme familjare, për t’u angazhuar në veprimtari pune, edukimi apo arsimimi ose për programe rehabilitimi, për të cilat shërbimi i provës është dakord.

Në këtë rast gjykata përcakton masat që duhet të marrë shërbimi i provës.

Gjykata revokon qëndrimin në shtëpi dhe e zëvendëson atë me një ndëshkim tjetër, kur nuk ekzistojnë më kushtet e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni. Në qoftë se personi i dënuar largohet pa autorizimin e gjykatës nga vendbanimi apo shkel detyrimet e caktuara në vendimin e gjykatës, zbatohet neni 62 i këtij Kodi”.

Kjo formë e vuajtjes së dënimit me burgim aplikohet nga gjykata kur plotësohen njëkohësisht dy kushte:

Së pari: Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor gjykata çmon se i pandehuri duhet të dënohet jo më shumë se dy vjet burgim, pavarësisht nëse i dënuari është ose jo nën një masë sigurimi arresti / kur të dënuarit i kanë mbetur për të vuajtur jo më shumë se dy vjet burgim, sipas një vendimi të dhënë më parë për një periudhë më të gjatë se dy vjet burgimi;

Së dyti: Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezulton se ekziston një nga rrethanat e mëposhtme:

➤ *e pandehura/ e dënuara të jetë shtatzënë ose nënë me fëmijë, nën moshën 10 vjeç, që jetojnë me të;*

➤ *i pandehuri/ i dënuari të jetë baba, të ketë përgjegjësi prindërore për fëmijën që jeton me të nën moshën 10 vjeç, kur nëna e fëmijës ka vdekur apo është e pazonja të kujdeset për të;*

➤ *i pandehuri/ i dënuari është në kushte të rënda shëndetësore, që kërkojnë kujdes të vazhdueshëm nga shërbimi shëndetësor, jashtë burgut.*

➤ *i pandehuri/ i dënuari të jetë mbi 60 vjeç dhe të jetë i paaftë nga ana shëndetësore;*

➤ *i pandehuri/ i dënuari të jetë nën moshën 21 vjeç, me nevoja të dokumentuara shëndetësore, studimore, profesionale apo përgjegjësi familjare.*

Për të aplikuar në mënyrë sa më të drejtë nenin 59/a të Kodit Penal, gjykata gjatë gjykimit ka për detyrë të identifikojë rrethanën e posaçme që ekziston në jetën e përditshme të të pandehurit apo të dënuarit. Nga një interpretim i dispozitave të ndryshuara në Kodit Penal, të cilat bëjnë fjalë për alternativat e dënimit me burgim në harmoni me dispozitat e ligjit nr. 10 024, datë 27.11.2008, rezulton se gjykata në përmbushjen e detyrës së saj për identifikimin e rrethanave të posaçme e ka të domosdoshëm mendimin e specializuar të Shërbimit të Provës. Për rrjedhojë, nëse gjatë gjykimit, i pandehuri/i dënuari apo prokurori paraqet një kërkesë për aplikimin e nenit 59/a, gjykata është e detyruar (*nëse një raport i tillë nuk është kryer nga shërbimi i provës gjatë fazës së hetimeve paraprake*) që të thërrasë në gjykim një përfaqësues të Shërbimit të Provës dhe t'i caktojë si detyrë kryerjen e raportit përkatës, i cili do të identifikojë në mënyrë të specializuar rrethanën e posaçme të pretenduar nga palët. Gjithashtu, në këtë raport Shërbimi i Provës i sugjeron gjykatës aplikimin e një detyrimi të parashikuar nga neni 60 i Kodit Penal. Ky detyrim duhet të jetë i përshtatshëm me një nga rrethanat e veçanta dhe t'i shërbejë të pandehurit apo të dënuarit për riintegrimin e tij në shoqëri. Sikundër parashikohet edhe në nenin 59 të Kodit Penal këto rrethana edhe në nenin 59/a të këtij Kodi janë të ngjashme:

- *Mosha e të pandehurit/ të dënuarit;*
- *Kushtet shëndetësore apo mendore të të pandehurit / të të dënuarit;*
- *Mënyra e jetesës së të pandehurit/ të të dënuarit;*
- *Detyrimet apo përgjegjësitë thelbësore të të pandehurit / të të dënuarit kundrejt familjes apo personave në ngarkim;*
- *Nevoja konkrete e të pandehurit/ të dënuarit për rehabilitimin shëndetësor apo trajtimin mjekësor;*
- *Nevoja apo detyrimi i të pandehurit/ të dënuarit për t'u arsimuar.*

Thirrja e Shërbimit të Provës dhe caktimi i detyrës për përgatitjen e raportit nga ky shërbim janë veprime që mund të kryhen nga gjykata në çdo fazë të shqyrtimit gjyqësor, qoftë edhe pas paraqitjes së pretendimeve të fundit nga palët. Një veprim i tillë është në përputhje të plotë me nenet 378/5 dhe 367 të Kodit të Procedurës Penale.

Nisur nga formulimi i nenit 59/a arrihet në përfundimin se në qoftë se këto kushte kanë ekzistuar edhe përpara dhënies së vendimit me burgim dhe gjykata nuk ka aplikuar nenin 59/a të Kodit për këtë të pandehur kur ky i fundit apo prokurori e ka kërkuar një dënim të tillë, atëherë ky i pandehur kur merr statusin e të dënuarit nuk mund të përfitojë “*qëndrimin në shtëpi*” sipas nenit 59/a të Kodit Penal. Pra, nëse i dënuari paraqet një kërkesë për aplikimin ndaj tij të nenit 59/a, gjykata duhet të vendosë rrëzimin e kërkesës.

Në rastet kur gjykata pranon kërkesën për aplikimin e nenit 59/a, atëherë gjykata lejon që dënimi me burgim të ekzekutohet jo në një I.E.V.P., por:

- *në shtëpinë e të pandehurit/të dënuarit,*
- *në një banesë tjetër,*
- *në një qendër të kujdesit dhe shëndetit publik.*

Sipas formulimit të nenit 59/a të Kodit Penal dhe dispozitave të posaçme të ligjit “Për ekzekutimin e dënimeve penale”, nr. 10 024, datë 27.11.2008, rezulton se në të tria këto vende të vuajtjes së dënimit, i dënuari është nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës. Është ky shërbim, i cili i paraqet gjykatës raporte të detajuara për nevojat e ndryshme me karakter shëndetësor, profesional, familjar, arsimor, etj. që ka i dënuari, përmbushja e të cilave (nevojave) mund të kërkojnë largimin e tij nga vendbanimi. Në këto raste, pas referimit të fakteve nga i dënuari dhe nga Shërbimi i Provës, dhe marrjes së pëlqimit nga ky shërbim, gjykata mund të lejojë të dënuarin të largohet nga vendbanimi:

- ➔ për plotësimin e nevojave të domosdoshme familjare (përmbushja e detyrimeve familjare që lidhen me kujdesin dhe edukimin e fëmijëve, kujdesin ndaj prindërve, kujdesin ndaj personave në ngarkim, etj.);
- ➔ për t’u angazhuar në një veprimtari pune;
- ➔ për të marrë pjesë në një veprimtari edukuese ose për t’u arsimuar, veçanërisht në rastin e të dënuarve të mitur, ose të atyre nën 21 vjeç (ndjekja e shkollës apo kurseve të tjera profesionale dhe trajnuese);
- ➔ për të ndjekur një veprimtari rehabilituese, veçanërisht në rastet e të dënuarve që janë përdorues të lëndëve narkotike.

Pasi merr një nga vendimet e mësipërme, gjykata përcakton edhe masat që duhen marrë nga Shërbimi i Provës. Këto masa kanë të bëjnë me mënyrën e mbikëqyrjes së vendimit të gjykatës nga ana e Shërbimit të Provës.

Rast praktik: I dënuari Q.A., i moshës 78 vjeç, me vendimin nr. ..., datë .././2004 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, është dënuar me 8 (tetë) vjet burgim për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 76 (*Vrasje me dashje*) dhe 278/2 (*Mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municioneve*) të Kodit Penal. Gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, pasi i kanë mbetur edhe më pak se dy vjet nga vuajtja e plotë e dënimit me burgim, i dënuari Q.A. ka paraqitur kërkesë për të qëndruar në shtëpi, në bazë të nenit 59/a të Kodit Penal. Gjatë shqyrtimit gjyqësor ka rezultuar e provuar sipas dokumentacionit shëndetësor dhe deklaramit të mjekut specialist se i dënuari vuan nga një sëmundje e rëndë e pashërueshme. Për pasojë, ka nevojë për kujdes të vazhdueshëm, të cilin nuk mund ta marrë në kushtet e burgut. Në këto kushte, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin e saj nr. ... Akti, datë .././2009 ka vendosur : “1. *Pranimin e kërkesës: qëndrimin në shtëpi të të dënuarit Q.A. në bazë të nenit 59/a të Kodit Penal, për pjesën e mbetur të dënimit prej 1 (një) viti, 11 (njëmbëdhjetë) muaj e 26 (njëzetegjashtë) ditë, pjesë e mbetur nga dënimi i dhënë ndaj tij me 8 (tetë) vjet burgim, me vendimin nr. ..., datë .././2004 të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës. 2. I dënuari Q.A. gjatë kësaj kohe do të qëndrojë në shtëpinë e tij, e cila ndodhet në fshatin Rumanat, komuna Rrashbull, Durrës. 3. Gjatë kësaj kohe i dënuari do të mbajë kontakte me shërbimin e provës, si dhe mund të largohet nga banesa vetëm për arsye shëndetësore. 4. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të dënuarit Q.A. nga I.E.V.P.-ja....”.*

Rast praktik: I dënuari E.Xh., i moshës 46 vjeç, me vendimin nr. ..., datë .././2007 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, është dënuar me 2 (dy) vjet burgim për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 248 (*Shpërdorimi i detyrës*) dhe 186 (*Falsifikim i dokumenteve*) të KP. Gjatë kohës së vuajtjes së dënimit pasi i kanë mbetur edhe më pak se dy vjet nga vuajtja e plotë e dënimit me burgim, i dënuari E.Xh. ka paraqitur kërkesë për të qëndruar në shtëpi në bazë të nenit 59/a të Kodit Penal. Gjatë shqyrtimit gjyqësor ka rezultuar e provuar se i dënuari është kryefamiljar, me tre fëmijë, njëri prej të cilëve i moshës 7 vjeç. Bashkëshortja e të dënuarit vuan nga çrregullime funksionale depressive, gjendje anksoze, insomni, agresivitet cefale. Sipas një raportit mjeko-ligjor rezulton se kjo shtetase nuk është e zonja të ushtrijë detyrat prindërore dhe familjare. Në këto kushte, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin e saj nr. ... Akti, datë .././2009 ka vendosur : “1. *Pranimin e kërkesës: vazhdimin e vuajtjes së dënimit të mbetur pa vuajtur dhënë me vendimin nr. ..., datë .././2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ndryshuar me vendimin nr. ..., datë .././2008 të Gjykatës së Apelit Durrës, me qëndrimin në shtëpi të të dënuarit E.Xh. 2. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të dënuarit E.Xh. nga I.E.V.P.-ja....”.*

Rast praktik: I dënuari B.Sh., i datëlindjes .././1970, më datë 23.11.1993 është dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me 20 vjet burgim për veprën penale të “Vrasjes me dashje”, të parashikuar nga nenet 83 dhe 35 të Kodit Penal të vjetër. I dënuari vuan dënimin pranë I.E.V.P. Fushë-Krujë. Pasi i dënuari ka vuajtur gjithsej 18 vjet, 1 muaj dhe 3 ditë dhe i kanë mbetur për të vuajtur 1 vit, 4 muaj dhe 2 ditë, i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë për aplikimin e nenit 59/a/shkronja (b) të Kodit Penal. Gjatë shqyrtimit gjyqësor ka rezultuar e provuar se i dënuari ka 3 fëmijë, i pari 7 vjeç dhe dy të tjerët janë binjakë të datëlindjes .././2008. Bashkëshortja e të dënuarit është e pazonja për t’u kujdesur për ta për shkak se në bazë të epikrizës, datë 15.12.2009, ajo trajtohet me diagnozë astma bronkiale në krizë. Gjykata ka administruar edhe një deklaratë nga babai i viktimës sipas së cilës nuk ka hasmëri me B.Sh. Në këto kushte, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë me vendimin e saj nr. ... Akti, datë .././2010 ka vendosur : “1. *Pranimin e kërkesës: Pjesa e pavuajtur e dënimit prej 1 vit, 5 muaj për të dënuarin B.Sh. i jepet qëndrim në shtëpi. Lejohet kërkuesi B.Sh. që për nevoja të domosdoshme familjare për punësim të punojë në mobilieri “.....”. Detyrohet i dënuari B.Sh. të mbajë kontakte me shërbimin e provës gjatë periudhës që kryen në shtëpi pjesën e pavuajtur të dënimit. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të dënuarit B.Sh.”.*

Mbikëqyrja e ekzekutimit të këtij dënimi realizohet nga shërbimi i provës në përputhje me nenet 45 – 47 të VKM-së nr. 302, datë 25.03.2009. Për këtë arsye, ky shërbim harton dhe zhvillon një program individual për ekzekutimin e vendimit të gjykatës, i cili ka vendosur qëndrimin në shtëpi të të dënuarit. Gjithashtu, ky shërbim verifikon dhe njofton prokurorin për rregullsinë e përmbushjes së këtij vendimi dhe detyrimeve të tjera të vendosura nga gjykata në këtë vendim.

Në praktikë haset edhe një qëndrim tjetër nga ai i shpjeguar më sipër për zbatimin e nenit 59/a të Kodit Penal. Sipas mbështetësve të këtij qëndrimi, rezulton se neni 59/a i Kodit Penal do të aplikohet vetëm në rastet kur gjykata vendos ta deklarojë fajtor të pandehurin dhe ta dënojë atë me burgim deri në dy vjet, ose më shumë se dy vjet por për shkak të vuajtjes së paraburgimit të pandehurit i kanë mbetur më pak se dy vjet burgim për të vuajtur nga ky dënim i dhënë nga gjykata. Ky qëndrim përjashton aplikimin e nenit 59/a të Kodit Penal për të dënuarit me vendim të formës së prerë, të cilëve u ka mbetur më pak se dy vjet burgim për të vuajtur dhe që plotësojnë kushtet e tjera të përcaktuara nga neni 59/a i Kodit Penal. Argumenti kryesor ku bazohet ky qëndrim është vendosja e nenit 59/a menjëherë pas nenit 59 të Kodit Penal, pra, një interpretim sistematik i nenit 59/a të Kodit Penal në raport me nenet e tjera që parashikojnë dënimet alternative. Por një qëndrim i tillë është i gabuar dhe bie ndesh me formulimin e nenit 59/a të Kodit Penal. Si përfundim, neni 59/a do të aplikohet edhe për të dënuarit me vendim të formës së prerë, të cilëve u ka mbetur më pak se dy vjet burgim për të vuajtur dhe që plotësojnë kushtet e tjera të përcaktuara nga neni 59/a i Kodit Penal.

Një çështje tjetër e diskutueshme është ngjashmëria e “*qëndrimit në shtëpi*” me “*lirimin me kusht*” e parashikuar nga neni 64 i këtij Kodi. Nisur nga përmbajtja e këtyre dy dispozitave na rezulton se ka ndryshime të mëdha të cilat konsistojnë në:

- *mospërputhjen e masës së dënimit të vuajtur nga përfituesit e “qëndrimit në shtëpi” nga përfituesit e “lirimit me kusht”;*
- *arsyet të cilat duhet të paraqesë dhe plotësojë përfituesi i “qëndrimit në shtëpi” me ato të cilat duhet të paraqesë dhe plotësojë përfituesi i “lirimit me kusht”;*
- *faktin e të qenit ose jo përsëritës në krim.*

Prandaj, nisur edhe nga këto ndryshime thelbësore përforcohet mendimi se “*qëndrimi në shtëpi*” përfitohet si nga të pandehurit, ashtu edhe nga të dënuarit ndërkohë që “*lirimi me kusht*” përfitohet vetëm nga të dënuarit.

Revokimi i dënimit “*Qëndrim në shtëpi*” sipas nenit 59/a të Kodit Penal

Sipas parashikimeve që ka bërë ligjvënësi, dënimi i dhënë sipas nenit 59/a i Kodit Penal revokohet nga gjykata kur nuk ekzistojnë më kushtet e parashikuara nga pikat a), b), c), ç) dhe d) të këtij neni. Më konkretisht, dënimi i dhënë sipas nenit 59/a do të revokohet tërësisht apo pjesërisht ose do të zëvendësohet me një dënim tjetër nëse:

- *kalon gjendja e shtatzënisë së të dënuarës;*
- *fëmija e të dënuarës mbush moshën 10 vjeç;*
- *fëmija e të dënuarit, të cilit i ka vdekur bashkëshortja apo i është bërë e pazonja, mbush moshën 10 vjeç;*
- *gjendja shëndetësore e të dënuarit është përmirësuar, nuk është më e rëndë dhe nuk ka rrezik të përsëritet më;*
- *mundësohet kujdesi shëndetësor i vazhdueshëm brenda burgut;*
- *i dënuari mbush moshën 21 vjeç pavarësisht se ekzistojnë ende nevojat e dokumentuara shëndetësore, studimore apo përgjegjësitë familjare;*
- *i dënuari nën 21 vjeç nuk ka më nevoja të dokumentuara shëndetësore, studimore apo përgjegjësi familjare.*

Ligjvënësi duhet të kishte parashikuar një moshë më të madhe për fëmijët e të dënuarve, të gjendur në situatat e parashikuara nga pikat a) dhe b) të nenit 59/a të Kodit Penal. Nisur edhe nga mosha e lejuar nga ligji për punë në Republikën e Shqipërisë,⁴⁰ mosha e fëmijëve të parashikuar nga neni 59/a i Kodit Penal duhet të ishte më e madhe se 10 vjeç, të paktën 16 vjeç.

Për shkak se kjo alternative burgimi nuk ka shumë kohë që ka filluar të aplikohet, deri tani nuk kemi gjetur raste praktike të revokimit të saj nga gjykatat tona.

2.4 Detyrimet të dënuarit të vënë në provë (Neni 60 i Kodit Penal)

Nga formulimi gramatikor i neneve 59, 60 dhe 62 të Kodit Penal kanë lindur interpretime të ndryshme sa i përket çështjes nëse gjykata në rastet kur aplikon një “*dënim me kusht*” apo një “*qëndrim në shtëpi*” është ose jo e detyruar të urdhërojë të dënuarin të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës apo gjatë kohës së provës të përmbushë një ose disa nga detyrimet e parashikuara nga neni 60 i Kodit Penal. Në praktikë po hasen tre qëndrime lidhur me këtë çështje:

- *Gjykata nuk është e detyruar të urdhërojë të dënuarin të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës dhe as të përmbushë një ndër detyrimet e parashikuara nga neni 60 i Kodit Penal;*
- *Gjykata urdhëron të pandehurin që gjatë kohës së provës të përmbushë një ose disa detyrime të parashikuara nga neni 60 i Kodit Penal, por nuk mund të urdhërojë të pandehurin të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës;*
- *Gjykata urdhëron të pandehurin që gjatë kohës së provës të përmbushë një ose disa detyrime të parashikuara nga neni 60 i Kodit Penal, si dhe urdhëron të pandehurin të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës gjatë periudhës së provës.*

⁴⁰ *Shih nenin 98 të Kodit të Punës, i cili parashikon se: “Ndalohet marrja në punë e të miturve nën moshën 16 vjeç. Bëjnë përjashtim rastet kur të miturit nga mosha 14 deri në 16 vjeç punësohen gjatë pushimeve shkollore vetëm në punë të lehta, që nuk dëmtojnë shëndetin dhe formimin e tyre.*

2) Të miturit nga mosha 14 vjeç deri në moshën 16 vjeç mund të jenë subjekt i këshillimit dhe i formimit profesional, sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Për t'u dhënë një përgjigje të saktë çështjeve të shtruara më sipër duhet të shohim se çfarë parashikojnë konkretisht dispozitat përkatëse të Kodit Penal. Sipas nenit 60 të tij parashikohet se:

“I dënuari i vënë në provë, mund të detyrohet nga gjykata të plotësojë një apo më tepër prej detyrimeve” të mëposhtme:

1. *Të ushtrojë një veprimtari profesionale ose të marrë një arsim apo formim profesional.*
2. *Shfrytëzimi i pagës dhe i të ardhurave të tjera ose i pasurisë për përmbushjen e detyrimeve financiare.*
3. *Të riparojë dëmin civil të shkaktuar.*
4. *Të ndalohet të drejtojë automjete të caktuara.*
5. *Të mos ushtrojë veprimtari profesionale kur vepra penale ka lidhje me këtë veprimtari.*
6. *Të mos frekuentojë vende të caktuara.*
7. *Të mos frekuentojë lokale që shërbejnë pije alkoolike.*
8. *Të qëndrojë në banesën e tij në orare të caktuara.*
9. *Të mos shoqërohet me persona të caktuar, kryesisht me të dënuar apo bashkëpunëtorët e veprës penale.*
10. *Të mos zotërojë, mbajë apo përdorë armë.*
11. *Mjekimi ose rehabilitimi në një institucion shëndetësor ose nënshtrimi në një program të trajtimit, mjekësor apo rehabilitues.*
12. *Heqja dorë nga përdorimi i alkoolit ose drogës.*
Në përcaktimin e detyrimeve për të dënuarin, gjykata merr parasysh moshën e të dënuarit, gjendjen mendore, mënyrën e jetesës dhe nevojat e tij, veçanërisht ato të lidhura me familjen, edukimin ose punën, motivet e kryerjes së veprës penale, qëndrimin pas kryerjes së veprës penale, si dhe rrethana të tjera, që ndikojnë në vendosjen e detyrimeve, sipas këtij neni dhe mbikëqyrjen e tyre”.

Ndërsa në nenin 61 të Kodit Penal parashikohet se:

“Gjatë kohës së provës i dënuari është i detyruar:

- a) *të paraqitet rregullisht dhe të informojë në vazhdimësi shërbimin e provës për përmbushjen e kushteve dhe detyrimeve të caktuara nga gjykata;*
- b) *të marrë pëlqimin nga shërbimi i provës për ndryshimin e vendbanimit, qendrës së punës apo për lëvizjet e shpeshta brenda vendit”.*

Nga sa shihet sistemi ynë i dënimeve alternative me burgim është një përzierje e dy sistemeve botërore të këtyre dënimeve: a) sistemit kontinental, i cili ka parasysh vetëm pezullimin e dënimit me burgim duke i vënë si kusht të vetëm të dënuarit moskryerjen e veprave të tjera penale dhe b) sistemit të mbikëqyrjes, ose i quajtur ndryshe “*Probacioni*”. Ky sistem ka në thelb të tij nevojën për t'i vendosur të dënuarit një detyrim, i cili do të mbikëqyret edhe nga një person i specializuar, që sipas ligjit penal shqiptar është Shërbimi i Provës.

Nga analiza që i bëhet në tërësi neneve të Kodit Penal që parashikojnë alternativat e dënimeve me burgim dhe ligjit nr. 10 024, datë 27.11.2008 “Për ekzekutimin e dënimeve penale” na rezulton se sistemi ynë i dënimeve alternative është më shumë i prirur drejt sistemit të mbikëqyrjes (*Probacionit – vënie në provë*; latinisht - *probatio*), duke iu larguar sistemit kontinental, por jo të shkëputet tërësisht prej tij. Ky argument bëhet edhe më i besueshëm nga përdorimi i fjalës “*mund*” në nenin 60 të Kodit Penal (i cili parashikon detyrimet konkrete) si dhe në nenin 59 të këtij Kodi.

Gjykata në vendimin e saj të dënimit me burgim sipas neneve 59 dhe 59/a të Kodit Penal mund të japë një ose më shumë nga detyrimet e parashikuara në nenin 60 të Kodit Penal në varësi të rrethanave të cilat vërtetohen gjatë gjykimit. Përcaktimi i detyrimit në kuadër të aplikimit të dënimit alternativ synon të përmbushë tre qëllime kryesore:

1. Të drejtën e të dënuarit;
2. Të drejtën e të dëmtuarit;
3. Interesin e shoqërisë.⁴¹

Sipas renditjes së parashikuar në nenin 60 të Kodit Penal, i dënuari i vënë në provë mund të detyrohet nga gjykata të plotësojë një apo më tepër prej detyrimeve të mëposhtme:

1. Të ushtrojë një veprimtari profesionale ose të marrë një arsim apo formim profesional.

Ky është një ndër detyrimet që jepen më shpesh nga gjykata. Në dhënien e këtij detyrimi gjykata, si në të gjitha detyrimet e tjera, duhet të bazohet shumë në raportin e përgatitur nga Shërbimi i Provës. Është ky shërbim, i cili në mënyrë të specializuar i ngarkuar nga ligji duhet të identifikojë në mënyrën më të mirë të mundshme nevojën e të dënuarit. Por mendimi i Shërbimit të Provës nuk është vendimtar, sikundër pa të drejtë pretendohet nga disa gjyqtarë. Raporti është një provë si të gjitha provat e tjera dhe për pasojë nuk ka vlerë të paracaktuar në procesin gjyqësor. Ky raport do të marrë vlerën e provës me qëllim përdorimin e tij nga gjykata në arsyetimin e vendimit të saj vetëm pasi të jetë debatuar nga palët gjatë shqyrtimit gjyqësor. Detyrimi i parashikuar nga pika 1 e nenit 60 të Kodit Penal jepet zakonisht kur të pandehurit janë moshë të reja dhe të papunë ose kur të pandehurit janë familjarë dhe kanë në ngarkim persona të tjerë.

Rast praktik: I pandehuri *E.D.*, është i moshës 20 vjeç dhe me arsim të mesëm. Më datë 15.10.2009 *E.D.* është kapur duke tentuar të vjedhë një aksesor automjeti. Për këtë arsye, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e saj nr. 49, datë 21.10.2010 ka vendosur : “1. *Deklarimin fajtor të të pandehurit E.D. për kryerjen e veprës penale të “Vjedhjes”, mbetur në tentativë, e parashikuar nga neni 134/1-22 i Kodit Penal dhe në bazë të këtij neni, dënimin e të pandehurit me 3 (tre) burgim. 2. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit dhe përfundimisht i pandehuri E.D. dënohet me 2 (dy) muaj burgim.*

⁴¹ *Shih* Rregullat e Tokios (Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Masat Alternative të Dënimit me Burgim), miratuar me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së.

3. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, duke e vënë të pandehurin E.D. në provë për një periudhë kohore prej 18 (tetëmbëdhjetë) muajsh me kusht që gjatë kësaj kohe i pandehuri të mos kryejë asnjë veprë tjetër penale. 4. Në aplikim të nenit 60/1 të Kodit Penal, i pandehuri E.D. detyrohet të ushtrojë një veprimtari profesionale...”.

2. Shfrytëzimi i pagës dhe i të ardhurave të tjera ose i pasurisë për përmbushjen e detyrimeve financiare.

Ky është një lloj detyrimi i cili nuk ka gjetur ende aplikim. Qëllimi i këtij detyrimi është përdorimi i sanksionit penal kundër të dënuarit, me qëllim që ky i fundit të përmbushë detyrimet ndaj personave që ka në ngarkim. Në përcaktimin e masës së këtij detyrimi gjykata duhet të mbajë parasysh raportin mes detyrimeve dhe gjendjes social-ekonomike të të pandehurit duke vendosur shfrytëzimin e pagës apo të ardhurave të tjera në një proporcion të drejtë me masën e detyrimit financiar të përcaktuar më parë nga një akt tjetër ligjor. Rasti tipik ku mund të gjejë zbatim ky detyrim është kur i dënuari dënohet për kryerjen e veprave penale të “Braktisje e fëmijëve të mitur” apo “Mosdhënies së mjeteve për jetesë” të parashikuara nga nenet 124 dhe 125 të Kodit Penal. Aktualisht në praktikën gjyqësore nuk kemi hasur raste të aplikimit të këtij detyrimi.

3. Të riparojë dëmin civil të shkaktuar. Ky detyrim mund të jepet nga gjykata duke urdhëruar të dënuarin të shlyejë në tërësi apo edhe me këste dëmin civil të shkaktuar nga vepra penale. Rrjedhimisht, që të jepet ky detyrim, gjykata duhet të ketë qartësisht të përcaktuar masën e dëmit civil të shkaktuar. Në përcaktimin e kohës dhe mënyrës sesi do të shlyhet ky detyrim, gjykata duhet të udhëhiqet nga një analizë e thellë e gjendjes social-ekonomike të të pandehurit. Për pasojë, gjykatës i del për detyrë që të hetojë për gjendjen social-ekonomike të të pandehurit dhe të mos vendosë *apriori* këtë detyrim. Aktualisht në praktikën gjyqësore nuk kemi hasur raste të aplikimit të këtij detyrimi.

4. Të ndalohet të drejtojë automjete të caktuara. Ky detyrim në pamje të parë rezulton të jetë një mbivendosje me pikën 3 të nenit 30 ose me nenin 37 të Kodit Penal, por në fakt mes tyre ka dallime. Në rastin e parashikuar nga pika 4 e nenit 60 të Kodit Penal, detyrimi nuk mund të ekzistojë i vetëm por jepet së bashku me një dënim alternativ nga ata të parashikuar nga nenet 59 dhe 59/a të Kodit Penal. Ndërsa detyrimi i parashikuar në nenin 37 të Kodit Penal aplikohet si dënim plotësues së bashku me një dënim me burgim, dënim me gjobë apo një dënim alternativ. Por mund të jepet edhe i vetëm nëse gjykata çmon se ekzistojnë kushtet dhe rrethanat. Në këtë rast “*ndalimi për të drejtuar automjete*” mund të jepet së bashku apo veçmas me dënimin kryesor; nuk ka rëndësi nëse dënimi kryesor është ose jo me burg, me gjobë apo dënim alternativ. Një ndryshim tjetër i rëndësishëm është edhe periudha e ndalimit për të drejtuar automjete si dhe çasti kur fillon kjo periudhë. Në rastin e parashikuar nga neni 37 i Kodit Penal periudha gjatë së cilës i dënuari ndalohet të drejtojë automjete është e pavarur nga koha e dënimit me burgim dhe për më tepër fillon të ekzekutohet pasi dënimi me burgim ka përfunduar (*neni 44 i Kodit Penal*). Ndërsa në rastin e “*ndalimit për të drejtuar automjete*” sipas pikës 4 të nenit 60 të Kodit Penal, kjo periudhë nuk mund të zgjatet tej periudhës për

të cilën është pezulluar dënimi me burgim dhe i pandehuri është vënë në provë. Çasti i fillimit të këtij detyrimi është çasti kur vendimi i dënimit merr formë të prerë.

5. Të mos ushtrojë veprimtari profesionale kur vepra penale ka lidhje me këtë veprimtari. Ky detyrim është e udhës të zbatohet në rastet kur vepra penale e kryer nga i pandehuri ka lidhje të drejtpërdrejtë me një veprimtari profesionale. Nuk ka rëndësi nëse kjo veprimtari ushtrohet në mënyrë të ligjshme apo të paligjshme nga i dënuari. Zakonisht ky detyrim ka gjetur zbatim në dënimet e dhëna për shkak të kryerjes së veprave penale të falsifikimit të dokumenteve, shpërdorimit të detyrës; mashtrimit; korrupsionit pasiv të punonjësve privatë apo shtetërorë; në dënimet për vepra penale ushtarake si dezertimi, mosparaqitja apo largimi pa leje nga reparti, etj.

Rast praktik: I pandehuri I.H., i moshës 30 vjeç, ka qenë ushtar profesionist. Më datë 02.10.2006 mes të pandehurit dhe Komandës së Brigadës së Reagimit të Shpejtë (BRSH) është lidhur edhe kontrata 3 (tre) vjeçare “Për futjen në shërbimin ushtarak me pagesë”. Sipas kësaj kontrate, i pandehuri detyrohej të punonte si ushtar profesionist me pagesë, duke u emëruar automatikisht në, Kompania III, në BRSH Tiranë deri më datë 02.10.2009. Por pa përfunduar ky afat, i pandehuri është larguar nga detyra pa asnjë arsye objektive, duke iu shmangur kështu shërbimit ushtarak me pagesë. Gjithashtu, nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi se i dënuar nuk ka qenë e dënuar më parë. Për këtë arsye, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e saj nr. 411, datë 19.03.2009 ka vendosur: “1. Deklarimin fajtor të të pandehurit I.H. për kryerjen e veprës penale të “Dezertimit nga ushtria”, e parashikuar nga neni 33/1 i Kodit Penal Ushtarak dhe në bazë të këtij neni, dënimin e të pandehurit me 3 (tre) muaj burgim. 2. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit dhe përfundimisht i pandehuri I.H. dënohet me 2 (dy) muaj burgim. 3. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, duke e vënë të pandehurin I.H. në provë, për një periudhë kohore prej 18 (tetëmbëdhjetë) muajsh me kusht që gjatë kësaj kohe i pandehuri të mos kryejë asnjë vepër tjetër penale dhe të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës. 4. Në aplikim të nenit 60/5 të Kodit Penal i pandehuri I.H. detyrohet të mos ushtrojë detyra ushtarake në radhët e Forcave të Armatosura brenda periudhës së provës”.

Rast praktik: I pandehuri V.B., i moshës 50 vjeç, ka qenë me detyrë magazinier në një shoqëri private. Gjatë kohës së ushtrimit të detyrës, i pandehuri ka falsifikuar disa fatura shitjeje me qëllim përfitimi. Gjithashtu, nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi se i dënuar nuk ka qenë i dënuar më parë. Për këtë arsye, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e saj nr., datë 29.06.2009 ka vendosur : “1. Deklarimin

fajtor të të pandehurit V.B. për kryerjen e veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, e parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal dhe në bazë të këtij neni, dënimin e të pandehurit me 2 (dy) vjet burgim. 2. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, duke e vënë të pandehurin V.B. në provë, për një periudhë kohore prej 2 (dy) vjetësh me kusht që gjatë kësaj kohe i pandehuri të mos kryejë asnjë vepër tjetër penale dhe të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës. 3. Në aplikim të nenit 60/5 të Kodit Penal i pandehuri V.B. detyrohet të mos ushtrojë detyrën e magazinierit apo të shitësit, brenda periudhës së provës....”.

6. Të mos frekuentojë vende të caktuara. Ky detyrim ka për qëllim që të ndalojë të pandehurin të frekuentojë në mënyrë të përhershme apo periodike një ambient të caktuar, i cili mund të mbart mundësi potenciale, krijon kushte dhe rrethana të favorshme që i pandehuri të kryejë vepra të tjera penale të njëjta apo të ndryshme nga ajo për të cilën është duke vuajtur dënimin. Këto vende mund të jenë: banesa ku banojnë persona të dëmtuar nga vepra penale apo të afërm të tyre, në rastet e veprave të kryera kundër jetës apo shëndetit apo mospërbushjes së detyrimeve familjare; vendet ku ka një dendësi të madhe personash mund të ndalohen për t’u frekuentuar nga persona të dënuar për vjedhje; vende publike, kinema, stadione, apo vende të tjera ku zhvillohen veprimtari publike me karakter argëtues mund të ndalohen të frekuentohen nga persona të dënuar për vepra penale të “Prishjes së qetësisë publike”; baret e natës, vende ku shërbehen pije alkoolike, etj., vende të ngjashme janë vende të cilat mund t’u ndalohen për t’u frekuentuar nga persona të dënuar për veprën penale të “Prostitucion”, “Prodhim dhe shitje narkotikësh”, etj.

Rast praktik :

E pandehura L.B., e moshës 32 vjeç, ka qenë e martuar e më pas është divorcuar. Nga martesja e saj ajo ka edhe një fëmijë të mitur. Për shkak të vështirësive të mëdha ekonomike e pandehura ka migruar në qytetin e Tiranës për një jetë më të mirë. Aktualisht ajo jeton në një çadër tek Ura e Farkës në Tiranë. Nga pamundësia për të gjetur punë, e pandehura ka filluar të prostitutojë. Gjithashtu, nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi se e dënuara nuk ka qenë e dënuar më parë. Për këtë arsye, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e saj nr., datë 19.03.2009 ka vendosur:

“1. Deklarimin fajtor të të pandehurës L.B. për kryerjen e veprës penale të “Prostitucionit”, e parashikuar nga neni 113 i Kodit Penal dhe në bazë të këtij neni dhe nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale dënimin e saj me 4 (katër) muaj burgim. 2. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, duke e vënë të pandehurën L.B. në provë, për një periudhë kohore prej 2 (dy) vjetësh me kusht që gjatë kësaj kohe e pandehura të mos kryejë asnjë vepër tjetër penale. 3. Në aplikim të nenit 60/7 të K.Penal

urdhërohet e pandehura L.B. të mos frekuentojë lokale që shërbejnë pije alkoolike brenda periudhës së provës.

7. Të mos frekuentojë lokale që shërbejnë pije alkoolike. Ky detyrim ka për qëllim që të ndalojë të dënuarin të jetë sërish pjesë e ambienteve që mbartin rrezik potencial për realizimin e veprave penale nga i pandehuri. Në këto ambiente të dënuarit mund të konsumojnë pije të ndryshme alkoolike dhe për pasojë, ekuilibri mendor i tyre mund të ulet, duke u kthyer kështu në rrezik potencial për kryerjen e veprave penale. Gjithashtu, në këto ambiente të dënuarit mund të vihen sërish në kontakt me elementë kriminalë, të cilët mund t'i shtyjnë këta të dënuar në kryerjen e veprave të reja penale, të njëjta me atë që kanë kryer më parë apo të ndryshme. Zakonisht, ky detyrim aplikohet ndaj personave të mitur, të cilët janë dënuar për vepra penale të tilla si “*Prodhim dhe shitje narkotikësh*”; “*Kundërshtim me dhunë i punonjësve të policisë së rendit publik*”; “*Prishje e qetësisë publike*”, etj. Ambientet të cilat u janë ndaluar kësaj kategorie të dënuarish janë kryesisht diskotekat, baret/klubet e natës, baret apo restorante në të cilat shërbehen pije alkoolike, stadiumet, etj...

8. Të qëndrojnë në banesën e tij në orare të caktuara. Ka për qëllim parandalimin e kryerjes së veprave penale nga i dënuari. Zakonisht të tilla orare janë ato ku, elementët e sigurisë, kontrolli i policisë apo vëmendja e publikut ndaj sjelljeve kriminale është më e ulët në krahasim me orare të tjera. Të tilla orare mund t'i ofrojnë të dënuarit kushte të favorshme për të kryer vepra penale, pasi i dënuari nuk ka frikë se veprimet e tij mund të diktohen apo të hasin në rezistencën e personave të tjerë. P.sh: personat që shkaktojnë probleme të rendit publik nëpër stadione mund të detyrohen nga gjykata të qëndrojnë në shtëpitë e tyre gjatë kohës që zhvillohet ky aktivitet; të miturit apo përdoruesit e lëndëve narkotike mund të detyrohen të qëndrojnë në shtëpitë e tyre gjatë natës; apo mund të detyrohen që të mos frekuentojnë në orare të caktuara, kryesisht natën, vende të tilla si bare, diskoteka apo vende ku shërbehen pije alkoolike. Në këtë mënyrë, në dhënien e vendimit nga gjykata ndërthuren disa detyrime nga ato të parashikuara nga neni 60 i Kodit Penal.

9. Të mos shoqërohet me persona të caktuar, kryesisht me të dënuar apo bashkëpunëtorët e veprës penale. Edhe ky dënim mundëson parandalimin e kryerjes së veprave të tjera nga i pandehuri si dhe rehabilitimin e tij. Duke qëndruar larg ndikimit negativ të këtyre personave, të cilët kanë sjellje devijante dhe mund të rrezikojnë përfshirjen e të dënuarit sërish në kryerjen e veprave penale, rritet mundësia që i pandehuri të mos kryejë në të ardhmen vepra penale. Gjithashtu, rritet mundësia që i dënuari të integrohet në shoqëri.

10. Të mos zotërojë, mbajë apo përdorë armë. Në pamje të parë kjo dispozitë duket sikur është mbivendosje e neneve 278 dhe 279 të Kodit Penal, i cili parashikon veprën penale të “*Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake*” dhe “*Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve të ftohta*”. Por në fakt nuk është kështu. Kuptimi i saj është krejt tjetër. Është e vërtetë se mbajtja, zotërimi apo përdorimi i armëve pa lejen e

posaçme nga organi kompetent është si rregull vepër penale. Por ka edhe raste të tjera përjashtimore kur persona të caktuar në situata të caktuara mund të lejohen të mbajnë, zotërojnë apo përdorin armë (*veçanërisht bëhet fjalë për armët e zjarrit*). Për pasojë, detyrimi i parashikuar nga neni 60 i Kodit Penal do të zbatohet vetëm ndaj kësaj kategorie personash, të cilët janë të pajisur me leje të posaçme për mbajtjen e armëve, ose që i mbajnë këto armë për shkak të detyrës që kryejnë dhe që kanë kryer vepra penale duke përdorur armët e dhëna me leje ose që i mbajnë për shkak të detyrës që kryejnë. Të tillë persona janë ushtarakët, gjyqtarët, policët, rojet, gjahtarët, etj., p.sh., kur një gjahtar, punonjës policie apo i një shoqërie sigurimi dënohet për “*Prishje të rendit publik*” duke përdorur armën, ose kanos një person tjetër me armën e punës, etj.

Rast praktik :

I pandehuri L.F. i moshës 72 vjeç, për disa vjet ka patur në përdorim një armë gjahu, me lejen e organeve kompetente. Gjatë gjykimit rezultoi se, i dënuari L.F. ka patur një grindje për shkaqe banale me fqinjin e tij. Pasi ka përfunduar debati, i filluar nga fqinji i tij, i dënuari L.F. ka shtirë disa herë në ajër, me qëllim që të trembte fqinjin e tij. Gjithashtu, nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi se i dënuari nuk ka qenë i dënuar më parë. Për këtë arsye, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e saj nr. ..., datë 20.11.2009 ka vendosur: “*1. Deklarimin fajtor të të pandehurit L.F. për kryerjen e veprës penale të “Prishjes së qetësisë publike”, të parashikuar nga neni 274 i Kodit Penal dhe në bazë edhe të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale dënohet me 2 (dy) muaj burgim. 2. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, duke e vënë të pandehurin L.F. në provë, për një periudhë kohore prej 18 (tetëmbëdhjetë) muajsh me kusht që gjatë kësaj kohe i pandehuri të mos kryejë asnjë vepër tjetër penale. 3. Në aplikim të nenit 60/10 të Kodit Penal i pandehuri L.F. detyrohet të mos zotërojë apo mbajë armë brenda periudhës së provës”.*

11. Mjekimi apo rehabilitimi në një institucion shëndetësor ose nënshtrimi në një program të trajtimit mjekësor apo rehabilitues. Ky detyrim është i nevojshëm, madje i domosdoshëm të jepet nga gjykata në rastet kur i dënuari është përdorues i lëndëve narkotike apo alkoolit. Ky është një nga llojet e detyrimeve që është aplikuar gjerësisht nga gjykatat në Shqipëri.

Rast praktik :

I pandehuri E.M. i moshës 20 vjeç, ka disa vjet që është përdorues i rregullt i lëndës narkotike *cannabis sativa*. Gjatë gjykimit rezultoi se i pandehuri E.M. prej disa vjetësh ka qenë konsumator i rregullt i lëndës narkotike *cannabis sativa* deri në 5-6 cigare në ditë. Nuk rezultoi që i pandehuri të ketë qenë shpërndarës i kësaj lënde. Sipas aktit të ekspertimit të kryer nga një mjek klinikist toksikolog rezultoi

se sasia prej 4,7 (katër presje shtatë) gramë e kapur të pandehurit E.M. është dozë dy ditore për përdorim vetjak. Gjithashtu, nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi se i dënuari nuk ka qenë i dënuar më parë dhe ka një situatë të rëndë ekonomike në familjen e tij. Për këtë arsye, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e saj nr. ..., datë 04.11.2009 ka vendosur : “1. Deklarimin fajtor të të pandehurit E.M., për kryerjen e veprës penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve“, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 (pesë) vjet burgim. 2. Vuajtja e dënimit ka filluar që nga dita e arrestimit të tij në flagrancë më datë 30.03.2008. 3. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, për pjesën e mbetur pa vuajtur prej 3 (tre) vjetësh, 4 (katër) muaj e 16 (gjashtëmbëdhjetë) ditë, duke e vënë në provë të pandehurin E.M., për një periudhë kohe prej 3 (tre) vjetësh, me kusht që gjatë kësaj kohe i pandehuri të mos kryejë asnjë vepër tjetër penale. 4. Në aplikim të nenit 389 të Kodit të Procedurës Penale urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të pandehurit E.M. nëse i pandehuri nuk mbahet i arrestuar, i ndaluar apo i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale. 5. Në aplikim të pikës 1 dhe 11 të nenit 60 të Kodit Penal Gjykata urdhëron të pandehurin E.M. të ushtrojë një veprimtari profesionale si dhe t’i nënshtrohet një programi rehabilitues kundër varësisë ndaj lëndës narkotike”.

12. Heqja dorë nga përdorimi i alkoolit ose i drogës. Ky detyrim rekomandohet të jepet nga gjykata në rastin e dënimit të personave përdorues të rregullt të lëndëve narkotike ose/dhe alkoolit.

Një çështje që shtrohet për diskutim në rrethet akademike dhe gjyqësore është edhe çështja: A mund të japë gjykata një detyrim tjetër nga detyrimet e përcaktuara në nenin 60 të Kodit Penal?

Sipas formulimit aktual të ligjit penal shqiptar rezulton se detyrimet e nenit 60 të Kodit Penal janë shteruese dhe jo indikative. Kjo do të thotë se gjykata nuk mundet t’i caktojë të dënuarit një detyrim tjetër nga ato të parashikuara nga neni 60 i Kodit Penal. Gjykata është e lirë t’i caktojë më shumë se një nga këto detyrime por asnjëherë një detyrim tjetër, i cili nuk është i parashikuar shprehimisht në nenin 60 të Kodit Penal.

a) Shkelja e kushteve dhe e detyrimeve gjatë kohës së provës (Neni 62 i Kodit Penal)

Nëse i dënuari, gjatë afatit të provës kryen një vepër tjetër penale apo shkel detyrimet ose kushtet e caktuara nga gjykata, hyn në fuqi dhe aplikohet neni 62 i Kodit Penal. Sipas nenit 62 të Kodit Penal parashikohet se:

“Nëse i dënuari, gjatë afatit të provës, kryen një vepër tjetër penale, gjykata mund të ndryshojë detyrimet që ka vendosur, ta zëvendësojë dënimin e dhënë me një dënim tjetër, apo ta revokojë, tërësisht apo pjesërisht, vendimin e pezullimit.

Nëse i dënuari, gjata afatit të provës, shkel kushtet ose detyrimet që i janë vendosur, shërbimi i provës i raporton menjëherë prokurorit.

Për shkelje të lehta dhe për herë të parë të kushteve ose detyrimeve që i janë vendosur nga gjykata, prokurori ka të drejtë të japë paralajmërim, i cili regjistrohet në dosjen personale të të dënuarit.

Për shkelje të rënda ose të përsëritura, prokurori i kërkon gjykatës ndryshimin e detyrimit të vendosur, shtimin e detyrimeve të tjera, zëvendësimin e tyre me një sanksion tjetër, ose revokimin e vendimit të pezullimit të dënimit dhe vuajtjen e pjesës së mbetur të dënimit në burg”.

Nga formulimi i nenit 62 rezulton se ky nen aplikohet në dy situata;

1. i dënuari, gjatë afatit të provës kryen një vepër tjetër penale.
2. i dënuari gjatë afatit të provës shkel kushtet apo detyrimet që i janë vendosur nga gjykata.

Nisur nga këto dy situata, ky nen parashikon aplikimin e tij nga:

1. Prokurori. Prokurori ndërhyt dhe aplikon nenin 62 të Kodit Penal gjatë fazës së ekzekutimit (gjatë kohës së provës), nëse i dënuari i vënë në provë, gjatë kohës së provës shkel detyrimet që i janë vendosur nga gjykata. Në këtë rast, prokurori ka të drejtë t’i bëjë vetëm një paralajmërim të dënuarit, i cili vendoset në dosjen e të dënuarit. Sipas nenit 62 të Kodit Penal, Shërbimi i Provës ka një rol kryesor në identifikimin dhe raportimin e sjelljes së të dënuarit tek prokurori, nëse ajo është në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga gjykata.

2. Gjykata. Gjykata aplikon nenin 62 të Kodit Penal nëse i dënuari:

- gjatë kohës së provës kryen një vepër tjetër penale;
- gjatë kohës së provës kryen një shkelje të rëndë apo të përsëritur të detyrimeve apo kushteve të vendosura në vendimin e dënimit.

Në të dyja këto raste, gjykata investohet vetëm në bazë të një kërkesë të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor të vendit të vuajtjes së dënimit nga i dënuari. Në vendimin e saj gjykata ka të drejtë të vendosë:

- a** ndryshimin e detyrimit të vendosur më parë me një tjetër detyrim. Ky ndryshim do të bëhet i kushtëzuar nga ndryshimi i rrethanave të vuajtjes së dënimit dhe rrethanave në të cilat gjendet i dënuari;
- b** zëvendësimin e dënimit alternative me një dënim tjetër alternativ. Në këtë rast, gjykata mund të aplikojë, p.sh., në vend të nenit 58 të Kodit Penal nenin 59/a të këtij kodi apo nenin 63 të tij, etj.;
- c** revokimin tërësisht apo pjesërisht të dënimit alternative me burgim dhe dërgimin e të dënuarit në I.E.V.P. për vuajtjen e pjesës së mbetur të dënimit me burgim. Kjo është masa më e rëndë që mund të marrë gjykata sipas nenit

62 të Kodit Penal. Për pasojë, kjo masë do të aplikohet kur është e pamundur që dënimi të arrijë qëllimin e tij edukues për shkak të sjelljes shumë të keqe apo/dhe rrezikshmërisë shoqërore të lartë të të dënuarit.

b) Çështja e kompetencës

Sipas formulimit të nenit 470 të Kodit të Procedurës Penal dhe ligjit nr. 8331, datë 16.04.1998, i ndryshuar, “Për ekzekutimin e dënimeve penale”, shqyrtimi i kërkesave për revokim apo zëvendësim do të bëhet nga gjykata e vendit ku është duke u ekzekutuar vendimi, me përjashtim të rastit kur, vendimi ekzekutohet në një shtet të huaj. Në këtë rast kompetente do të jetë gjykata që ka dhënë vendimin.

Kjo mënyrë do të sjellë një ndjekje më të mirë të ekzekutimit të dënimit alternativ, si një kosto të ulët të proceseve gjyqësore.

2.5 Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik (Neni 63 i Kodit Penal)

Kjo është një formë tjetër alternative e vuajtjes së dënimit me burgim. Sipas nenit 63 të Kodit Penal parashikohet se:

“Gjykata, për shkak të rrezikshmërisë së pakët të personit dhe të rrethanave të kryerjes së veprës penale, kur ka caktuar një dënim gjer në një vit burgim, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me detyrimin që i dënuari të përmbushë një punë në interes publik.

Puna me interes publik nënkupton kryerjen nga i dënuari të një pune, me pëlqimin e tij dhe pa shpërblim, në favor të interesit publik apo shoqatës së caktuar në vendimin e gjykatës, për një kohë nga dyzet deri në dyqind e dyzet orë.

Ky detyrim nuk mund të vendoset kur i dënuari refuzon pezullimin në seancë gjyqësore.

Puna në interes publik kryhet brenda afatit prej gjashtë muajsh.

Në vendimin e saj gjykata përcakton numrin e orëve të punës dhe detyrimin që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës. Shërbimi i provës vendos llojin e punës që do të kryhet, përcakton vendin e kryerjes së punës dhe ditët e javës kur do të kryhet ajo, duke pasur parasysh, për aq sa është e mundur, punësimin e rregullt të të dënuarit apo detyrimet e tij familjare. Kohëzgjatja e punës me interes publik nuk i kalon tetë orë në ditë.

Nëse i dënuari nuk kryen punën me interes publik, nuk mban kontakte me shërbimin e provës apo shkel kushtet ose detyrimet e tjera, të vendosura nga gjykata, prokurori informon menjëherë gjykatën. Gjykata, në këtë rast, vendos sipas nenit 62 të këtij Kodi”.

Kjo formë e vuajtjes së dënimit me burgim aplikohet nga gjykata kur plotësohen dy kushte:

Së pari: Gjatë shqyrtimit gjyqësor gjykata çmon se i pandehuri duhet të dënohet jo më shumë se një vit burgim;

Së dyti: Gjatë shqyrtimit gjyqësor gjykata çmon se rrezikshmëria shoqërore e personit që ka kryer veprën penale dhe e rrethanave të kryerjes së kësaj vepre penale është e pakët.

Ky dënim ka një veçanti: nuk mund të jepet nga Gjykata nëse i dënuari nuk e dëshiron. Puna në interes publik konsiston në kryerjen e një pune pa shpërblim, në favor të interesit publik, të komunitetit ku banon i dënuari apo më gjerë. Kjo punë mund të kryhet në një institucion publik apo në një shoqatë të përcaktuar në vendimin e gjykatës. Kohëzgjatja e saj është nga 40 deri në 240 orë dhe duhet të kryhet nga i dënuari brenda një afati prej 6 muajsh.

Neni 63 i Kodit Penal parashikon edhe mënyrën e vuajtjes së këtij dënimi, duke mbajtur parasysh detyrimet familjare të të dënuarit; interesat dhe aftësitë e tij, etj. Në çdo rast koha ditore e punës nuk mund t'i kalojë 8 orë në ditë.

Edhe ky dënim do të revokohet apo do të zëvendësohet nëse i dënuari nuk i përmbahet kushteve të përcaktuara nga gjykata në vendimin e dënimit. Për revokimin apo zëvendësimin e këtij dënimi do të zbatohen të njëjtat rregulla që janë përkrahur më sipër, si në rastin e neneve 58, 59 e 59/a të Kodit Penal.

Mbikëqyrja e ekzekutimit të këtij dënimi realizohet nga Shërbimi i Provës, në përputhje me nenet 48 – 55 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 25.03.2009. Për këtë arsye, Shërbimi i Provës harton dhe zhvillon një program individual për ekzekutimin e vendimit të gjykatës. Gjithashtu, Shërbimi i Provës verifikon dhe njofton prokurorin për rregullsinë e përmbushjes së këtij vendimi dhe detyrimeve të tjera të vendosura nga gjykata në këtë vendim.

2.6 Lirimi me kusht (Neni 64 i Kodit Penal)

Në Kreun VII të Kodit Penal, në nenin 64 të këtij Kodi është parashikuar si një alternativë dënimi edhe lirimi me kusht. Kjo dispozitë ka pësuar në përmbajtjen e saj ndryshime me ligjet nr. 8733, datë 24.01.2001 dhe nr. 10 023, datë 27.11.2008. Në ndryshim nga alternativat e tjera, kjo alternativë dënimi si dhe alternativa e qëndrimit në shtëpi (neni 59/a i Kodit Penal) mund të jepen në fazën e ekzekutimit të dënimit. Kjo do të thotë që nëse plotësohen kriteret ligjore të këtyre dispozitave, shtetasit e dënuar mund t'i drejtohen gjykatës së vendit të vuajtjes së dënimit me kërkesë, duke kërkuar sipas rastit qëndrimin në shtëpi ose lirimin me kusht për pjesën e mbetur të dënimit.

Në përmbajtjen e tij neni 64 i Kodit Penal, i emërtuar *lirimi me kusht*, parashikon se:

“I dënuari me burgim mund të lirohet me kusht, nga vuajtja e dënimit vetëm për arsye të veçanta, nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij, si dhe të ketë vuajtur:

- jo më pak se gjysmën e dënimit të dhënë për kundërvajtje penale;

- jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi gjer në pesë vjet burgim;

- jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi nga pesë gjer në njëzet e pesë vjet burgim;

Në masën e dënimit të vuajtur nuk llogaritet koha e përfituar me amnisti ose falje.

Nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje.

Lirimi me kusht revokohet nga gjykata, kur i dënuari për një vepër penale të kryer me dashje, gjatë kohës së kushtit, kryen një vepër tjetër penale me dashje, po aq të rëndë ose më të rëndë se e para, duke u zbatuar dispozitat për bashkimin e dënimeve”.

Praktika gjyqësore në lidhje me lirimet me kusht është e pasur për ato gjykata që kanë në juridiksionin e tyre institucione të ekzekutimit të vendimeve penale. Për pasojë edhe problematikat e ndeshura gjatë aplikimit të nenit 64 të Kodit Penal janë të ndryshme dhe të shumëllojshme. Ajo që është vënë re gjatë praktikës është pikërisht fakti se nocioni “arsye e veçantë” nuk mbahet parasysh në çdo rast. Praktikienët dhe studiuesit e së drejtës që nuk mbajnë parasysh këtë nocion mjaftohen vetëm me plotësimin e kushteve të tjera. Nga ana tjetër, konstatohet se ka një grup tjetër praktikienësh dhe studiuesish, të cilët mbajnë parasysh në analizat e tyre nocionin “arsye e veçantë”. Këta përkrahës të kësaj ideje i referohen interpretimit literal të dispozitës nga ku rezulton se përcaktohet si një kusht *sine qua non* (domosdoshmëri) nocioni arsye e veçantë, duke u përdorur terminologjia “vetëm për arsye të veçanta”.

Përkufizimi i “arsyes së veçantë” nuk jepet nga Kodi Penal, por është lënë në çmim të gjykatës. Është gjykata ajo dhe asnjë organ tjetër që vlerëson arsyet e paraqitura nga i dënuari nëse janë apo jo arsye të veçanta, në kuptim të nenit 64 të Kodit Penal, por në çdo rast sipas formulimit ligjor duhet të ekzistojë një arsye e veçantë. Sipas formulimit të ri të nenit 64 të Kodit Penal janë dhënë në mënyrë indikative dhe jo shteruese, disa raste të cilat konsiderohen si “arsye të veçanta”. Këto raste janë zhvilluar më tej nga praktika gjyqësore shqiptare deri në Kolegjet Penale të Gjykatës së Lartë. Praktika gjyqësore ka treguar se arsyet e veçanta nuk mund të jenë të njëjta për të dënuar të ndryshëm. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë si “arsye të veçanta” mund të përmenden: “*gjendja e vështirë social-ekonomike e familjes së të dënuarit; gjendja e vështirë shëndetësore e familjarëve të të dënuarit dhe nevoja e tyre për ndihmë dhe asistencë mjekësore; vdekja apo ikja e familjarëve, nga të cilat lihen pa kujdes fëmijët e të dënuarit apo persona të tjerë që ai mund të ketë në ngarkim etj...*”.

Element tjetër i kërkuar nga kjo dispozitë është “*sjellja e të dënuarit*”. Ky parametër duhet parë në dinamikë për gjithë dënimin e vuajtur nga shtetasi i dënuar. Pasi të vlerësohen të gjitha raportet e sjelljes për këtë periudhë, gjykata më pas duhet të çmojë nëse nga konstatimi i gjithë treguesve të sjelljes arrihet qëllimi për edukimin apo risocializimin e këtij të dënuari ose jo. Në praktikë ka lindur për diskutim fakti kur i dënuari gjatë kohës së vuajtjes së dënimit ka marrë disa masa disiplinore dhe të gjitha këto masa janë parashkruar në kuptim të nenit 54/3 të ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar.

Në lidhje me vlerësimin e këtij momenti, në praktikën gjyqësore konstatohen dy shkolla mendimi: Nga njëra anë ka prakticienë të së drejtës të cilët ndajnë mendimin se personi i dënuar do e vuajë ndëshkimin disiplinor për një shkelje administrative të kryer për aq kohë sa ajo nuk është parashkruar. Në këtë logjikë, personit të dënuar nuk mund t'i privohen përfitimet ligjore pafundësisht. Kjo pasi fakti që ligjvënësi ka vënë një periudhë 6 mujore për shuarjen e masës disiplinore, tregon qartazi se qëllimi dhe fryma e ligjit është pikërisht rehabilitimi i të gjithë të dënuarve që vuajnë dënimin me kalimin e afateve ligjore, për t'u legjitimuar në gjykatë si përfitues të ligjit, në rastin konkret të lirimit me kusht.

Nga ana tjetër, përkrahësit e shkollës së dytë ndajnë mendimin se pavarësisht faktit se me kalimin e 6 muajve masat disiplinore të dhëna ndaj të dënuarit shuhen, gjykata në vlerësimin e saj të raporteve të vlerësimit të sjelljeve ndaj një të dënuari, të para në dinamikën e saj mund të marrë parasysh edhe masat disiplinore të dhëna një të dënuari. Të gjitha këto vlerësime në kompleks, të cilat krijojnë bindjen subjektive për gjykatën në lidhje me qëndrimin ose jo të këtij të dënuari në I.E.V.P. Sipas këtij mendimi edhe pse një shtetas i dënuar mund të përmbushë të gjitha kushtet ligjore të nenit 64 të Kodit Penal, nëse gjatë qëndrimit në vendin e vuajtjes së dënimit ka kryer një shkelje, ky veprim do merret në konsideratë nga gjykata në vlerësimin e sjelljes së tij, pavarësisht nëse është shuar. Kjo mund të ndikojë negativisht në faktin nëse i është arritur qëllimit për riintegrimin e të dënuarit në shoqëri.

Element tjetër i vlerësimit nga gjykata, i cili duhet të merret në konsideratë përveç parametrin të sjelljes është edhe parametri i punës së të dënuarit, e cila gjithashtu si sjellja duhet parë në funksion të arritjes së qëllimit për edukimin e të dënuarit. Ligjvënësi nuk përdor në parashikimin e këtyre dy parametrave, elementin fakultativ, por kërkon si pjesë të vlerësimit të gjykatës, të të dyjave këtyre parametrave njëkohësisht duke parashikuar nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimit për edukimin e tij.

Sipas kësaj fraze të këtij parashikimi ligjor është pikërisht gjykata ajo që krahas vlerësimit të sjelljes së një të dënuari duhet të vlerësojë dhe parametrin e punës së kryer nga i dënuari në institucionin e vuajtjes së dënimit. Ky parameter vlerësohet ashtu si dhe sjellja në dinamikën e gjithë periudhës së vuajtur të dënimit. Vlerësimi i gjykatës mund të bazohet në raportet dhe vlerësimet e punës që ndodhen në dosjen personale të të dënuarit. Ato mund të jenë raporte të veçanta vetëm mbi vlerësimin e punës, por mundet që të jenë rubrika të veçanta brenda raporteve të vlerësimit të sjelljeve. Në funksion të kryerjes së punëve, të dënuarit përfitojnë dhe ulje dënimi, pikërisht për shkak të kryerjes së tyre në institucion. Në këtë kuptim, edhe uljet e ditëve që ka përfituar i dënuari për shkak të kryerjes së punëve në institucion, duhet të merren në analizë nga gjykata gjatë vlerësimit të kriterit “punë”.

Në praktikë ka lindur një diskutim në lidhje me vlerësimin e parametrin punë. Kjo pasi nga njëra anë ligji kërkon që të vlerësohet edhe elementi “punë”, kurse nga ana tjetër ka shumë institucione të ekzekutimit të vendimeve penale që nuk kanë mundësi objektive t’iu ofrojnë punë të gjithë të dënuarve. Kështu për ilustrim po sjellim si shembull një Institucion të ri të Ekzekutimit të Vendimeve Penale siç është ai i Korçës, ku vuajnë dënimin në sigurinë e lartë dhe të zakonshme të këtij institucioni mbi 200 të dënuar.

Gjatë shqyrtimit të kërkesave të të dënuarve që vuajnë dënimin në këtë institucion me objekt lirim me kusht konstatohet se pjesa më e madhe e këtyre të dënuarve kanë bërë kërkesa për punë, por vetëm një pjesë të vogël të tyre u ishte ofruar punë nga institucioni. Kjo pasi vetë kushtet e këtij institucioni nuk mundësojnë për shkaqe objektive që të punësohen të gjithë të dënuarit. Në të tilla kushte, ajo që shtrohet për diskutim te qarqet e gjyqtarëve, prokurorëve, avokatëve apo studiuesve të së drejtës është pikërisht fakti se si do vlerësohet elementi “punë” i kërkuar nga ligji në kushtet kur vetë institucionet nuk u ofrojnë këtë mundësi të dënuarve që kërkojnë të punojnë.

Ka një grup studiuesish dhe prakticienësh të së drejtës të cilët janë të mendimit që një i dënuar nuk mund të “penalizohet” me vlerësimin negativ të këtij parametri kur i dënuari ka bërë kërkesë për punë, e cila duhet të jetë e dokumentuar dhe institucioni i vuajtjes së dënimit nuk ka mundësi objektive t’i krijojë kushte për të punuar, pasi mundësitë i ka të kufizuara. Kjo pasi edhe pse ligji kërkon vlerësimin e këtij parametri, në këtë rast nuk ka mundësi objektive vlerësimi nga gjykata.

Ajo që mund të jetë objekt vlerësimi është rasti kur i dënuari nuk ka depozituar në institucion kërkesë për punë pavarësisht faktit nëse institucioni e ofron ose jo këtë punë. Kjo pasi mosbërja e kërkesës për punë nga i dënuari mund të interpretohet si një mosshfaqje vullneti dhe dëshirë për të punuar.

Gjithsesi, mënyra sesi është formuluar dispozita në lidhje me këto dy parametra, tregon se vlerësimi duhet të jetë në kompleks dhe jo i veçuar. Ajo që kërkohet nga ligji është fakti se mjafton që nga ky vlerësim i këtyre dy parametrave të marra së bashku të vërtetohet se me pjesën e vuajtur të dënimit nga i dënuari i është arritur plotësisht qëllimit për edukimin e tij.

Një kriter tjetër ligjor, i cili kërkohet nga ligji në aplikimin e nenit 64 të Kodit Penal është pikërisht dhe vuajtja e një periudhe të caktuar të dënimit, i cili duhet të jetë kohë efektive dhe se varion:

- ▣ *jo më pak se gjysmën e dënimit të dhënë për kundërvajtje penale;*
- ▣ *jo më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi gjer në pesë vjet burgim;*
- ▣ *jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi nga pesë gjer në njëzet e pesë vjet burgim.*

Në praktikë kanë lindur dy grupe mendimesh në lidhje me mënyrën e realizimit të këtij

kushti. Njëra shkollë mendimi në analizën e nocionit “masë” i referohet vetëm dënimit të dhënë, p.sh., nëse dënimi është nën 5 vjet do llogaritet $2/3$ dhe nëse është mbi 5 vjet do llogaritet me $3/4$. Vlen për t’u theksuar se këtë mendim e kanë një pjesë e vogël e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Nga ana tjetër, përkrahësit e shkollës së dytë të mendimit përkrahin idenë se nisur nga interpretimi literal, logjik, por edhe teologjik i kësaj pjese të dispozitës për të përcaktuar se me çfarë kriteri do përllogaritet koha efektive e dënimit të vuajtur, i referohen marzhit të dënimit që parashikon vepra penale për të cilën është akuzuar dhe dënuar shtetasi. Në këtë kuptim sipas përkrahësve të kësaj ideje fillimisht shihet marzhi i veprës penale për të përcaktuar më pas nëse përllogaritja do bëhet me $2/3$ apo me $3/4$. Kështu, nëse personi është dënuar për një vepër penale të përcaktuar si krim, por që ka në maksimum si dënim 5 vjet burgim, shtetasi i dënuar legjitimohet t’i drejtohej gjykatës pasi të kishte vuajtur $2/3$ e dënimit të dhënë.

Rast praktik: Shtetasi A është deklaruar fajtor për veprën penale të vrasjes në tronditje të fortë psikike të çastit, ngelur në fazën e tentativës dhe se bazuar në nenet 82 e 22 të Kodit Penal ishte dënuar përfundimisht me 2 vjet burgim. Konstatohet se vepra për të cilën është deklaruar fajtor dhe dënuar shtetasi A ka një marzh dënimi që varion nga 5 ditë deri në 8 vjet burgim. Duke qene se marzhi i dënimit për veprën për të cilën është dënuar ky shtetas ka në maksimum më shumë se 5 vjet burgim, atëherë llogaritja e kohës së vuajtur të dënimit do llogaritet me $3/4$. Në këtë kuptim, ky i dënuar duhet të ketë vuajtur $2 \text{ vjet} \times 3/4 = 1 \text{ vit}$ e gjysmë burgim që të legjitimohet në kuptimin formal procedural për t’iu drejtuar gjykatës me kërkesë për lirim me kusht.

Ajo që mund të jetë objekt diskutimi për përkrahësit e shkollës së parë të mendimit që i referohen nocionit masës së dënimit të dhënë, lind pyetja se sa duhet të ketë vuajtur shtetasi i cili është dënuar për një vepër penale me 5 vjet burgim. Duke qenë se ky kriter është kriteri lidhës, vuajtja e dënimit do llogaritet në këtë rast hipotetik me $2/3$ apo me $3/4$ e dënimit prej 5 vjetësh.

Problem tjetër i hasur nga praktika gjyqësore është fakti nëse në masën e dënimit të vuajtur nuk do të llogaritet vetëm koha e përfituar me amnisti ose falje, apo edhe koha e fituar për shkak të paraburgimit, të punës ose me vendim gjykate (ulje dënimi sipas nenit 63 të ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar). Edhe në lidhje me këtë moment janë shfaqur dy shkolla mendimi.

Përkrahësit e shkollës së parë të mendimit përkrahin idenë se qëllimi i vetë ligjvënësit në parashikimin e kësaj dispozite ka qenë referuar termit “kohë efektive e vuajtur e dënimit”. Si rrjedhim i kësaj, këta përkrahës janë të mendimit se pavarësisht formulimit ligjor, përllogaritja e kohës së dënimit duhet bërë referuar vetëm kohës efektive të vuajtur nga shtetasi duke përjashtuar çdo lloj ulje apo përfitimi tjetër.

Përkrahësit e shkollës së dytë të mendimit i referohen në mënyrë strikte formulimit ligjor të dispozitës si dhe interpretimit literal të saj. Sipas këtyre përkrahësve nuk do llogaritet në dënimin e vuajtur vetëm koha e përfituar nga i dënuari me amnisti nga Kuvendi ose me falje me Dekret të Presidentit të Republikës. Të gjitha uljet e tjera që i dënuari i përfiton për shkak të ligjit, si llogaritja e paraburgimit (me 1.5 ditë), ose përfitimi i disa ditëve në varësi të kohës së punës dhe volumit të punës së kryer nga i dënuari në institucion apo uljet që përfitojnë të dënuarit me vendim gjykate të cilat nuk mund të jenë më shumë se 90 ditë në vit për të dënuarit që vuajnë dënimet në burgjet e sigurisë së zakonshme dhe jo më shumë se 45 ditë në vit për të dënuarit që vuajnë dënimet në burgjet e sigurisë së lartë, llogariten në kriterin ligjor të kërkuar për një të dënuar i cili kërkon lirimin me kusht.

Po kështu, sipas këtyre përkrahësve edhe pse formulimi i kësaj pjese të dispozitës mund të kishte një mospërputhje me vetë interpretimin logjik të përmbajtjes së dispozitës, pikërisht kjo ka qenë fryma dhe qëllimi i ligjvënësit. Kjo pasi ligjvënësi i kishte pasur të gjitha mundësitë që në ndryshimet e fundit që i janë bërë kreut mbi alternativat e dënimit me burgim, të kishte përjashtuar nga llogaritja e vuajtjes së dënimit dhe përfitimet e tjera të të dënuarve, përveç amnistisë dhe faljes, meqenëse ligji nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” kishte dalë pas parashikimit fillestar të nenit 64 të Kodit Penal.

Në praktikën gjyqësore është shtruar për diskutim gjatë zbatimit të nenit 64 të Kodit Penal nëse gjykatat mund të lirojnë me kusht persona të dënuar më parë për krime të kryera me dashje, por që në momentin e bërjes së kërkesës kanë qenë të rehabilituar.

Mënyra sesi është formuluar dispozita tregon se qëllimi i ligjvënësit ka qenë që të përjashtojë nga ky përfitim ligjor të gjithë të dënuarit përsëritës për krime të kryera me dashje, duke e ngushtuar sferën e përjashtimit të subjekteve përfitues. Pra, dispozita i referohet nocionit “*i dënuar*”.

Nga ana tjetër, ligji material penal parashikon në nenin 69 të tij se në cilat raste personat do quhen të padënuar apo të rehabilituar. Në këtë kuptim me kalimin e afateve të përcaktuara në nenin 69 të Kodit Penal, gjendja gjyqësore e personave të dënuar do jetë e bardhë dhe se këta persona humbasin statusin e të dënuarit. Kjo do të thotë se nëse një të dënuari për krime të kryera me dashje:

- i kanë kaluar afatet e rehabilitimit
- është duke vuajtur dënimin për një vepër tjetër, si dhe
- plotëson të gjitha kriteret e tjera ligjore të nenit 64 të Kodit Penal,

ai ka të drejtë t’i drejtohet gjykatës për lirimin me kusht.

Nga ana tjetër, ka mendime që për efekt të kësaj dispozite, personat që janë dënuar për krime të kryera me dashje dhe që po vuajnë një dënim për një vepër tjetër edhe pse i

përmbushin të gjitha kriteret e tjera ligjore të nenit 64 të Kodit Penal, nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga kjo dispozitë, pasi qenia e rehabilituar nuk mund t'i shtrijë efektet tek kjo dispozitë.

Nisur nga këto argumente të përkrahësve të këtij mendimi, konstatohet se ligjvënësi nuk bën një ndarje se çfarë dhe kur mund të përfitojë personi i rehabilituar. Kjo pasi e vetmja ndarje ligjore në këndvështrimin penal është në persona të dënuar dhe persona të padënuar ose të rehabilituar dhe se fitimi i cilësisë së të qenit i rehabilituar është një e drejtë që të çon tek çdo përfitim ligjor dhe jo në privime nga këto përfitime ligjore në raste të caktuara.

Pra, në këtë këndvështrim vetëm gjatë kohës që do quhen të dënuar për krime të kryera me dashje shtetasit nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga neni 64 i Kodit Penal, kurse për të gjitha rastet e tjera ata nuk kanë asnjë lloj pengese që t'i drejtohen gjykatës dhe të përfitojnë kur plotësohen dhe kriteret e tjera ligjore.

Neni 64 në emërtimin e tij përdor formulimin “*lirimi me kusht*”. Nisur nga ky formulim në praktikën gjyqësore ekzistojnë dy grupe studiuesish dhe prakticienësh, të cilët janë të ndarë në mendime në lidhje me faktin se sa do të jetë koha e kushtit. Vetë kjo dispozitë në lidhje me këtë moment nuk bën asnjë parashikim ligjor. Si rrjedhim, janë krijuar dy shkolla mendimi me argumentet përkatëse në lidhje me faktin se sa duhet të jetë kjo kohë kushti.

Referuesit e njëres ide mendojnë se koha e kushtit duhet të jetë sa pjesa e pavuajtur e dënimit për të cilën i dënuari lirohet me vendim gjykate, pra, nëse një person ka vuajtur 3 vjet e gjysmë për një vepër penale për të cilën është dënuar 4 vjet burgim dhe më pas lirohet me kusht, koha e kushtit sipas këtyre përkrahësve do të jetë vetëm 6 muaj. Pra, përgjithësisht kohëzgjatja e kushtit për këta përkrahës nisur nga kriteri përcaktues që ata përdorin është një kohë relativisht e vogël.

Përkrahësit e idesë së dytë mendojnë dhe mbështesin idenë se koha e kushtit duhet të jetë sa koha (afati) i vënies në provë të personit. Këta përkrahës, duke njehsuar kohën e kushtit me kohën e provës, mendojnë se afati duhet të jetë 18 muaj deri në 5 vjet. Nga ana tjetër, vetë dispozita materiale (neni 64 i Kodit Penal) në asnjë parashikim të përmbajtjes së saj nuk përmend apo referon si kohë kushti kohën e vënies në provë që parashikon neni 59 i Kodit Penal.

Gjithashtu rezulton se ekziston dhe një mendim tjetër doktrinar jo shumë i përhapur sipas të cilit koha e kushtit duhet të jetë sa afati i parashkrimit i veprës penale për të cilën është dënuar shtetasi. Duke qenë se kjo ide i vë të gjithë të dënuarit e liruar me kusht në pozita jo të favorshme, ajo nuk ka gjetur mbështetje në praktikën gjyqësore.

Nga ana tjetër konstatohet se ligjvënësi në nenin 64 të Kodit Penal përdor në formulim termin “*gjatë kohës së kushtit*”. Duke qenë një parashkrim i tillë, kjo kohë nuk mund të

njehsohet me kohën e provës, por do jetë një kohë tjetër. Ky argument përforcohet më tepër edhe nga fakti se dispozita ka pasur ndryshime kohët e fundit dhe nëse ligjvënësi do kishte si qëllim që kjo kohë të ishte e njëjtë me kohën e provës nuk do të kishte asnjë pengesë që ta parashikonte shprehimisht tek kjo dispozitë. Pra, qëllimi i ligjvënësit ka qenë për një kohë tjetër kushti, të ndryshme nga ajo e provës. Ajo që ligjvënësi nuk ka zgjidhur është pikërisht afati i kësaj kohe kushti. Megjithatë, në këtë situatë faktike për oportunitet ligjor, koha e provës do ishte një afat kohe i përshtatshëm që mund të shërbente edhe si afat kushti, deri në një rregullim ligjor të dispozitës.

Një problem tjetër i dalë nga praktika gjyqësore në lidhje me këtë dispozitë është pikërisht fakti nëse personit të liruar me kusht duhet t'i vendosen detyrime apo jo. Nëse i referohemi në mënyrë strikte formulimit të dispozitës, nenit 64 të Kodit Penal, rezulton se ligjvënësi nuk ka parashikuar asnjë lloj detyrimi për gjykatën që t'i caktojë personit të liruar me kusht një ose disa detyrime, ashtu siç parashikon neni 60 dhe 61 i po këtij Kodi, për dënimet e tjera alternative. Nga ana tjetër, ligji nr. 10 024, datë 27.11.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, në nenin 31/6 të tij, konkretisht te tre paragrafët e fundit të tij, ka parashikuar detyrimin e personit të liruar me kusht që t'i raportojë rregullisht shërbimit të provës gjatë kohës së lirimit me kusht. Ky i dënuar i liruar me kusht ka gjithashtu detyrimin të njoftojë paraprakisht Shërbimin e Provës dhe organet vendore të policisë së shtetit në rast se ndryshon vendbanimin, duke dhënë dhe arsyet e këtij ndryshimi. Paragrafi i fundit i kësaj dispozite parashikon dhe të drejtën që ka shërbimi i provës që t'i kërkojë prokurorit ndryshimin e një ose të disa detyrimeve të personit të liruar me kusht kur ai nuk është në gjendje t'i përmbushë ato. Një parashikim i tillë ligjor tregon se personit të liruar me kusht mund t'i vendosen një ose disa detyrime nga gjykata. Nga ana tjetër, dispozita materiale e Kodit Penal (neni 64) në lidhje me këtë moment është blankete. Po kështu dhe vetë ligji që parashikon nocionin “*detyrime ndaj personit të liruar me kusht*”, nuk përcakton se cilat janë konkretisht këto detyrime.

Në këtë këndvështrim praktika gjyqësore është shfaqur në dy mënyra. Ka një praktikë gjyqësore ku gjykata në vendimin e saj përcakton dhe një ose disa detyrime që duhet të respektojë personi i liruar me kusht duke argumentuar dhënien e këtyre detyrimeve me faktin se detyrimet e përcaktuara në nenin 60 dhe 61 të Kodit Penal vlejné për të gjitha dënimet alternative, përfshirë dhe lirimin me kusht. Po kështu një argument tjetër i përkrahësve të kësaj praktike gjyqësore është dhe fakti që nëse do pranohet si periudhë kushti periudhën e provës, gjykata mund t'i vendosë personit të liruar me kusht një ose disa detyrime sipas rastit, njësoj si personin e vënë në provë, në varësi të rrethanave të çështjes dhe natyrës së veprës së konsumuar. Për ta ilustruar po paraqesim një rast praktik ku Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me vendimin e saj nr., datë 27.01.2010 kur ka disponuar lirimin me kusht të të dënuarit K.E, përveçse e ka vënë në provë për një afat të caktuar, i ka caktuar disa detyrime të cilat konsistojnë në ushtrimin e një veprimtarie profesionale ose të marrë formim profesional, të mos shoqërohej me personat e dënuar bashkëpunëtorë të veprës penale të kryer, si dhe të mos mbante armë.

Nga ana tjetër konstatohet se ka një praktikë të dytë gjyqësore ku gjykatat në aplikimin e lirimimit me kusht nuk i vënë personit të liruar asnjë detyrim nga ato të parashikuara nga nenet 60 dhe 61 të Kodit Penal. Përkrahësit e kësaj praktike mjaftohen vetëm me urdhërimin e personit të dënuar për lirimimin me kusht.

Ka gjithashtu raste nga praktika gjyqësore kur gjykatat në diapozitivin e vendimit përveç faktit që disponojnë në lidhje me lirimimin me kusht të personit të dënuar, shprehen edhe për detyrimin që ka personi i dënuar i liruar me kusht që gjatë kohës së kushtit të mos kryejë vepër tjetër penale me dashje.

Nisur nga mënyra se si është formuluar, por edhe nga interpretimi literal i këtij paragrafi të dispozitës (neni 64, paragrafi i fundit i Kodit Penal), rezulton se aplikimi i pikërisht këtij paragrafi në praktikë ka hapur diskutime midis juristëve. Kjo pasi ligjvënësi revokon vendimin e lirimimit me kusht vetëm për të dënuarit e liruar që kanë kryer vepër penale me dashje dhe vetëm kur gjatë kohës së kushtit kryejnë një vepër tjetër penale, po me dashje. Në këtë këndvështrim ligjvënësi nuk parashikon se si do të veprohet në rastet kur personi i liruar me kusht i dënuar për një vepër me dashje, kryen gjatë kohës së kushtit një vepër penale në pakujdesi apo në rastet kur personi i liruar me kusht për një vepër penale të kryer nga pakujdesia dhe që gjatë kohës së kushtit kryen një vepër penale të kryer me dashje. Duke ju referuar parashikimit ligjor rezulton se në të dyja këto raste, gjykata pasi jep vendim, dënimi ekzekutohet nga i dënuari dhe se pjesa e kushtit për veprën e parë i pushon efektet juridike.

Ajo që konstatohet gjithashtu në lidhje me këtë moment është fakti se dispozita (neni 64) nuk bën ndonjë parashikim ligjor për mënyrën se si veprohet apo për procedurat që duhet të respektojnë subjektet procedurale në rast se janë kushtet për revokimin e dënimit për personin e liruar me kusht, ashtu siç parashikohet për dënimet e tjera alternative në rastet kur shkelen kushtet dhe detyrimet gjatë kohës së provës në nenin 62 të Kodit Penal.

Megjithatë, pavarësisht mungesës së një parashikimi të tillë juristët ndajnë mendimin që procedura e ndjekur duhet të jetë e njëjtë si tek dënimet e tjera alternative. Në këto raste është pikërisht organi i cili merret me mbikëqyrjen e ekzekutimit të këtij vendimi, që është shërbimi i provës, i cili në çdo rast njofton organin e prokurorisë, organ i cili pasi konstaton se jemi në kushtet e nenit 64, paragrafi i fundit, i bën kërkesë gjykatës ku kërkon revokimin e vendimit me të cilin është liruar me kusht i dënuari dhe bashkimin e dënimeve midis këtyre dy vendimeve. Nga ana tjetër dhe vetë ligji nr. 10 024, datë 27.11.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, në nenin 31/10 të tij, parashikon procedurat që duhen ndjekur gjatë shqyrtimit të një kërkesë me objekt revokimin e dënimit alternativ.

Ajo që shtrohet për diskutim së pari është fakti se cilat dënime duhet të bashkohen në rastin e revokimit të vendimit të lirimimit me kusht. Për t'i dhënë një përgjigje kësaj pyetjeje duhet që t'i referohemi fillimisht dispozitave mbi bashkimin e dënimeve. Referuar përmbajtjes së tyre rezulton se edhe në rastin objekt studimi gjykata duhet që të

bëjë bashkimin e dënimit të mbetur pa vuajtur për të cilin është liruar me kusht personi me dënimin e ri për veprën tjetër penale të kryer pa dashje. Kështu për të ilustruar këtë fakt po paraqesim një shembull për një person që është dënuar për një vepër penale të kryer me dashje dhe lirohet me kusht në momentin që i ka mbetur pa vuajtur dhe 6 muaj burgim dhe gjatë kohës së kushtit kryen po një vepër tjetër me dashje për të cilën dënohet me 5 vjet burgim. Pasi dhe ky vendim të ketë marrë formë të prerë zbatohen dispozitat mbi bashkimin e dënimeve midis 6 muaj burgim dhe 5 vjet burgim, duke iu referuar nenit 56/2 të Kodit Penal.

Ligjvënësi shqiptar, si rregull, lejon lirimin me kusht kur përmbushen të gjitha kushtet dhe kriteret e nenit 64 të Kodit Penal, vetëm për të dënuarit me burgim deri në 25 vjet, por nga ana tjetër parashikon edhe përjashtime nga rregulli. Kështu, në nenin 65 të Kodit Penal parashikohet se:

*“Nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin me burgim të përjetshëm. Vetëm në raste të jashtëzakonshme i dënuari me burgim të përjetshëm mund të lirohet me kusht kur:
Ka vuajtur jo më pak se njëzet e pesë vjet burgim dhe, gjatë vuajtjes së dënimit ka mbajtur sjellje shembullore dhe çmohet se i është arritur qëllimit të dënimit për edukimin e tij”.*

Sipas parashikimit ligjor të kësaj dispozite, i dënuari me burgim të përjetshëm mund të lirohet nga gjykata vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe kur plotësohen njëkohësisht tre kushte ligjore, të cilat janë:

Së pari: Të kishte vuajtur jo më pak se njëzet e pesë vjet burgim.

Së dyti: Gjatë vuajtjes së dënimit të kishte mbajtur sjellje shembullore dhe

Së treti: Çmohet se në këtë periudhë të vuajtjes së dënimit dhe me këtë sjellje i ishte arritur qëllimit të dënimit për edukimin e tij.

Qëllimi i ligjvënësit në këtë rast ka qenë vendosja e kriterëve ligjore tepër të larta për lirimin me kusht nisur nga rrezikshmëria e veprës penale dhe e të dënuarve, për shkak të të cilave këta shtetas janë dënuar me burgim të përjetshëm. Përveç faktit që ligjvënësi kërkon vuajtjen e jo më pak se 25 vjet burgim kërkon gjithashtu se gjatë kësaj periudhe dinamika e sjelljes të jetë e vlerësuar shembullore, çka kërkon një disiplinë dhe sjellje tepër pozitive për të dënuarit, të cilat e kategorizojnë rastin si të jashtëzakonshëm. Në këtë këndvështrim, duke qenë kërkesat tepër të larta të ligjit është vështirë praktikisht që të aplikohet një dispozitë e tillë. Kjo pasi do ishte pothuaj hipotetike dhe pothuaj e pamundur që i dënuari të kishte vuajtur mbi 25 vjet burgim dhe se gjatë gjithë periudhës të ishte vlerësuar në mënyrë shembullore.

Në lidhje me aplikimin e nenit 64 dhe 65 të Kodit Penal, e vetmja dispozitë procedurale në Kodin e Procedurës Penale është neni 477 i tij, i cili parashikon se:

- ➔ *Gjykata e vendit të ekzekutimit vendos për lirimin me kusht dhe revokimin e vendimit të lirimit me kusht, sipas kriterëve të caktuara në Kodin Penal.*
- ➔ *Kërkesa nuk mund të përsëritet para se të kenë kaluar gjashtë muaj nga dita kur vendimi i rrëzimit të kërkesës ka marrë formë të prerë.*

Kjo dispozitë procedurale parashikon si gjykatë kompetente për shqyrtimin e kërkesave të lirimit me kusht, gjykatën e vendit të ekzekutimit të dënimit. Po sipas përmbajtjes së kësaj dispozite, në rast se gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës, një kërkesë e tillë me të njëjtin objekt mund të ngrihet vetëm pasi të kenë kaluar 6 muaj nga dita që vendimi të ketë marrë formë të prerë. Në praktikën gjyqësore është konstatuar fakti se të dënuarit bazuar në të drejtat e tyre, çmojnë se nuk përmbushin për momentin ndonjë kriter ligjor nga ato të nenit 64 të Kodit Penal apo për të ushtruar të drejtën e tyre për të hequr dorë nga gjykimi i kërkesës, duke kërkuar pushimin e gjykimit dhe më pas për ta ushtruar këtë të drejtë në një moment tjetër. Kështu për vitin 2009, vetëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë janë pushuar për shkak të heqjes dorë nga gjykimi 49 kërkesa me objekt lirimin me kusht. Nga ana tjetër, shumë gjykata kanë unifikuar praktikën në lidhje me çështjet e pushuara duke ia kaluar të njëjtit gjyqtar që ka pushuar çështjen fillimisht. Kjo me qëllim që të ndërpriteshin kërkesat abuzive nga të dënuarit.

Praktika gjyqësore në lidhje me aplikimin e lirimit me kusht po gjen një përhapje të gjerë.

Kështu, vetëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë gjatë vitit 2009 janë aplikuar 17 lirime me kusht. Një gjë e tillë tregon qartë se nga ana e gjyqtarëve dhe prokurorëve po kuptohet si duhet qëllimi i kësaj dispozite, duke e bërë të zbatueshme edhe në praktikë.

Edhe shtetasit shqiptarë që janë dënuar jashtë shtetit për vepra të ndryshme penale dhe janë transferuar në Shqipëri për të vuajtur dënimin kanë të drejtë të kërkojnë lirimin me kusht nëse plotësojnë kriteret ligjore të nenit 64 të Kodit Penal. Kjo pasi këta shtetas pavarësisht nëse janë dënuar në shtete të ndryshme, nëse e kanë përfunduar procedurën ligjore të njohjes dhe zbatimit të vendimit penal të atij shteti dhe janë transferuar në I.E.V.P.-të në Shqipëri, ata përfitojnë njësoj si të gjithë shtetasit e tjerë që vuajnë dënimin në këto institucione, përfshirë dhe lirimin me kusht.

Ajo çka është shtruar për diskutim në praktikën gjyqësore është çështja nëse do të përfitojë lirim me kusht një i dënuar në shtetin shqiptar, por që ka një shtetësi të huaj dhe me vendbanim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Nëse i referohemi Kushtetutës së Shqipërisë, në nenin 16 të saj parashikohet në mënyrë të qartë se personat e huaj që nuk janë shtetas shqiptarë gëzojnë të njëjtat të drejta me shtetasit shqiptarë. Si rrjedhim, ata gëzojnë të njëjtat të drejta si shtetasit shqiptarë, përfshirë dhe të drejtat për të kërkuar aplikimin e dënimeve alternative, qoftë ky dhe lirim me kusht nëse plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore.

Objekt diskutimi në lidhje me këta shtetas është pikërisht mënyra e mbikëqyrjes së tyre në fazën e ekzekutimit. Rregullimi i mbikëqyrjes së këtyre dënimeve, e veçanërisht i atij

të lirit me kusht, është bërë bazuar në parashikimet e akteve me karakter ndërkombëtar të ratifikuara nga shteti shqiptar, si dhe nga neni 60 i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 25.03.2009. Një akt i tillë ndërkombëtar është dhe Konventa Evropiane për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose liruar me kusht. Kjo Konventë është ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 8724, datë 26.12.2000.

Sipas nenit 5 dhe 6 të kësaj Konvente rezulton se shteti që ka dhënë dënimin mund t'i kërkojë shtetit në territorin e të cilit i dënuari ka vendbanimin e tij të zakonshëm që:

- a** *të realizojë vetëm mbikëqyrjen*
- b** *të realizojë mbikëqyrjen dhe kur është e nevojshme të bëjë dhe ekzekutimin, dhe*
- c** *të realizojë zbatimin e plotë të dënimit.*

Në këto raste mbikëqyrja, ekzekutimi ose zbatimi i plotë i dënimit përmbushen nga shteti në territorin e të cilit i dënuari (autori i veprës penale) ka caktuar vendbanimin e tij. Si rrjedhim, shteti kërkues dhe shteti i kërkuar informojnë njëri-tjetrin reciprokisht në lidhje me çdo rrethanë që ka të bëjë me përmbushjen e masave të mbikëqyrjes gjatë periudhës së provës në territorin e shtetit të kërkuar.

Sipas përmbajtjes së dispozitave të kësaj Konvente e konkretisht nenit 11/2 të saj, rezulton se masat e mbikëqyrjes që zbatohen nga shteti i kërkuar nuk mundet në asnjë rast të rëndohen nga natyra ose kohëzgjatja e tyre nga çka parashikon shteti kërkues.

Në nenin 27, Konventa parashikon se rruga e zakonshme nëpërmjet së cilës kalon kërkesa por edhe përgjigja e kërkesës është nëpërmjet dy Ministrive të Drejtësisë së shtetit kërkues dhe shtetit të kërkuar. Megjithatë Konventa parashikon që komunikimet e nevojshme mund të bëhen dhe drejtpërdrejt midis autoriteteve të palëve kontraktuese dhe në raste urgjente nëpërmjet Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (Interpol).

Po kështu nga tërësia e përmbajtjes së dispozitave të kësaj Konvente, e cila pas ratifikimit është bërë pjesë e rendit juridik të brendshëm të shtetit shqiptar, rezulton në mënyrë të qartë se mbikëqyrja e dënimeve alternative të dhëna nga gjykatat shqiptare për shtetasit e huaj me vendbanim në territorin e një shteti tjetër është plotësisht e realizueshme. Kjo do të thotë që dhënia e dënimeve alternative duhet bërë njësoj jo vetëm për shtetasit shqiptarë por edhe për shtetasit e huaj, mjafton që të plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore të kërkuara nga ligji penal shqiptar.



1 INSTITUTI I SHËRBIMIT TË PROVËS, ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I TIJ. MODELET E STANDARDIZUARA TË SHËRBIMIT TË PROVËS

1.1 Instituti i Shërbimit të Provës

Qëllimi kryesor i paketës ligjore mbi dënimet alternative,⁴² krahas reformimit të alternativave të dënimit me burgim, është edhe krijimi i infrastrukturës së përshtatshme për mbikëqyrjen e alternativave nëpërmjet prezantimit të institucionit shtetëror të Shërbimit të Provës.⁴³ Ligji nr. 10 024/2008 bën një prezantim të përgjithshëm të Shërbimit të Provës, duke deleguar rregullat e detajuara për organizimin dhe funksionimin e tij në akte nënligjore në përputhje me standardet e nenit 118 të Kushtetutës. Në bazë dhe zbatim të ligjit nr. 10 024/2008, janë miratuar dy akte nënligjore me karakter normativ:

(i) Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 25.03.2009⁴⁴ “Për miratimin e Rregullores ‘Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve e të procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative’”. Sikundër parashikohet që në nenin 1 të saj, objekti i rregullores është përcaktimi i rregullave lidhur me:

- a) rolin e Shërbimit të Provës në çdo fazë të procedimit penal;
- b) organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës;
- c) statusin e punonjësve të Shërbimit të Provës;
- ç) standardet dhe procedurat e mbikëqyrjes së ekzekutimit të dënimeve alternative;
- d) mënyrën e realizimit të të drejtave të të dënuarve.

(ii) Urdhri i Ministrit të Drejtësisë nr. 6325, datë 31.07.2009⁴⁵ “Për miratimin e rregullores ‘Për bashkëpunimin e Shërbimit të Provës me OJF-të dhe Shërbimin e Ndërmjetësimit’”. Ky akt nënligjor përcakton rregullat e bashkëpunimit të Shërbimit të Provës me OJF-të dhe Shërbimin e Ndërmjetësimit, për të siguruar mbikëqyrjen e të dënuarve me masa alternative; asistimin e të dënuarve për t’u riedukuar dhe integruar në shoqëri, si dhe reduktimin dhe parandalimin e kriminalitetit.

Kuadri normativ mbi dënimet alternative dhe Shërbimin e Provës vendos nga njëra anë rregulla mbi organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës, mbi standardet dhe

⁴² Ligji nr. 10 023, datë 27.11.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar” dhe ligji nr. 10 024, datë 27.11.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale””.

⁴³ Shërbimi i Provës filloi funksionimin e tij në datën 11.05.2009 – data e emërimit të Drejtorit të Përgjithshëm të tij.

⁴⁴ Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 39, datë 03.04.2009.

⁴⁵ Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 130, datë 05.09.2009.

procedurat e mbikëqyrjes së ekzekutimit të alternativave të dënimit me burgim përballeshme rregullave për realizimin efikas të të drejtave të vetë të dënuarve nga ana tjetër. Caktimi dhe mbikëqyrja e dënimeve/masave alternative është konceptuar si një proces që përfshin shumë aktorë bashkëpunues me njëri-tjetrin, por gjithsesi me role dhe përgjegjësi të ndara (prokurorin, gjykatën, Shërbimin e Provës, të dënuarin, mbrojtësin, të dëmtuarin, organet shtetërore, si dhe organizatat jofitimprurëse dhe Shërbimin e Ndërmjetësimit).

Shërbimi i Provës ngarkohet jo vetëm të mbikëqyrë zbatimin e alternativave të dënimit me burgim, por edhe të ndihmojë organin procedues (gjykatën dhe prokurorinë) për shpjegime të specializuara në drejtim të thelbit të alternativave të dënimit me burgim. Ky institucion u emërtua “Shërbimi i Provës” nisur nga modelet evropiane të legjislacionit.⁴⁶ Emërtesa lidhet me funksionin bazë të këtij Shërbimi “mbikëqyrjen e plotësimit të masave apo detyrimeve të të dënuarit në kohën e provës si alternativa më e mirë ndaj dënimit me burgim për arritjen e qëllimit edukues dhe risocializues ndaj të dënuarit”.

Ligji nr. 10 024/2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331/1998 ‘Për ekzekutimin e vendimeve penale’” prezanton Shërbimin e Provës⁴⁷ si organin shtetëror të ngarkuar me këto funksione gjatë procedimit penal:

- mbikëqyrjen e zbatimit të dënimeve alternative (neni 31/7 paragrafi 1);
- dhënien e ndihmës në ekzekutimin e dënimit alternativ, duke ndihmuar veçanërisht personin e dënuar në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin social (neni 31/7 paragrafi 1);
- dhënien e ndihmës për organin e prokurorisë për marrjen e vendimeve gjatë fazës së hetimeve paraprake (neni 31/8 paragrafi 1);
- dhënien e ndihmës për gjykatën për vlerësimin e duhur të dënimit alternativ (neni 31/8 paragrafi 2).

Nga ana tjetër, në nenin 6 të VKM-së nr. 302/2009 është përcaktuar në mënyrë parimore se:

“1. Shërbimi i Provës mbikëqyr dhe mbështet zbatimin e dënimeve alternative me qëllim mbrojtjen e interesave publike dhe parandalimin e kryerjes së veprave penale, asistimin e personit të dënuar gjatë kryerjes së dënimit alternativ në përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve që rrjedhin nga ky dënim, si dhe në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin e tij shoqëror.

2. Shërbimi i Provës bashkëpunon dhe paraqet informacion dhe raporte para prokurorisë dhe gjykatës sipas parashikimeve ligjore.

3. Shërbimi i Provës përcakton metodat e zbatimit të dënimit alternativ në përputhje me parashikimet ligjore. Kur është e nevojshme, Shërbimi i Provës bashkëpunon me institucione shtetërore, qendrore apo lokale, me komunitetin lokal, si dhe me institucione të tjera dhe organizata jofitimprurëse për zbatimin e dënimeve alternative”.

Duke analizuar këtë kuadër ligjor arrihet në përfundimin që qëllimi i ligjvënësit ka qenë

⁴⁶ Probation Service.

⁴⁷ Nga një lexim i kombinuar i neneve 31/7, 31/8 dhe 31/12.

atribuimi i funksioneve të Shërbimit të Provës përgjatë të gjitha fazave të procedimit penal: (i) gjatë hetimit paraprak; (ii) gjatë gjykimit; dhe (iii) gjatë ekzekutimit të vendimit. Ky qëllim është shprehur në mënyrë të drejtpërdrejtë në nenet 31/7 dhe 31/8 të ligjit nr. 10 024/2008:

“Shërbimi i provës është organi shtetëror, që mbikëqyr zbatimin e dënimeve alternative, paraqet informacion dhe raporte para prokurorit ose gjykatës”; dhe

“Raporti mbështetet në fakte, duhet të jetë i paanshëm dhe objektiv, si dhe dërgohet brenda kohës së caktuar nga gjykata”.

Nga ana tjetër, ky qëllim mbi funksionet e Shërbimit të Provës është konfirmuar edhe në nenin 31 të VKM-së nr. 302/2009, që parashikon detyrimin e këtij Shërbimi për të hartuar dhe paraqitur raportet:

“Shërbimi i Provës, me kërkesë të prokurorit ose gjykatës, paraqet një raport vlerësues për personin nën hetim, për të pandehurin ose për të dënuarin në këto raste:

- a) gjatë fazës së hetimeve paraprake;*
- b) gjatë gjykimit përpara dhënies së vendimit penal;*
- c) gjatë fazës së ekzekutimit të dënimit penal:*
 - i) në rastin e mbikëqyrjes së personit të dënuar;*
 - ii) në rastin e shqyrtimit të kërkesës për lirim me kusht;*
 - iii) në përfundimin para kohe të periudhës së vënies në provë;*
 - iv) në përfundim të dënimit alternativ apo në përfundim të përmbushjes së detyrimeve të caktuara”.*

Padyshim, funksioni më thelbësor është ai i fazës së ekzekutimit të vendimit penal për mbikëqyrjen e zbatimit të alternativave dhe ndihmën e të dënuarit për t'u riintegruar në shoqëri.

1.2 Organizimi i Shërbimit të Provës

Shërbimi i Provës është organ shtetëror i centralizuar, në varësi të Ministrisë së Drejtësisë. Ky koncept organizimi përshkon të gjitha rregullat normative (mënyra e emërimit të Drejtorit të Përgjithshëm dhe të stafit; organizimi i strukturës dhe i organikës; organizimi i buxhetit; centralizimi; kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm, etj.). Ligjvënësi ka zgjedhur këtë model organizimi për shkak të funksionit bazë që kryen Shërbimi i Provës, mbikëqyrja e dënimeve alternative. Mbikëqyrja e dënimeve alternative është pjesë e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale dhe rrjedhimisht u ndoq i njëjti model ligjor për varësinë institucionale të strukturave me funksione të kësaj natyre si: shërbimi gjyqësor përmbarimor apo sistemi penitenciar. Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve janë agjenci në varësi të Ministrit të Drejtësisë sepse fokusi i veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë është sistemi i drejtësisë, ku ekzekutimi i vendimeve gjyqësore përbën një prej aspekteve më të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, ky model organizimi

e ka bazën edhe në përgjegjësinë e pushtetit ekzekutiv, nëpërmjet Këshillit të Ministrave për hartimin dhe zhvillimin e politikave, përfshirë edhe atë penale.

Shërbimi i Provës është i organizuar në dy nivele: qendror (Drejtoria e Përgjithshme) dhe vendor (zyrat vendore). Ligji parashikon që pranë çdo gjykate të rrethit gjyqësor të ketë zyrë vendore të Shërbimit të Provës, mirëpo aktualisht ka një rregullim tranzitor me urdhër⁴⁸ të Ministrit të Drejtësisë, në bazë të të cilit funksionojnë vetëm katër zyra vendore me vendndodhje në qytetet Tiranë, Durrës, Fier dhe Shkodër. Me këtë organizim tranzitor, veprimtaria e Shërbimit të Provës përmbushet nga një staf prej 50 punonjësish (12 në Drejtorinë e Përgjithshme dhe 38 në zyrat vendore).

Secila nga zyrat vendore të Shërbimit të Provës i shtrin kompetencat tokësore në disa rrethe gjyqësore, duke bërë të mundur mbulimin e të gjithë territorit të vendit. Konkretisht, sipas urdhrit 5331/1 të Ministrit të Drejtësisë, Zyra Vendore Tiranë ushtron veprimtarinë në rrethet gjyqësore Dibër, Kavajë, Krujë, Kurbin dhe Tiranë; Zyra Vendore Durrës ushtron veprimtarinë në rrethet gjyqësore Durrës, Elbasan, Korçë dhe Pogradec; Zyra Vendore Shkodër ushtron veprimtarinë në rrethet gjyqësore Kukës, Lezhë, Mat, Shkodër dhe Tropojë; dhe Zyra Vendore Fier ushtron veprimtarinë në rrethet gjyqësore Berat, Fier, Gjirokastrë, Lushnje, Përmet, Sarandë dhe Vlorë.

Kompetencat tokësore sipas urdhrit të Ministrit janë të lidhura dhe i referohen konceptit të rrethit gjyqësor meqë zyrat vendore ushtrojnë veprimtarinë e tyre në funksion të procedimeve penale të ndjekura nga gjykatat dhe prokuroritë. Për zbrëthimin e ndarjeve administrative-territoriale që ato mbulojnë (lidhur me vendbanimet e të pandehurit/të dënuarit) është e nevojshme referenca tek Dekreti i Presidentit të Republikës nr. 6201, datë 08.06.2009 “Për përcaktimin e kompetencave tokësore të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe të qendrës së ushtrimit të veprimtarisë të secilës prej tyre”. Ky dekret jep shtrirjen territoriale të çdo rrethi gjyqësor sipas ndarjeve administrativo-territoriale (rreth, bashki apo qytet) të njohura me ligjin nr. 8653, datë 31.07.2000 “Për ndarjen administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Tabela 1

Nr.	Zyra Vendore Tiranë	Zyra Vendore Shkodër	Zyra Vendore Durrës	Zyra Vendore Fier
1	Tiranë	Shkodër	Durrës	Fier
2	Krujë	Lezhë	Elbasan	Berat
3	Kavajë	Kukës	Korçë	Vlorë
4	Dibër	Pukë	Pogradec	Gjirokastrë
5	Kurbin	Mat		Lushnje
6		Tropojë		Përmet
7				Sarandë


⁴⁸ Urdhri i Ministrit të Drejtësisë nr. 5331/1, datë 06.07.2009 ka karakter tranzitor dhe është nxjerrë në bazë të paragrafit 3 të nenit 61 të VKM-së nr. 302/2009, që parashikon shprehimisht “Deri në krijimin e të gjitha zyrave vendore të Shërbimit të Provës, Ministri i Drejtësisë përcakton me akt nënligjor vendndodhjen e zyrave vendore të para”.

1.3 Funksionimi i Shërbimit të Provës

Shërbimi i Provës në ushtrimin e veprimtarisë së tij bazohet mbi parimin e ligjshmërisë, të objektivitetit, të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, në mungesën e diskriminimit, të respektimit të dinjitetit të të pandehurit/dënuarit. Në veprimtarinë e tij, Shërbimi i Provës përpiqet të zhvillojë ndjenjën e përgjegjësisë së të dënuarit ndaj komunitetit dhe viktimës, si dhe të mbështesë e inkurajojë riintegrimin social të të dënuarit nëpërmjet një qëndrimi korrekt ndaj punës, shtetit ligjor dhe rregullave të ndërveprimit social.⁴⁹

Pikërisht në funksion të këtyre parimeve janë rregullat për rekrutimin e punonjësve të Shërbimit të Provës: kushti për arsimin e lartë arsimin e lartë në degët psikologji, punë sociale, sociologji ose juridik, si dhe procedura e rekrutimit me konkurs të hapur bazuar në meritat.⁵⁰

Gjithashtu, në funksion të këtyre parimeve dhe si një premisë që siguron profesionalizmin dhe efikasitetin e veprimtarisë së Shërbimit të Provës është trajnimi.⁵¹ Shërbimi i Provës organizon kurse trajnimi të detyrueshme për punonjësit, me qëllim aftësimin profesional dhe përsosjen e njohurive në drejtim të kryerjes së detyrave me efektivitet dhe profesionalizëm. Për realizimin e trajnimeve Shërbimi i Provës krijon marrëdhënie bashkëpunimi me institucione lokale, publike, shtetërore, private, organizata jofitimprurëse, vendase apo të huaja. Deri tani janë zhvilluar disa trajnime nën kujdesin e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri dhe Misionit EURALIUS II; është përgatitur manuali “Për punonjësin e Shërbimit të Provës”. Trajnimi i parë është zhvilluar me 20 punonjësit e parë të Shërbimit të Provës me temë “Shërbimi i Provës në Shqipëri” (18.06.2009-23.06.2009) organizuar nga Prezenca e OSBE-së dhe Misioni EURALIUS II.



⁴⁹ Neni 3 i VKM-së nr. 302, datë 25.03.2009 “Për miratimin e Rregullores ‘Për organizimin e funksionimit e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve e të procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative.’”

⁵⁰ Neni 13, po aty.

⁵¹ Neni 19, po aty.

Për përmbushjen e funksioneve të tij, Shërbimi i Provës, nëpërmjet punonjësve të tij, vendos kontakte me të dënuarin, zhvillon takime me të dhe me të afërm të tij, si dhe merr të gjitha të dhënat mbi kontekstin shoqëror të të dënuarit. Shërbimi i Provës dokumenton veprimtarinë e tij nëpërmjet krijimit të dosjes personale të të dënuarit, mban regjistra të veprimtarisë, për të konkluduar me hartimin dhe paraqitjen e raporteve të vlerësimit.

Dosja personale fillon të plotësohet që në momentin e vendosjes së kontaktit të parë me të dënuarin dhe vazhdon deri në përfundimin e ekzekutimit të dënimit. Aktet që përfshihen në të janë të renditura në nenin 25 pika 2 e VKM-së nr. 302/2009. Lista e akteve nuk është shteruese sepse në të përfshihet çdo dokument që lidhet me të dënuarin, i nevojshëm për realizimin e mbikëqyrjes së dënimit alternativ (shkronja 1 e pikës 2 të nenit 25) për t'iu përgjigjur karakterit fleksibël që përshkon masat alternative. Konkretisht, në dosjen personale përfshihen:

- a) vendimi penal gjyqësor që cakton dënimin alternativ;*
- b) urdhri i ekzekutimit të vendimit gjyqësor të lëshuar nga prokurori;*
- c) raportin i vlerësimit të përgatitur gjatë fazës së hetimeve paraprake për caktimin e dënimit alternativ, nëse ka;*
- ç) një fotokopje e dokumentit të identifikimit të të dënuarit;*
- d) raporti mjekësor për vlerësimin e kushteve shëndetësore, kur është e nevojshme;*
- dh) procesverbali i kontakteve me të dënuarin;*
- e) programi i mbikëqyrjes;*
- ë) raportet e përpiluara nga Shërbimi i Provës dhe të dërguara në gjykatë ose prokurori gjatë periudhës së mbikëqyrjes;*
- f) çdo paralajmërim të dhënë nga prokurori për shkelje të detyrimeve të vendosura nga gjykata gjatë periudhës së mbikëqyrjes;*
- g) një ekstrakt të paralajmërimit të bërë nga prokurori në rastin e shkeljeve të lehta dhe të kryera për herë të parë, nëse ka;*
- gj) raporti përfundimtar të hartuar nga Shërbimi i Provës në përfundim të mbikëqyrjes;*
- h) të dhëna mbi përparimin e të dënuarit gjatë periudhës së mbikëqyrjes, duke përfshirë arsyet për përfundimin e parakohshëm të saj;*
- i) kopje të ankesave të të dënuarit mbi Shërbimin e Provës dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre;*
- j) kopje të ankesës së të dënuarit mbi të dhënat dhe përmbajtjen e dosjes personale;*
- k) urdhrin e caktimit të institucionit të ekzekutimit të masës alternative;*
- l) çdo dokument tjetër në lidhje me të dënuarin që është i nevojshëm për realizimin e mbikëqyrjes”.*

Të dhënat e përfshira në dosje shërbejnë si baza për produktin final të Shërbimit të Provës, atë të hartimit të raporteve. Për këtë shkak, vlen rregullli që informacioni i përfshirë në dosjen personale duhet të jetë i besueshëm, objektiv dhe të ketë të bëjë vetëm me çështjet që lidhen me masën apo llojin e dënimit dhe ekzekutimin e tij.

Pikë kyçe e veprimtarisë së Shërbimit të Provës është ndërtimi i programit individual të të dënuarit në përputhje me dënimin alternativ konkret të caktuar. Për këtë qëllim, Shërbimi i Provës vlerëson personalitetin e të dënuarit, me qëllim qartësimin e nevojave lidhur me mungesat fizike, afektive ose shoqërore, vullnetit të të dënuarit për punë dhe aftësitë e tij profesionale, të cilat kanë penguar zhvillimin e një jete shoqërore normale të tij. Programi individual miratohet nga drejtori i zyrës përkatëse vendore. Programi individual hartohet në përshtatje me alternativën konkrete të caktuar dhe me nevojat konkrete të të dënuarit. Gjithsesi, elementët e domosdoshëm të një programi individual të përcaktuara në nenin 28, pika 4 e VKM-së nr. 302/2009 janë:

- “a) pjesa hyrëse, në të cilën tregohen gjeneralitetet, adresa e vendbanimit, vepra penale e kryer, numri i vendimit gjyqësor, dënimi i dhënë, periudha e provës, duke përmendur datat e fillimit dhe të mbarimit të saj, si dhe emri dhe mbiemri i punonjësit të Shërbimit të Provës të caktuar;*
- b) masat dhe çdo detyrim tjetër të vendosur nga gjykata, si dhe mënyrat e përdorura nga punonjësi i Shërbimit të Provës për të siguruar përmbushjen e këtyre detyrimeve dhe masave.*
- c) nevojat kriminogjene dhe sociale të personit nën mbikëqyrje, si dhe qëllimet e përcaktuara për përmirësimin e tyre;*
- ç) rreziku i përsëritjes së veprës penale, rreziku i cenimit të sigurisë publike dhe ai i vetëvrasjes apo vetëdëmtimit;*
- d) metodat e propozuara të ndërhyrjes për të plotësuar nevojat e identifikuar dhe për të reduktuar rrezikun;*
- dh) data, vendi dhe frekuenca e takimeve midis punonjësit të Shërbimit të Provës dhe të dënuarit që do të mbahen gjatë gjithë periudhës së mbikëqyrjes të përcaktuar nga gjykata”.*

Programi individual i shërben funksionit të Shërbimit të Provës për dhënien ndihmë të të dënuarit për kapërcimin e vështirësive dhe riintegrimin social, duke synuar reduktimin/eliminimin e rrezikshmërisë shoqërore të të dënuarit. Nëpërmjet këtij programi, Shërbimi i Provës përpiqet të ndërjegjësojë të dënuarin për veprën penale të kryer, për rëndësinë e saj duke e orientuar të dënuarin drejt sjelljeve vetëdisiplinuese. Gjithashtu, Shërbimi i Provës e mbështet të dënuarin që ai të përmbushë nevojat sociale që lidhen me edukimin, trajnimin, punësimin, strehimin apo çdo nevojë tjetër të ngjashme të kësaj natyre. Realizimi i kësaj veprimtarie kryhet duke respektuar të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të të dënuarve, si dhe duke garantuar respektimin e dinjitetit personal të tyre. Për të realizuar programin individual, Shërbimi i Provës kontakton me familjen e të dënuarit, persona të tjerë të afërt me të, kryen vëzhgim të mjedisit social të të dënuarit, bashkëpunon me OJF-të dhe Shërbimin e Ndërmjetësimit me qëllim reduktimin dhe eliminimin e rrezikshmërisë shoqërore të të dënuarit dhe rehabilitimin e tij.

Gjatë periudhës së mbikëqyrjes, punonjësi i Shërbimit të Provës përcakton, në çdo takim, se deri në çfarë mase janë realizuar objektivat e planit të mbikëqyrjes. Kur ndodhin ndryshime që mund të ndikojnë tek nevojat dhe rreziqet e identifikuar, plani i mbikëqyrjes mund të rishikohet nëpërmjet anekseve që i shtohen atij.

1.4 Bashkëpunimi i Shërbimit të Provës

Shërbimi i Provës ka një rol qendror në procesin e caktimit dhe të mbikëqyrjes së dënimeve alternative dhe për përmbushjen e funksioneve të tij ai bashkëpunon me prokurorin, me gjykatën, me të pandehurin/të dënuarin dhe mbrojtësin e tij, me të dëmtuarin, me organet shtetërore, me organizatat jofitimprurëse e Shërbimin e Ndërmjetësimit, si dhe në një rast të veçantë edhe me subjektin pranë të cilit kryhet puna në interes publik. Megjithatë, kuadri ligjor parashikon përgjegjësi dhe detyra të ndara për secilin nga këta aktorë.

Lidhja e Shërbimit të Provës me prokurorin. Përgjithësisht, roli i prokurorit në procesin e dënimeve alternative është shqyrtimi i rrethanave të rastit konkret për të vlerësuar nëse është e përshtatshme të caktohen masa alternative, si dhe për të siguruar provat e mjaftueshme për këtë qëllim. Prokurori i kërkon Shërbimit të Provës hartimin e raportit përkatës, në të cilin jepen edhe rekomandimet konkrete. Gjithashtu, prokurori luan rol edhe në fazën e mbikëqyrjes së masës alternative të caktuar, ku në raste të caktuara mund të ndërhyjë, duke dhënë paralajmërime ndaj të dënuarit për shkeljet e detyrimeve gjatë kohës së provës ose duke paraqitur kërkesa në gjykatë për përfundimin e parakohshëm të masës, për zëvendësimin/revokimin e saj apo për shtimin/ndryshimin e detyrimeve gjatë kohës së provës.

Lidhja e Shërbimit të Provës me gjykatën. Gjykata është organi me kompetencën ekskluzive për caktimin e masave alternative dhe llojin e detyrimeve për t'u përmbushur nga i dënuari. Gjithashtu, gjykata është organi që vendos mbi kërkesat e palëve në fazën e ekzekutimit të vendimit penal, të cilat përfshijnë përfundimin e parakohshëm të dënimit alternativ, zëvendësimin apo revokimin e tij. Në këtë proces vendimmarrës, gjykata padyshim që mbështetet në raportet e hartuara nga Shërbimi i Provës në të cilin krahas përshtatshmit të rrethanave konkrete të rastit për gjykim, jepen edhe rekomandimet konkrete.

Lidhja e Shërbimit të Provës me mbrojtësin. Roli i mbrojtësit në mbështetje të nenit 6 të Kodit të Procedurës Penale është të ndihmojë të pandehurin që atij t'i garantohen të drejtat procedurale dhe t'i ruhen interesat ligjore. Nën këtë këndvështrim, roli i mbrojtësit është t'i shpjegojë të pandehurit thelbin e alternativave të dënimit me burgim, mundësinë e përfshirjes së tij në këtë proces dhe gjatë ekzekutimit të dënimeve alternative, të asistojë të pandehurin si me dhënien e pëlqimit në ato raste ku ky pëlqim nevojitet, ashtu edhe për të paraqitur kërkesat e nevojshme procedurale përpara prokurorit/gjykatës. Për ilustrim, në rastin e alternativës së parashikuar nga neni 62 i Kodit Penal “*Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik*”, dhënia e pëlqimit të të dënuarit është kusht i domosdoshëm për caktimin e kësaj alternative nga gjykata.

Lidhja e Shërbimit të Provës me organet shtetërore. Organet shtetërore qendrore dhe organet e njësive të qeverisjes vendore i japin Shërbimit të Provës ndihmën e nevojshme për përmbushjen e detyrave ligjore. Shërbimi i Provës mund të paraqesë kërkesë pranë tyre, madje edhe tek Policia e Shtetit nëse e çmon të nevojshme ndihmën e tyre.⁵²

⁵² Neni i 31/7 ligjit “Për ekzekutimin e vendimeve penale” dhe neni 57 i VKM-së nr. 302/2009.

Lidhja e Shërbimit të Provës me organizatat jofitimprurëse dhe Shërbimin e Ndërmjetësimit.⁵³ Shërbimi i Provës bashkëpunon me këto organizata për të siguruar mbikëqyrjen e të dënuarit në përputhje me programin individual të trajtimit; asistencën dhe mbështetjen e të dënuarit për kapërcimin e vështirësive në lidhje me riintegrimin social dhe për përmbushjen e nevojave shoqërore të edukimit, arsimit, punësimit, strehimit dhe nevojave të tjera të ngjashme; hartimin dhe realizimin e programeve efikase të sjelljes për të dënuarin, bazuar në nevojat e identifikuara të tij, realizimin e programeve dhe veprimtarive në qendra ditore, si dhe të ndërhyrjeve të tjera me ndikim potencial në rehabilitimin e të dënuarit; vlerësimin e të dënuarve, kur për hartimin e raportit nevojiten analiza të specializuara mbi shëndetin e tyre mendor, abuzimin me substanca alkoolike, narkotike apo psikotrope ose analiza të tjera të cilat mund të kryhen nga OJF-ja; sistemimin e të dënuarve të liruar me kusht duke përgatitur dhe ofruar programe të lirit, mundësi strehimi, arsimit, trajnimit dhe punësimi, veprimtari në qendra ditore, programe terapeutike apo të kujdesit dhe çdo ndërhyrje tjetër të nevojshme për rehabilitimin e ish të dënuarve; zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të dëmtuarve nga vepra penale dhe të dënuarve; si dhe reduktimin dhe parandalimin e kriminalitetit. Ky bashkëpunim realizohet nëpërmjet nënshkrimit të memorandumeve të bashkëpunimit.

Lidhja e Shërbimit të Provës me të dëmtuarin. Megjithëse pjesëmarrja e të dëmtuarit nuk është kusht për caktimin e masave alternative ndaj të dënuarit, roli i tij merr ndonjëherë peshë domethënëse. Rasti më tipik mbetet kur gjykata i ka caktuar të dënuarit me masë alternative detyrimin për të riparuar dëmin civil të parashikuar nga neni 60 pika 3 të Kodit Penal. Nga ana tjetër, normalizimi i marrëdhënive me të dëmtuarin përbën një premisë për riintegrimin social të të dënuarit dhe për këtë shkak, kuadri ligjor ka parashikuar edhe bashkëpunimin e Shërbimit të Ndërmjetësimit me Shërbimin e Provës me funksionin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të dëmtuarve nga vepra penale dhe të dënuarve.

Lidhja e Shërbimit të Provës me subjektin pranë të cilit kryhet puna në interes publik. Në alternativën e parashikuar nga neni 63 i Kodit Penal parashikohet bashkëpunimi i Shërbimit të Provës me subjektin pranë të cilit kryhet kjo punë. Shërbimi i Provës lidh marrëveshje me subjektet në të cilin do të kryhet puna me interes publik për përmbushjen e programit. Marrëveshja përcakton programin, punën që do të kryhet, personin përgjegjës të caktuar nga subjektet për të mbikëqyrur realizimin e punës nga i dënuari, si dhe detyrimin e subjekteve për të njoftuar menjëherë Shërbimin e Provës në rastet e mospërmbushjes të detyrimeve nga i dënuari. Shërbimi i Provës i shpjegon personit përgjegjës të caktuar për mbikëqyrjen se është e nevojshme të evidentohen orët e punës mbi baza ditore për të verifikuar nëse orari i punës ditore është respektuar apo jo, si dhe për të informuar rregullisht Shërbimin e Provës mbi nivelin e performancës në punë të të dënuarit. Në bashkëpunim me subjektin pranë të cilit kryhet puna, Shërbimi i Provës i bën të ditur të dënuarit rregullat e sigurimit teknik në punë.

⁵³ Rregulla të detajuara janë parashikuar në Urdhrin e Ministrisë të Drejtësisë nr. 6325, datë 31.07.2009 "Për miratimin e rregullores 'Për bashkëpunimin e Shërbimit të Provës me OJF-të dhe Shërbimin e Ndërmjetësimit.'"

Gjithashtu, subjekti pranë të cilit kryhet puna informon Shërbimin e Provës mbi mënyrën e përmbushjes së punës nga i dënuari pranë tyre. Për të realizuar këtë bashkëpunim, Shërbimi i Provës ka detyrimin të përcaktojë një listë të institucioneve/shoqërive, publike apo private, ku mund të kryhet puna me interes publik.

1.5 Modelet e standardizuara të Shërbimit të Provës

Ministri i Drejtësisë, në zbatim të kuadrit ligjor, me urdhrin nr. 4583/1, datë 11.06.2009 “Për miratimin e modelit të regjistrave të Shërbimit të Provës, raportit të vlerësimit dhe raportit përfundimtar” ka modeluar aktet e mëposhtme:

- ➔ regjistrin themeltar të personave të dënuar;
- ➔ regjistrin e kërkesë-ankesave;
- ➔ regjistrin e shkeljeve të planit individual të trajtimit;
- ➔ regjistrin e ngjarjeve të rënda;
- ➔ regjistrin e OJF-ve dhe institucioneve të tjera që ofrojnë këshillim dhe asistencë ose vende pune për të dënuarit me dënim alternativ.

Gjithashtu, janë miratuar edhe modelet e raporteve të vlerësimit (për të dënuarin/të pandehurin/ personin nën hetim), si dhe të raportit përfundimtar të periudhës së mbikëqyrjes.

Në dokumentet e përshkruar më lart gjenden të pasqyruara të dhënat personale të të dënuarit, përshkrimi dhe analiza e veprës penale të kryer, qëndrimin e autorit të veprës penale ndaj veprës së kryer prej tij, përshkrimi dhe analiza e autorit të veprës penale përfshirë jetën dhe historinë personale të autorit që ka lidhje me veprën penale, analiza dhe vlerësimi i rrezikut që nënkupton rrezikun e përsëritjes së veprave penale prej autorit; përshkrimi dhe analiza e ekzekutimit të vendimit të gjykatës përfshirë sipas rastit informacionin në lidhje me programin e mbikëqyrjes dhe masat e marra për të adresuar nevojat kriminogjene të të dënuarit; sjelljen dhe progresin e bërë nga i dënuari gjatë ekzekutimit të dënimit; qëndrimin e të dënuarit ndaj viktimës; gjendjen familjare, rrethanat sociale të të dënuarit dhe planet konkrete për riintegrimin e tij social pas lirit të tij me kusht.

Nga ana tjetër, Drejtori i Përgjithshëm në zbatim të dispozitave përkatëse ligjore ka nxjerrë urdhra, udhëzime, metodika, marrëveshje bashkëpunimi, si më poshtë vijon:

1. Marrëveshjen e Bashkëpunimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve;
2. Marrëveshjen e Bashkëpunimit me OJF-të;
3. Marrëveshjen e Bashkëpunimit me pushtetin vendor;
4. Modelin e standardizuar të Programit individual të trajtimit të të dënuarve;
5. Modelet e standardizuara të raporteve të vlerësimit;
6. Modelin e standardizuar të letër referencave për OJF-të;

7. Modelet e standardizuara të formularëve statistikorë për zyrat vendore me të dhëna mbi të dënuarit (e mitur dhe të rritur);
8. Urdhra dhe udhëzime të ndryshme për efekt të mirëfunksionimit dhe organizimit të zyrave vendore.

Më në detaje, aktet e miratuara për Shërbimin e Provës, deri në fund të majit 2010, janë si më poshtë vijon:⁵⁴

Vendime të Këshillit të Ministrave

- VKM nr. 302, datë 25.03.2009 Për miratimin e rregullores “Për organizimin e funksionimin e shërbimit të provës dhe për përcaktimin e standardeve e të procedurave, për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative”.

Urdhra të Ministrit të Drejtësisë

- Urdhër nr. 4583/1, datë 11.06.2009 “Për miratimin e modelit të regjistrave të shërbimit të provës, raportit të vlerësimit dhe raportit përfundimtar”.
- Urdhër nr. 5331/1, datë 06.07.2009, “Për përcaktimin e vendndodhjes dhe kompetencave të zyrave vendore të shërbimit të provës”.
- Urdhër nr. 6325, datë 31.07.2009, “ Për bashkëpunimin e shërbimit të provës me OJF-të dhe shërbimin e ndërmjetësimit”.

Urdhra të Drejtorit të Përgjithshëm

- Urdhër nr. 283, datë 21.08.2009, “Për miratimin e formularëve statistikorë dhe mënyrën e plotësimit të tyre”.
- Urdhër nr. 189, datë 03.07.2009, “Për miratimin e modelit të dokumentit, “Programi individual i trajtimit të të dënuarve me dënime alternative”.
- Urdhër nr. 245, datë 31.07.2009, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Shërbimin e Provës”.

Udhëzime të Drejtorit të Përgjithshëm

Udhëzim nr. 319, datë 18.09.2009 “Për trajtimin e rasteve të mbikëqyrjes të të dënuarve me dënim alternative me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

- Udhëzim nr. 353, datë 30.09.2009: “Për llogaritjen e fillimit dhe përfundimit të periudhës së provës për të dënuarin; Për trajtimin e rastit kur i dënuari në provë ndryshon vendqëndrimin e tij, etj;
- Udhëzim nr. 616, datë 21.05.2010 “Për mënyrën e përdorimit të modelit të standardizuar të letër referencave, për të dënuarit me dënime alternative, për të cilët Shërbimi Provës bashkëpunon me OJF-të e specializuara dhe me subjektet që ofrojnë shërbimin e ndërmjetësimit”.

⁵⁴ Informacion i marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, datë 17.06.2010.

Marrëveshje dhe Memorandume bashkëpunimi

- Marrëveshje bashkëpunimi midis Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe OJF te ndryshme.
4 memorandume te nënshkruara
- Memorandum bashkëpunimi midis Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe bashkive e komunave te vendit.
27 memorandume të nënshkruara

Të gjitha sa më sipër janë pjesë përbërëse e bazës ligjore të zbatueshme nga Shërbimi i Provës. Ato synojnë jo vetëm dhe rritjen e transparencës dhe të mirëfunksionimit të Shërbimit të Provës, por edhe standardizimit të praktikave të këtij Shërbimi dhe krijimin e traditës.

Modelet e standardizuara të raporteve të përgatitura nga Shërbimi i Provës për fazat para dhënies së dënimit dhe pas dhënies së dënimit janë në Shtojcën II, faqe 274.

2 STATISTIKA TË ZBATIMIT TË ALTERNATIVAVE TË DËNIMIT ME BURGIM

Për periudhën 1 qershor 2009 – 31 maj 2010, Shërbimi i Provës ka kryer një volum pune të madh, madje jashtë parashikimeve, duke u nisur nga fakti që është një institucion i ri dhe në fillimet e funksionimit të tij.

Deri më 31 maj 2010, nga Shërbimi i Provës janë kërkuar 772 raporte vlerësimi për persona të pandehur dhe të dënuar. Deri po në këtë datë, organi i prokurorisë ka kërkuar nga Shërbimi i Provës 205 raporte vlerësimi për persona nën hetim dhe të pandehur. Kërkesa e parë drejtuar Shërbimit të Provës mban datën 27.05.2009 (drejtuar Zyrës Vendore Tiranë), ndërsa raporti i parë i vlerësimit daton 09.06.2009.

Prokuroritë e rretheve gjyqësore i kanë dërguar për ekzekutim 1552 urdhra ekzekutimi, nga të cilët 210 urdhra ekzekutimi janë për dënime alternative të dhëna për të mitur, për të cilët gjykata ka dhënë dënime alternative dhe kanë filluar procedurat ligjore të përcaktuara për procesin e mbikëqyrjes për ta.

Madje ka patur kërkesa të Shërbimit të Provës edhe për bashkëpunim gjyqësor ndërkombëtar që dënimi alternativ të mbikëqyret jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në përputhje me kërkesat e Konventës Evropiane. Këto përfundime jepen nga statistikat dhe paraqitjet grafike⁵⁵ si më poshtë vijon:

a. Të dhëna mbi të dënuarit, ndaj të cilëve janë caktuar alternativa të dënimit me burgim dhe që mbikëqyren nga Shërbimi i Provës

Numri i përgjithshëm i të dënuarve me dënime alternative që mbikëqyren nga Shërbimi i Provës në të gjithë vendin deri më 31 maj 2010 është 1552. Sipas Zyrave Vendore ky numër pasqyrohet në **Tabelën 2** dhe **Grafikun 1**.

➤ Zyra Vendore Tiranë ka nën mbikëqyrje 771 të dënuar, ndaj të cilëve janë caktuar alternativa të dënimit me burgim. Kjo zyrë vendore mbulon ndarjet territoriale me një popullsi prej 1.029.270 banorë.

➤ Zyra Vendore Durrës ka nën mbikëqyrje 272 të dënuar, ndaj të cilëve janë caktuar alternativa të dënimit me burgim. Kjo zyrë mbulon ndarjet territoriale me një popullsi prej 856.820 banorë.

➤ Zyra Vendore Fier ka nën mbikëqyrje 278 të dënuar, ndaj të cilëve janë caktuar alternativa të dënimit me burgim. Kjo zyrë mbulon ndarjet territoriale me një popullsi prej 803.820 banorë.

➤ Zyra Vendore Shkodër ka nën mbikëqyrje 231 të dënuar, ndaj të cilëve janë caktuar alternativa të dënimit me burgim. Kjo zyrë mbulon ndarjet territoriale me një popullsi prej 480.403 banorë.


⁵⁵ Statistikat e përdorura në këtë manual janë marrë nga Raporti i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës për periudhën 1 qershor 2009 - 31 maj 2010. Falënderojmë Shërbimin e Provës për përgatitjen e tyre.

Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm jepen këto të dhëna krahasimisht me stafin e Shërbimit të Provës. Nga analiza e këtyre treguesve rezulton që një specialist i Shërbimit të Provës ka në mbikëqyrje rreth 52 të dënuar.

Tabela 2

Nr.	Zyra Vendore	Të dënuar në mbikëqyrje	Nr. punonjësve sipas ZVSHP	Të mbikëqyrur për specialist
1	Shkodër	231	6	39
2	Durrës	272	7	39
3	Fier	278	7	40
4	Tiranë	771	10	77
	TOTALI	1552	30	52

Grafiku 1



b. Të dhëna për të dënuarit sipas llojit të masës alternative

Një statistikë tjetër e rëndësishme është ajo që na jep numrin e të dënuarve për secilin lloj dënimi alternativ, si më poshtë:

- 1251 persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 59 i Kodit Penal “pezullim i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë”, shifër kjo e barabartë me 80.6% të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.
- 22 persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 59/a i Kodit Penal “qëndrim në shtëpi”, shifër kjo e barabartë me 1.42% të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.

➤ 135 persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 63 i Kodit Penal “*Pezullim i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik*”, shifër kjo e barabartë me 8.70% të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.

➤ Asnjë person nuk është dënuar nga gjykata duke aplikuar nenin 58 të Kodit Penal “*gjysmëliria*”.

➤ 144 persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 64 i Kodit Penal “*Lirim me kusht*”, shifër kjo e barabartë me 9.28% të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.


Sikurse tregojnë shifrat, mbizotëron në masë të madhe aplikimi nga gjykata e nenit 59 të Kodit Penal “*pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë*”, duke bërë të mundur mosdërgimin në burg për vuajtjen e dënimit të autorëve të veprave penale, por kalimin e tyre nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës për periudhën e provës që varion nga 18 muaj deri në 5 vjet.

Në radhë të dytë qëndron numri i të dënuarve të liruar me kusht në aplikim të neni 64 të Kodit Penal “*lirim me kusht*”. Kjo shifër përbën numrin e të dënuarve që lënë burgun dhe që vihen nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës për periudhën e provës që cakton gjykata.

Tabela 3

Nr	Lloji i dënimeve alternative	Numri total i të dënuarve	Numri total i të dënuarve në %
1	“ <i>Pezullimi i ekzekutimit dhe vënia në provë</i> ” neni 59 i KP	1251	80.6%
2	“ <i>Qëndrimi në shtëpi</i> ” neni 59/a i KP	22	1.42%
3	“ <i>Lirimi me kusht</i> ” neni 64 i KP	144	9.28%
4	“ <i>Punë në interes publik</i> ” neni 63 i KP	135	8.70%
5	“ <i>Gjysmëliria</i> ” neni 58 i KP	0	0%
TOTALI		1552	100%

Grafiku 2



Nga këto statistika rezulton që alternativa e parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal është më e përhapur, ndërsa alternativa e parashikuar nga neni 58 i Kodit Penal “gjysmëliria” ende nuk ka gjetur zbatim. Alternativa e dytë më e përdorur është ajo e parashikuar nga neni 64 e Kodit Penal “lirimi me kusht”. Një shpjegim i mundshëm i këtyre statistikave ka lidhje me traditën e prokurorit/gjykatës, por edhe të mbrojtësit, të cilët janë familjarizuar me këto lloj alternativash dhe i njohin mirë konceptet që qëndrojnë në themel të tyre. Megjithatë, interesant është numri në rritje i të dënuarve me alternativat “qëndrim në shtëpi” dhe “pezullim i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik”. Një analizë më e thelluar e statistikave sigurisht që mbetet për të ardhmen, pas ndjekjes së ecurisë së të dënuarve pas përfundimit të dënimeve alternativave.

c. Të dhëna mbi ritmin e statistikave për Shërbimin e Provës sipas muajve


Një statistikë tjetër tregon ritmin e aplikimit të dënimeve alternative që është i njëjtë me ritmin e rritjes së ngarkesës së Shërbimit të Provës. Nga analiza e këtyre të dhënave është e dukshme që alternativat e dënimit me burgim janë duke u zbatuar në rritje domethënëse dhe ky konkluzion është optimist për të ardhmen e Shërbimit të Provës. Për ilustrim mjafton vetëm krahasimi i numrit 36 që i përket muajit të parë të Shërbimit të Provës, muajit qershor, me numrin 139 që i përket muajit maj 2010.

Tabela 4

Numri i të dënuarve që mbikqyren nga Zyrat Vendore sipas muajve, për periudhën 1 qershor 2009 – 31 maj 2010

Zyrat Vendore	Qer '09	Korr '09	Gu '09	Sht '09	Tet '09	Nën '09	Dhje '09	Jan '10	Shk '10	Mar '10	Pri '10	Maj '10	Total
Tiranë	36	55	6	51	41	73	156	99	49	23	120	62	771
Durrës	0	21	4	6	29	19	23	35	20	27	26	26	272
Fier	0	13	1	17	32	34	14	44	49	33	21	20	278
Shkodër	0	14	2	8	9	23	18	28	24	31	44	31	231
TOTALI	36	103	13	82	111	149	211	206	114	246	139	1552	

Grafiku 3



ç. Të dhëna mbi periudhën e mbikëqyrjes në të cilën i dënuari është në provë


Një statistikë tjetër e rëndësishme është ajo që ka të bëjë me periudhën e provës. Nga analiza e vendimeve gjyqësore të dërguara pranë Shërbimit të Provës për të dënuarit nën mbikëqyrje rezulton se periudha e provës e caktuar nga gjykata varion nga 18 muaj deri në 5 vjet në përputhje me parashikimin ligjor. Periudha mesatare është 18 muaj deri në 2.5 vjet e cila përbën 77,73% të rasteve.

Tabela në vijim jep një pasqyrë të plotë të gjatësisë së periudhës së provës dhe numrin e të dënuarve për secilën periudhë të shprehur edhe në përqindje në raport me numrin total të dënimeve të dhëna me periudhë prove. Po kështu paraqitja grafike pasqyron dukshëm dinamikën në lidhje me këto të dhëna.

Tabela 5

Nr	LËNDA	PERIUDHA E PROVËS					
		18 muaj - 3 vjet	3 vjet	4 vjet	5 vjet	18 muaj - 5 vjet	
1	Periudha e provës	18 muaj - 3 vjet	3 vjet	4 vjet	5 vjet	18 muaj - 5 vjet	1
2	Nr të dënuarve	1068	228	40	81	1417	2
3	% e të dënuarve	75.37%	16.09%	2.82%	5.71%	100%	3

Grafiku 4




d. numri i të dënuarve me “punë me interes publik” sipas zyrave vendore dhe sipas numrit të orëve të punës të dhëna nga gjykata

Një statistikë tjetër e rëndësishme që duhet evidentuar është edhe aplikimi nga gjykata e nenit 63 të Kodit Penal në dhënien e dënimit alternativ “punë në interes publik”. Numri i të dënuarve me “punë në interes publik” në të gjithë vendin është 135 prej të cilëve 102 janë në territorin ku shtrin kompetencat Zyra Vendore e Tiranës. Tabela në vijim na jep pasqyrën e plotë për këtë statistikë:

Tabela 6

Nr	Zyra Vendore	Numri i të dënuarve	Orë pune
1	Zyra Vendore Tiranë	78	40
		3	50
		14	60
		1	70
		4	80
		1	100
		1	120
		10	40
2	Zyra Vendore Durrës	1	50
		7	60
		3	80
		1	100
		4	120
		1	200
		1	240
3	Zyra Vendore Fier	2	240
		1	40
4	Zyra Vendore Shkodër	2	80
TOTALI		135	1770

Grafiku 5



Konkluzion

Megjithëse është ende herët për të bërë një analizë të thelluar të suksesit të veprimtarisë së Shërbimit të Provës dhe të llojit të alternativave të dënimit me burgim, një përfundim i parë është që statistikën në rritje janë optimiste për zhvillimin e këtyre alternativave. Padyshim mund të thuhet që një prej objektivave të alternativave të dënimit me burgim është arritur “reduktimi i kostove të dënimit me burgim” për shkak se i gjithë kontingjenti i dërguar nën masa alternative paraqet në potencë një numër të dënuarish me burgim, të destinuar për t’u përfshirë në regjimin penitenciar. Nga ana tjetër, statistikën në rritje edhe të alternativave të tjera, krahas atyre tradicionale “pezullimi i dënimit me burgim dhe vënia në provë” e parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal dhe “lirimi me kusht” e parashikuar nga neni 64 i Kodit Penal, tregon që edhe qëllimi i ligjvënësit për efektivitetin e Kodit Penal në kreun e alternativave të dënimit me burgim është duke u arritur. Sigurisht që në të ardhmen një prej sfidave është ndjekja e qëllimit të riedukimit dhe riintegritimit të të dënuarve. Për efekte të kësaj analize mbetet e nevojshme studimi krahasues i rasteve recidiviste të kësaj kategorie të të dënuarish, si dhe studimi i jetës së mëtejshme sociale të tyre.

4

KREUI

ROLI DHE POZITA PROCEDURALE E SHËRBIMIT TË PROVËS

Sipas ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 10 024, datë 27.11.2008 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, si dhe parashikimeve të reja që sollën aktet e tjera nënligjore, të dala në bazë e për zbatimin e tij, kusht i nevojshëm, për të mos thënë i domosdoshëm i vendimmarrjes së gjykatës, në rastet e aplikimit të alternativave me burgim është edhe raporti i përpiluar nga Shërbimi i Provës. Ky organ ka detyrim jo vetëm të përpilojë këtë raport, por edhe të mbikëqyrë dhe ndihmojë zbatimin e dënimeve alternative, si dhe të ndihmojë personin e liruar nga vuajtja e mëtejshme e dënimit me burgim, për kapërcimin e vështirësive për riintegrimin social.

Sa më sipër, në bazë të ligjit nr. 10 023, datë 27.11.2008, këtij Shërbimi iu ngarkua detyra për përgatitjen e raportit përkatës, i cili do të vlerësonte qëndrimin e të dënuarit ndaj veprës dhe pasojave të saj; gjendjen gjyqësore të të dënuarit; sjelljen e të dënuarit në raport me personat e tjerë; gjendjen psiko-sociale të të dënuarit; gjendjen familjare si dhe planet e tij konkrete, të cilat do ta ndihmojnë në riintegrimin e tij të plotës nëse gjykata do të vendosë lirimin e të pandehurit/ të dënuarit nga burgimi.

Për realizimin e detyrave të mësipërme, Shërbimit të Provës i është dhënë e drejta për të realizuar intervistimin e të gjithë subjekteve të përmendura nga i dënuari në kërkesën e tij për lirimin me kusht apo të përmendura nga prokurori, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij gjatë hetimeve paraprake. Bazuar në përfundimet e arritura gjatë intervistimit të subjekteve të përmendura më lart, në raportin e përgatitur nga Shërbimi i Provës i rekomandohet gjykatës (apo dhe prokurorit gjatë hetimeve paraprake) se cila do të jetë perspektiva e riintegrit të të dënuarit apo të pandehurit në shoqëri e për pasojë, cili do të jetë detyrimi më i përshtatshëm për t’u përmbushur nga i pandehuri/i dënuari, nga detyrimet e parashikuara nga neni 60 i Kodit Penal. Ky rekomandim përgjithësisht orientohet në tre plane:

1. *Bashkëpunimi me Shërbimin e Provës;*
2. *Situata familjare dhe shoqërore nëse, i dënuari apo i pandehuri ka mbështetjen e të gjithë familjes së tij, si nga ana psiko-emocionale dhe ajo financiare për përballimin e vështirësive pas lirim;*
3. *Në fushën e punësimit apo të arsimimit. Nëse ka një ofertë punësimi; a i ofron punëdhënësi apo instituti arsimor kushte të mjaftueshme për trajtimin e nevojshëm human dhe financiar për t’u integruar në shoqëri.*

1 ROLI DHE POZITA PROCEDURALE E SHËRBIMIT TË PROVËS GJATË FAZËS SË HETIMEVE PARAPRAKE

Parashikimi pas ndryshimeve në Kodin Penal, si ligj material, në ligjin nr. 10 024, datë 27.12.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, në Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve e procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative”, miratuar me vendimin nr. 302, datë 25.03.2009 të Këshillit të Ministrave, dalë në zbatim të ligjit, padyshim është një risi për kuadrin ligjor shqiptar. Kjo pasi krijimi i një institucioni të tillë, i cili deri dje nuk ishte i parashikuar, përbën njëherazi një ndihmesë të madhe për organin e hetimit, por edhe për gjykatën në aplikimin e formave të dënimeve alternative. Për më tepër një organ i tillë i bën realisht të zbatueshme në praktikë dënimet alternative, të cilat deri dje për sa i përket fazës së ekzekutimit mbeteshin vetëm një formalitet në letër dhe që vareshin në ndërgjegjen e personave për t’u zbatuar. Kjo vinte pikërisht si rezultat i mungesës së një organi të mirëfilltë, i cili të merrej me mbikëqyrjen në ekzekutimin e dënimeve alternative.

Nga ana tjetër, konstatohet se implementimi i Shërbimit të Provës në legjislacionet me karakter material nuk është bashkëshoqëruar me ndryshime të karakterit procedural, e cila ka sjellë vështirësi në lidhje me pozitën procedurale të Shërbimit të Provës, sidomos në fazën e hetimit dhe gjykimit. Në lidhje me rolin që duhej të luajë ky organ në fazën e ekzekutimit, parashikimet ligjore janë dhe më të qarta.

Neni 31/7 i ligjit nr. 10 024, datë 27.12.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, në paragrafin e parë parashikon se:

“Shërbimi i provës është organi shtetëror, që mbikëqyr zbatimin e dënimeve alternative, paraqet informacion dhe raporte para prokurorit ose gjykatës, sipas këtij ligji dhe ndihmon në ekzekutimin e dënimit alternativ, si dhe ndihmon personin e dënuar në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin social”.

Nga formulimi ligjor i kësaj dispozite rezulton se Shërbimi i Provës, me cilësinë e organit shtetëror, ka detyrimin që të paraqesë informacione dhe raporte para prokurorit ose gjykatës. Nëse do i referoheshim fillimisht fazës së hetimit, sipas nenit 31/8, paragrafi i parë i ligjit të sipërcituar rezulton se që në fazën e hetimit organi i prokurorisë me kërkesë ka të drejtë të kërkojë nga Shërbimi i Provës një raport në të cilin të vlerësohen rrethanat shoqërore për ta ndihmuar prokurorinë në marrjen e vendimeve gjatë fazës së hetimeve paraprake. Sipas paragrafit të dytë të kësaj dispozite rezulton se ky raport duhet të përmbajë:

- informacion dhe të dhëna për personalitetin e shkelësit të ligjit,
- punësimin e mëparshëm,
- sjelljen e tij

- nivelin arsimor, si dhe
- faktorët që ndikojnë apo mund të ndikojnë me sjelljen e tij,

Këto të dhëna jepen në raport me qëllim që të ndihmojnë gjykatën në vlerësimin e duhur të dënimit alternativ.

Në paragrafin e katërt të këtij ligji ligjvënësi parashikon gjithashtu se raporti duhet të përmbajë edhe rekomandimin e Shërbimit të Provës për dënimin e përshtatshëm alternativ për personin, integrimin e tij në shoqëri dhe parandalimin e kryerjes së veprave të tjera penale.

Në praktikën gjyqësore ka lindur për diskutim çështja se për çfarë vendimmarrjesh në fazën e hetimeve paraprake ka pasur qëllim ligjvënësi dhe me çfarë cilësie procedurale paraqitet ky raport i Shërbimit të Provës në fazën e hetimeve paraprake.

Për të analizuar këto dy çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me rolin e Shërbimit të Provës në fazën e hetimeve paraprake i referohemi fillimisht se çfarë vendimmarrjesh merr organi i prokurorisë në fazën e hetimeve paraprake.

Së pari: Ky organ i drejtohet gjykatës për marrjen e masës së sigurimit personal për personin në hetim të një veprë penale, duke kërkuar dhe llojin e masës konkrete.

Së dyti: Vendos mosfillimin e procedimit penal pas kryerjes së verifikimeve të nevojshme, konform nenit 290 të Kodit të Procedurës Penale.

Së treti: Vendos pushimin e çështjes penale ose të akuzës nëse janë rastet e parashikuara nga neni 328 i Kodit të Procedurës Penale.

Së katërti: Merr vendim për përfundimin e hetimeve dhe dërgimin e çështjes për gjykim.

Për sa u përket vendimmarrjeve të organit të prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal apo për pushimin e çështjeve ose akuzës konstatohet se të dyja këto lloj vendimmarrjesh, duke qenë se kanë të bëjnë me mungesën e elementëve të veprës penale apo të personit që dyshohet, nuk kanë asnjë lidhje me dënimet alternative. Si rrjedhim, nuk ka mundësi që në të dyja këto raste, Shërbimi i Provës të ndihmojë organin e hetimit për marrjen e vendimeve të tilla.

Për sa i përket fazës së marrjes së vendimit kur organi i prokurorisë ka kërkuar në gjykatë një masë sigurimi personal, rezulton se ky organ përcakton në kërkesën e drejtuar gjykatës llojin e kësaj mase duke analizuar fillimisht kushtet dhe kriteret për caktimin e saj. Në përfundim të kësaj analize prokurori çmon nëse duhet të kërkojë në gjykatë masë sigurimi personal *arrest në burg*, ose masa të tjera alternative të përcaktuara nga nenet 232 dhe 240 të Kodit Penal.

Nëse organi i prokurorisë do kishte mundësinë që para se të bënte kërkesën në gjykatë për caktim mase sigurimi të kishte një raport nga Shërbimi i Provës, me të gjitha të dhënat që përcakton ligji e kryesisht për personalitetin e shkelësit të ligjit, ky Shërbim do e ndihmonte së tepërmi organin e hetimit para një vendimmarrje të tillë. Edhe pse një gjë e tillë do ndikonte pozitivisht në përcaktimin e një mase alternative sigurimi nga organi i prokurorisë, kjo gjë aktualisht ende është e pamundur objektivisht. Kjo pasi e gjithë koha e nevojshme e vënë në dispozicion të organit të prokurorisë deri në marrjen e vendimit për bërjen e kërkesës në gjykatë për masë sigurimi është vetëm 48 orë (në rastet e arrestimit apo ndalimit), ndërkohë që aktualisht Zyrat e Shërbimit të Provës nuk funksionojnë pranë çdo gjykate të rretheve gjyqësore sipas parashikimit ligjor të nenit 31/12 të ligjit nr. 10 024, datë 27.12.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”. P.sh., nëse një raport i tillë kërkohet nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë para bërjes së kërkesës në gjykatë, i kërkon një raport Shërbimit të Provës, Zyra Vendore e Shërbimit të Provës që mbulon në juridiksionin e vet këtë prokurori, që është Zyra Vendore e Durrësit, e ka pothuaj të pamundur që t’i vërë në dispozicion raportin e saj brenda 48 orëve organit të prokurorisë. Kjo pasi largësia e madhe, mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme njerëzore dhe profesionale e bëjnë të pamundur procesin e intervistimit gjatë kësaj periudhe dhe arrijnë në konkluzione përfundimtare dhe më pas përpilimin e një raporti të tillë.

Situata është më e thjeshtë në rastet kur prokuroria depoziton në gjykatë një kërkesë vetëm për caktim mase sigurimi. Në të tilla raste organi i prokurorisë i ka të gjitha mundësitë, por edhe kohën e mjaftueshme që para se të bëjë kërkesën në gjykatë, t’i kërkojë Shërbimit të Provës një raport që i përkiste të dyshuarit. Nëse raporti i Shërbimit të Provës do jetë pozitiv, kjo gjë mund t’i shërbejë organit të prokurorisë për t’i kërkuar gjykatës një caktim mase sigurimi alternative nga ajo e arrestit në burg.

Për sa i përket vendimit për përfundimin e hetimeve dhe bërjen e kërkesës për dorëzimin e çështjes në gjykatë, konstatohet se organi i prokurorisë gjatë gjykimit, pjesë të kësaj vendimmarrje ka dhe kërkesën për marrjen e provave, deri dhe në bërjen e konkluzioneve përfundimtare, ku kërkohet jo vetëm fajësia, por dhe lloji dhe masa e dënimit. Në këtë kuptim organi i prokurorisë gjatë fazës së hetimeve ka të drejtë t’i kërkojë Shërbimit të Provës një raport dhe më pas këtë raport e bën pjesë të akteve të depozituara në gjykatë, duke kërkuar administrimin e tij si provë. Mbi bazën e rekomandimeve të këtij raporti, organi i prokurorisë mund të arrijë në një konkluzion nëse duhet të kërkojë ose jo që gjykata të aplikojë ndaj të pandehurit një dënim alternativ. Ajo që është e rëndësishme është fakti se prokuroria nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga raporti i Shërbimit të Provës, i cili është rekomandues në çdo rast dhe jo detyrues për organin e prokurorisë.

Ajo që vihet re në praktikën gjyqësore është fakti se nga disa prokurori ose nga disa prokurorë është hapur një praktikë ku pothuaj në çdo rast i drejtohen në fazën e hetimeve Shërbimit të Provës, ku i kërkojnë një raport në lidhje me personalitetin e të pandehurit, punësimin e mëparshëm të tij, sjelljen dhe nivelin arsimor të tij, etj. Nga ana tjetër ka ende prokurorë të cilët e shohin me skepticizëm administrimin e një raporti të tillë. Kjo nisur nga dy arsye:

Së pari: Vetë ligji (neni 38/8, paragrafi i parë) nuk bën një parashikim detyrues për organin e prokurorisë që ta detyrojë në çdo rast t'i drejtohet Shërbimit të Provës për të marrë një raport të tillë. Si rrjedhim, ligji ka nevojë për një ndryshim me qëllim që të jetë më i qartë në këtë drejtim, duke parashikuar se kur dhe për çfarë rastesh organi i prokurorisë mund t'i drejtohet Shërbimit të Provës.

Së dyti: Për shkak të mungesës jo vetëm të burimeve njerëzore që kanë Zyrat Vendore të Shërbimit të Provës, por edhe për shkak të faktit se në Shqipëri funksionojnë aktualisht vetëm 4 Zyra Vendore të Shërbimit të Provës, jo siç e parashikon vetë ligji. Për pasojë, pritja e një raporti të tillë nga prokuroria apo prokurori të ndryshme, mund të passjellë dhe zvarritje të padobishme të hetimit, çka do çonte dhe në zgjatje të afateve të hetimit, e cila do të mund të cenonte dhe interesat apo të drejtat e të pandehurve të paraburgosur.

Në të tilla kushte zgjidhja e vetme për unifikimin e praktikave të tilla është përcaktimi në mënyrë të saktë e parashikimeve ligjore jo vetëm me pozitën e Shërbimit të Provës në fazën e hetimit, por edhe me faktin nëse këto raporte duhet të administrohen në çdo rast ose jo.

Ajo që konstatohet gjatë praktikës gjyqësore është dhe fakti se ka pasur raste kur gjykatat nuk kanë pranuar gjykimin e shkurtuar ndaj të pandehurve për shkak se dosjes gjyqësore i mungonte raporti i Shërbimit të Provës, i cili duhej të merrej në fazën e hetimeve. Nëpërmjet kësaj vendimmarrjeje, gjykatat kanë pasur rëndësinë e këtij raporti në fazën e hetimeve paraprake që më pas i shërben dhe gjykimin të çështjes.

Ajo që lë vend për interpretime në këtë drejtim është fakti se me çfarë vlere procedurale duhet të administrohet nga organi i prokurorisë një raport i tillë.

Për shkak të mungesës së përshtatjes së ndryshimeve ligjore në ligjin procedural, pozita e Shërbimit të Provës është ende e paqartë jo vetëm në fazën e hetimit, por edhe në fazën e gjykimin. Për pasojë, kjo gjë ka sjellë vështirësi dhe në llojin apo produktin ligjor që “prodhon” ky Shërbim, se çfarë cilësie do ketë raporti i përgatitur nga Shërbimi i Provës në fazën e hetimit.

Legjislacione të ndryshme këtë situatë e kanë zgjidhur me parashikime të sakta ligjore, p.sh., sistemi ligjor gjerman, duke përcaktuar pozicionin procedural të Shërbimit të Provës si ekspert-dëshmitar, ka zgjidhur edhe produktin që përfitohet nga ky subjekt i njohur dhe i parashikuar nga ligji.

Sistemi ynë ligjor duke mos parashikuar në mënyrë të qartë pozicionin procedural të Shërbimit të Provës në hetim dhe gjykim, ka sjellë më pas vështirësi në natyrën e provës që ka produkti i tij.

Në këtë kuptim, nëse i referohemi nocionit “*Provat*” të përcaktuara në Titullin IV, në kreun I të Kodit të Procedurës Penale, nuk rezulton që raporti i përgatitur nga Shërbimi i Provës të jetë përcaktuar në ndonjë nga llojet e provave tek ky organ. Po kështu edhe

ligji nr. 10 024, datë 27.12.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” nuk bën ndonjë parashikim të tillë në lidhje me raportin e Shërbimit të Provës si lloj prove.

Nga ana tjetër, Rregullorja e Shërbimit të Provës përcakton në nenin 32 të saj rregulla të hollësishme për raportin e Shërbimit të Provës duke përcaktuar dhe faktin që një raport i tillë paraqitet edhe në fazën e hetimeve paraprake, madje specialisti që përpilon raportin në këtë fazë ka të drejtë të paraqesë mendim për llojin dhe masën e dënimit që ai e quan të përshtatshme.

Konkretisht neni 32 i kësaj rregullore, në paragrafët 1–5 të tij parashikon se:

“1. Shërbimi i provës harton raportin vlerësues duke analizuar rrethanat sociale që lidhen me personin nën hetim, të pandehurin apo të dënuarin. Ky raport paraqet një ekspertim të personit nën hetim, të pandehurit apo të dënuarit brenda kompetencave të Shërbimit të Provës.

2. Në rastin e fazës së hetimeve paraprake dhe të gjykimit, ky raport hartohet nga një punonjës i caktuar nga drejtori i zyrës vendore për këtë qëllim. Në rastet e fazës së ekzekutimit të dënimit penal, raporti hartohet nga punonjësi i caktuar me mbikëqyrjen e të dënuarit.

3. Raporti i vlerësimit paraqet të dhëna që i vijnë në ndihmë prokurorit ose gjykatës në marrjen e vendimit në çdo fazë të procedimit penal, bazuar në informacione të detajuara dhe në analizën e rrethanave, shkaqeve të kryerjes së veprës penale dhe qëndrimeve të tij të paraqitura nga Shërbimi i Provës në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme.

4. Shërbimi i Provës paraqet në raport mendimin e tij për llojin apo masën dënimit të përshtatshme që duhet marrë në çdo rast individual. Ky mendim jepet në mënyrë objektive dhe të paanshme, pavarësisht qëndrimeve të prokurorisë apo të mbrojtësit.

5. Raporti i vlerësimit paraqitet në formë të përmbledhur, duke shmangur termat e specializuara apo shprehjet që do ta vështirësonin kuptimin e tij”.

Nëse i referohemi paragrafëve të dispozitës rezulton se raporti paraqet një ekspertim të personit nën hetim, pra, paraqet të dhëna specifike dhe teknike për këtë person.

Në këtë prizëm, në mungesë të një parashikimi ligjor të shprehur, raporti mund të përbëjë në një farë mënyre një akt ekspertimi. Si i tillë, organi i prokurorisë në administrimin e tij në fazën e hetimeve paraprake mund të respektojë rregullat procedurale të parashikuara në nenet 178–185 të Kodit të Procedurës Penale që kanë të bëjnë me ekspertimet.

2 ROLI DHE POZITA PROCEDURALE E SHËRBIMIT TË PROVËS GJATË GJYKIMIT

Sipas përmbajtjes aktuale që kanë sot dispozitat përkatëse të Kodit Penal dhe Kodi i Procedurës Penale na rezultojnë se Shërbimi i Provës nuk është ndër subjektet procedurale të parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale. Në pjesën e parë të këtij Kodi parashikohen subjektet e procedimit penal. Sipas përkufizimit të dhënë nga teoria dhe praktika e së drejtës procedurale penale “*subjekte të procedimit penal*” janë të gjithë pjesëmarrësit e procedimit penal, të cilët luajnë role të rëndësishme në realizimin e detyrave të procedimit penal, duke vepruar në përputhje me të drejtat, detyrat dhe kompetencat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale.⁵⁶ Subjektet e procedimit penal janë:

- **Gjykata**
- **Prokurori**
- **Policia gjyqësore**
- **I pandehuri**
- **Mbrojtësi i të pandehurit**
- **I dëmtuari**
- **I dëmtuari akuzues**
- **Paditësi në procesin penal**
- **I padituri në procesin penal.**

Nga sa shihet më sipër, ky është një përkufizim, i cili nuk lë shteg për interpretime të zgjeruara d.m.th. nuk lë hapësira që pjesëmarrës të tjerë në procesin penal të përfshihen në rrethin e “*subjekteve të procedimit penal*”. Të tillë pjesëmarrës janë p.sh.: dëshmitarët dhe ekspertët.

Në të njëjtën situatë juridike gjendet sot edhe Shërbimi i Provës. Shërbimi i Provës nuk është subjekt i procedimit penal por merr pjesë në këtë procedim në rolin e “*ekspertit*” për të ndihmuar subjektet e procedimit penal në kryerjen e detyrave të tyre, me qëllim dhënien e një vendimi sa më të drejtë e të përshtatshëm jo vetëm për të pandehurin por edhe për të dëmtuarin nga vepra penale si dhe shoqërinë.

Ky përfundim bazohet edhe në përmbajtjen e dispozitave të VKM-së nr. 302, datë 25.03.2009, të cilat e trajtojnë raportin e përpiluar nga Shërbimi i Provës si “*...ekspertim të personit nën hetim, të pandehurit apo të dënuarit brenda kompetencave të Shërbimit të Provës*”.⁵⁷

Është tashmë e ditur se dëshmitarët dhe ekspertët prodhojnë prova, të cilat përdoren nga gjykata në përfundim të shqyrtimit gjyqësor për të marrë një vendim i cili do të përcaktojë:

- a) nëse është kryer vepra penale ose jo;
- b) nëse i pandehuri është ose, jo i përgjegjshëm penalisht;
- c) nëse i pandehuri e ka kryer jo veprën penale;
- d) llojin dhe masën e dënimit që do të vuajë i pandehuri.

⁵⁶ Ky përkufizim është dhënë në Komentarin e Kodit të Procedurës Penale, Halim Islami, Ilir Panda e Artan Hoxha, botim i Danida dhe Soros, Tiranë 2003, fq. 63.

⁵⁷ *Shih* nenin 32/paragrafi 1 i VKM-së nr. 302, datë 25.03.2009.

Për të përcaktuar masën dhe llojin e dënimit, sipas nenit 47/2 të Kodit Penal parashikohet se: *“Në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese”*.

Ndërsa, në nenin 380 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se: *“Për të marrë vendimin gjykata nuk mund të përdorë prova të tjera veç atyre që janë marrë ose janë verifikuar në shqyrtimin gjyqësor”*.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën rezulton se për të marrë një vendim përfundimtar e për pasojë, për të dhënë edhe një dënim gjykata mund të bazohet vetëm në prova të marra apo të verifikuara gjatë shqyrtimit gjyqësor. Ky është një rregullim absolut, i cili nuk lejon përjashtime. Pra, në kuptimin negativ të këtij rregulli rezulton se :

- ***Gjykata nuk mund të japë një vendim të bazuar në akte të cilat nuk kanë marrë cilësinë e “provës”.***
- ***këto akte nuk marrin kuptimin e “provës” nëse nuk merren ose verifikohen gjatë shqyrtimit gjyqësor.***

Nga sa më sipër, arrihet në përfundimin se edhe Shërbimi i Provës do të prodhojë një *“provë”* gjatë procesit penal, e cila e shqyrtuar në harmoni me provat e tjera, do t’i shërbejë gjykatës për të marrë një vendim përfundimtar dhe për pasojë për të dhënë një dënim ndaj autorit të veprës penale.

Nisur nga analiza e mësipërme nxirret si përfundimin se raporti i Shërbimit të Provës i paraqitur para gjykatës (qoftë edhe i kryer gjatë hetimeve paraprake me kërkesë të prokurorit por që verifikohet gjatë gjykimit) është një *“provë”* në kuptimin e ligjit procedural penal. Rrjedhimisht, ky raport e fiton këtë cilësi vetëm gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në asnjë rrethanë tjetër. Ndërsa, specialisti i Shërbimit të Provës është në cilësinë e *“ekspertit”* në procesin penal. Për pasojë, ai duhet t’i nënshtrohet rregullave për caktimin e ekspertit të parashikuara nga nenet 178 e vijues të Kodit të Procedurës Penale.

Problematika e mungesës së raportit të Shërbimit të Provës në fashikullin për gjykim

Nisur nga analiza e mësipërme në lidhje me subjektet e procedimit penal, provat në këtë procedim, rolin e Shërbimit të Provës, si dhe natyrën e raportit të përpiluar nga ky Shërbim, rezulton se në rastet e gjykimit të shkurtuar të parashikuar nga neni 403 e vijues i Kodit të Procedurës Penale, i cili bazohet vetëm mbi aktet e paraqitura nga prokuroria, aplikimi i dënimeve alternative, pa patur në fashikullin për gjykim të raportit të Shërbimit të Provës do të jetë jo i mirë bazuar në prova dhe në ligj. Ky përfundim bazohet në faktin se në gjykimin e shkurtuar gjykata e ka proceduralisht të pamundur të marrë prova gjatë shqyrtimit gjyqësor, qoftë këto edhe për të përcaktuar vetëm llojin dhe

masën e dënimit. Më saktë, mungesa e këtij raporti, do ta vendosë në vështirësi gjykatën për të përcaktuar se:

- *cili nga dënimet alternative do të jetë më i përshtatshëm në rastin konkret;*
- *cili nga detyrimet e parashikuara nga neni 60 i Kodit Penal do të jetë më i përshtatshëm në rastin konkret, kur gjykata ka vendosur aplikimin e një dënimi alternativ.*

Në përfundim të analizës së bërë më lart për rolin dhe pozitën procedurale të Shërbimit të Provës në Shqipëri është me vend që ligjvënësi të bëjë ndryshimet përkatëse në ligjin procedural penal për të saktësuar qartë pozitën procedurale të Shërbimit të Provës dhe të raportit të përgatitur nga ky Shërbim gjatë gjykimit penal.

3 ROLI DHE POZITA PROCEDURALE E SHËRBIMIT TË PROVËS GJATË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE QË PËRMBAJNË DËNIME ALTERNATIVE

Në nenin 31/7, paragrafi i parë të ligjit nr. 10 024, datë 27.12.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 ‘Për ekzekutimin e vendimeve penale’”, Shërbimi i Provës parashikohet si organ shtetëror që ka kompetencë edhe mbikëqyrjen e zbatimit të dënimeve alternative.

Vetë dispozitat e Kodit Penal, të ndryshuar, mbi dënimet alternative, parashikojnë në përmbajtjen e tyre rolin mbikëqyrës të Shërbimit të Provës. Kështu vetë neni 59 i Kodit Penal, në paragrafin e fundit parashikon se:

“Nëse i dënuari nuk mban kontakte me shërbimin e provës, apo nuk përmbush detyrimet e parashikuara në nenin 60, siç është urdhëruar nga gjykata, gjykata vendos zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër, zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes, brenda periudhës së provës, ose revokimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit”.

Sipas këtij parashikimi ligjor, gjykata ka të drejtë që nëse i dënuari nuk mban kontakte me Shërbimin e Provës apo nuk përmbush detyrimet e parashikuara në nenin 60 të këtij

Kodi siç ka urdhëruar gjykata, atëherë kjo e fundit ka tre opsione vendimmarrjeje:

Së pari: Zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër

Së dyti: Zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes brenda periudhës së provës

Së treti: Revokimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit.

Mbetet i paqartë fakti se çfarë ka pasur qëllim ligjvënësi në parashikimin e opsionit të dytë për gjykatën, ku parashikon zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes brenda periudhës së provës, në një kohë që e gjithë periudha e provës karakterizohet nga një periudhë mbikëqyrjeje, e cila realizohet nga Shërbimi i Provës. Në këtë kuptim, nëse gjykata do

zgjatë periudhën e mbikëqyrjes, ajo ka zgjatur njëherazi periudhën e provës. Praktika gjyqësore në këtë drejtim ende nuk ka pasur një zhvillim.

Po kështu edhe në aplikimin e alternativës tjetër të dënimit të parashikuar nga neni 59/a i Kodit Penal, i emërtuar “*Qëndrimi në shtëpi*,” ligjvënësi parashikon rolin mbikëqyrës të Shërbimit të Provës në fazën ekzekutive të këtij dënimi. Kështu, nëse gjykata lejon personin e dënuar me “*qëndrim në shtëpi*” që të largohet nga vendbanimi për plotësimin e nevojave të domosdoshme familjare me qëllim që të angazhohet në:

- veprimtari pune,
- veprimtari edukimi,
- veprimtari arsimimi, ose për
- programe rehabilitimi,

duhet që të marrë pëlqimin e Shërbimit të Provës sipas parashikimit ligjor të nenit 59/a të Kodit Penal.

Më pas është gjykata që në vendimin e saj përcakton dhe masat që duhet të marrë Shërbimi i Provës. Nocioni “*masë*” i parashikuar në këtë dispozitë nuk gjen ndonjë parashikim të veçantë në dispozitat e kreut të “*Alternativave të dënimit me burgim*”. Megjithatë, këto masa mund të konsistojnë kryesisht në veprimet konkrete që duhet të kryejë Shërbimi i Provës me qëllim monitorimin apo mbikëqyrjen e kësaj vendimmarrjeje të gjykatës. Kjo pasi largimi i personit të dënuar nga vendbanimi të jetë vetëm për plotësimin e atyre nevojave që gjykata ka përcaktuar në vendimin e saj.

Nga ana tjetër, në paragrafin e fundit kjo dispozitë (neni 59/a i Kodit Penal) parashikon se gjykata zbaton nenin 62 të këtij Kodi kur:

- personi i dënuar largohet pa autorizimin e gjykatës nga vendbanimi, apo
- shkel detyrimet e caktuara në vendimin e gjykatës.

Duke qenë një parashikim ligjor referues, ai i referohet nenit 62 të Kodit Penal. Paragrafi i parë i kësaj dispozite, parashikon dhe vendimmarrjen e gjykatës nëse i dënuari gjatë afatit të provës kryen një vepër tjetër penale.

Sipas përmbajtjes së këtij paragrafi të dispozitës parashikohet se:

“Nëse i dënuari, gjatë afatit të provës, kryen një vepër tjetër penale, gjykata mund të ndryshojë detyrimet që ka vendosur, ta zëvendësojë dënimin e dhënë me një dënim tjetër, apo ta revokojë, tërësisht ose pjesërisht, vendimin e pezullimit”.

Kjo dispozitë parashikon në paragrafët e dytë, të tretë dhe të katërt, në mënyrë të qartë mënyrën, procedurën dhe rolin që ka Shërbimi i Provës në rast se gjatë afatit të provës i dënuari shkel kushtet dhe detyrimet që ka vendosur gjykata.

Detyrimet e të dënuarit të vënë në provë, të cilat parashikohen dhe nga neni 62 i Kodit Penal janë përcaktuar në mënyrë të shprehur dhe në nenet 60 dhe 61 të Kodit Penal.

Nga ana tjetër, kusht ligjor sipas nenit 62 të Kodit Penal mund të përbëjë edhe çdo lloj detyrimi tjetër i ndryshëm nga ato të përcaktuara në këto dy dispozita, por i përcaktuar në vendimin e gjykatës si p.sh., urdhërohet i dënuari të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës, etj. Në të tilla raste, Shërbimi i Provës ngarkohet me detyrimin që t'i raportojë në mënyrë të menjëhershme prokurorit sapo të konstatojë një fakt të tillë. Më pas është prokurori i cili disponon në këtë mënyrë sipas procedurave ligjore:

“Për shkelje të lehta dhe për herë të parë të kushteve ose detyrimeve që i janë vendosur nga gjykata, prokurori

- ka të drejtë të japë paralajmërim, i cili regjistrohet në dosjen personale të të dënuarit.

Për shkelje të rënda ose të përsëritura, prokurori i kërkon gjykatës:

- ndryshimin e detyrimit të vendosur,
- shtimin e detyrimeve të tjera,
- zëvendësimin e tyre me një sanksion tjetër, ose
- revokimin e vendimit të pezullimit të dënimit dhe vuajtjen e pjesës së mbetur të dënimit në burg”.

Edhe dënimi tjetër alternativ i parashikuar në nenin 63 të Kodit Penal i emërtuar “*Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik,*” parashikon rolin që duhet të kryejë Shërbimi i Provës. Risia që sjell parashikimi i një dënimi të tillë alternativ pas ndryshimeve është pikërisht fakti që në ndryshim nga e njëjta dispozitë, por para ndryshimeve, llojin e punës që do kryhet, vendin e punës, si dhe ditët kur do të kryhet e përcakton vetëm Shërbimi i Provës. Gjykata në dhënien e një vendimi të tillë alternativ përcakton vetëm numrin e orëve të punës, si dhe detyrimin që i dënuari të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës. Është më pas vetë Shërbimi i Provës, i cili ka detyrimin që të mbajë parasysh punësimin e rregullt të të dënuarit apo detyrimet e tij familjare.

Pikërisht këto parashikime i bën neni 63 i Kodit Penal kur shprehet në mënyrë eksplicite se:

“Në vendimin e saj gjykata përcakton numrin e orëve të punës dhe detyrimin që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës. Shërbimi i provës vendos llojin e punës që do të kryhet, përcakton vendin e kryerjes së punës dhe ditët e javës kur do të kryhet ajo, duke pasur parasysh, për aq sa është e mundur, punësimin e rregullt të të dënuarit apo detyrimet e tij familjare. Kohëzgjatja e punës me interes publik nuk i kalon tetë orë në ditë”.

Duke qenë një organ mbikëqyrës në ekzekutimin e një dënimi alternativ të tillë, është

Shërbimi i Provës ai që konstaton dhe më pas informon prokurorin që i dënuari nuk kryen punën në interes publik, nuk mban kontakte të rregullta dhe periodike me vetë Shërbimin e Provës apo shkel kushtet ose detyrimet e tjera të vendosura nga gjykata. Më pas është prokurori i cili informon menjëherë gjykatën dhe kjo e fundit në këtë rast vendos sipas nenit 62 të këtij Kodi.

Ajo që konstatohet në këto dispozita të Kodit Penal është fakti se ligjvënësi nuk ka bërë ndonjë parashikim specifik në lidhje me Shërbimin e Provës tek dënimet alternative të “gjysmëlirisë”, parashikuar nga neni 58 i Kodit Penal apo te “lirimi me kusht” parashikuar nga neni 64 i Kodit Penal. Gjithsesi, një parashikim më të hollësishëm në lidhje me rolin dhe detyrat që ka Shërbimi i Provës në fazën e ekzekutimit të dënimeve alternative e parashikon vetë ligji nr. 10 024, datë 27.11.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 31.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”. Në nenin 29 të tij, ky ligj parashikon se:

“Kur gjykata vendos ekzekutimin e vendimit me burgim në gjysmëliri, parashikuar në nenin 58 të Kodit Penal, ia dërgon menjëherë vendimin prokurorit për ekzekutim. Administrata e burgjeve dhe shërbimi i provës, në bazë të vendit të kryerjes së detyrimeve nga personi i dënuar, përcakton institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale, ku do të vendoset i dënuari në gjysmëliri, bazuar në detyrimet që ai duhet të përmbushë. Shërbimi i provës harton programin ditor, që duhet të zbatohet personi i dënuar për periudhën kohore, që ai ndodhet jashtë institucionit”.

Sipas përmbajtjes së kësaj dispozite, gjykata e cila aplikon vendimin alternativ me “gjysmëliri” parashikuar nga neni 58 i Kodit Penal, ia dërgon menjëherë vendimin prokurorisë pranë asaj gjykate me qëllim ekzekutimin e tij. Më pas, bazuar në detyrimet që i dënuari duhet të përmbushë, të përcaktuara në vendimin e gjykatës, është administrata e burgjeve por dhe Shërbimi i Provës si organ mbikëqyrës që përcaktojnë institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale ku do të vendoset i dënuari në gjysmëliri.

3.1 Roli dhe pozita procedurale e Shërbimit të Provës gjatë mbikëqyrjes së ekzekutimit të dënimit alternativ të “gjysmëlirisë”, parashikuar nga neni 58 i Kodit Penal

Mënyra e mbikëqyrjes së këtij dënimi parashikohet në nenin 7 të ligjit nr. 10 024, datë 27.11.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 31.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”.

Kjo dispozitë në përmbajtjen e saj parashikon se:

“Shërbimi i provës mbikëqyr personin e dënuar me gjysmëliri, kur ndodhet jashtë institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale.

Shërbimi i provës i raporton menjëherë prokurorit dhe, kur është e nevojshme, edhe drejtorit të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, kur personi i dënuar me gjysmëliri nuk përmbush kushtet ose detyrimet e tij për qëllimin e këtij dënimi.

Kur personi i dënuar me gjysmëliri nuk kthehet në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale, drejtori i institucionit, në bashkëpunim me shërbimin e provës, pasi të kenë verifikuar faktet dhe rrethanat për moskthimin e tij, informojnë menjëherë prokurorin”.

Sipas kësaj dispozite përcaktohet qartë momenti apo roli se kur Shërbimi i Provës kryen detyrat e veta funksionale në dënimet alternative të “gjysmëlirisë”.

Në këtë këndvështrim rezulton se Shërbimi i Provës mbikëqyr të dënuarin me “gjysmëliri” në momentin që ai ndodhet jashtë institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale për shkak të përmbushjes së detyrimeve për të cilat është aplikuar kjo alternativë dënimi. Nëse gjatë kësaj periudhe Shërbimi i Provës konstaton se personi i dënuar me gjysmëliri nuk përmbush kushtet ose detyrimet e tij për qëllimin e këtij dënimi, pasi mban një procesverbal përkatës për dokumentimin e këtij fakti i raporton menjëherë prokurorit të caktuar, i cili merret me ekzekutimin e vendimeve penale dhe në rast se e çmon të nevojshme, mund të vërë në dijeni dhe drejtorin e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale.

Ligjvënësi ka zgjidhur ligjërisht edhe situatën faktike kur i dënuari me “gjysmëliri” nuk kthehet në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale. Në këto raste, është drejtori i institucionit, i cili në bashkëpunim me Shërbimin e Provës, pasi të verifikojë faktet dhe rrethanat për moskthimin e këtij të dënuari në institucion, informojnë menjëherë prokurorin, i cili më pas vë në lëvizje gjykatën.

Nga ana tjetër, Rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve e procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative,” miratuar me vendimin nr. 302, datë 25.03.2009 të Këshillit të Ministrave, dalë në zbatim të ligjit, në kreun VII të saj, në nenet 35 dhe 36, parashikon mënyrën e mbikëqyrjes së të dënuarve me “gjysmëliri”.

Në nenin 35 të saj, kjo rregullore parashikon se:

“1. Shërbimi i Provës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me urdhër të përbashkët përcaktojnë institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale ku do të vendoset i dënuari në gjysmëliri. Në këtë përcaktim, mbahen parasysh shkaku për të cilin gjykata ka caktuar masën alternative të gjysmëlorisë dhe vendin ku duhet të përmbushë detyrimet personale jashtë burgut.

2. Modeli i urdhrit miratohet nga Ministri i Drejtësisë me propozim të Drejtorëve të Përgjithshëm të Burgjeve dhe Shërbimit të Provës”.

Në zbatim të vetë ligjit, nenit 6 të tij, Rregullorja përcakton se institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale për të dënuarin me “gjysmëliri” bëhet me urdhër të përbashkët të Shërbimit të Provës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, model i së cilit miratohet nga Ministria e Linjës, nga e cila varen këto dy institucione, e cila është Ministria e Drejtësisë. Në përcaktimin e vendit ku do të vuhet dënimi këto dy institucione (Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Shërbimi i Provës) mbajnë parasysh dy kritere thelbësore të cilët janë:

- Shkaku për të cilin gjykata ka caktuar masën alternative të gjysmëlorisë dhe
- Vendin ku duhet të përmbushë detyrimet personale jashtë burgut i dënuari me dënim alternativ.

Nga ana tjetër, në nenin 36 të kësaj Rregulloreje, Këshilli i Ministrave ka përcaktuar se Shërbimi i Provës, mbikëqyrjen e personit të dënuar me “gjysmëliri,” duhet ta bëjë në bazë të një programi. Në lidhje me këtë moment kjo dispozitë parashikon se:

“Shërbimi i Provës harton dhe zhvillon një program ditor individual për ekzekutimin e dënimit me gjysmëliri, në përputhje me nenin 28 të kësaj rregulloreje.

Ky program përmban detyrimet e të dënuarit gjatë kohës që ndodhet jashtë institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, duke përcaktuar:

- a) oraret e hyrjes dhe daljes në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale;*
- b) personat me të cilët i dënuari lejohet ose ndalohet të mbajë kontakte gjatë kohës së qëndrimit jashtë institucionit;*
- c) ambientet e lejuara dhe ato të ndaluara për frekuentim;*
- d) kushte të tjera”.*

Paragrafi i parë i kësaj dispozite parashikon se Shërbimi i Provës, veprimtarinë e tij për ekzekutimin e dënimit me gjysmëliri, duhet ta zhvillojë bazuar në një program të hartuar, i cili duhet të jetë:

- program individual për secilin të dënuar, dhe
- program ditor.

Kjo do të thotë që mbikëqyrja duhet të jetë e monitoruar me veprime konkrete dhe e dokumentuar bazuar në programin e hartuar. Ky program duhet të jetë në përputhje me parashikimet që bën neni 28 i kësaj Rregulloreje.

Vetë kjo dispozitë referuese në përmbajtjen e saj parashikon në mënyrë të detajuar se:

“1. Shërbimi i Provës vlerëson personalitetin e të dënuarit, me qëllim qartësimin e nevojave lidhur me mungesat fizike, afektive ose shoqërore, vullnetit të të dënuarit për punë dhe aftësitë e tij profesionale, të cilat kanë penguar zhvillimin e një jete shoqërore normale të tij. Shërbimi bazuar në këtë vlerësim, si dhe në të dhënat personale, familjare e shoqërore, masën e dënimit, ndërton programin individual të trajtimit të të dënuarit në përputhje me dënimin alternativ përkatës. Ky program duhet të miratohet nga drejtori i zyrës përkatëse vendore.

2. Në takimin e dytë me të dënuarin, punonjësi i Shërbimit të Provës i caktuar i paraqet dhe shpjegon të dënuarit përmbajtjen e programit individual. Programi individual i trajtimit të të dënuarit, diskutohet me të dënuarin. Ky program mund të ndryshohet në varësi të ecurisë së të dënuarit.

3. Programi individual nënshkruhet nga punonjësi i Shërbimit të Provës dhe i dënuari dhe, kur i dënuari është i mitur, edhe nga mbrojtësi i tij. Një kopje e programit individual i dorëzohet të dënuarit dhe mbrojtësit të tij.

4. Programi individual përmban elementët e mëposhtme:

a) pjesa hyrëse, në të cilën tregohen gjeneralitetet, adresa e vendbanimit, vepra penale e kryer, numri i vendimit gjyqësor, dënimi i dhënë, periudha e provës, duke përmendur datat e fillimit dhe të mbarimit të saj, si dhe emri dhe mbiemri i punonjësit të Shërbimit të Provës të caktuar;

b) masat dhe çdo detyrim tjetër të vendosur nga gjykata, si dhe mënyrat e përdorura nga punonjësi i Shërbimit të Provës për të siguruar përmbushjen e këtyre detyrimeve dhe masave;

c) nevojat kriminogjene dhe sociale të personit nën mbikëqyrje, si dhe qëllimet e përcaktuara për përmirësimin e tyre.

ç) rreziku i përsëritjes së veprës penale, rreziku i cenimit të sigurisë publike dhe ai i vetëvrasjes apo vetëdëmtimit;

d) metodat e propozuara të ndërhyrjes për të plotësuar nevojat e identifikuarat dhe për të reduktuar rrezikun;

dh) data, vendi dhe frekuenca e takimeve midis punonjësit të Shërbimit të Provës dhe të dënuarit që do të mbahen gjatë gjithë periudhës së mbikëqyrjes të përcaktuar nga gjykata.

5. Kur gjykata vendos detyrimin e të dënuarit për të marrë pjesë në një program rehabilitimi, programi individual shkurtimisht përshkruan përmbajtjen, kohëzgjatjen dhe mënyrën e kryerjes së tij.

6. Kur gjykata vendos detyrimin e kryerjes së një pune të papaguar në interes publik, plani i mbikëqyrjes përmban përshkrimin e veprimtarive, vendin e punës dhe oraret e saj.

7. Gjatë periudhës së mbikëqyrjes, punonjësi i Shërbimit të Provës përcakton, në çdo takim, se deri në çfarë mase janë realizuar objektivat e planit të mbikëqyrjes.

8. Kur ndodhin ndryshime që mund të ndikojnë tek nevojat dhe rreziqet e identifikuara, plani i mbikëqyrjes mund të rishikohet, nëpërmjet anekseve që i shtohen atij.

9. Në rast rishikimi të planit të mbikëqyrjes, paragrafi 3 zbatohet kur është e përshtatshme. ”

Sipas përmbajtjes së kësaj dispozite, Shërbimi i Provës edhe në fazën e ekzekutimit të vendimit ka detyrimin që të vlerësojë personalitetin e të dënuarit. Si rrjedhim, bazuar në këtë vlerësim si dhe në të dhënat personale familjare e shoqërore, masën e dënimit, ai harton programin individual të trajtimit të dënuarit në përputhje me dënimin alternativ përkatës.

Një program i tillë duhet t'i bëhet i njohur të dënuarit në takimin e dytë që zhvillon specialisti i Shërbimit të Provës me të. Si rezultat i diskutimit të zhvilluar në këtë takim, programi dhe mund të ndryshohet në varësi të ecuresë së të dënuarit. Një kopje e këtij programi nënshkruhet nga i dënuari dhe kur i dënuari është i mitur, dhe nga mbrojtësi i tij, të cilëve iu dorëzohet dhe një kopje e këtij programi. Sipas pikës 4 të kësaj dispozite, programi duhet të përmbajë një sërë elementesh të detyrueshme në përmbajtjen e tij.

Ajo që mund të haset me vështirësi në praktikë nga Shërbimi i Provës është fakti që mundësitë objektive të këtij organi për të hartuar programe individuale ditore për çdo të dënuar me kërkesa të hollësishme, e bëjnë pothuaj të vështirë hartimin e tij. Kjo vështirësohet dhe më tej kur dënimet alternative po gjejnë një përhapje gjithmonë dhe më të gjerë.

Sipas paragrafit të dytë të nenit 36 të Rregullores, programi përmban detyrimet e të dënuarit vetëm gjatë kohës që ndodhet jashtë institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale duke përcaktuar:

- rastet kur do hyjë dhe dalë personi i dënuar në institucion;
- personat me të cilët i dënuari lejohet të takohet;
- personat me të cilët ndalohet që të mbajë kontakte gjatë kohës së qëndrimit jashtë institucionit;
- ambientet që lejohet të frekuentojë;
- ambientet që ndalohet të frekuentojë;
- por edhe kushte të tjera në varësi të rrethanave të rastit konkret.

Konstatohet gjithashtu se parashikimi i shkronjës “d” në nenin 36 të Rregullores i jep mundësi Shërbimit të Provës që në hartimin e programit të përcaktojë dhe kushte specifike sipas rasteve konkrete të mbikëqyrjes.

Parashikimi i një klauzole të tillë lë në diskrecionin e Shërbimit të Provës përcaktimin e kushteve të tjera, të cilat duhet të jenë specifike në varësi të rastit konkret.

3.2 Roli dhe pozita procedurale e Shërbimit të Provës gjatë mbikëqyrjes së ekzekutimit të “pezullimit të ekzekutimit të dënimeve me burgim dhe vënia në provë”, parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal

Në nenin 31/5 të ligjit nr. 10 024, datë 27.11.2009 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 ‘Për ekzekutimin e vendimeve penale’” parashikohet pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë. Sipas përmbajtjes së kësaj dispozite rezulton se:

“Kur gjykata vendos pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me vënien në provë, parashikuar në nenin 59 të Kodit Penal, ia dërgon vendimin prokurorit dhe institucioneve të ekzekutimit të vendimit penal.

I dënuari i vënë në provë, gjatë kohës së provës, duhet të raportojë rregullisht te shërbimi i provës, i cili duhet të informojë rregullisht organet vendore të Policisë së Shtetit.

Shërbimi i provës mbikëqyr ekzekutimin e vendimit të gjykatës dhe i raporton menjëherë prokurorit, kur personi i dënuar nuk mban kontakte me këtë shërbim apo nuk përmbush detyrimin e vendosur”.

Nga interpretimi literal i dispozitës rezulton se vendimi i gjykatës mbi dënimin alternativ të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë e personit të dënuar, ekzekutohet apo mbikëqyret nga Shërbimi i Provës. Për çdo problem të lindur ky Shërbim i raporton menjëherë prokurorit si subjekt procedural, i cili legjitimohet për të vënë në lëvizje gjykatën. Si shkaqe për t’i raportuar Shërbimi i Provës prokurorit, mund të shërbejnë:

- kur i dënuari nuk mban kontakte me këtë shërbim, ose
- kur nuk përmbush detyrimet e vendosura nga gjykata.

Po sipas kësaj dispozite, të dënuarit e vënë në provë, gjatë gjithë periudhës së provës kanë detyrim të raportojnë rregullisht tek Shërbimi i Provës dhe ky i fundit duhet të informoje rregullisht organet vendore të Policisë së Shtetit. Nisur nga mënyra sesi është formuluar dispozita, rezulton se Shërbimi i Provës duhet të informojë jo vetëm prokurorin, por edhe policinë. Mbetet ende jo i qartë fakti në të cilin ligjvënësi ka parashikuar me ligj që Shërbimi i Provës duhet të informojë edhe organet vendore të policisë së shtetit, ndërkohë që këto organe ligji i mëparshëm nuk i ka ngarkuar dhe më pas dhe ndryshimet ligjore nuk kanë parashikuar se mbikëqyrjen e këtyre dënimeve alternative ta bënin pikërisht këto organe.

Në zbatim të këtij ligji, Rregullorja e Shërbimit të Provës në kreun e VIII, nenet 37 – 44 të saj, parashikon procedurat dhe mënyrën e mbikëqyrjes së të dënuarve për të cilët gjykata ka vendosur “*pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë të personit*”.

Në nenin 37 të saj, Rregullorja, ashtu si tek mbikëqyrja e dënimit alternativ me “*gjysmëliri*”, parashikon dhe në këtë dispozitë hartimin e një lloj programi individual nga Shërbimi i Provës. Për shkak të vetë natyrës dhe specifikave të këtij lloj dënimi alternativ, ligjvënësi nuk ka parashikuar në këto raste një program të llojit ditor. Me këtë program përcaktohen në mënyrë sa më të qartë dhe të saktë të drejtat dhe detyrimet e të dënuarit gjatë ekzekutimit të dënimit dhe se të gjitha këto duhen të jenë në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 28 të kësaj Rregulloreje.

Si organ mbikëqyrës, Shërbimi i Provës në këndvështrim të nenit 38 të Rregullores, ka detyrimin të informojë të dënuarin mbi detyrimin e vetë këtij të dënuari që të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës gjatë zbatimit të këtij dënimi alternativ. Gjatë hartimit të programit individual punonjësi i Shërbimit të Provës përcakton:

- numrin e takimeve,
- kohëzgjatjen e takimeve,
- frekuencën e takimeve, dhe
- vendin e takimeve me të dënuarin në provë.

Në paragrafët 3, 4, 5 dhe 6 kjo dispozitë e Rregullores parashikon në mënyrë të detajuar mënyrën se si veprohet kur i dënuari i vënë në provë nuk paraqitet për shkaqe objektive ose subjektive në takimin e planifikuar me Shërbimin e Provës. Po kështu, për të pasur një mbikëqyrje sa më efektive të kësaj alternative dënimi, në zbatim edhe të parashikimeve ligjore të nenit 61 të Kodit Penal, Rregullorja e Shërbimit të Provës në nenin 39 të saj parashikon në mënyrë të qartë detyrimet që ka i dënuari i vënë në provë në rast se ndryshon vendbanimin apo vendqëndrimin.

Kjo dispozitë e Rregullores parashikon gjithashtu procedura strikte për të dënuarin e vënë në provë në lidhje me mënyrën se si duhet të njoftojë Shërbimin e Provës në rast të këtij ndryshimi. Një gjë e tillë bëhet nga i dënuari sipas nenit 39/4 të Rregullores edhe kur i dënuari ndryshon vendin e punës. Parashikimi i një dispozite të tillë nga ligjvënësi është bërë me qëllim që Shërbimi i Provës të jetë sa më pranë këtij procesi mbikëqyrjeje, duke mos u shkëputur i dënuari i vënë në provë për asnjë moment nga kontakti me këtë shërbim.

Në rast se vendbanimi apo vendqëndrimi i ri i të dënuarit të vënë në provë është jashtë kompetencës tokësore të Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës të ngarkuar fillimisht me çështjen, kjo e fundit i dërgon brenda 3 ditëve Zyrës Vendore kompetente të Shërbimit të Provës dosjen personale të të dënuarit të vënë në provë si dhe njofton menjëherë gjykatën që ka dhënë vendimin. Ajo që mund të shtrohet për diskutim në këtë moment është pikërisht fakti se për çfarë arsyesh gjykata që ka dhënë vendimin duhet të informohet

nga Shërbimi i Provës në këto raste. Mos do të ishte më e drejtë parashikimi i një lloj informacioni nga Shërbimi i Provës si organ mbikëqyrës tek prokurori, i cili ka vënë në ekzekutim një dënim penal të formës së prerë, por i një natyre të tillë?

Në lidhje me njoftimin që i dënuari i bën Shërbimit të Provës për ndryshimin e vendit të punës, rezulton se kjo ka një logjikë juridike, pasi i jep mundësinë Shërbimit të Provës që të përshtatë programin individual për këtë të dënuar në varësi dhe të llojit të punës që kryen i dënuari.

Ligjvënësi në një dispozitë tjetër të Rregullores, e konkretisht në nenin 40 të saj, detyron specialistin e Shërbimit të Provës që të përmbushin detyrimet e tyre funksionale që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e këtij dënimi alternativ, në rast se gjykata ka caktuar për të dënuarin e vënë në provë një ose më shumë se një nga detyrimet e përcaktuara në nenin 60 të Kodit Penal. Ky Shërbim duhet të mbështesë dhe informojë këtë të dënuar jo vetëm në përmbushje të këtyre detyrimeve, por dhe verifikon përmbushjen e tyre. Në këtë kuadër vetë Rregullorja e legjitimon Shërbimin e Provës që jo vetëm të identifikojë, por edhe të lidhë marrëveshje me institucionet lokale, siç janë Policia e Shtetit, qendrat e arsimit apo të trajnimit, qendrat e punës, institucionet mjekësore apo organizatat jofitimprurëse të ndryshme që ofrojnë programe rehabilitimi, të cilët në thelb ofrojnë mbështetjen për përmbushjen e një apo më shumë detyrimeve të vendosura nga gjykata.

Shërbimi i Provës ka lidhur disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione apo organizata të ndryshme, si p.sh. deri në datën 18 qershor 2010, ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme së Shërbimit të Provës dhe OJF-ve janë nënshkruar 4 marrëveshje bashkëpunimi dhe 27 marrëveshje bashkëpunimi janë nënshkruar me bashkitë dhe komunat në vend. Nga ana tjetër, ka pasur raste kur gjykata të veçanta kanë lidhur marrëveshje me fondacione të ndryshme dhe në vendimet gjyqësore në vendosjen e detyrimeve kanë përcaktuar dhe fondacionin ku do përmbushet një detyrim i tillë. Përmendim këtu vendimin nr. 345 datë 03.11.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, ku detyrimi i vënë të dënuarit në provë A.T. konform nenit 60/1 të Kodit Penal, për të vazhduar të marrë arsim profesional, i ishte lënë të përmbushej pranë Fondacionit Ndihmë për Fëmijët “N.P.F”, me të cilin ky organ kishte lidhur marrëveshje. Përveç këtij detyrimi për të përmbushur, gjykata i kishte caktuar të përmbushte dhe detyrime të tjera. Konkretisht atë të parashikuar nga neni 60/1 i Kodit Penal, për të qëndruar në banesë pas orës 20.00 dhe atë të parashikuar nga neni 60/9 i Kodit Penal, për të mos u shoqëruar me bashkëpunëtorët e veprës penale.

Vetë Rregullorja e Shërbimit të Provës në nenet 41 – 44 të saj përcakton rregulla të hollësishme në lidhje me mbikëqyrjen e realizuar nga Shërbimi i Provës në lidhje me detyrimin për të ushtruar një veprimtari profesionale ose për të marrë një formim profesional për të përmbushur detyrimet financiare ose detyrime të tjera, si dhe të detyrimit për mjekim ose rehabilitim.

Kështu, vetë neni 41 i Rregullores në pikën 4 të tij përcakton në mënyrë të shprehur që nëse gjykata në vendimin e saj nuk ka përcaktuar llojin e veprimtarisë që do të ndiqet

nga i dënuari, është Shërbimi i Provës organi i cili ka detyrimin për të përcaktuar llojin e aktivitetit dhe mënyrën e realizimit të tij.

Në këtë këndvështrim ky Shërbim ka detyrimin që pasi të identifikojë qendrat arsimore, por dhe institucionet e kualifikimit profesional në nivel lokal që organizojnë kurse të tilla, të marrë më pas masa që i dënuari të vendoset në formën e ushtrimit të veprimtarisë profesionale apo arsimit ose formimit profesional. Pra, nga ky parashikim ligjor rezulton se përveç gjykatës, këtë të drejtë e ka dhe Shërbimi i Provës, i cili përveç se mbështet të dënuarin në përmbushjen e detyrimeve të vëna nga gjykata, ka njëherazi detyrimin të kontrollojë në mënyrë periodike nëse përmbushen rregullisht këto detyrime ose jo. P.sh., nëse i dënuari shkon rregullisht për të ndjekur kursin e formimit profesional ose jo. Në varësi të përmbushjes së këtyre detyrimeve Shërbimi i Provës ka detyrime më pas nëse duhet ose jo të informojë prokurorin.

Ajo që duhet theksuar në këtë drejtim është fakti se Shërbimi i Provës ka detyrim për të përcaktuar vetëm llojin e aktivitetit dhe mënyrën e realizimit të tij, dhe jo të përcaktojë vendosjen si detyrim kryerjen e një aktiviteti profesional apo aktiviteti tjetër. Kjo pasi këtë të drejtë e ka vetëm gjykata për t'i caktuar detyrime personit të vënë në provë.

Për sa i përket mbikëqyrjes që bën Shërbimi i Provës në përmbushjen e detyrimeve financiare nga i dënuari i vënë në provë, përcaktim ky i nenit 42 të Rregullores, ky Shërbim në rastin konkret kryen tre veprime konkrete të cilat konsistojnë në:

- Kërkon dhe mbledh informacion mbi vendbanimin, mbi situatën dhe detyrimet financiare, vendin e punës dhe kohëzgjatjen e kontratës së punësimit dhe nëse është rasti dhe informacion në lidhje me personat në ngarkim të të dënuarit.
- I shpjegon të dënuarit detyrimin për të përmbushur detyrimet e vëna nga gjykata, duke identifikuar mënyrën dhe kohën e duhur të përmbushjes së detyrimeve financiare.
- Kontrollon rregullisht nëse i dënuari në provë i përmbush detyrimet e vendosura nga gjykata, duke dokumentuar për çdo rast raportet e kontrollit.

Për sa i përket përmbushjes së detyrimeve të tjera të parashikuara në nenet 60/4; 60/5; 60/6; 60/7; 60/8; 60/9; 60/10 dhe 60/11 të Rregullores së Shërbimit të Provës, rezulton se Shërbimi i Provës si detyrim kryesor që është në funksion të mbikëqyrjes së këtyre llojeve detyrimeve, ka bashkëpunimin tepër të ngushtë me institucionet lokale apo me entet e tjerë publikë ose privatë, të cilët mund të orientojnë në mbikëqyrjen e ekzekutimit të këtyre detyrimeve. Për çdo lloj detyrimi të përcaktuar nga dispozitat e sipërcituara, Shërbimi i Provës brenda 3 ditëve nga kontakti i parë me të dënuarin, ka detyrimin që t'i dërgojë Policisë së Shtetit dhe çdo organizate tjetër ose institucioni që mund të asistojë mbikëqyrjen, informacionin mbi të dënuarin në provë, duke iu kërkuar njëherazi këtyre subjekteve që të njoftohet menjëherë në rast se i dënuari nuk i përmbush detyrimet.

E ndërsa dispozitat penale materiale të përcaktuara në nenin 62 të Kodit Penal i jepnin të drejtë prokurorit që t'i bënte paralajmërim të dënuarit, neni 43 i Rregullores në pikën 4 të tij ia njeht këtë të drejtë edhe Shërbimit të Provës.

Në nenin 44 të saj, Rregullorja përcakton procedurën dhe mënyrën e mbikëqyrjes si të detyrimit për mjekim apo rehabilitimin të vendosur nga gjykata personit të vënë në provë. Si hap fillestar, i cili duhet të realizohet brenda 10 ditëve nga kontakti i parë me të dënuarin është pikërisht identifikimi në nivel lokal i qendrës së përshtatshme për përmbushjen e detyrimit, qendër e cila mund të jetë shëndetësore, organizatë, institucion apo që realizon programe rehabilitimi për substancat narkotike, alkoolin apo lloje të tjerash programi rehabilitimi. Më pas për vendosjen në këto qendra është përsëri specialisti i Shërbimit të Provës i cili kontrollon nëse i dënuari ndjek programet e trajtimit.

Në këtë kuptim, me qëllim lehtësimin e përmbushjes së detyrimeve, Shërbimi i Provës ka të drejtë të lidhë marrëveshje me qendrat mjekësore, institucionet, organizatat dhe specialistët për rregullimin e procedurave të bashkëpunimit.

Ligjvënësi ka zgjidhur edhe situatën kur ky detyrim konsiderohet i papërmbushur. Një detajim i tillë sipas kësaj dispozite të Rregullores konsiderohet i papërmbushur kur i dënuari i vënë në provë:

- në mënyrë të paarsyeshme refuzon përfshirjen në një program trajnimi;
- në mënyrë të pajustificuar ndërpret programin e trajnimit, dhe kur
- refuzon t'iu nënshtrohet testeve për konsumim të substancave.

Aktualisht nuk konstatohen ende raste nga praktika gjyqësore kur të dënuarit e vënë në provë nuk kanë përmbushur detyrimet e dhëna nga gjykata.

3.3 Roli dhe pozita procedurale e Shërbimit të Provës gjatë mbikëqyrjes së ekzekutimit të dënimit alternativ të “qëndrimin në shtëpi”, parashikuar nga neni 59/a i Kodit Penal

Për sa i përket mbikëqyrjes së dënimit alternativ të “qëndrimin në shtëpi”, parashikuar nga neni 59/a i Kodit Penal, vetë ligji nr. 10 024, datë 27.11.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 31.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, në nenin 31/4 të tij parashikon mënyrën e ekzekutimit dhe të mbikëqyrjes së tij.

Në përmbajtjen e saj, kjo dispozitë parashikon se:

“Kur gjykata vendos vuajtjen e dënimit të dhënë, me qëndrim në shtëpi, parashikuar në shkronjën “a” të nenit 59 të Kodit Penal, ia dërgon menjëherë për ekzekutim vendimin prokurorit dhe, në rast se ai mbahet në një institucion të ekzekutimit të vendimeve penale, edhe drejtorisë së këtij institucioni.

Shërbimi i provës mbikëqyr ekzekutimin e vendimit me qëndrim në shtëpi dhe bashkëpunon, sipas rastit, me autoritetet e pushtetit vendor, shërbimet sociale, organet vendore të policisë, si dhe subjekte të tjera, private dhe shtetërore.

Shërbimi i provës siguron informacionin dhe asistencën e nevojshme për personin e dënuar nga institucionet shëndetësore, institucionet e ndihmës sociale, si dhe organizatat joqeveritare që bashkëpunojnë me të për zbatimin e vendimit me qëndrim në shtëpi.

Shërbimi i provës harton programe për personin, që vuan dënimin me qëndrim në shtëpi. Kur personi i dënuar nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e vendosura nga gjykata, për shkak të ndryshimit të rrethanave, shërbimi i provës i rishikon këto detyrime, për të cilat i raporton menjëherë prokurorit”.

Nëse personi, që vuan dënimin me qëndrim në shtëpi, nuk respekton detyrimet e vendosura nga gjykata, shërbimi i provës, pasi të ketë verifikuar faktet dhe rrethanat, i raporton prokurorit dhe, sipas rastit, i propozon atij kërkesën për ndryshimin e detyrimit”.

Sipas këtij parashikimi ligjor në rast se gjykata aplikon këtë dënim alternativ, ajo ka detyrimin që një kopje të këtij vendimi t’ia dërgojë për ekzekutim prokurorit edhe nëse personi ndaj të cilit aplikohet një dënim i tillë është duke u mbajtur në një institucion të ekzekutimit të vendimeve penale edhe drejtorisë së këtij institucioni.

Ligjvënësi në paragrafin e parë të kësaj dispozite parashikon si detyrim ligjor të gjykatës që nëse personi mbahet në I.E.V.P., i dërgohet një kopje titullarit të këtij institucioni. Një parashikim i tillë është bërë nisur nga fakti se aplikimi i një dënimi të tillë alternativ, bëhet jo vetëm në fazën e ekzekutimit të dënimit, por edhe në fazën e dhënies së dënimit, kur shtetasi ende ka qenë i pandehur, i paraburgosur, por jo me statusin e të dënuarit.

Sipas rasteve konkrete, Shërbimi i Provës bashkëpunon me autoritetet e pushtetit vendor, me shërbimet sociale, me organet vendore të policisë, si dhe subjekte të tjera private dhe shtetërore me qëllim ekzekutimin e vendimit. Në këtë kuadër, Shërbimi i Provës jo vetëm harton programe për personin që vuan dënimin me “qëndrimin në shtëpi”, por dhe

siguron informacionin dhe asistencën e nevojshme për personat e dënuar nga institucionet shëndetësore, institucionet e ndihmës sociale, si dhe organizatat jofitimprurëse që bashkëpunojnë me të në zbatimin e vendimit.

Ligjvënësi i ka dhënë të drejtë Shërbimit të Provës se nëse i dënuari nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e vendosura nga gjykata për shkak të ndryshimit të rrethanave, që t'i rishikojë këto detyrime për të cilat i raporton menjëherë prokurorit. Mbetet e paqartë në praktikë mënyra se si i rishikon këto detyrime Shërbimi i Provës apo se çfarë vendimmarrjesh merr ky Shërbim në këtë drejtim, apo kufizohet vetëm në raportimin që i bën prokurorit. Kjo pasi një detyrim i përcaktuar për t'u përmbushur në vendimin e gjykatës nuk mund të ndryshohet nga prokurori, dhe për më tepër nga ky Shërbim.

Situata është e ndryshme dhe në rastin tjetër kur nuk kanë ndryshuar rrethanat, por personi i cili vuan dënimin me *“qëndrim në shtëpi”* nuk respekton detyrimet e vendosura nga gjykata. Në këto raste, në kuadër të mbikëqyrjes Shërbimi i Provës fillimisht verifikon faktet dhe rrethanat dhe më pas sipas parashikimit ligjor i raporton prokurorit, ku sipas rastit i propozon atij kërkesën për ndryshimin e detyrimit.

Ligji në këtë pjesë të dispozitës i jep të drejtën edhe Shërbimit të Provës për të propozuar për ndryshimin e detyrimit, ndërkohë që këtë detyrim nuk e ka të drejtë ta ndryshojë prokurori, i cili informohet nga Shërbimi i Provës. Jo vetëm kaq, por ka dy shkolla mendimi në lidhje me këtë moment.

Përkrahësit e njëres ide mendojnë se detyrimet e dhëna nga gjykata nuk mund të ndryshojnë gjatë periudhës që personi po vuan dënimin në shtëpi.

Përkrahësit e idesë tjetër mendojnë se kur janë rastet e parashikimeve në dispozitën e sipërcituar, prokurori mund t'i drejtohet gjykatës mbi bazën e informacionit të marrë nga Shërbimi i Provës duke kërkuar ndryshimin e detyrimit.

Edhe Rregullorja e Shërbimit të Provës në kreun IX, në nenet 45 – 47 të saj, përcakton mënyrën dhe procedurat e mbikëqyrjes të të dënuarve, për të cilët gjykata ka vendosur *“qëndrimin në shtëpi”*. Edhe në këto raste, Shërbimi i Provës harton dhe zhvillon një program individual për çdo të dënuar që vuan *“qëndrimin në shtëpi”*. Në funksion të mbikëqyrjes, Shërbimi i Provës kontakton institucionet lokale apo çdo lloj organi ose enti privat dhe publik, të cilët mund të asistojnë në ekzekutimin e dënimit me *“qëndrim në shtëpi”*, duke lidhur dhe marrëveshje për këtë qëllim.

Mbikëqyrja e ekzekutimit të dënimit me *“qëndrim në shtëpi”* nga ana e Shërbimit të Provës bëhet në disa forma, të cilat janë:

- vizita rutinë të lajmëruara;
- vizita rutinë të palajmëruara në shtëpinë e të dënuarit ose qendrat e kujdesit ku ai vuan dënimin;

- mbajtjen e kontakteve me të dënuarin, si dhe
- mbajtjen e kontakteve me familjen e të dënuarit.

Ligjvënësi ka zgjidhur në parashikimet e tij dhe situatën kur gjykata sipas nenit 59/a, paragrafi i 2, ka lejuar të dënuarin për t'u larguar nga vendbanimi. Në këto raste, Shërbimi i Provës harton një program duke mbikëqyrur mënyrën e respektimit nga i dënuari të plotësisimit të nevojave të domosdoshme familjare të lejuara nga gjykata. Në rast se Shërbimi i Provës si organ mbikëqyrës konstaton se nuk ekzistojnë kushtet për të cilat gjykata ka caktuar masën alternative, ai i raporton menjëherë prokuror me qëllim që ky i fundit t'i drejtohet gjykatës për revokimin e masës alternative dhe zëvendësimin e saj me një tjetër. Raporti i Shërbimit të Provës, përveç se duhet të jetë informues në këtë rast, duhet të përmbajë dhe një propozim konkret për dënimin zëvendësues.

Të njëjtin raportim Shërbimi i Provës e bën dhe në rastet kur i dënuari nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga dënimi me “*qëndrim në shtëpi*”, pasi verifikon faktet dhe rrethanat që kanë sjellë mospërmbushjen. Më pas është prokurori, i cili zbaton të gjitha procedurat dhe detyrimet e nenit 62 të Kodit Penal.

Situata është e ndryshme në rastin kur Shërbimi i Provës çmon se mospërmbushja e detyrimeve të të dënuarit ka ardhur si rezultat i pamundësisë objektive. Në të tilla raste, ky shërbim, duke qene organi që monitoron përmbushjen e këtyre detyrimeve, i propozon prokurorit ndryshimin e këtyre detyrimeve në përputhje me mundësitë konkrete dhe nevojat e vetë të dënuarit.

3.4 Roli dhe pozita procedurale e Shërbimit të Provës gjatë mbikëqyrjes së ekzekutimit të dënimit alternativ “*punë në interes publik*”, parashikuar nga neni 63 i Kodit Penal

Ligji nr. 10 024, datë 27.11.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 31.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, parashikon në nenet 31–31/3 mënyrën e ekzekutimit të një vendimi penal me punë në interes publik. Pjesë e këtij ekzekutimi është dhe roli që luan Shërbimi i Provës në këtë drejtim, i cili kufizohet në mbikëqyrjen e këtij vendimi.

Fillimisht gjykata, pasi vendos ndaj një personi të dënuar, me pëlqimin e këtij personi, pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik, ia dërgon menjëherë për ekzekutim një kopje të vendimit prokurorit, i cili merret me ekzekutimin e dënimit.

Nga ana tjetër, pasi vihet në dijeni për një dënim të tillë alternativ, Shërbimi i Provës harton dhe zhvillon një program për kryerjen e punës në interes publik. Në hartimin e këtij programi, Shërbimi i Provës bazohet në aftësitë e personit si dhe në formimin

profesional të personit të dënuar me këtë dënim alternativ.

Në bashkëpunim me subjektin pranë të cilit do kryhet puna, Shërbimi i Provës, para fillimit të kryerjes së punës, i bëjnë të ditur personit të dënuar rregullat e sigurimit teknik në punë. Në kuadër të informimit, Shërbimi i Provës informon personin e dënuar në lidhje me detyrimin që ka ky person për:

- të mbajtur kontakte rregullisht me Shërbimin e Provës;
- të përmbushur në mënyrë korrekte udhëzimet e dhëna nga Shërbimi i Provës si organ mbikëqyrës.

Sipas nenit 31, paragrafi i fundit, është pikërisht Shërbimi i Provës organi i cili ka të drejtë që të përcaktojë listën e institucioneve si dhe të shoqërisë publike ose private se ku mund të kryhet puna në interes publik.

Edhe neni 63 i Kodit Penal, por edhe neni 31/1, paragrafi i parë i ligjit, përcaktojnë se gjykata në marrjen e një vendimi të tillë alternativ urdhëron personin e dënuar që të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës.

Në lidhje me këtë moment ka dy praktika gjyqësore. Ka gjyqtarë të cilët duke e konsideruar një detyrim të përcaktuar në ligj, nuk e shprehin në dispozitivin e vendimit këtë urdhërim, duke e çmuar se kjo do përbënte thjesht si një përsëritje të një detyrimi ligjor. Nga ana tjetër, ka një praktikë tjetër gjyqësore ku gjyqtarët përcaktojnë në mënyrë të shprehur këtë urdhërim ligjor, duke e bërë atë pjesë të vendimit. Një veprim i tillë është në unitet me faktin që është Shërbimi i Provës organi i cili mbikëqyr të dënuarin që kryen një punë në interes publik. Në funksion të mbikëqyrjes është ky Shërbim, organ i cili i raporton menjëherë prokurorit kur personi i dënuar:

- nuk mban kontakte të rregullta me vetë Shërbimin e Provës dhe
- nuk përmbush detyrimin apo detyrimet e vendosura nga gjykata.

Nga ana tjetër, Shërbimi i Provës vihet në dijeni menjëherë nga subjekti pranë të cilit kryhet puna në interes publik kur i dënuari nuk e kryen punën në mënyrë të rregullt. Ligjvënësi ka konsideruar moskryerje në mënyrë të rregullt të punës rastet kur:

- I dënuari që kryen një punë në interes publik, paraqitet me vonesa në punë. Edhe pse ligji nuk e parashikon në mënyrë të shprehur në formulimin e kësaj dispozite, qëllimi i tij ka qenë se paraqitja me vonesë duhet të jetë e përsëritur, pasi nuk do kishte logjikë të konsiderohej moskryerje e rregullt e punës paraqitja me vonesë e të dënuarit vetëm në një rast sporadik.
- Mungesat pa arsye të të dënuarit në punë.

Ligjvënësi në lidhje me këtë rast përdor shumësin, duke lënë të kuptohet se duhet të jetë më shumë se një mungesë pa arsye.

- Mosrespektimin e rregullave për kryerjen e punës.

Si raste të tilla mund të konsiderohen mosrespektimi p.sh., i rregullave të sigurimit teknik.

- Mosrespektimi i rregullave në lidhje me sjelljen në punë.

Si raste të tilla mund të konsiderohen mosrespektimi i rregullave që kanë të bëjnë me etikën, disiplinën në punë etj., dhe

- Mosrespektimin e rregullave që kanë të bëjnë me rendimentin në punë.

Si të tilla raste mund të konsiderohen raste kur personi i dënuar nuk kryen normën e lejuar të punës, nuk e kryen në sasinë e duhur apo me cilësinë e duhur, etj.

Neni 31/3 i këtij ligji përcakton si risi pezullimin e vendimit për punë në interes publik. Sipas kësaj dispozite tre janë rastet kur gjykata mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të dënimit me punë në interes publik. Ato janë:

a) për shkak të sëmundjes së papritur të personit të dënuar, për të cilën është i nevojshëm trajtimi mjekësor dhe e pengon atë të kryejë punën;

b) për shkak të vdekjes së një anëtarit të familjes, si pasojë e së cilës personi i dënuar duhet të veprojë si kujdestar për anëtarët e tjerë të familjes dhe e pengon atë në kryerjen e punës;

c) për shkak të rrethanave të tjera të jashtëzakonshme, të cilat kërkojnë praninë e vazhdueshme të të dënuarit dhe e pengojnë atë të kryejë punën.

Nisur nga parashikimi ligjor konstatohet se procedura që ndiqet për një pezullim të tillë kalon në disa etapa:

Së pari: Personi i dënuar me kryerjen e një pune në interes publik i paraqet fillimisht prokurorit kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit për punën në interes publik.

Së dyti: Është Shërbimi i Provës që me një raport përmbledhës i raporton prokurorit, pasi ka kryer verifikimet e nevojshme, nëse ka ndryshuar ose jo situata fillestare, e cila përligj ose jo kërkesën e të dënuarit, duke iu referuar tre rasteve për të cilat vendoset ky pezullim.

Së treti: Kryerja e punës në interes publik pezullohet derisa gjykata të japë një vendim për kërkesën e paraqitur.

Së katërti: Është gjykata më pas ajo që bazuar në kërkesën e bërë nga prokurori, disponon me vendim, brenda 5 ditëve nga marrja e një kërkesë të tillë.

Pas marrjes së vendimit, gjykata ia dërgon menjëherë një kopje të tij prokurorit. Në

vendim gjykata ka detyrimin që të përcaktojë dhe periudhën kohore të pezullimit. Mënyra se si është formuluar dispozita rezulton se gjykata duhet në çdo rast të vendosë pezullimin e vendimit për punë në interes publik, çka nuk përputhet me vetë rolin dhe pozicionin që ka vetë gjykata në gjykime. Duke qenë një dispozitë e parashikuar rishtazi në ligj, ajo ende nuk është shoqëruar me një praktikë gjyqësore në këtë drejtim.

Përveç këtyre dispozitave ligjore edhe Rregullorja e Shërbimit të Provës, e dalë në bazë dhe për zbatim të detyrimeve ligjore, parashikon në Kreun X të saj, në nenet 48 – 55, një grup dispozitash në lidhje me mënyrën dhe procedurat e mbikëqyrjes nga ana e Shërbimit të Provës së të dënuarve për të cilët gjykata ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim në detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik.

Sipas nenit 48 të Rregullores, i cili në përmbajtjen e vet është në unitet me nenin 63 të Kodit Penal, është pikërisht Shërbimi i Provës organi i cili vendos:

- llojin e punës që do të kryhet
- vendin ku do kryhet puna në interes publik, si dhe
- ditët e javës kur do kryhet kjo punë.

Nëse gjykata ka vendosur kryerjen e punës në favor të interesit të një shoqate, Shërbimi i Provës në këtë rast ka autoritetin të përcaktojë llojin e punës, ditët e punës, si dhe ditët e javës kur do të kryhet ajo.

Në përcaktimin e këtyre elementeve Shërbimi i Provës ka autoritetin të vlerësojë objektivisht një sërë rrethanash të cilat konsistojnë në:

- llojin e veprës penale të kryer;
- treguesit personale të të dënuarit, ku përfshihen arsimi, mosha dhe gjendja shëndetësore;
- aftësitë profesionale të të dënuarit;
- përvojën e mëparshme të tij, si dhe
- kushte të tjera sociale apo familjare të të dënuarit, të cilat vlerësohen nga Shërbimi i Provës në varësi të çdo rasti konkret.

Nga ana tjetër, Shërbimi i Provës, kur përcakton vendin ku do të kryhet puna në interes publik, merr në konsideratë dhe vendbanimin e të dënuarit. Nëse konstaton se në këtë vendbanim nuk ka një institucion të përshtatshëm për kryerjen e punës në interes publik, Shërbimi i Provës cakton një institucion tjetër, i së njëjtës natyre, i cili ndodhet në rrethin më të afërt me vendbanimin e të dënuarit. Kjo me qëllim që kryerja e punës në interes publik të jetë sa më efikase.

Menjëherë pas përcaktimit të institucionit ku do të kryhet puna, Shërbimi i Provës harton për të dënuarin një program individual për kryerjen e punës në interes publik. Ky program duhet të përmbajë:

- ditët e javës gjatë të cilave do të kryhet puna, oraret për fillimin dhe mbarimin e punës dhe veprimtaritë e përditshme;
- mënyrën e takimeve me punonjësit e shërbimit të provës, si dhe
- elemente të tjera të nevojshme të cilat vlerësohen rast pas rasti.

Ligjvënësi ka zgjidhur dhe situatën kur i dënuari është person i mitur. Në këto raste programi ditor duhet të hartohet duke marrë parasysh elemente specifike të tillë, si:

- moshën e të miturit;
- interesin më të lartë të fëmijës, dhe
- nevojat psikosociale të të miturit.

Për të analizuar elementë të tillë, Shërbimi i Provës ka të drejtë që të konsultohet me prindërit, kujdestarin, mbrojtësin e tij, i cili mund të jetë ai i zgjedhur ose i caktuar kryesisht nga gjykata, ose persona të tjerë të kërkuar nga i mituri, të cilët mund të jenë të afërm ose jo të familjes.

Në kuadër të realizimit sa më efikas të mbikëqyrjes, Shërbimi i Provës lidh marrëveshje me subjektet në të cilët do të kryhet puna në interes publik. Lidhja e këtyre marrëveshjeve bëhet në funksion të realizimit të programit, duke e përcaktuar si pjesë të marrëveshjes dhe këtë program. Ajo mund të përcaktojë gjithashtu personin përgjegjës të caktuar nga subjektet për të mbikëqyrur realizimin e punës nga i dënuari, si dhe detyrimin e subjekteve për të njoftuar menjëherë Shërbimin e Provës në rast se i dënuari nuk përmbush detyrimet. Po kështu, Shërbimi i Provës ka detyrimin që t'i shpjegojë personit përgjegjës që është caktuar nga subjekti për mbikëqyrjen që të evidentojë orët e punës mbi baza ditore me qëllim që të verifikojë nëse orari i punës ditore është respektuar ose jo, si dhe për të informuar rregullisht Shërbimin e Provës mbi nivelin e performancës në punë të të dënuarit.

Sipas parashikimit të nenit 50 të Rregullores, para fillimit të punës, në kontaktin që Shërbimi i Provës ka me të dënuarin, ai e informon atë për:

- detyrimin për të përmbushur udhëzimet e dhëna nga ky Shërbim;
- detyrimin për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga puna që kryen, si dhe
- detyrimet për të mbajtur kontakte me Shërbimin e Provës.

Nga ana tjetër i dënuari që kryen një punë në interes publik, ka të drejta të njëjta me punonjësit e tjerë të cilat konsistojnë në:

- mbrojtjen e shëndetit;
- sigurinë në punë;
- mirëqenien sociale;
- kohëzgjatjen në punë, si dhe

- të gjitha ato të drejta që rregullojnë marrëdhëniet e punës.

Kufizimet e vetme për personin e dënuar në këtë rast janë ato që rrjedhin nga natyra e dënimit dhe përmbushja e detyrimeve të tij.

I vetmi organ i cili është identifikuar nga ligji për mbikëqyrjen e të dënuarit gjatë ekzekutimit të vendimit për kryerjen e punës në interes publik ose për interes të shoqatës, është Shërbimi i Provës. Nëse ky Shërbim njoftohet nga subjekti pranë të cilit kryhet puna, për mospërmbushje të detyrimeve nga i dënuari, atëherë Shërbimi kryen dy detyra kryesore në këto raste.

Së pari: verifikon objektivisht informacionin e marrë nga subjekti ku i dënuari po kryen punën, dhe

Së dyti: i raporton në mënyrë të menjëhershme prokurorit, mbi rezultatet e verifikimit.

Terminologjia e përdorur pothuaj në të gjitha dispozitat “*raporton në mënyrë të menjëhershme*”, presupozon faktin se ky raportim duhet bërë në kohën më të parë të mundshme nga Shërbimi i Provës tek prokurori.

Në rastet kur i dënuari i ka paraqitur prokurorit një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit me punë në interes publik, ky i dënuar ka gjithashtu detyrimin që të njëjtën kërkesë t’ia paraqesë dhe Shërbimit të Provës. Kjo bëhet me qëllim që Shërbimi i Provës të informojë personin përgjegjës të caktuar me mbikëqyrjen e punës. Ajo që konstatohet në këtë pjesë është fakti se dispozitat e rregullores që parashikojnë mbikëqyrjen e personit që kryen një punë në interes publik, parashikojnë caktimin e një personi përgjegjës ose personi të caktuar nga subjekti ku i dënuari kryen punën, me qëllim që jo vetëm të mbikëqyrë në detaje punën, por edhe të jetë në rolin e një ndërmjetësi midis të dënuarit që kryen punë në interes publik dhe vetë Shërbimit të Provës.

Me marrjen e kërkesës që i dënuari ia paraqet Shërbimit të Provës krahas prokurorit, ky Shërbim, pasi verifikon shkaku e paraqitur nga i dënuari për pezullim, i raporton prokurorit mbi rezultatet e arritura gjatë verifikimit të këtij shkak. Sipas nenit 53 të Rregullores në raportin e mbajtur nga Shërbimi i Provës evidentohet fakti nëse kushtet e të dënuarit kanë ndryshuar në atë masë aq sa justifikojnë pezullimin apo jo.

Në rastet kur i dënuari nuk përmbush kushtet dhe detyrimet si:

- nuk kryen punën në interes publik;
 - nuk mban kontakte të rregullta me Shërbimin e Provës, apo
 - shkel kushtet dhe detyrimet e tjera të caktuara nga gjykata,
- Shërbimi i Provës ka detyrimin t’i raportojë për këtë fakt prokurorit si organ i cili merret me ekzekutimin e një vendimi penal.

Nëse i dënuari gjatë gjithë kohës së caktuar për kryerjen e punës në interes publik ose në interes të një shoqate, përmbush të gjitha detyrimet e caktuara, vetë subjekti pranë të cilit është kryer puna, në përfundim të kohës së punës pajis të dënuarin me një vërtetim mbi orët e punës dhe datat e kryerjes së saj. Ajo që konstatohet në lidhje me këtë moment është fakti se jo vetëm ligji, por as Rregullorja nuk specifikojnë se përse i shërben të dënuarit një vërtetim i tillë. Nisur nga interpretimi logjik i dispozitës (neni 55 i Rregullores) rezulton se një vërtetim i tillë mund t'i shërbejë të dënuarit për ta bërë pjesë të dosjes së tij të ekzekutimit të vendimit penal që mbahet nga prokurori, por edhe të mbikëqyrjes, me qëllim që i dënuari më pas të quhet i padënuar për efekt të gjendjes gjyqësore.

3.5 Roli dhe pozita procedurale e Shërbimit të Provës gjatë mbikëqyrjes së ekzekutimit të “lirimit me kusht”, parashikuar nga neni 64 i Kodit Penal

Për sa i përket mënyrës së mbikëqyrjes së dënimit alternativ të “lirimit me kusht”, i parashikuar nga neni 64 i Kodit Penal, vetë ligji nr. 10 024, datë 27.11.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 31.04.1998 ‘Për ekzekutimin e vendimeve penale’”, në nenin 31/6 të tij parashikon shprehimisht se:

“I dënuari me burgim, në përputhje me nenin 64 të Kodit Penal, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për lirim me kusht në gjykatën e vendit të ekzekutimit të dënimit. Kërkesa shqyrtohet nga një gjyqtar, i ndryshëm nga ai që ka dhënë vendimin e dënimit me burgim.

Pas paraqitjes së kërkesës për lirim me kusht, drejtori i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale paraqet në gjykatë një kopje të dosjes personale të personit të dënuar dhe një raport për të. Në raport përcaktohen natyra e veprës penale të kryer, qëndrimi i personit të dënuar ndaj veprës penale dhe ndaj viktimës apo familjes së viktimës, ndonjë vepër e mëparshme penale, e kryer prej tij, gjendja fizike dhe psikologjike e personit të dënuar, si dhe dinamika e sjelljes së tij në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale.

Gjykata i kërkon shërbimit të provës të paraqesë një raport për kushtet familjare dhe prejardhjen shoqërore të të dënuarit, si dhe për planet konkrete, për të mundësuar riintegrimin e plotë të tij pas lirimit.

Kur gjykata vendos lirimin me kusht të personit të dënuar, ia dërgon vendimin prokurorit të gjykatës së rrethit gjyqësor, ku do të jetojë i dënuari pas lirimit dhe institucionit të ekzekutimit të vendimit penal.

Personi i liruar me kusht duhet t'i raportoje rregullisht shërbimit të provës gjatë kohës së lirimit me kusht.

Kur personi i liruar me kusht synon të ndryshojë vendbanimin, ai duhet të njoftojë paraprakisht shërbimin e provës dhe organet vendore të Policisë së Shtetit, duke dhënë motivet përkatëse.

Shërbimi i provës mbikëqyr ekzekutimin e vendimit të lirimit me kusht dhe, kur është e nevojshme, bashkëpunon me organet e pushtetit vendor dhe ato të Policisë së Shtetit. Shërbimi i provës mund t'i kërkojë prokurorit ndryshimin e një ose të disa detyrimeve të personit të liruar me kusht, kur ai nuk është në gjendje t'i përmbushë ato”.

Sipas përmbajtjes së kësaj dispozite rezulton se gjykata kompetente për gjykimin e kërkesave të tilla është gjykata e vendit ku i dënuari po vuan dënimin, parashikim i cili është në unitet të plotë me nenin 477 të Kodit të Procedurës Penale. Nga ana tjetër, me qëllim mosparagjykimin e vendimmarrjes gjyqësore, në rastet kur është e njëjta gjykatë, si ajo që ka dhënë vendimin dhe ajo e vendit ku ekzekutohet dënimi i dhënë, ligjvënësi ka ndaluar që të dyja këto gjykime t'i zhvillojë i njëjti gjyqtar. Praktika gjyqësore në këtë drejtim është e konsoliduar. Ka pasur mjaft raste në praktikën gjyqësore ku gjyqtarë të ndryshëm të cilët kanë qenë në trupin gjykues që kanë dhënë vendimin e dënimit, u ka rënë me anë të shortit gjykimi i kërkesës së të njëjtit shtetas, me objekt lirim me kusht. Në të tilla raste, bazuar në paragrafin e parë të nenit 31/6 të ligjit, gjyqtarët kanë dhënë dorëheqjen, dorëheqje të cilat janë pranuar nga titullarët e gjykatës.

Ligjvënësi ka parashikuar në dispozitë se pasi i dënuari paraqet në gjykatë një kërkesë për “*lirim me kusht*”, drejtori i institucionit përveç detyrimit për paraqitjen në gjykatë të një kopje të dosjes personale të të dënuarit, ka dhe detyrimin për paraqitjen e një raporti përmbledhës. Në këtë raport duhet të përcaktohet qartë:

- natyra e veprës penale e kryer,
- qëndrimi i personit të dënuar ndaj veprës penale dhe ndaj viktimës apo familjarëve të tij,
- faktin nëse ka kryer ndonjë vepër penale të mëparshme,
- gjendjen fizike dhe psikologjike të personit të dënuar, si dhe
- dinamika e sjelljes në vendin e vuajtjes së dënimit.

Praktika gjyqësore e deritanishme në lidhje me këtë moment ka treguar se në të gjitha gjykimet me objekt “*lirim me kusht*”, gjykatat kanë administruar si provë edhe raportin e drejtorit të I.E.V.P.-së. Ajo që konstatohet është fakti se ky raport paraqitet në mënyrë të përmbledhur për të gjitha kërkesat ligjore të sipërcituara, në një formular standard, duke vënë kryqë në lidhje me opsionet e paraqitura në raport. Ajo çka përbën një shqetësim nga qarqet e prakticienëve të së drejtës është pikërisht fakti se këto raporte duhet të jenë për çdo rast në mënyrë të detajuar dhe jo në formularë standarde, me qëllim që të krijohet një tablo sa më e saktë në lidhje me të gjitha elementet ligjore të kërkuara.

Në kuadrin e administrimit të provave, gjykata administron si provë dhe raportin që i kërkon të hartojë për këtë qëllim Shërbimit të Provës. Në raport Shërbimi i Provës përcakton disa rrethana që i kërkon pikërisht neni 31/6, paragrafi i tretë i ligjit. Si të tilla përmendim:

- kushtet familjare të personit të dënuar;

- prejardhjen shoqërore të të dënuarit dhe
- planet konkrete për të mundësuar riintegrimin e tij të plotë pas lirimit.

Tek shqyrtimi i kërkesave të tilla, Shërbimi i Provës është gjithmonë prezent, duke paraqitur dhe raportin përkatës për këtë qëllim. Ajo që konstatohet është fakti se raportet nuk përmbajnë planet konkrete në lidhje me punësimin e personit që kërkohet të lirohet me kusht, i cili do mundësojë riintegrimin e tij të plotë në shoqëri. Kjo vjen si rezultat i mungesave të marrëveshjeve me subjekte të ndryshme për këtë qëllim. Për të krijuar një tablo sa më të qartë në lidhje me këtë moment po paraqesim në mënyrë të përmbledhur një përmbajtje të një raport shërbimi të përpiluar nga Zyra Vendore e Shërbimit të Provës në Durrës datë 14.01.2010, në një çështje të gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, në lidhje me të dënuarin TH.D. Ky raport përmban:

- Pjesën hyrëse që përmban të dhëna për të dënuarin, për vendimin e dënimit, për datën e fillimit dhe përfundimit të dënimit, gjykatën që e ka dhënë, detyrimet e dhëna nga gjykata për të dënuarin nëse ka të tilla, periudhën e dënimit të vuajtur, qëllimin e raportit, datën e raportit dhe emrin e specialistit të Shërbimit të Provës që ka përgatitur raportin.
- Përcaktimi i burimeve të informacionit të përdorura për hartimin e raportit ku përfshihet i gjithë dokumentacioni i ndodhur në dosjen gjyqësore si dhe dy intervistat e kryera nga specialisti i Shërbimit të Provës.
- Pjesën përshkruese dhe analizuese të ekzekutimit të vendimit të gjykatës, ku përfshihet vepra për të cilën është deklaruar fajtor i dënuari, masa e dënimit, ecuria e çështjes, nëse është ushtruar ankim, I.E.V.P.-ja ku vuan dënimin i dënuari, dhe treguesit e sjelljes.
- Pjesën analizuese dhe vlerësimin e rrezikut, ku analizohen në mënyrë të detajuar se çfarë rreziku/rreziqesh ka nëse i dënuari lirohet me kusht. Çfarë faktorësh apo arsyesh e bëjnë që një kërkesë e tillë të jetë e përligjur, nëse ka të tilla, etj.
- Pjesën e konkluzioneve dhe të rekomandimeve. Në këtë pjesë specialisti i Shërbimit të Provës, në mënyrë të përmbledhur, paraqet se sa dënim i ka mbetur të dënuarit, dhe se me dënimin e vuajtur a i është arritur qëllimit për edukimin e tij dhe riintegrimin e tij në shoqëri, çfarë qëndrimi dhe reflektimi ka i dënuari ndaj veprës penale të kryer, çfarë arsyesh të veçanta ka paraqitur, a ka treguar interes për të bashkëpunuar me Shërbimin e Provës me qëllim që të përballojë vështirësitë që mund të hasë në integrimin social të tij, planet e punësimit, nëse ka të tilla dhe nëse Shërbimi i Provës e shikon të mundshme llojin e këtij dënimi alternativ ose jo. Gjithsesi një parashikim i tillë ka karakter sugjerues, pasi në çdo rast është gjykata organi i cili në bazë të analizës së provave ka të drejtë të vendosë nëse i dënuari duhet ose jo të lirohet me kusht.

Pasi gjykata liron me kusht një të dënuar, ajo ka detyrimin që një kopje të vendimit t'ia dërgojë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor ku do jetojë i dënuari pas lirimit me kusht, si dhe një kopje tjetër Institucionit të Ekzekutimit të Vendimit Penal.

Nga ana tjetër, personi i cili është liruar me kusht, ka detyrimin t'i raportojë rregullisht Shërbimit të Provës gjatë gjithë kohës së kushtit. Në këtë kuptim, kur personi i liruar me kusht, synon të ndryshojë vendbanimin, ai duhet të njoftojë paraprakisht duke dhënë dhe motivet përkatëse, Shërbimin e Provës dhe organet vendore të Policisë së Shtetit.

Shërbimi i Provës pas dhënies së vendimit të lirimimit me kusht ka detyrimin ligjor të mbikëqyrë ekzekutimin e një vendimi të tillë penal. Në këtë prizëm, nëse Shërbimi i Provës e konsideron të nevojshme, mund të bashkëpunojë me organet e pushtetit vendor, si dhe me ato të policisë së shtetit. Nëse personi i liruar me kusht ka vështirësi objektive në përmbushjen e një ose disa detyrimeve, duke mos qenë në gjendje t'i përmbushë ato, është përsëri Shërbimi i Provës i cili ka të drejtë që t'i drejtohet prokurorit, duke i kërkuar dhe ndryshimin e një ose disa nga këto detyrimeve të personit të liruar me kusht.

Nga ana tjetër, Rregullorja e Shërbimit të Provës, në kreun XI, parashikon rregulla mbi mënyrën e mbikëqyrjes së të dënuarve, për të cilët gjykata ka vendosur "*lirimim me kusht*", të përcaktuara në nenet 56–59 të kësaj Rregulloreje. Sipas këtyre dispozitave, Shërbimi i Provës ka detyrimin që të hartojë dhe zhvillojë një program i cili duhet të jetë individual me qëllim ekzekutimin e vendimit të "*lirimim me kusht*". Në kuadrin e mbikëqyrjes së ekzekutimit të një vendimi penal të kësaj natyre, Shërbimi i Provës sa herë që e çmon të nevojshme, ka tagrin që të bashkëpunojë me organet e pushtetit vendor, si dhe me Policinë e Shtetit. Ky Shërbim njëherazi ka detyrimin që të informojë personin e dënuar në lidhje me detyrimin ligjor që ka ky person për të raportuar rregullisht pranë këtij Shërbimi lidhur me kryerjen e dënimit.

Pasi njoftohet paraprakisht mbi ndryshimin e vendbanimit dhe mbi arsyet e këtij ndryshimi, Shërbimi i Provës ka detyrimin që të njoftojë menjëherë prokurorin, si dhe Shërbimin e Provës në juridiksionin e së cilit përfshihet banesa e të liruarit me kusht. Dispozita nuk përcakton se cilin prokuror duhet të njoftojë Shërbimi i Provës, por nga kuptimi teologjik i saj rezulton që është prokurori i cili ka ekzekutuar këtë vendim penal dhe jo prokurori i vendit ku ka adresën e re të banimit i liruari me kusht.

Ashtu si tek ligji, neni 31/6, dhe Rregullorja në nenin 59 të saj, përcakton procedurën që duhet të ndjekë Shërbimi i Provës në rastin kur i dënuari nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet që rridhnin nga lirimi me kusht. Në këto raste, Shërbimi i Provës ndjek konkretisht këtë procedurë:

- verifikon kushtet dhe rrethanat për mospërmbushjen e tyre. Kjo me qëllim që të konkludojë nëse kjo mospërmbushje kishte ardhur për shkaqe objektive ose subjektive;
- njofton prokurorin në lidhje me këtë mospërmbushje;
- i bën propozime prokurorit në lidhje me ndryshimin e detyrimeve në përputhje me kushtet dhe nevojat e përshtatshme.

Dispozita e ligjit jep një pasqyrim më të saktë se sa dispozita e Rregullores që rregullon këtë moment. Kjo pasi edhe pse Rregullorja nuk e parashikon se sa detyrime duhet të mospërmbushë personi i liruar me kusht për t'u ndodhur përpara këtij rasti, këtë e përcakton pikërisht neni 31/6, paragrafi i fundit i ligjit. Sipas përmbajtjes së kësaj dispozite mjafton që të konstatohet se personi i liruar nuk është në gjendje të mospërmbushë këto detyrime, pavarësisht nëse janë të gjitha, disa apo vetëm një prej atyre që ka vendosur gjykata.

Konstatohet gjithashtu se nuk parashikohet më pas se si vepron prokurori në ndryshimin e këtyre detyrimeve. Referuar logjikës juridike, prokurori duhet që në raste të tilla të verë në lëvizje gjykatën. Kjo pasi është pikërisht gjykata ajo që ka vendosur fillimisht këto detyrime, dhe më pas po ky organ ai që ka të drejtë që të ndryshojë këto detyrime. Praktika gjyqësore në lidhje me shqyrtimin e kërkesave të tilla është ende e pakonsoliduar, çka përbën një tendencë të së ardhmes në këtë zhvillim që ka sot aplikimi i dënimeve alternative.

Mënyra se si ekzekutohet dhe mbikëqyret një dënim alternativ përcaktohet nga neni 31/9 i ligjit nr. 10 024, datë 27.11.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 31.04.1998 ‘Për ekzekutimin e vendimeve penale’”.

Në përmbajtjen e saj kjo dispozitë parashikon se:

“Kur gjykata vendos pezullimin e vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me një dënim alternativ, ia dërgon menjëherë vendimin prokurorit, për ekzekutimin e dënimit alternativ.

Në qoftë se personi i dënuar është i burgosur, gjykata ia dërgon një kopje të vendimit edhe institucionit të ekzekutimeve të vendimeve penale, ku mbahet i dënuari, për lirimin e tij. Shërbimi i provës mund t'i propozojë prokurorit për të ndryshuar, sipas ligjit, kushtet dhe detyrimet për të dënuarin, pasi verifikon faktet dhe rrethanat e mospërmbushjes së tyre nga i dënuari.

Në ekzekutimin e dënimit alternativ, shërbimi i provës mbikëqyr përmbushjen e detyrimeve dhe të kushteve të përcaktuara në vendimin e gjykatës, asiston dhe këshillon të dënuarin në përmbushjen e këtyre detyrimeve dhe jep ndihmë në integrimin social të tij. Me kërkesë të gjykatës ose të prokurorit, shërbimi i provës përgatit një raport për zbatimin e vendimit të gjykatës dhe të programit të mbikëqyrjes. Kur i dënuari nuk përmbush kushtet dhe detyrimet e përcaktuara nga gjykata, shërbimi i provës paraqet raport para prokurorit, i cili përmban informacion për rrethanat e shkeljes, shpjegimet e dhëna nga i dënuari, vlerësimin e punonjësit të shërbimit të provës dhe propozimin, së bashku me arsyet përkatëse, për të caktuar detyrime shtesë, për të zgjatur afatin e mbikëqyrjes apo për të ndryshuar kushtet e detyrimet për ekzekutimin e dënimit”.

Sipas kësaj dispozite nëse gjykata vendos aplikimin e një dënimi alternativ, një kopje të vendimit ia dërgon prokurorit dhe në rast se personi i dënuar është i burgosur, një kopje tjetër të këtij vendimi ia dërgon I.E.V.P.-së ku mbahet i dënuari.

Roli i Shërbimit të Provës në ekzekutimin e një dënimi alternativ konsiston në:

- Mbikëqyrjen e përmbushjes së detyrimeve dhe kushteve të përcaktuara në vendimin e gjykatës;
- Asistencën dhe këshillimin e të dënuarit në përmbushjen e këtyre detyrimeve, si dhe
- Në dhënien ndaj të dënuarit të gjithë ndihmës së nevojshme për integrimin social të tij.

Në rast se gjatë ushtrimit të detyrës Shërbimi i Provës konstaton, pas verifikimit të fakteve dhe rrethanave, mospërmbushje të detyrimeve nga i dënuari, mund t'i propozojë prokurorit, për të ndryshuar sipas ligjit, kushtet dhe detyrimet për të dënuarin. Ligji në këtë drejtim ka një përcaktim të saktë kur përmend nocionet kushte dhe detyrime, me të cilat kuptojmë të gjitha ato kushte dhe detyrime që janë përcaktuar vetëm nga gjykata në dhënien e vendimit dhe që kërkojnë përsëri vënien në lëvizje të gjykatës për t'i ndryshuar ato.

4 SHKELJA E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE GJATË EKZEKUTIMIT TË DËNIMIT ALTERNATIV

Ligjvënësi në të njëjtën dispozitë, neni 31/9 i ligjit nr. 10 024, datë 27.11.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 31.04.1998 ‘Për ekzekutimin e vendimeve penale’”, ka parashikuar dhe rolin e Shërbimit të Provës kur i dënuari nuk përmbush kushtet dhe detyrimet e përcaktuara nga gjykata. Në këto raste Shërbimi i Provës ka detyrimin që të paraqesë para prokurorit një raport i cili duhet të përmbajë:

- *informacionin në lidhje me rrethanat e shkeljes;*
- *shpjegimet e dhëna nga i dënuari gjatë procesit të intervistimit ose pyetjes;*
- *vlerësimin e punonjësit të Shërbimit të Provës, dhe*
- *propozimin e punonjësit të Shërbimit të Provës së bashku me arsyet përkatëse.*

Propozimi që punonjësi i Shërbimit të Provës mund të japë në këto raste konsiston në:

- *caktimin e detyrave shitesë;*
- *zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes apo*
- *ndryshimin e kushteve dhe detyrimeve për ekzekutimin e dënimit.*

Ajo çka mund të shtrohet për diskutim në lidhje me këtë moment është fakti nëse prokuroria duhet të respektojë apo jo në çdo rast propozimin e Shërbimit të Provës. Juristët ndajnë dy mendime në këtë drejtim. Një grup juristësh mbështesin idenë se prokurori në kërkesën drejtuar gjykatës në të tilla raste nuk është i ndërruar nga propozimi i Shërbimit të Provës, pasi ai është i pavarur në llojin e kërimit.

Nga ana tjetër ekziston dhe një grup tjetër juristësh që mbështesin idenë se prokurori duhet që të kërkojë në gjykatë propozimin që ka bërë Shërbimi i Provës. Kjo pasi është ky Shërbim i cili ndjek nga afër duke mbikëqyrur ekzekutimin e dënimit alternativ, duke njohur dhe problematiken e vetë çështjes. Prokurori në këto raste është vetëm subjekti

procedural që i jep formën ligjore kërkesës në gjykatë, pasi vetëm ai mund të legjitimohet si subjekt në gjykim dhe jo Shërbimi i Provës.

Ligjvënësi në nenin 31/10 të ligjit parashikon procedurën që ndiqet për shqyrtimin e kërkesës së prokurorit që ka të bëjë me shkeljen nga i dënuari të kushteve të dënimit alternativ apo mospërmbushjen e detyrimit të dhënë. Sipas kësaj dispozitë, gjykimi në këto raste bëhet i zakonshëm duke respektuar gjitha rregullat procedurale të vendosura për këtë qëllim, përfshirë dhe ato që kanë të bëjnë me ankimet. Kërkesa e prokurorit shqyrtohet nga gjykata brenda 7 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës dhe se gjatë periudhës së shqyrtimit gjykata ka të drejtë në varësi të rrethanave të pezullojë ekzekutimin e dënimit alternativ dhe të urdhërojë që personi i dënuar të vendoset në një institucion të ekzekutimit të vendimeve penale.

Në përfundim të shqyrtimit të një kërkesë të tillë gjykata në varësi të mënyrës së shkallës së mospërmbushjes së detyrimeve nga i dënuari, mund të vendosë:

- ndryshimin e vendimit
- revokimin e pjesëshëm të dënimit alternativ. Këtu mund të ndryshojë një ose disa detyrime që duhet të përmbushet i dënuari, ose
- revokimin e plotë të dënimit alternativ.

Në te gjitha rastet, nëse gjykata jep dënimin me burgim kjo do të thotë që çdo dënim tjetër alternativ është i papërshtatshëm.

Ligjvënësi ka rregulluar gjithashtu me parashikimet ligjore edhe procedurën që duhet të kryejë Shërbimi i Provës në rast se i dënuari kryen dënimin alternativ apo përmbush detyrimin e dhënë. Kështu, sipas parashikimit ligjor të nenit 31/11 të ligjit, Shërbimi i Provës në këto raste ka detyrimin që të paraqesë para prokurorit raportin për përfundimin e plotë të periudhës së mbikëqyrjes. Më pas është prokurori i cili ka detyrimin që të nxjerrë një vendim të veçantë për kryerjen e dënimit alternativ, vendim i cili bëhet pjesë e akteve të dosjes së ekzekutimit të vendimit që disponon prokurori, pse jo dhe e dosjes së mbikëqyrjes së ekzekutimit që disponon shërbimi i provës.

Kjo dispozitë (neni 31/11 i ligjit) ka parashikuar se gjykata ka të drejtë që mbi bazën e kërimit të prokurorit të vendosë përfundimin para afatit të dënimit alternativ. Në kërkesën e tij drejtuar gjykatës në të tilla raste, prokurori vërteton se i dënuari ka kryer të gjitha detyrimet dhe vlerësohet se nuk është më e nevojshme për t'i zbatuar më tej ato, për të arritur qëllimin e dënimit alternativ. Kërkesa e prokurorit duhet të përmbajë gjithashtu të dhëna për:

- procedimet penale të të dënuarit,
- një përshkrim të dinamikës së sjelljes së tij,
- progresin e arritur gjatë ekzekutimit të dënimit, si dhe
- arsyet e paraqitjes së një kërkesë të tillë.

Është më pas gjykata organi i cili ka tagrin ligjor për të disponuar nëse duhet të përfundojë më parë dënimi alternativ apo jo. P.sh., nëse të dënuarit do t'i hiqet koha e mbetur e provës apo jo, nëse do ndërpritet puna në interes publik ose jo, etj. Në çdo rast përfundimi para afatit i dënimit alternativ duhet të bëhet me një vendimmarrje gjyqësore. Ligji parashikon gjithashtu se një kërkesë e tillë paraqitet nga prokurori në gjykatë pasi plotësohen dy kritere ligjore:

Së pari: I dënuari ka ekzekutuar më shumë se gjysmën e periudhës kohore të dënimit alternativ, dhe

Së dyti: I dënuari nuk paraqet rrezikshmëri për kryerjen e ndonjë vepre tjetër penale, rendin publik apo palët e treta.

Praktika gjyqësore në lidhje me ndryshimin ose revokimin e dënimit alternativ, apo përfundimin para afatit të dënimit alternativ nuk është e konsoliduar. Ajo përbën aktualisht një prirje që i takon së ardhmes duke pasur parasysh faktin e zhvillimeve të reja që po pësojnë në praktikën gjyqësore shqiptare aplikimi i dënimeve alternative.

5 RAPORTET E PËRGATITURA NGA SHËRBIMI I PROVËS

Për përmbushjen e funksioneve të tij, Shërbimi i Provës, nëpërmjet specialistëve të tij, vendos kontakte me të dënuarin, zhvillon takime me të dhe me të afërm të tij, krijon një dosje personale të të dënuarit, mban regjistra të veprimtarisë për të konkluduar me hartimin dhe paraqitjen e raporteve të vlerësimit dhe raporteve përfundimtare. Raportet e vlerësimit, si rregull, hartohen me kërkesë të prokurorit ose gjykatës. Megjithatë, në disa raste të veçanta, Shërbimi i Provës harton dhe paraqet raporte vlerësimi kryesisht, për të raportuar një ngjarje jashtë rutine përgjatë mbikëqyrjes së dënimit alternativ. Ndërsa raporti përfundimtar mbi ecurinë në tërësi të ekzekutimit të dënimit alternativ nga i dënuari hartohet me iniciativën e Shërbimit të Provës dhe dokumenton, ndër të tjera, edhe kryerjen e funksionit bazë nga ky Shërbim “mbikëqyrjen e dënimit alternativ”. Ky raport përbën bazën për prokurorin për nxjerrjen e vendimit të veçantë mbi kryerjen e dënimit alternativ.

Neni 31/7 i ligjit nr. 8331/1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar,⁵⁸ në përkufizimin e institucionit të Shërbimit të Provës përcakton si një prej funksioneve të këtij institucioni paraqitjen e informacionit dhe të raporteve para prokurorit dhe gjykatës, sipas kërkesave të parashikuara në ligj. Teksti i kësaj norme të jep një përshtypje të parë sikur është ndërtuar për t’i ndarë funksionet e Shërbimit të Provës në “mbikëqyrje të zbatimit të dënimeve alternative”; “paraqitje informacioni dhe raporteve para prokurorit ose gjykatës, sipas këtij ligji”; “dhënie ndihmë në ekzekutimin e dënimit alternativ”; dhe “dhënie ndihmë ndaj të dënuarit në kapërcimin e vështirësive për riintegrim social”. Mirëpo metoda e interpretimit literal dhe gramatikor nuk është e përshtatshme në këtë rast sepse nxjerr përfundime të kundërta me qëllimin ligjvënës, rrjedhimisht duhet përdorur interpretimi logjik për të nxjerrë përfundimin që Shërbimi i Provës paraqet informacione dhe raporte para gjykatës dhe prokurorit sa herë ka kërkesë prej tyre, si dhe kryesisht në përmbushje të funksioneve të tij gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të dënimeve alternative për të ndihmuar ekzekutimin e tyre.

Ligji nr. 8331/1998, i ndryshuar, përmend dy lloj aktesh që përpilohen dhe paraqiten nga Shërbimi i Provës “raportet” dhe “informacionet”. Informacioni përmendet jo vetëm në përkufizimin e Shërbimit të Provës, por edhe në disa dispozita të veçanta, siç është rasti i nenit 31/5, sipas të cilit Shërbimi i Provës paraqet informacion drejtuar Policisë së Shtetit dhe organeve të qeverisjes vendore mbi sjelljen e të dënuarit gjatë kohës që ai është në provë për shkak të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim nga gjykata. Nga ana tjetër, neni 6/2 i Rregullores së Organizimit të Shërbimit të Provës miratuar përmes VKM-së nr. 302/2009 parashikon se ky Shërbimi bashkëpunon dhe paraqet informacion dhe raporte para prokurorisë dhe gjykatës sipas parashikimeve ligjore.

⁵⁸ I ndryshuar me ligjin nr. 10 024, datë 27.11.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”.

A ka ndryshim ndërmjet informacionit dhe raportit?

Kuadri ligjor në fuqi nuk jep përkufizime mbi raportin apo informacionin, por mjaftohet duke i cituar ato si akte që përpilohen dhe paraqiten nga Shërbimi i Provës gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij. Nga analiza e normave që përmendin këto akte, nxirret përfundimi që informacioni përbën një akt me shkrim që i drejtohet të tretëve, jashtë rrethit të subjekteve të procedimit penal, me qëllim njoftimin e një fakti të caktuar. Ndërsa raporti mund të përkufizohet si akt procedural, i cili dokumenton veprimtarinë e Shërbimit të Provës që i drejtohet subjekteve të procedimit penal që ka për objekt verifikimin dhe analizën e rrethanave të caktuara në një procedim penal dhe shërben në procedurën e vlerësimit dhe të identifikimit të përshtatshmërisë së një alternative dënimi të caktuar apo në procedurën e vlerësimit të nivelit dhe të cilësisë së ekzekutimit të një alternative dënimi të caktuar.

Koha e përpilimit dhe e paraqitjes së raportit

Raportet e Shërbimit të Provës të natyrës vlerësuese paraqiten në faza të ndryshme të procedimit penal, në varësi të kërkesës dhe të objektit që analizojnë dhe raportojnë. Për shkak të momentit procedural në të cilin këto raporte paraqiten, ato vlerësojnë sjelljen dhe rrethanat e personin nën hetim, të të pandehurit ose të të dënuarit. Më konkretisht, Shërbimi i Provës mund të hartojë dhe paraqesë raporte vlerësimi⁵⁹ gjatë fazës së hetimeve paraprake, gjatë gjykimit përpara dhënies së vendimit penal, si dhe gjatë fazës së ekzekutimit të dënimit penal. Përgjatë fazës së ekzekutimit të dënimit penal, Shërbimi i Provës përpilon dhe paraqet raporte:

- i) në rastin e mbikëqyrjes së personit të dënuar;
- ii) në rastin e shqyrtimit të kërkesës për lirimin me kusht;
- iii) në përfundimin para kohe të periudhës së vënies në provë;
- iv) në përfundim të dënimit alternativ apo në përfundim të përmbushjes së detyrimeve të caktuara.

Raportet e Shërbimit të Provës përgjatë fazës së ekzekutimit të dënimit penal janë të natyrës vlerësuese ose përfundimtare.

Llojet e raportit

Ndonëse legjislacioni në fuqi nuk përmban një set të përmbledhur rregullash mbi llojet e raportit, nëpërmjet interpretimit të normave mbi dënimet alternative, mund të nxirret një klasifikim i tyre bazuar në tre kritere:

- (1) sipas kriterit të formës dhe të përmbajtjes;
- (2) sipas kriterit të fazës procedurale të hartimit dhe paraqitjes së

⁵⁹ Neni 31 i VKM-së nr. 302/2009 "Për miratimin e Rregullores 'Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve e të procedurave, për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative'".

tyre; dhe

(3) sipas kriterit të llojit të alternativës së dënimit.

1. Llojet e raportit sipas kriterit të formës dhe përmbajtjes

Në varësi të formës dhe përmbajtjes së raportit, legjislacioni në fuqi njih dy lloje raportesh të Shërbimit të Provës:

i. Raporte vlerësuese – të cilat hartohen dhe paraqiten nga Shërbimi i Provës përgjatë gjithë procedimit penal, me kërkesë të organit procedues ose me nismën e vetë Shërbimit. Ato vlerësojnë rrethanat e rastit konkret derisa alternativa e dënimit nuk është ekzekutuar tërësisht.

ii. Raporte përfundimtare – të cilat hartohen dhe paraqiten nga Shërbimi i Provës me nismën e vetë Shërbimit në përfundim të dënimit alternativ nga i dënuari.

2. Llojet e raportit sipas kriterit të fazës procedurale të hartimit dhe paraqitjes së tyre

Në varësi të fazës procedurale të hartimit dhe paraqitjes së tyre, raportet e Shërbimit të Provës klasifikohen më tej në tre nënkategori:

- i. raporte para vendimit gjyqësor të fajësisë dhe caktimit të dënimit alternativ;
- ii. raporte gjatë ekzekutimit të dënimit alternativ; dhe
- iii. raporte pas periudhës së dënimit alternativ.

3. Llojet e raportit sipas kriterit të llojit të alternativës së dënimit me burgim

Në varësi të llojit të alternativës që i referohen, raportet e Shërbimit të Provës klasifikohen në pesë nënkategori në:

- i. raporte të të dënuarit me gjysmëliri;
- ii. raporte të të dënuarit gjatë kohës së provës së pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim;
- iii. raporte të të dënuarit me qëndrim në shtëpi; dhe
- iv. raporte të të dënuarit gjatë kohës së kryerjes së një pune me interes publik; dhe
- v. raporte të të dënuarit për lirim me kusht.

Qëllimi i raportit

Raporti i përpiluar nga Shërbimi i Provës ndihmon prokurorin dhe gjykatën për zgjidhjen e drejtë të rastit konkret për çështjet e mëposhtme:

- për identifikimin e rastit për dhënien e një dënimi alternativ;
- për identifikimin e llojit të alternativës së përshtatshme për t'u caktuar në rastin konkret;
- për identifikimin e detyrimeve konkrete që duhen caktuar ndaj të dënuarit me masë alternative;
- për ndërhyrjen e organit procedues (prokurorit/gjykatës) për riparimin e shkeljes së kushteve/detyrimeve të caktuara ndaj të dënuarit gjatë ekzekutimit të dënimit alternativ, nëse verifikohet një shkelje e tillë;
- për deklarimin e dënimit alternativ të përfunduar nga i dënuari.

Çështjet e mësipërme përfshihen në planin individual të një rasti konkret dhe duket sikur raportet e Shërbimit të Provës kanë vetëm vlerë brenda një rasti individual. Megjithatë, në një këndvështrim më të gjerë, raportet e përpiluara nga Shërbimi i Provës kanë edhe qëllimin e ndihmës së organit procedues, veçanërisht të prokurorit, për krijimin e një politike penale të qëndrueshme dhe të njehsuar në raste të ngjashme.

Raporti vlerësues i Shërbimit të Provës paraqet të dhëna konkrete që i vijnë në ndihmë në radhë të parë prokurorit për të ndërmarrë veprimet e duhura procedurale në një procedim penal konkret deri në paraqitjen e kërkesës së duhur përpara gjykatës. Në eventualitetin e paraqitjes së një kërkesë procedurale pranë gjykatës që bazohet në këtë raport, atëherë raporti i vlerësimit ndihmon edhe gjykatën në marrjen e vendimit mbi kërkesën e paraqitur.

Raporti vlerësues përmban informacione të detajuara dhe një analizë të rrethanave dhe të shkaqeve të kryerjes së veprës penale, si dhe një analizë të qëndrimit të mbajtur nga subjekti aktiv i procedimit penal (që në varësi të fazës së procedimit mund të paraqitet në cilësinë e personit nën hetim, të pandehurit apo të dënuarit). Shërbimi i Provës ka detyrimin e kryerjes së kësaj analize në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme.

Gjithashtu, raporti vlerësues përmban edhe rekomandimin e Shërbimit të Provës për llojin apo masën e përshtatshme që duhet marrë në çdo rast individual. Ky rekomandim jepet në mënyrë objektive dhe të paanshme, pavarësisht qëndrimeve të prokurorisë apo të mbrojtësit. Nga ana tjetër, raporti i vlerësimit paraqitet në formë të përmbledhur dhe hartuesi i tij (punonjësi i Shërbimit të Provës) ka detyrimin për të shmangur termat e specializuar apo shprehjet që do ta vështirësonin kuptimin e tij nga subjekti procedural (gjykata/prokurori/mbrojtësi) që do t'i lexojë dhe përdorë, i cili mund të mos ketë njohuri të specializuara në këtë fushë.

Këto detyrime të Shërbimit të Provës për elementët e përmbajtjes së raporteve sanksionohen në

nenin 32 të VKM-së nr. 302/2009. Këto detyrime përshkohen dhe janë në përputhje me parimet e objektivitetit dhe të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut që karakterizojnë veprimtarinë e Shërbimit të Provës, të përcaktuara në nenin 3 të së njëjtës VKM.

Në disa raste specifike, raportet e vlerësimit mbartin edhe funksionin e njoftimit dhe të analizës së një shkeljeje⁶⁰ nga i dënuari të kushteve apo detyrimeve të caktuara gjatë ekzekutimit të masës alternative. Këto lloj raportesh janë jashtë rutinës normale të ekzekutimit të një alternative dënimi me burgim dhe përpilohen me iniciativën e vetë Shërbimit të Provës. Në këto raste, Shërbimi i Provës i raporton menjëherë prokurorit për çdo shkelje të kushteve dhe detyrimeve. Më pas, është prokurori që vendos, sipas shkallës së shkeljes së këtyre kushteve, për llojin e hapit procedural që duhet të ndërmarrë.

Konkretisht, prokurori për shkelje të lehta dhe për herë të parë nga i dënuari ka të drejtë t'i japë paralajmërim, i cili regjistrohet në dosjen personale të të dënuarit, kurse për shkelje të rënda ose të përsëritura prokurori i bën kërkesë gjykatës. Nëse shkeljet janë të rënda ose të përsëritura, prokurori mund të kërkojë ndryshimin e detyrimit të vendosur, shtimin e detyrimeve të tjera, zëvendësimin e tyre me një sanksion tjetër ose revokimin e vendimit të pezullimit të dënimit dhe vuajtjen e pjesës së mbetur të dënimit me burgim.

Mirëpo mund të ndodhë që kushtet të mos plotësohen ose detyrimet të mos përmbushen jo për fajin e tij, pra për shkaqe që nuk varen nga vullneti i tij. Në këto raste, prokurori ndërhyt me kërkesë në gjykatë për reformimin e detyrimeve të të dënuarit në përputhje me kushtet dhe nevojat e tij.

Këto rregullime ligjore vlejné në çdo rast që dënimi alternativ shoqërohet me kohë prove, përgjatë të cilës i dënuari mbart detyrimin për të mbajtur kontakte me Shërbimin e Provës; për të respektuar kushtet ligjore (siç mund të jetë moskryerja e një vepre tjetër penale); dhe për të përmbushur detyrime konkrete të caktuara nga gjykata në vendimin e saj.

Ligjvënësi ka parashikuar edhe situatën e kundërt me shkeljen e kushteve dhe të detyrimeve të caktuara gjatë ekzekutimit të dënimit alternativ. Neni 31/11 i ligjit nr. 8331/1998, i ndryshuar, në paragrafin e dytë dhe të tretë të tij parashikon si rast përjashtimor përfundimin e dënimit alternativ para afatit të provës. Një kërkesë e tillë mund të paraqitet nga prokurori në gjykatë pasi i dënuari të ketë ekzekutuar më shumë se gjysmën e periudhës kohore dhe nuk paraqet rrezikshmëri për kryerjen e ndonjë vepre tjetër penale, rendin publik apo palët e treta. Kërkesa duhet të përmbajë të dhëna për precedentët penale të të dënuarit, përshkrimin e dinamikës së sjelljes së të dënuarit dhe progresin e arritur gjatë ekzekutimit të dënimit, si dhe arsyet që përlligjin paraqitjen e një kërkesë të tillë. Pavarësisht faktit se është prokurori i cili është subjekti procedural i ngarkuar me ekzekutimin e vendimeve penale dhe që paraqet kërkesën me objekt përfundimin para afatit të dënimit alternativ për të dënuarin, organi i cili disponon pas një vlerësimi objektiv të fakteve, rrethanave dhe provave për çdo rast është gjykata.

⁶⁰ Neni 62 i Kodit Penal.

Ligji parashikon edhe raportin përfundimtar të Shërbimit të Provës mbi një rast të caktuar që tregon ecurinë e ekzekutimit të dënimit alternativ ndaj të dënuarit. Qëllimi i këtij raporti është dhënia ndihmë prokurorit, si në drejtim të rastit konkret, ashtu edhe në krijimin e një politike të ardhshme të përshtatshme penale. Ky raport dokumenton të gjithë veprimtarinë e Shërbimit të Provës mbi një procedim penal të caktuar dhe mund të konsiderohet edhe si dokumenti përmbyllës.

Kërkesa për paraqitjen e raportit

Në varësi të fazës ku gjendet procedimi penal dhe të qëllimit për të cilin kërkohet raporti i Shërbimit të Provës, si kërkues për përpilimin e një raporti vlerësimi mund të shfaqet prokurori ose gjykata. Subjekti procedural që i drejtohet me kërkesë Shërbimit të Provës, si rregull, është organi që posedon aktet e procedimit penal.

Nëse çështja është në hetim paraprak dhe aktet e procedimit posedohen nga prokurori, atëherë kërkesa nga prokurori i drejtohet Shërbimit të Provës. Prokurori mund të kërkojë raport vlerësimi nga Shërbimi i Provës që në hetimet paraprake, kur verifikon rrethana të tilla kryerjes së veprës penale dhe rrethana të tilla subjektive të të dënuarit që mund të justifikojnë në gjykatë kërkesën për caktimin e një dënimi alternativ. Kjo detyrë e prokurorit buron edhe nga analiza e qëndrimit që mban i dënuari në procedimin penal, që mund të materializohet në gjykim nëpërmjet procedurës me gjykim të shkurtuar të çështjes.

Nëse çështja është në gjykim dhe aktet e procedimit janë në gjykatë, atëherë kërkesa i drejtohet Shërbimit të Provës nga gjykata. Përgjatë gjykimit mund të ndodhë që palët të kërkojnë kryerjen e një raporti vlerësimi, kërkesë e cila mund të pranohet nga gjykata dhe pikërisht kjo e fundit paraqet kërkesën për raport, duke caktuar edhe afatin, brenda të cilit duhet të paraqitet raporti vlerësues nga Shërbimi i Provës.

Nëse çështja është në ekzekutim, Shërbimi i Provës është automatikisht në ushtrim të funksionit të tij, të cilin e dokumenton nëpërmjet përpilimit dhe paraqitjes së raporte me nismën e tij. Meqë subjekti procedural i ngarkuar me ligj për ekzekutimin e vendimit penal është prokurori dhe rrjedhimisht raportet e përpiluara nga Shërbimi i Provës i drejtohen prokurorit. Këto raporte në varësi të situatës që analizojnë (përfundim të ekzekutimit apo shkelje nga i dënuari) mund të jenë të natyrës përfundimtare ose vlerësuese.

Megjithatë, në fazën e ekzekutimit, mund të ndodhë në varësi të rrethanave të çështjes që Shërbimi i Provës të vihet në lëvizje me kërkesë si nga prokurori, ashtu edhe nga gjykata për përpilimin e një raporti vlerësues. Për ilustrim të kësaj procedure mund të përmendet si rast tipik kur i dënuari me burgim paraqet kërkesë në gjykatë për lirim me kusht sipas nenit 64 të Kodit Penal.

Dosja personale e Shërbimit të Provës

Raportet dhe informacionet e përgatitura dhe të paraqitura nga Shërbimi i Provës përfshihen në dosjen personale të të dënuarit.⁶¹ VKM-ja nr. 302/2009⁶² parashikon se Shërbimi i Provës krijon dosje personale për çdo të dënuar, plotësimi i së cilës fillon që në momentin e vendosjes së kontaktit të parë me të dënuarin dhe vazhdon deri në përfundimin e ekzekutimit të dënimit. Dosja personale arkivohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës me përfundimin e kryerjes së dënimit alternativ ose në rast lirimi të të dënuarit. Pjesë e kësaj dosje janë raportet e përpiluara nga Shërbimi i Provës dhe të dërguara në gjykatë ose prokurori gjatë periudhës së mbikëqyrjes; çdo paralajmërim i dhënë nga prokurori për shkelje të detyrimeve të vendosura nga gjykata gjatë periudhës së mbikëqyrjes; një ekstrakt të paralajmërimit të bërë nga prokurori në rastin e shkeljeve të lehta dhe të kryera për herë të parë, nëse ka; si dhe raporti përfundimtar i hartuar nga Shërbimi i Provës në përfundim të mbikëqyrjes.

Përmbajtja e raporteve sipas llojeve të tyre

Raportet në varësi të formës, kohës së paraqitjes dhe të llojit të dënimit alternativ kanë përmbajtje të ndryshme. Sipas Rregullores së organizimit të Shërbimit të Provës, të miratuar me VKM-në nr. 302/2009, Ministri i Drejtësisë, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës ka miratuar modele të standardizuara të raporteve (të paraqitura në Shtojcën II të këtij manuali). Standardizimi është parashikuar si mjet për unifikimin e veprimtarisë së institucionit të Shërbimit të Provës dhe për garantimin e elementëve të domosdoshëm që duhet të përmbajë raporti.

1. Raportet vlerësuese dhe përfundimtare

Elementët e këtyre lloj raporteve përcaktohen në mënyrë të detajuar në nenin 34 të VKM-së nr. 302/2009. Është pikërisht kjo dispozitë që i ndan në mënyrë të shprehur raportet në raporte vlerësimi (ato që paraqiten në çdo fazë të përfundimit përpara dhënies së vendimit gjyqësor që cakton masën alternative dhe ato që përgatiten për ngjarje të ndodhura gjatë ekzekutimit të dënimit alternativ) dhe në raporte përfundimtare (ato që përgatiten pas përfundimit të mbikëqyrjes së dënimit alternativ).

⁶¹ Në interpretimin e VKM-së nr. 302/2009, duhet konsideruar gjithmonë që sipas nenit 2 shkronja e) të saj “Dispozitat, që zbatohen për të dënuarin, zbatohen për aq sa janë të pajtueshme edhe për personin nën hetim dhe të pandehurin. Ndaj personit nën hetim dhe të pandehurit shtrihen edhe të drejtat dhe garancitë që janë parashikuar për të dënuarin”.

⁶² Neni 25 i VKM-së nr. 302/2009.

i. Raporti vlerësues

Elementët. Sipas nenit 34 të Rregullores së Shërbimit të Provës, raporti vlerësues përmban:

- një përshkrim dhe analizë të veprës penale;
- një përmbledhje të të gjithë informacionit dhe fakteve të rastit të paraqitura në formën e një analize mbi shkakun e kryerjes së kësaj veprë penale të veçantë në këtë kohë;
- burimet e informacionit të përdorura në përgatitjen e raportit, duke përfshirë njerëzit e intervistuar dhe dokumentet e konsultuara;
- numrin e takimeve të mbajtura me personat e intervistuar dhe refuzimin e bashkëpunimit apo çdo dyshim mbi saktësinë e informacionit të paraqitur në mënyrë të arsyetuar, si dhe burimet e informacionit mbi të cilat aksesit ka qenë i pamundur;
- përshkrimin dhe analizën e autorit të veprës penale, duke përfshirë informacion mbi sfondin e tij social, historinë personale, historinë kriminale dhe reagimet ndaj dënimeve të mëparshme dhe, kur është e nevojshme, arsimimin, punësimin apo trajnimet, strehimin, shëndetin fizik apo mendor, vështirësitë personale, duke përfshirë gjendjen financiare, përdorimin e drogës dhe të alkoolit, qëndrime të përgjithshme shoqërore dhe çdo faktor tjetër të rëndësishëm;
- rrezikun e përsëritjes së veprave penale prej autorit të veprës penale dhe të dëmit të mundshëm të veprimeve të tij në të ardhmen, si dhe faktorët që mund të ndikojnë ose prekin sjelljen e tij në përgjithësi. Kur është e përshtatshme, raporti përfshin mendime/konsiderata mbi mënyrat e reduktimit apo menaxhimit të rrezikut të përsëritjes apo dëmit;
- përfundimet dhe rekomandimet për rastin konkret.

Qëllimi i këtij raporti është dhënia ndihmë organit procedues që e ka kërkuar apo të cilit i drejtohet të vlerësojë në mënyrë të përshtatshme personalitetin dhe rrezikshmërinë e personit nën hetim/të pandehurit/të dënuarit duke bërë të mundur dhënien e drejtësisë në një rast individual.

Raporti vlerësues⁶³ hartohet duke analizuar rrethanat sociale të subjektit të analizuar (personit nën hetim, të pandehurit apo të dënuarit). Në Rregulloren e organizimit të Shërbimit të Provës, miratuar me VKM-në nr. 302/2009, parashikohet që ky raport paraqet një ekspertim të personit nën hetim, të pandehurit apo të dënuarit brenda kompetencave të Shërbimit të Provës. Rregullorja e përshkruan në këtë mënyrë përmbajtjen e raportit vlerësues për të deklaruar që ky raport përbën një mendim të specializuar të një organi të ngarkuar me ligj me detyrën e vlerësimit të individit, subjekt vlerësimi. Nga ana tjetër, Rregullorja i ka vendosur Shërbimit të Provës edhe kufijtë e vlerësimit, duke përcaktuar që ky vlerësim kryhet vetëm brenda kompetencave të Shërbimit të Provës të dhëna me ligj.

⁶³ Neni 32 i Rregullores së Shërbimit të Provës.

Kërkuesi i raportit. Raportet vlerësuese si rregull paraqiten me kërkesë të prokurorit ose të gjykatës, në varësi të fazës në të cilën ndodhet procedimi penal. Megjithatë në raste specifike dhe për ngjarje të papritura, këto raporte mund të përgatiten edhe nga Shërbimi i Provës me iniciativën e tij.

Përmbajtja dhe burimet. Raporti i vlerësimit është i përmbledhur dhe paraqet të dhëna bazuar në informacione të detajuara dhe në analizën e rrethanave, shkaqeve të kryerjes së veprës penale dhe qëndrimeve të të dënuarit. Burimi i parë i informacionit të Shërbimit të Provës janë takimet me personin, i cili është subjekt i këtij vlerësimi (të cilat janë të paktën dy të detyrueshme), me të cilin zhvillohen intervista për nxjerrjen e informacioneve dhe krijimin e analizës. Nëse i dënuari i kontaktuar nga Shërbimi i Provës refuzon të bashkëpunojë, atëherë ky fakt citohet në raportin e vlerësimit dhe shërben si tregues për autoritetin që procedon me vlerësimin e këtij raporti (gjykata/prokurori). Mirëpo mund të ndodhë që personi për të cilin është kërkuar raporti nuk gjendet. Në këtë rast, Shërbimi i Provës njofton organin procedues që ka kërkuar raportin (prokurorin/gjykatën). Në këtë njoftim tregohen faktet e gjetura nga burime të tjera informacioni, duke theksuar faktin e pamundësisë së gjetjes së personit për t'u vlerësuar.

Shërbimi i Provës mund të përdorë si burime informacioni për përpilimin e raportit vlerësues edhe anëtarët e familjes së të dënuarit, persona nga shkolla e tij apo vendi i tij i punës. Madje, Shërbimi i Provës për marrjen e informacioneve të nevojshme mund të kontaktojë edhe çdo person tjetër që mund të ofrojë informacion të dobishëm për hartimin e raportit të vlerësimit. Për këtë qëllim në nenin 33 të VKM-së nr. 302/2009 përcaktohet si detyrim i punonjësit të Shërbimit të Provës të kontaktojë me çdo person dhe institucion që mund të ofrojë informacion të dobishëm rreth personit në vlerësim, rreth arsimit, punësimit, strehimit, sjelljes, shëndetit, rrethanave të tij shoqërore dhe familjare.

Mund të ndodhë që në një rast të caktuar të jetë e nevojshme një analizë komplekse dhe tepër e specializuar psikologjike, sociologjike, pedagogjike, mjekësore apo analizë tjetër e ngjashme, e cila nuk mund të zhvillohet nga punonjësit e Shërbimit të Provës. Në këtë rast, është parashikuar që të ndërhyjë Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës. Për sigurimin e kësaj ekspertize, Zyra Vendore e Shërbimit të Provës i kërkon Drejtorisë së Përgjithshme ekspertizën e duhur për të hartuar raportin e vlerësimit.

Rekomandimi. Raporti vlerësues përfundon gjithmonë me rekomandimin konkret të Shërbimit të Provës drejtuar organit procedues që i drejtohet ky raport (prokurorit/gjykatës). Ky rekomandim tregon llojin apo masën që duhet ndërmarrë në rastin individual të analizuar. Në rast se raporti vlerësues paraqitet përpara dhënies së vendimit gjyqësor mbi fajësinë e të pandehurit, rekomandohet nëse duhet caktuar apo jo një dënim alternativ, dhe nëse po, lloji i dënimit alternativ, si dhe lloji i detyrimeve konkrete që mund të jenë të përshtatshme në rastin konkret. Në rast se raporti vlerësues paraqitet në fazën e ekzekutimit të dënimit alternativ, ai rekomandon mënyrën më të përshtatshme për ekzekutimin e suksesshëm të vendimit gjyqësor (siç mund të jetë dhënia e paralajmërimit për të dënuarin nga prokurori apo ndryshimi i detyrimeve nëpërmjet zëvendësimit, shtimit apo pakësimit të tyre deri tek

zëvendësimi i dënimit alternativ). Rekomandimi i Shërbimit të Provës jepet në mënyrë objektive dhe të paanshme, pavarësisht qëndrimeve të prokurorisë apo të mbrojtësit në përputhje me parimet e veprimitarisë së këtij Shërbimi, siç janë objektiviteti, paanshmëria dhe respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

ii. Raporti përfundimtar

Elementët. Raporti për përfundimin e plotë të periudhës së mbikëqyrjes përmban:

- gjeneralitetet e të dënuarit;
- të dhënat e vendimit gjyqësor penal që ka caktuar masën alternative;
- datën e fillimit dhe të përfundimit të masës alternative të dënimit;
- arsyen e përfundimit të masës alternative; dhe
- një paraqitje të ecurisë së përmbushjes së detyrimeve dhe masës alternative të dënimit.

Qëllimi. Raporti përfundimtar ka për qëllim të informojë prokurorin mbi sjelljen e të dënuarit gjatë ekzekutimit të dënimit alternativ, me qëllim që prokurori të nxjerrë vendimin e tij të veçantë për kryerjen e dënimit alternativ në përputhje me nenin 31/11 të ligjit nr. 8331/1998, i ndryshuar.

Kërkuesi i raportit. Raporti përfundimtar përgatitet dhe paraqitet gjithmonë me nismën e vetë Shërbimit të Provës pas verifikimit të ekzekutimit tërësisht të dënimit alternativ.

Përmbajtja dhe burimet. Raporti përfundimtar përmban një përshkrim të detajuar të të gjithë rastit individual, duke treguar të dhënat e vendimit gjyqësor dhe ecurinë në kohë të të gjithë dënimit alternativ. Lidhur me dënimin alternativ, përshkruhet jo vetëm lloji i tij, por edhe kushtet që duheshin përmbushur, detyrimet që duheshin respektuar dhe masën e realizimit të tyre nga i dënuari. Raporti përfundimtar tregon të gjitha burimet e shfrytëzuara për përshkrimin e informacionit, që nga intervistat dhe takimet me të dënuarin dhe me persona të tjerë, deri tek dokumentet e konsultuara nga Shërbimi i Provës.

Arsyeja e përfundimit. Raporti përfundimtar tregon edhe shkaku e përfundimit të dënimit alternativ, që si rregull i korrespondon përmbushjes së kohës së provës me respektim të kushteve dhe detyrimeve të caktuara nga i dënuari.

Në disa raste arsyeja e përfundimit mund të jetë e pazakontë:

- për shkak të revokimit të vendimit gjyqësor që ka caktuar dënimin alternativ dhe zëvendësimit të tij me dënimin me burgim nga gjykata; ose
- për shkak të përfundimit të parakohshëm të dënimit alternativ të

deklaruar me vendim gjyqësor sipas nenit 31/11 të ligjit nr. 8331/1998, i ndryshuar.

Në këto raste, raporti përfundimtar përshkruan edhe atributet e vendimit gjyqësor që i ka dhënë fund ekzekutimit të dënimit alternativ.

Përfundimet. Ky lloj raporti bën edhe një analizë mbi rrezikun e përsëritjes së veprave penale prej autorit të veprës penale dhe të dëmit të mundshëm të veprimeve të tij në të ardhmen, si dhe faktorët që mund të ndikojnë ose prekin sjelljen e tij në përgjithësi.

2. Raportet sipas fazës së përpilimit dhe paraqitjes së tyre

Elementët e këtyre lloj raporteve nxirren nga analiza e normave të ligjit nr. 8331/1998, i ndryshuar (nenet 31/8 e në vijim). Ky ligj përcakton në rrjedhë kronologjike veprimtarinë e Shërbimit të Provës përpara dhënies së vendimit gjyqësor mbi fajësinë e të dënuarit deri në përfundimin e ekzekutimit të dënimit alternativ, duke përmendur raportet si aktet që dokumentohet kjo veprimtari. Nga analiza e këtyre normave nxirren raportet e Shërbimit të Provës para vendimit, raportet gjatë ekzekutimit të dënimit alternativ dhe raportet pas përfundimit të dënimit alternativ.

i. Raporti i Shërbimit të Provës para vendimit

Elementët. Ky raport është i llojit vlerësues dhe përmban elementët e përshkruar tek raporti vlerësues.

Qëllimi. Raporti para vendimit ndihmon në radhë të parë prokurorin për të krijuar një vlerësim të plotë mbi rrethanat konkrete të të dënuarit për të paraqitur kërkesat e duhura në gjykimin e çështjes. Nga ana tjetër, ky raport ndihmon edhe gjykatën për të vlerësuar nëse është rasti për të caktuar dënim alternativ, llojin e alternativës që duhet caktuar deri tek detyrimet konkrete që duhen caktuar ndaj të dënuarit.

Kërkuesi i raportit. Shërbimi i Provës si rregull paraqet një raport të tillë me kërkesë të prokurorit. Megjithatë, nëse raporti vendoset të kryhet gjatë gjykimit të çështjes, atëherë është gjykata që i drejtohet Shërbimit të Provës dhe ky i fundit ka detyrimin ta paraqesë atë brenda afatit të përcaktuar nga gjykata.

Përmbajtja dhe burimet. Raporti para vendimit përmban informacion dhe të dhëna në formë analize për personalitetin e shkelësit të ligjit dhe rrethanat shoqërore të tij (punësimin e mëparshëm, sjelljen e nivelin arsimor dhe faktorët që ndikojnë apo mund të ndikojnë në sjelljen e tij). Raporti mbështetet në fakte të nxjerra nëpërmjet intervistave (të të pandehurit, të afërmeve dhe personave të tjerë) dhe nëpërmjet dokumenteve. Këto burime duhet të citohen shprehimisht. Edhe për këtë lloj raporti vlen rregulli i paanësisë dhe i objektivitetit.

Rekomandimi. Në përfundim të tij raporti i përpiluar para vendimit duhet të përmbajë edhe rekomandimin e Shërbimit të Provës nëse është rasti ose jo për caktimin e dënimit alternativ; në rast se po, rekomandimin për dënimin e përshtatshëm alternativ dhe të detyrimeve konkrete duke synuar integrimin e të dënuarit në shoqëri dhe parandalimin e kryerjes së veprave të tjera penale.

ii. Raporti i Shërbimit të Provës gjatë ekzekutimit të dënimit alternativ

Elementët. Sipas rregullave të Kodit Penal mbi alternativat e dënimit me burgim, gjykata në caktimin e një dënimi të tillë urdhëron të dënuarin të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës, si dhe të dënuarin të përmbushë disa kushte dhe detyrime të caktuara. Funkzioni bazë i Shërbimit të Provës është mbikëqyrja e përmbushjes së detyrimeve dhe të kushteve të përcaktuara në vendimin e gjykatës, si dhe për të asistuar e këshilluar të dënuarin në përmbushjen e këtyre detyrimeve nga i dënuari, me qëllim që ai të riintegrohet në shoqëri.

Pikërisht për dokumentimin e këtij funksioni, Shërbimi i Provës harton dhe paraqet raportet e vlerësimit gjatë ekzekutimit të dënimit alternativ. Rrjedhimisht, ato përmbajnë elementët e raporteve vlerësuese.

Qëllimi. Qëllimi i këtyre raporteve është të ndihmojë prokurorin për ndërmarrjen e hapave të duhur proceduralë gjatë fazës së ekzekutimit, si dhe gjykatën për dhënien e vendimeve të duhura gjatë fazës së ekzekutimit të dënimit alternativ. Këto vendime kanë natyrë të ndryshme dhe variojnë që nga dhënia e paralajmërimit, te ndryshimi apo revokimi i dënimit alternativ dhe zëvendësimi i tij me dënim me burgim, gjer tek përfundimi para kohe i dënimit alternativ që ia ka arritur qëllimit të riintegrit social të të dënuarit.

Kërkuesi i raportit. Këto raporte paraqiten si me kërkesë të gjykatës ose prokurorit, ashtu edhe me iniciativë të vetë Shërbimit të Provës. Madje mund të thuhet që në fazën e ekzekutimit të dënimit alternativ Shërbimi i Provës paraqitet shumë aktiv në përpilimin e raporteve të natyrës vlerësuese. Për këtë shkak, në një rubrikë më poshtë jepen disa shpjegime më të detajuara për llojet e raporteve që përpilohen me iniciativë të Shërbimit të Provës.

Përmbajtja dhe burimet. Raportet e hartuara dhe të paraqitura me kërkesë të gjykatës ose të prokurorit përmbajnë çështje sipas kërkesës së tyre dhe lidhen gjithmonë me zbatimin e vendimit të gjykatës dhe të programit individual të mbikëqyrjes së të dënuarit. Ndërsa raportet e vlerësimit të hartuara me iniciativë të Shërbimit të Provës përmbajnë informacion të verifikuar nga Shërbimi i Provës dhe për të cilin duhet të vihet në dijeni organi procedues, në radhë të parë prokurori dhe në vijim gjykata. Nëse objekt i këtij raporti është një shkelje apo mospërmbushje e një detyrimi të caktuar në kuadër të dënimit alternativ, atëherë raporti duhet të japë të dhëna për këtë shkelje, për arsyet, si dhe një analizë të situatës së krijuar.

Për sa u takon burimeve, këto raporte bazohen në të njëjtat burime të raporteve vlerësuese dhe duhet t'i përmendin shprehimisht burimet e përdorura.

Rekomandimi. Në përfundim të tij raporti duhet të përmbajë edhe rekomandimin e Shërbimit të Provës sipas objektit që ka vlerësuar. Nëse është rasti i kryerjes së suksesshme të dënimit alternativ, atëherë rekomandimi mund të jetë për përfundimin e parakohshëm të tij. Nëse është rasti i ndryshimit të kushteve të të dënuarit, atëherë jepet rekomandimi për ndryshimin e detyrimeve apo edhe të llojit të dënimit alternativ. Nëse është rasti i shkeljes së dënimit alternativ, atëherë rekomandimi jepet për dhënien e një paralajmërimi nga prokurori, për shtimin e detyrimeve apo për zëvendësimin e dënimit alternativ gjer në revokimin e tij dhe zëvendësimin me dënimin me burgim.

Raportet gjatë fazës së ekzekutimit me iniciativën e Shërbimit të Provës

Në këtë fazë ka një sërë raportesh që paraqiten me iniciativën e Shërbimit të Provës, të cilat përgjithësisht kanë natyrë informuese dhe karakter të menjëhershëm. Këto raporte klasifikohen në kategorinë e raporteve vlerësuese.

▣ **Raporti i parë** që mund të paraqitet nga Shërbimi i Provës kryesisht në fazën e mbikëqyrjes së ekzekutimit të dënimeve alternative është ai i vlerësimit të përdorimit të pijeve alkoolike dhe substancave narkotike ose psikotrope nga i dënuari.⁶⁴ Në fazën e ekzekutimit të dënimit, Shërbimi i Provës merr kontaktin e parë me të dënuarin dhe kryen një vlerësim paraprak mbi situatën e tij. Punonjësi i Shërbimit të Provës ka detyrimin që në këtë vlerësim paraprak të verifikojë edhe faktin nëse i dënuari është përdorues i pijeve alkoolike apo i substancave narkotike apo psikotrope. Në një rast verifikimi pozitiv të këtyre rrethanave, Shërbimi i Provës përgatit raportin e vlerësimit pas kontaktit të parë, i cili përmban të dhëna mbi llojin e substancave të përdorura, sasinë, masën e përdorimit dhe mënyrat e sigurimit të substancës, periudhën dhe historikun e konsumimit të substancës, si dhe nëse është rasti institucionin ku i dënuari është regjistruar për trajtim. Ky raport i njoftohet menjëherë prokurorit dhe qëllimi i tij është dhënia ndihmë prokurorit për të ndërhyrë me kërkesa procedurale në gjykatë për të reformuar detyrimet e caktuara ndaj të dënuarit për ekzekutimin e dënimit alternativ në përputhje me situatën e të dënuarit ndaj substancave alkoolike, narkotike apo psikotrope.

▣ Shërbimi i Provës harton me iniciativën e tij raporte mbi të dënuarin, edhe në rastin kur i dënuari nuk përmbush kushtet dhe detyrimet e përcaktuara nga gjykata,⁶⁵ të cilat mund të mos respektohen për shkaqe edhe të pavarura nga vullneti i të dënuarit. Ky raport përmban informacion për rrethanat e shkeljes, duke identifikuar nëse është shkelur kushti apo janë shkelur detyrimet, si dhe shkakun që ka ndikuar në këtë shkelje. Raporti mbi mospërmbushjen e kushteve dhe detyrimeve hartohet pas takimit dhe dëgjimit të

⁶⁴ Neni 24 i VKM-së nr. 302/2009.

⁶⁵ Neni 62 i Kodit Penal dhe neni 30 i VKM-së nr. 302/2009.

të dënuarit, shpjegimet e dhëna nga i cili bëhen pjesë e këtij raporti. Shërbimi i Provës i bashkëlidh këtij raport, sipas rastit, kur është e nevojshme, të dhëna në lidhje me mospërbushjen nga ana e të dënuarit të detyrimeve të vendosura nga gjykata.

Ky lloj raporti përmban jo vetëm vlerësimin e punonjësit të Shërbimit të Provës, por edhe propozimin konkret për prokurorin për veprimet që duhen ndërmarrë në përputhje me shkallën e rrezikshmërisë së shkeljes dhe vlerësimin që Shërbimi i Provës i ka bërë rastit. Llojet e propozimit mund të jenë dhënia e një paralajmërimi në rastet e të miturve ose shkeljeve të kryera për herë të parë; apo paraqitja e kërkesës drejtuar gjykatës për të ndryshuar detyrimin, për të shtuar detyrime të tjera, për t'i zëvendësuar ato me dënime të tjera ose për të revokuar pezullimin e kryerjes së dënimit dhe periudhën e dënimit me burgim.

Ky raport hartohet dhe paraqitet në mënyrë të menjëhershme sapo Shërbimi i Provës identifikon dhe verifikon shkeljen e kushtit apo të detyrimeve nga i dënuari, si dhe shkakun e shkeljes/mospërbushjes. Qëllimi i këtij raporti është informimi i prokurorit, që ai të ndërmarrë hapat e duhur proceduralë për rivendosjen e ligjit, që fillon me dhënien e një paralajmërimi të regjistrueshëm në dosjen personale të të dënuarit. Ky paralajmërim jepet nëse shkelja e raportuar është e lehtë dhe kryhet nga i dënuari për herë të parë.

Në rast se prokurori vlerëson se shkeljet e raportuara janë të rënda ose të përsëritura, atëherë ai bazuar në këtë raport vlerësimi, duhet t'i drejtohet gjykatës me kërkesë për ndryshimin e detyrimit të vendosur, shtimin e detyrimeve të tjera, zëvendësimin e tyre me një sanksion tjetër, ose revokimin e vendimit të pezullimit të dënimit dhe vuajtjen e pjesës së mbetur të dënimit në burg. Në këto raste, qëllimi i raportit vlerësues të Shërbimit të Provës është edhe ndihma për gjykatën për marrjen e një vendimi të drejtë mbi kërkesën e prokurorit.

Në rast se mospërbushja e detyrimeve u atribuohet shkaqeve të pavarura nga i dënuari, atëherë Shërbimi i Provës rekomandon reformimin e detyrimeve të caktuara në përputhje me situatën konkrete të të dënuarit. Edhe në këtë rast, qëllimi i këtij raporti është të ndihmojë prokurorin dhe gjykatën për të ndërmarrë veprimet dhe vendimet e përshtatshme për ekzekutimin e suksesshëm të dënimit alternativ.

iii. Raportet e Shërbimit të Provës pas përfundimit të periudhës së provës

Shërbimi i Provës në përfundim të dënimit alternativ apo me përmbushjen e detyrimeve të caktuara nga i dënuari harton dhe paraqet raportin për përfundimin e plotë të periudhës së mbikëqyrjes. Elementët, qëllimi, kërkesi i raportit, përmbajtja, burimet dhe shkaku i përfundimit janë shpjeguar në rubrikën e raportit përfundimtar.

Në këtë rubrikë, duhen evidentuar dy llojet e raporteve që hartohen dhe paraqiten përgjatë kësaj faze. Raporti më i zakonshëm është ai për përfundimin e dënimit alternativ, i cili i

drejtohet prokurorit të ekzekutimit dhe i shërben atij për të nxjerrë vendimin e veçantë për kryerjen e dënimit alternativ.

Krahas këtij raporti përfundimtar, Shërbimi i Provës në këtë fazë mund të paraqesë edhe një raport për përfundimin e detyrimeve të caktuara nga gjykata në kuadër të dënimit alternativ. Ky lloj raporti i drejtohet prokurorit dhe përmban një përshkrim të dinamikës së sjelljes së të dënuarit dhe progresin e arritur nga i dënuari gjatë ekzekutimit të dënimit alternativ; një përshkrim mbi faktin nëse i dënuari paraqet ose jo rrezikshmëri për kryerjen e ndonjë vepre tjetër penale, rendin publik apo palët e treta; si dhe konkluzionin nëse vlerësohet se nuk është më e nevojshme për të zbatuar më tej detyrimet për të arritur qëllimin e dënimit alternativ. Raporti për përfundimin e detyrimeve të caktuara nga gjykata paraqitet pasi i dënuari ka ekzekutuar më shumë se gjysmën e periudhës kohore. Ky lloj raporti i shërben prokurorit për t'u mbështetur, nëse ai çmon t'i drejtohet gjykatës për të kërkuar përfundimin para afatit të dënimit alternativ. Nëse prokurori paraqet një kërkesë të tillë në gjykatë, atëherë ky raport i shërben edhe gjykatës për të vendosur përfundimin para afatit të dënimit alternativ.

3. Raportet sipas llojeve të dënimit alternativ

Nisur nga lloji i alternativës që i referohen, raportet e Shërbimit të Provës ndryshojnë në përmbajtjen e tyre sepse kanë për objekt vlerësimin e llojeve të ndryshme të detyrimeve të të dënuarit dhe rrjedhimisht fokusohen tek përshtatshmëria e situatës së tij me llojin e alternativës së dënimit me burgim. Në vijim jepen disa informacione praktike mbi llojet e këtyre raporteve.

i. Raporti i mbikëqyrjes së të dënuarit me gjysmëliri (alternativa e parashikuar nga neni 58 i Kodit Penal)

Ky raport rregullohet nga neni 30 i ligjit nr. 8331/1998 dhe përmban të dhëna mbi sjelljen e të dënuarit kur ai ndodhet jashtë I.E.V.P.-së. Mund të nxirret përfundimi që Shërbimi i Provës potencialisht mund të hartojë tre lloj raportesh gjatë mbikëqyrjes së dënimit alternativ “gjysmëliria”:

a) Raporti i përgjithshëm mbi ecurinë e përgjithshme të të dënuarit përgjatë ekzekutimit të kësaj alternative. Ky raport përpilohet në përfundim të alternativës së dënimit me burgim “gjysmëlirisë” dhe i drejtohet prokurorit të ekzekutimit. Ky është i llojit raport përfundimtar, pra, përmban të njëjtat elementë, ka të njëjtin qëllim, si dhe të njëjtën përmbajtje me raportin përfundimtar.

b) Raporti i menjëhershëm mbi mosekzekutimin e kushteve dhe detyrimeve nga i dënuari. Ky raport përpilohet menjëherë sapo Shërbimi i Provës konstaton mosekzekutimin e kushteve apo detyrimeve të të dënuarit, të cilat përbëjnë thelbin e kësaj alternative.

Sigurisht që kushtet dhe detyrimet janë të caktuara individualisht rast pas rasti nga gjykata në vendimin për caktimin e alternativës së “*gjysmëlirisë*” në përputhje me nenin 59/a të Kodit Penal (kushte dhe detyrime konkrete të personit të dënuar për punën, arsimin, kualifikimin ose aftësimin profesional, përgjegjësitë thelbësore familjare apo për nevojën për trajtim ose rehabilitim mjekësor).

Raporti i menjëhershëm i drejtohet në çdo rast prokurorit të ekzekutimit. Ky raport është raport vlerësimi dhe ka karakter informues të situatës së krijuar tek prokurori i ekzekutimit. Nëse Shërbimi i Provës çmon se për këto shkelje duhet të njoftohet edhe drejtori i I.E.V.P.-së, atëherë ky raport i njoftohet edhe atij.

Raporti i menjëhershëm përpilohet me iniciativë të Shërbimit të Provës dhe qëllimi i tij është dhënia e ndihmës prokurorit për të ndërhyrë në rivendosjen e ligjit për ekzekutimin e suksesshëm të dënimit alternativ. Veprimi më i lehtë që mund të ndërmarrë prokurori është dhënia e një paralajmërimi të regjistrueshëm në dosjen personale të të dënuarit.

Nëse prokurori vlerëson t’i drejtohet gjykatës me kërkesë, atëherë qëllimi i këtij raporti është të ndihmojë edhe gjykatën për dhënien e një vendimi të drejtë në rastin konkret. Duke qenë i natyrës vlerësuese, ky raport përmban në fund rekomandimin konkret të Shërbimit të Provës për zgjidhjen e situatës.

c) Raporti i përbashkët dhe i menjëhershëm i Shërbimit të Provës dhe drejtorit të I.E.V.P.-së. Ky raport përmban informacionin mbi moskthimin e të dënuarit në I.E.V.P. Ai përpilohet nga Shërbimi i Provës dhe drejtori i I.E.V.P.-së menjëherë pas verifikimit prej tyre të faktit të moskthimit të të dënuarit dhe të rrethanave konkrete. Ky raport i drejtohet prokurorit të ekzekutimit dhe përpilohet me nismën e vetë Shërbimit të Provës. Qëllimi i tij është dhënia e informacionit të duhur prokurorit, që ai të ndërmarrë masat e duhura për rivendosjen e ligjit. Edhe ky raport është i natyrës vlerësuese dhe përmbillet me një rekomandim të shprehur të Shërbimit të Provës për llojin e masës që duhet ndërmarrë, sigurisht bazuar në analizën e specializuar të fakteve të raportuara.

ii. Raporti i mbikëqyrjes së të dënuarit me pezullim të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënie në provë (alternativa e parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal).

Raportet e Shërbimit të Provës gjatë mbikëqyrjes së kësaj alternative rregullohen nga neni 31/5 i ligjit nr. 8331/1998, i ndryshuar, nga nenet 37-44 të VKM-së nr. 302/2009 dhe nga nenet 59 e 62 të Kodit Penal. Nga analiza e këtyre normave nxirret përfundimi se Shërbimi i Provës gjatë mbikëqyrjes së kësaj alternative mund të përpilojë dhe paraqesë potencialisht dy lloj raportesh:

a) Raporti i përgjithshëm mbi ecurinë e përgjithshme të të dënuarit përgjatë ekzekutimit

të kësaj alternative. Ky raport përpilohet kryesisht nga Shërbimi i Provës në përfundim të alternativës së dënimit me burgim dhe i drejtohet prokurorit të ekzekutimit. Përmbajtja e këtij raporti ndryshon në varësi të detyrimeve që ka caktuar gjykata për t'u përmbushur nga i dënuari gjatë kohës së provës. Konkretisht pjesë e këtij raporti bëhet respektimi i detyrimit nga i dënuari për të mbajtur kontakte të rregullta me Shërbimin e Provës dhe paraqitjen e tij në takimet e caktuara; respektimi i detyrimit nga i dënuari për të njoftuar ndryshimin e vendbanimit; respektimi i detyrimit për të ushtruar një veprimtari profesionale ose për të marrë një formim profesional (duke përshkruar edhe kontrollet periodike të ushtruara për të verifikuar nëse i dënuari në provë i ndjek kurset e arsimit apo kualifikimit); përmbushja nga i dënuari i detyrimeve financiare të caktuara (duke përshkruar edhe kontrollet e rregullta të ushtruara për të verifikuar nëse i dënuari në provë i përmbush detyrimet e vendosura nga gjykata mënyrën e dokumentimit të rezultateve të kontrollit); apo përmbushjen e detyrimit për mjekim ose rehabilitim.

Ky raport përmbillet me përfundimet e Shërbimit të Provës mbi rastin konkret të mbikëqyrur, duke treguar edhe rrezikun e mundshëm të përsëritjes së veprave penale prej të dënuarit apo të dëmit eventual të veprimeve të tij në të ardhmen, si dhe faktorët që mund të ndikojnë ose prekin sjelljen e tij në përgjithësi.

b) Raporti i menjëhershëm për mospërmbushjen e detyrimeve. Ky raport hartohet nga Shërbimi i Provës me nismën e tij dhe ka karakter të menjëhershëm sapo ky Shërbim konstaton një prej këtyre rrethanave:

- i dënuari nuk mban kontakte me Shërbimin e Provës;
- i dënuari nuk përmbush kushtin e përgjithshëm të përcaktuar nga ligji “moskryerjen e një vepre tjetër penale gjatë kohës së provës”; ose
- i dënuari nuk përmbush detyrimet konkrete që ka vendosur gjykata ndaj tij sipas neneve 59 e 60 të Kodit Penal.

Ky raport i paraqitet prokurorit të ekzekutimit dhe përmban një përshkrim të detajuar të shkeljes konkrete, të shkaqeve të shkeljes, si dhe burimet e informacionit të shfrytëzuara nga Shërbimi i Provës. Qëllimi i këtij raporti është informimi i prokurorit mbi shkeljen në mënyrë që ai të ndërhyjë me kryerjen e veprimeve të duhura procedurale. Në këtë rast, zbatohen rregullat e nenit 59, paragrafi i fundit, sipas të cilit “*nëse i dënuari nuk mban kontakte me shërbimin e provës apo nuk përmbush detyrimet e parashikuara në nenin 60, siç është urdhëruar nga gjykata, gjykata vendos zëvendësimin e dënimit të parë me një dënim tjetër, zgjatjen e afatit të mbikëqyrjes, brenda periudhës së provës, ose revokimin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit*”. Në këtë rast, raporti i menjëhershëm mbi shkeljen e konstatuar i shërben edhe gjykatës për dhënien e vendimit mbi kërkesën e paraqitur nga prokurori.

iii. Raporti i mbikëqyrjes së të dënuarit me qëndrim në shtëpi (alternativa e parashikuar nga neni 59/a i Kodit Penal)

Raportet që përpilohen përgjatë ekzekutimit të dënimit alternativ “qëndrim në shtëpi” përmenden në nenin 31/4 i ligjit nr. 8331/1998, në nenet 46 dhe 47 të VKM-së nr. 302/2009, si dhe në mënyrë të tërthortë edhe në nenin 59/a të Kodit Penal. Nga analiza e këtyre normave, nxirret përfundimi që Shërbimi i Provës potencialisht mund të hartojë tre lloj raportesh gjatë mbikëqyrjes së dënimit alternativ “gjysmëliria”, të cilat përmbajnë të dhëna dhe informacione mbi sjelljen e të dënuarit gjatë ekzekutimit të dënimit alternativ “qëndrim në shtëpi”. Në këtë çështje duhet mbajtur në konsideratë që pavarësisht se kjo alternativë dënimi emërtohet “qëndrim në shtëpi”, në të vërtetë koncepti i shtëpisë së të dënuarit barazohet me atë të një shtëpie tjetër private (të një të treti), apo edhe me atë të një qendre të kujdesit dhe të shëndetit publik.

Për sa u takon burimeve të informacionit për përgatitjen e raporteve gjatë mbikëqyrjes së ekzekutimit të kësaj alternative, Shërbimi i Provës bashkëpunon, sipas rastit, me autoritetet e pushtetit vendor, shërbimet sociale, organet vendore të policisë, si dhe subjekte të tjera, private dhe shtetërore. Neni 31/4 i ligjit nr. 8331/1998, i ndryshuar, përcakton si të tilla edhe institucionet shëndetësore, institucionet e ndihmës sociale, si dhe organizatat joqeveritare që bashkëpunojnë me të për zbatimin e vendimit me “qëndrim në shtëpi”. Ky përcaktim i veçantë për “qëndrimin në shtëpi” sigurisht që ka lidhje me thelbin e kësaj alternative që detyron të dënuarin të rrijë në një ambient të izoluar, të ndryshëm nga I.E.V.P.-ja.

Tre llojet e raporteve që përpilohen dhe paraqiten nga Shërbimi i Provës për mbikëqyrjen e kësaj alternative janë:

a) Raporti i përgjithshëm mbi ecurinë e përgjithshme të të dënuarit përgjatë ekzekutimit të kësaj alternative. Ky raport përpilohet në përfundim të alternativës së dënimit me burgim “qëndrim në shtëpi” dhe i drejtohet prokurorit të ekzekutimit. Ky është i llojit raport përfundimtar, pra, përmban të njëjtat elementë, ka të njëjtin qëllim, si dhe të njëjtën përmbajtje me raportin përfundimtar. Ai përmbillet me analizën e Shërbimit të Provës mbi mundësinë e kryerjes së veprave penale nga i dënuari në të ardhmen apo me rrezikun mbi një dëm të mundshëm të veprimeve të tij në të ardhmen, duke treguar edhe faktorët që determinojnë sjelljen e të dënuarit.

b) Raporti i menjëhershëm për mosekzekutimin e kushteve dhe detyrimeve nga i dënuari. Ky raport përpilohet menjëherë sapo Shërbimi i Provës konstaton mosekzekutimin e kushteve apo detyrimeve të të dënuarit, që përbëjnë thelbin e kësaj alternative. Ky raport është i natyrës vlerësuese mbi rrethanat, ka karakter informues dhe përpilohet menjëherë nga Shërbimi i Provës me iniciativën e tij.

Edhe përgjatë ekzekutimit të kësaj alternative, mospërmbushja e detyrimeve mund të vijë si rezultat i shkaqeve të pavarura nga vullneti i të dënuarit. Kur Shërbimi i Provës konstaton se kushtet e parashikuara në nenin 59/a, paragrafi 1 të Kodit Penal, për të

cilat gjykata ka caktuar masën alternative “qëndrim në shtëpi” nuk ekzistojnë më, raporton menjëherë tek prokurori me qëllim që t’i kërkohet gjykatës revokimin e masës alternative dhe zëvendësimin e saj me një tjetër. Raporti i Shërbimit të Provës përmban, në këtë rast, një propozim konkret për dënimin zëvendësues. Por Shërbimi i Provës mund të rekomandojë edhe vetëm ndryshimin e detyrimeve në përputhje me mundësitë dhe nevojat e reja të të dënuarit.

Nëse detyrimet e caktuara shkelen me dashje nga i dënuari, atëherë Shërbimi i Provës rekomandon ndërmarrjen e veprimeve të ndryshme siç mund të jenë dhënia e paralajmërimit nga prokurori, ndryshimin e detyrimeve, ndryshimin e dënimit alternativ deri në revokimin dhe zëvendësimin e tij me dënim me burgim.

c) Raporti i Shërbimit të Provës për të lejuar të dënuarin të dalë nga qëndrimi në shtëpi. Sipas nenit 59/a të Kodit Penal, gjykata mund të lejojë personat e dënuar me qëndrim në shtëpi të largohen nga vendbanimi për plotësimin e nevojave të domosdoshme familjare, për t’u angazhuar në veprimtari pune, edukimi apo arsimimi ose për programe rehabilitimi, për të cilat Shërbimi i Provës është dakord. Sigurisht që pëlqimi i Shërbimit të Provës jepet nëpërmjet raportit të vlerësimit, në të cilin përshkruhen dhe analizohen nevojat konkrete të të dënuarit dhe jepet rekomandimi konkret për gjykatën për dhënien e kësaj lejeje të dënuarit. Në këto raste, pas referimit të fakteve nga i dënuari dhe nga Shërbimi i Provës, gjykata përcakton edhe masat që duhen marrë nga Shërbimi i Provës.

iv. Raporti i mbikëqyrjes së të dënuarit gjatë kryerjes së punës në interes publik (alternativa e parashikuar nga neni 63 i Kodit Penal)

Raportet e Shërbimit të Provës gjatë mbikëqyrjes së kësaj alternative rregullohen nga nenet 31/1 dhe 31/2 i ligjit nr. 10 024/2008, nga nenet 52-54 të VKM-së nr. 302/2009, si dhe në mënyrë të tërthortë edhe nga neni 63 i Kodit Penal. Gjkata, në vendimin që pezullon ekzekutimin e dënimit dhe zëvendësimin e tij me detyrimin për kryerjen e një pune me interes publik, urdhëron personin e dënuar të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës.

Gjatë mbikëqyrjes së të dënuarit që kryen punë me interes publik, Shërbimi i Provës harton dhe paraqet këto raporte:

a) Raporti i përgjithshëm mbi ecurinë e përgjithshme të të dënuarit përgjatë ekzekutimit të kësaj alternative. Ky raport përpilohet në përfundim të alternativës së dënimit me burgim dhe i drejtohet prokurorit të ekzekutimit. Ai përpilohet me nismën e Shërbimit të Provës në ushtrim të funksionit bazë të tij. Raporti i përgjithshëm është i natyrës përfundimtare dhe rrjedhimisht përmban elementët dhe qëllimin e përshkruar të këtij raporti. Ai përmbillet me përfundimet e Shërbimit të Provës, të bazuara në një analizë të specializuar të fakteve, mbi mundësinë e përfshirjes në të ardhmen të të dënuarit në veprimtari kriminale dhe mbi dëmin e mundshëm të veprimeve të tij.

b) Raporti i menjëhershëm për mospërmbushjen e detyrimeve. Ky raport hartohet nga Shërbimi i Provës menjëherë sapo ai konstaton që i dënuari nuk mban kontakte me të apo kur nuk kryen punën me interes publik. Ky raport i paraqitet prokurorit të ekzekutimit dhe hartohet kryesisht nga Shërbimi i Provës. Qëllimi i tij është informimi i menjëhershëm i prokurorit për shkeljen dhe të shkakut të saj, në mënyrë që prokurori në vijim të ndërmarrë hapat e duhur proceduralë për rivendosjen e ligjit (dhënien e një paralajmërimi; reformimin e detyrimeve apo ndryshimin e alternativës deri në zëvendësimin e saj me dënim me burgim). Si burim kryesor informacioni për përgatitjen e këtij raporti shërben punëdhënësi, pranë të cilit i dënuari kryen punën në interes publik. Megjithatë informacioni i dhënë nga ky burim verifikohet objektivisht nga Shërbimi i Provës.

c) Raporti për nevojën e pezullimit të punës me interes publik. Ky raport është i natyrës vlerësuese dhe hartohet nga Shërbimi i Provës pas verifikimit të situatës që i dënuari pretendon se ka ndryshuar (sëmundje e papritur; vdekje e një të afërmi; rrethana të tjera të jashtëzakonshme). Ky raport hartohet me kërkesë të prokurorit të ekzekutimit, i cili vihet në lëvizje nga kërkesa e të dënuarit për pezullimin e urdhrit për punën me interes publik. Në këto raste, Shërbimi i Provës verifikon shkakun e paraqitur nga i dënuari në kërkesën e tij për pezullim dhe rezultatet e verifikimit janë pjesë e raportit që i paraqitet prokurorit. Në raport, Shërbimi i Provës evidenton edhe nëse kushtet e të dënuarit kanë ndryshuar në atë masë që justifikojnë pezullimin. Raporti për nevojën e pezullimit përmban edhe kohëzgjatjen e rrethanës penguese të të dënuarit për të kryer punën në interes publik, për të orientuar prokurorin dhe gjykatën në caktimin e periudhës kohore të pezullimit. Qëllimi i këtij raporti është të ndihmojë prokurorin për të kërkuar në gjykatë pezullimin e vendimit për punë në interes publik, si dhe gjykatën për të dhënë vendim mbi një kërkesë të tillë.

v. ***Raporti i lirimimit me kusht (alternativa e parashikuar nga neni 64 i Kodit Penal).***

Raportet e Shërbimit të Provës gjatë mbikëqyrjes së kësaj alternative rregullohen nga neni 31/6 i ligjit nr. 8331/1998, i ndryshuar, nga neni 57 i VKM-së nr. 302/2009 dhe nga neni 64 i Kodit Penal.

Për këtë lloj alternative, Shërbimi i Provës harton dhe paraqet këto raporte:

a) Raporti mbi përshtatshmërinë e caktimit të kësaj alternative. Ky raport përpilohet përpara caktimit të kësaj alternative, me kërkesë të gjykatës, ku i dënuari me burgim ka paraqitur kërkesën për lirimim me kusht. Ky raport, ka natyrë vlerësuese dhe i drejtohet gjykatës duke treguar një analizë mbi kushtet familjare dhe prejardhjen shoqërore të të dënuarit, si dhe për planet konkrete, për të mundësuar riintegrimin e plotë të tij pas lirimimit. Qëllimi i këtij raporti është të asistojë gjykatën për dhënien e një vendimi mbi kërkesën e të dënuarit me burgim për t'u liruar me kusht.

b) Raporti i përgjithshëm mbi ecurinë e përgjithshme të të dënuarit përgjatë ekzekutimit të kësaj alternative. Ky raport përpilohet në përfundim të alternativës së lirimit me kusht dhe i drejtohet prokurorit të ekzekutimit.

c) Raporti i menjëhershëm për mospërbushjen e detyrimeve. Ky raport hartohet nga Shërbimi i Provës menjëherë sapo ai konstaton një prej këtyre rrethanave:

- i dënuari nuk mban kontakte me Shërbimin e Provës;
- i dënuari nuk përmbush detyrimin e përgjithshëm “moskryerjen e një veprë tjetër penale gjatë kohës së provës”; ose
- i dënuari nuk përmbush detyrimet konkrete që ka vendosur gjykata ndaj tij për kohën e provës.

Ky raport përpilohet nga Shërbimi i Provës me iniciativën e tij dhe i paraqitet prokurorit të ekzekutimit. Qëllimi i këtij raporti është dhënia ndihmë prokurorit për të evidentuar shkeljen e kushtit/detyrimeve të të dënuarit përgjatë ekzekutimit të kësaj alternative të dënimit me burgim, me qëllim që ai në vijim të ndërmarrë veprimet e duhura procedurale sipas ligjit.

SHTOJCA I



L I G J
Nr. 8724, datë 26.12.2000

PËR RATIFIKIMIN E “KONVENTËS EUROPIANE PËR MBIKËQYRJEN E PERSONAVE TË DËNUAR OSE TË LIRUAR ME KUSHT”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e
Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Konventa Europiane për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2859, datë 5.1.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

**KONVENTA EUROPIANE PËR MBIKËQYRJEN E PERSONAVE TË DËNUAR
OSE TË LIRUAR ME KUSHT**

Strasburg, më 30.11.1964

Seria e traktateve europiane nr.51

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës nënshkrues të kësaj Konvente,
Duke konsideruar se qëllimi i Këshillit të Europës është realizimi i një bashkimi më të ngushtë midis anëtarëve të tij;
Duke afirmuar vullnetin e tij për të bashkëpunuar në luftën kundër kriminalitetit;
Duke konsideruar se për këtë qëllim atyre u përket, që për çdo vendim që është marrë në njërin prej tyre, të përmbushin në territorin e të tjerëve, nga njëra anë rehabilitimin shoqëror të keqbërësve të dënuar ose të liruar me kusht dhe, nga ana tjetër, vënien në ekzekutim të sanksionit në rastin kur kushtet e parashikuara nuk janë përmbushur,

Kanë rënë dakord përsa vijon:

Titulli I - Parime themelore

Neni 1

1. Palët kontraktuese angazhohen të japin, konform dispozitave të mëposhtme, ndihmën e ndërsjellë për rehabilitimin shoqëror të keqbërësve të parashikuar nga neni 2. Kjo ndihmë përbëhet nga mbikëqyrja e keqbërësve që realizohet, nga njëra anë, me masat e përshtatshme për të lehtësuar përmirësimin dhe ripërshtatjen e tyre në jetën shoqërore dhe, nga ana tjetër, me kontrollin e sjelljes së tyre për të dhënë mundësi, kur është e nevojshme, që ose të shpallet sanksioni ose të vihet ai në ekzekutim.
2. Palët kontraktuese do të vënë në ekzekutim, konform dispozitave të mëposhtme, dënimin ose masën e sigurimit me heqje të lirisë, të dhënë ndaj keqbërësit dhe për të cilin zbatimi është pezulluar.

Neni 2

1. Në vështrim të kësaj Konvente, shprehja “keqbërës” do të thotë çdo person që, në territorin e Palëve kontraktuese, është bërë objekt:
 - a) i një vendimi gjyqësor fajësie, i shoqëruar me pezullimin me kusht të vendimit të dënimit;
 - b) i një dënimi që ka sjellë heqjen e lirisë, dhënë me kusht ose ekzekutimi i të cilit është pezulluar me kusht, pjesërisht ose tërësisht, ose në çastin e dënimit ose më pas.
2. Në nenet e mëposhtme, termi “dënim” ka të bëjë me vendimet e marra, si në bazë të pikës a ashtu edhe të pikës b të paragrafit 1 të mësipërm.

Neni 3

Vendimet e parashikuara nga neni 2 duhet të jenë përfundimtare dhe të ekzekutueshme.

Neni 4

Vepra penale që motivon kërkesën e parashikuar nga neni 5 duhet të jetë e dënueshme nga ligji i Shtetit kërkues dhe ai i Shtetit të kërkuar.

Neni 5

Shteti që ka dhënë dënimin mund t’i kërkojë Shtetit, në territorin e të cilit keqbërësi ka caktuar vendbanimin e zakonshëm të tij:

- a) të realizojë vetëm mbikëqyrjen konform titullit II;
- b) të realizojë mbikëqyrjen dhe, kur është e nevojshme, të bëjë ekzekutimin konform titujve II e III;
- c) të realizojë zbatimin e plotë të dënimit konform dispozitave të titullit IV.

2. Shteti i kërkuar është i detyruar, në kushtet e parashikuara nga kjo Konventë, t'i japë rrugë një kërkesë të tillë.

3. Kur Shteti kërkuar ka formuluar një kërkesë të parashikuar nga paragrafi 1 i mësipërm dhe kur Shteti i kërkuar çmon, në çdo rast të veçantë, të parapëlqyeshme të përdorë njërën nga mundësitë e parashikuara në këtë paragraf, Shteti i kërkuar mund të refuzojë t'i japë rrugë kësaj kërkesë, por gjithnjë duke u deklaruar e gatshme për t'i dhënë rrugë një kërkesë tjetër që ai do të caktojë.

Neni 6

Me kërkesë të Shtetit që ka dhënë dënimin, mbikëqyrja, ekzekutimi ose zbatimi i plotë, të përcaktuara nga neni i mëparshëm, përmbushen nga Shteti në territorin e të cilit keqbërësi ka caktuar vendbanimin e zakonshëm të tij.

Neni 7

Mbikëqyrja, ekzekutimi ose zbatimi i plotë refuzohen:

- a) kur ata konsiderohen nga Shteti i kërkuar se janë me natyrë të tillë që prekin sovranitetin e tij, sigurinë, parimet themelore të rendit të tij juridik ose interesa të tjerë thelbësorë;
- b) kur dënimi që motivon kërkesën e parashikuar nga neni 5 bazohet në fakte që janë gjykuar përfundimisht në Shtetin e kërkuar;
- c) kur Shteti i kërkuar i konsideron faktet që motivojnë dënimin ose si vepër penale politike ose si vepër penale e lidhur me një vepër të tillë politike, ose si vepër penale thjesht ushtarake;
- d) kur parashkrimi i sanksionit është përmbushur sipas ligjit të Shtetit kërkuar ose sipas atij të Shtetit të kërkuar;
- e) kur autori i veprës penale përfiton nga një amnisti ose masë e faljes në Shtetin kërkuar ose në Shtetin e kërkuar.

2. Mbikëqyrja, ekzekutimi ose zbatimit i plotë mund të refuzohen:

- a) kur autoritetet kompetente të Shtetit të kërkuar kanë vendosur të mos fillojnë ndjekjen penale ose të pushojnë ndjekjen penale që ata kanë ushtruar për të njëjtat fakte;
- b) kur faktet, që motivojnë dënimin, përbëjnë objekt për ndjekje penale në Shtetin e kërkuar;
- c) kur dënimi, që motivon kërkesën, është dhënë në mungesë;
- d) kur Shteti i kërkuar çmon se dënimi për të cilin ai është vënë në lëvizje është i papajtueshëm me parimet udhëheqëse të zbatimit të së drejtës penale të saj, veçanërisht kur, për shkak të moshës së tij, autori i veprës penale nuk do të ishte dënuar në Shtetin e kërkuar.

3. Në fushën e veprave penale fiskale, mbikëqyrja ose ekzekutimi bëhen në kushtet e parashikuara nga kjo Konventë vetëm nëse kështu është vendosur midis Palëve kontraktuese për çdo vepër penale ose kategori veprash penale.

Neni 8

Shteti kërkues dhe Shteti i kërkuar informojnë, kur është e nevojshme, reciprokisht njëri-tjetrin për çdo rrethanë që ka të bëjë me përmbushjen e masave të mbikëqyrjes në territorin e Shtetit të kërkuar ose vënien në ekzekutim të dënimit në këtë Shtet.

Neni 9

Shteti i kërkuar njofton pa vonesë Shtetin kërkues për dhënien rrugë të kërkesës.

Titulli II – Mbikëqyrja

Neni 10

Shteti kërkues i bën të njohur Shtetit të kërkuar kushtet që i janë caktuar keqbërësit dhe, kur është rasti, masat e mbikëqyrjes, të cilave ky është i detyruar t'u nënshtrohet gjatë periudhës së provës.

Neni 11

1. Shteti i kërkuar përmbush kërkesën e Shtetit kërkues dhe, kur është e nevojshme, ai përshtat sipas legjislacionit të vet masat e parashikuara të mbikëqyrjes.
2. Masat e mbikëqyrjes që zbatohen nga Shteti i kërkuar nuk mund, në asnjë rast, të rëndohen nga natyra ose kohëzgjatja e tyre nga ç'ka parashikuar Shteti kërkues.

Neni 12

Kur Shteti i kërkuar pranon të realizojë mbikëqyrjen, ai përmbush detyrat e mëposhtme:

1. njofton pa vonesë Shtetin kërkues për pritjen që ai i bën kërkesës së tij;
2. realizon bashkëpunimin e autoriteteve ose organizmave që janë ngarkuar, në territorin e tij, të mbikëqyrin dhe t'i qëndrojnë pranë keqbërësit;
3. informon Shtetin kërkues për të gjitha masat e marra dhe për zbatimin e tyre.

Neni 13

Në rastin kur i interesuari është vënë para revokimit të vendimit të pezullimit me kusht të parashikuar nga neni 2, ose për shkak të një ndjekjeje penale ose dënimi për një vepër tjetër penale, ose për shkak të shmangies nga detyrimet që i janë vënë, Shteti i kërkuar i dërgon kryesisht të dhënat e nevojshme Shtetit kërkues.

Neni 14

Me përfundimin e periudhës së mbikëqyrjes, me kërkesë të Shtetit kërkues, Shteti i kërkuar i jep këtë të fundit të gjitha të dhënat e nevojshme.

Neni 15

Vetëm Shteti kërkues ka kompetencë të çmojë, mbi bazën e të dhënave dhe mendimit të dhënë nga Shteti i kërkuar, nëse keqbërësi i ka përmbushur ose jo kushtet që i ishin vënë dhe, mbi bazën e këtyre konstatimeve, të kryejë çdo hap tjetër të mëtejshëm në bazë të legjislacionit të saj.

Ai informon Shtetin e kërkuar për vendimin që merr.

Titulli III – Mbi ekzekutimin e dënimeve

Neni 16

Pas revokimit të vendimit të pezullimit me kusht nga Shteti kërkues dhe me kërkesë të këtij Shteti, Shteti i kërkuar ka kompetencë të ekzekutojë dënimin.

Neni 17

Ekzekutimi bëhet në përputhje me ligjin e Shtetit të kërkuar, pas verifikimit të autencitetit të kërkesës për ekzekutim dhe konformitetit të saj me kushtet e fiksuara nga kjo Konventë.

Neni 18

Shteti i kërkuar i dërgon në kohën e duhur Shtetit kërkues një dokument që vërteton ekzekutimin e dënimit.

Neni 19

Shteti i kërkuar e zëvendëson, kur kjo është me vend, sanksionin e dhënë në Shtetin kërkues, me dënimin ose masën e parashikuar nga ligji i vet për një vepër penale analoge. Ky dënim ose masë i korrespondon, me aq sa është e mundur dhe në natyrën e tij, atij të dhënë nga vendimi i ekzekutimit. Ai nuk mund as të kapërcejë maksimumin e parashikuar nga ligji i Shtetit të kërkuar dhe as të rëndojë nga natyra ose kohëzgjatja sanksionin e dhënë në Shtetin kërkues.

Neni 20

Shteti kërkues nuk mundet më të marrë asnjë masë për ekzekutimin e kërkuar, veç kur Shteti i kërkuar e ka njoftuar atë për refuzim ose pamundësi ekzekutimi.

Neni 21

Shteti i kërkuar është kompetent në çështje të lirimit me kusht. E drejta e faljes mund të ushtrohet nga Shteti kërkues dhe nga Shteti i kërkuar.

Titulli IV – Heqja dorë në favor të Shtetit të kërkuar

Neni 22

Shteti kërkuar do t'i bëjë të njohur Shtetit të kërkuar dënimin për të cilin ai kërkon zbatimin e plotë.

Neni 23

1. Shteti i kërkuar përshtat dënimin ose masën e dhënë me legjislacionin e vet penal ashtu sikur ai të ishte dhënë për të njëjtën veprë penale të kryer në territorin e vet.
2. Sanksioni i dhënë në Shtetin e kërkuar nuk mund të rëndojë sanksionin e dhënë në Shtetin kërkuar.

Neni 24

Shteti i kërkuar siguron zbatimin e plotë të dënimit të përshtatur ashtu si do të veprohej për një dënim të dhënë nga juridiksionet e tij.

Neni 25

Pranimi nga Shteti i kërkuar i një kërkesë të formuluar konform këtij titulli pushon të drejtën për ekzekutimin e dënimit në Shtetin kërkuar.

Titulli V – Dispozita të përbashkëta

Neni 26

1. Çdo kërkesë e parashikuar nga neni 5 formulohet me shkrim.

Ajo përmban:

- a) autoritetin që e ka nxjerrë;
- b) objektin e saj;
- c) identitetin e keqbërësit dhe vendbanimin e tij në Shtetin e kërkuar.

2. Kërkesa për mbikëqyrje shoqërohet me origjinalin ose me kopjen autentike të vendimit që përmban arsyet që kanë motivuar mbikëqyrjen dhe që specifikon masat që i vihen keqbërësit. Ajo saktëson, me aq sa është e mundur, rrethanat e veprës penale që ka motivuar vendimin e mbikëqyrjes, kohën dhe vendin e kryerjes, cilësimin ligjor të saj, dhe kur kjo është e nevojshme, kohëzgjatjen e sanksionit për ekzekutimin. Ajo jep të gjitha të dhënat për natyrën dhe kohëzgjatjen e masave të mbikëqyrjes që kërkohen për t'u ekzekutuar. Ajo përmban referenca në dispozitat ligjore të zbatueshme dhe të dhënat e nevojshme mbi personalitetin e keqbërësit dhe mbi sjelljen e tij në Shtetin kërkuar para dhe pas dhënies së vendimit për mbikëqyrje.

3. Kërkesa për ekzekutim shoqërohet me origjinalin ose me një kopje autentike të vendimit që ka konstatuar revokimin e kushtit pezullues të dënimit ose të ekzekutimit

të tij, si dhe vendimin e dënimit. Karakteri i ekzekutueshëm i këtyre dy vendimeve vërtetohet në format e parashikuara nga ligji i Shtetit që i ka dhënë.

Kur vendimi për t'u ekzekutuar zëvendëson një tjetër të mëparshëm pa bërë një paraqitje të fakteve, do t'i bashkëngjitet një kopje autentike e vendimit që përmban këtë paraqitje.

4. Kërkesa që ka për objekt zbatimin e plotë të dënimit shoqërohet me dokumentet e parashikuara në paragrafin 2 të mësipërm.

Neni 27

1. Kërkesa dërgohet nga Ministria e Drejtësisë e Shtetit kërkues drejtuar Ministrisë së Drejtësisë të Shtetit të kërkuar. Përgjigjja transmetohet sipas të njëjtës rrugë.

2. Komunikimet e nevojshme për zbatimin e kësaj Konvente shkëmbehen ose sipas rrugëve të treguara në paragrafin 1 të këtij neni ose drejtpërdrejt midis autoriteteve të Palëve kontraktuese.

3. Në raste urgjente, komunikimet e parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni mund të transmetohen nëpërmjet Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (Interpol).

4. Çdo Palë kontraktuese mundet, me deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të bëjë të njohur se ajo dëshiron t'u përmbahet rregullave të reja të ndryshme nga ato të formuluar në paragrafët 1 e 2 të këtij neni.

Neni 28

Kur Shteti i kërkuar çmon se të dhënat e paraqitura nga Shteti kërkues janë të pamjaftueshme për t'i dhënë atij mundësi të zbatojë këto Konventë, ai kërkon plotësimin e të dhënave. Ai mund të caktojë një afat për marrjen e këtyre informacioneve.

Neni 29

1. Me rezervën e dispozitave të paragrafit 2 të këtij neni, nuk do të kërkohet përkthimi i kërkesave dhe shkresave që i bashkëngjiten, si dhe i të gjitha dokumenteve të tjera lidhur me zbatimin e kësaj Konvente.

2. Çdo Palë kontraktuese mundet, në çastin e nënshkrimit ose depozitimit të instrumenteve të rafitikimit, të pranimit ose aderimit, me deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të rezervojë të drejtën të kërkojë që kërkesat dhe shkresat që u bashkëngjiten të shoqërohen me përkthim, ose në gjuhën e vet ose në njërën nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Europës ose në njërën nga këto gjuhë që ajo do të caktojë. Palët e tjera kontraktuese mund të kërkojnë të zbatojnë reciprocitetin.

3. Ky nen nuk prek dispozitat lidhur me përkthimin e kërkesave dhe shkresave që u bashkëngjiten, që përmbahen në marrëveshjet ose traktatet që janë në fuqi që mund të përfundohen midis dy ose disa Palësh kontraktuese.

Neni 30

Për shkresat dhe dokumentet e transmetuara në zbatim të kësaj Konvente nuk do të kërkohet asnjë formalitet legalizimi.

Neni 31

Shteti i kërkuar ka kompetencë, me kërkesë të Shtetit kërkuar, të marrë shpenzimet për ndjekjen penale dhe gjykimin, të kryera në këtë Shtet. Kur ai vepron për marrjen e këtyre shpenzimeve, ai është i detyruar t'i rikthejë Shtetit kërkuar vetëm honoraret për ekspertët që ai ka marrë.

Neni 32

Shpenzimet për mbikëqyrje dhe ekzekutim të bëra në Shtetin e kërkuar nuk kthehen.

Titulli VI – Dispozita të fundit

Neni 33

Kjo Konventë nuk cenon dispozitat që rregullojnë policinë e të huajve.

Neni 34

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim nga Shtetet anëtare të Këshillit të Europës. Ajo do të ratifikohet ose do të pranohet. Instrumentet e ratifikimit ose të pranimin do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.
2. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së të tretit depozitim të instrumenteve të ratifikimit ose të pranimin.
3. Për çdo Shtet nënshkrues që do të shprehë më pas pëlqimin e vet për ta ratifikuar ose pranuar, kjo do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumenteve të ratifikimit ose të pranimin.

Neni 35

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës mund të ftojë çdo Shtet joanëtar i Këshillit të Europës për të aderuar në këtë Konventë.
2. Aderimi bëhet me anë të depozitimit të instrumenteve të aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës që do të fillojë efektet tre muaj pas datës së depozitimit.

Neni 36

1. Çdo Shtet kontraktues mundet, në çastin e nënshkrimit ose në çastin e depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimin ose aderimit të caktojë territorin ose territoret ku do të zbatohet kjo Konventë.
2. Çdo Shtet kontraktues mundet, në çastin e depozitimit të ratifikimit, të pranimin ose të aderimit ose në çdo çast tjetër më pas, me anë të një deklaratë drejtuar Sekretarit

të Përgjithshëm të Këshillit të Europës të shtrijë zbatimin e kësaj Konvente në çdo territor tjetër të caktuar në deklaratë, ku ai është i ngarkuar të mbulojë marrëdhëniet ndërkombëtare.

3. Çdo deklaratë e bërë në bazë të dy paragrafëve të mëparshëm mund të tërhiqet, përsa i takon çdo territori të caktuar në deklaratë sipas kushteve të parashikuara nga neni 39 i kësaj Konvente.

Neni 37

1. Kjo Konventë nuk prek detyrimet që përmbahen në dispozitat e çdo Konvente tjetër ndërkombëtare me karakter dypalësh ose shumëpalësh, që rregullon ose do të rregullojë, midis dy ose disa Palëve kontraktuese, ekstradimin ose forma të ndihmës gjyqësore në fushën penale.

2. Palët në Konventë mund të përfundojnë midis tyre marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe, lidhur me çështjet e rregulluara nga kjo Konventë, vetëm me qëllim të plotësimit të dispozitave të kësaj Konvente ose për të lehtësuar zbatimin e parimeve që ajo mishëron.

3. Megjithatë, kur dy ose disa Palë kanë vendosur ose sapo kanë vendosur marrëdhënie mbi bazën e një legjislacioni uniform ose të një regjimi të posaçëm, ato do të kenë të drejtë të rregullojnë marrëdhëniet e ndërsjella në këtë fushë duke u mbështetur plotësisht në këto sisteme që nuk bien ndesh me këtë Konventë.

Palët kontraktuese që do të përjashtojnë nga marrëdhëniet e tyre të ndërsjella zbatimin e kësaj Konvente, konform dispozitave të këtij paragrafi, do t'i drejtojnë për këtë qëllim një njoftim Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 38

1. Çdo Palë kontraktuese mundet, në çastin e nënshkrimit ose në çastin e depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit ose aderimit, të deklarojë se do të bëjë një ose disa rezerva që figurojnë në aneksin e kësaj Konvente.

2. Çdo Palë kontraktuese që ka formuluar një rezervë në bazë të paragrafit të mëparshëm mund ta tërheqë atë tërësisht ose pjesërisht, duke i drejtuar një deklaratë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës dhe që do të fillojë efektet në datën e marrjes së saj.

3. Pala kontraktuese që ka formuluar një rezervë lidhur me një dispozitë të kësaj Konvente nuk mund të pretendojë për zbatimin e kësaj dispozite nga një Palë tjetër; megjithatë, ajo mundet, nëse rezerva është e pjesshme ose me kusht, të pretendojë për zbatimin e kësaj dispozite në atë masë që ajo vetë e ka pranuar atë.

4. Çdo Palë kontraktuese mundet, në çastin e nënshkrimit të kësaj Konvente ose të depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, të pranimit ose të aderimit, me njoftim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të bëjë të ditur se ajo konsideron ratifikimin, pranimin ose aderimin të tillë që pas sjell detyrimin, konform të drejtës ndërkombëtare, të përfshijë në rendin e brendshëm dispozitat e nevojshme për zbatimin e kësaj Konvente.

Neni 39

1. Kjo Konventë do të mbetet në fuqi pa kufizim në kohë.
2. Çdo Palë kontraktuese mundet, përsa i takon, të denoncojë këtë Konventë duke i drejtuar një njoftim Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.
3. Denoncimi do të fillojë efektet gjashtë muajsh pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 40

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të njoftojë Shtetet anëtare të Këshillit dhe çdo Shtet që ka aderuar në këtë Konventë për:

- a) çdo nënshkrim;
- b) depozitimin e instrumenteve të ratifikimit, pranimit ose aderimit;
- c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente konform neni 34 të saj;
- d) çdo njoftim ose deklaratë të marrë në zbatim të paragrafit 4 të neni 27 të paragrafit 2 të neni 29, të paragrafit 3 të neni 37 dhe të paragrafit 4 të neni 38;
- e) çdo deklaratë të marrë në zbatim të dispozitave të paragrafëve 2 e 3 të neni 36;
- f) çdo rezervë të formuluar në zbatim të paragrafit 1 të neni 38;
- g) tërheqja e çdo rezerve të bërë në zbatim të paragrafit 2 të neni 38;
- h) çdo njoftim të marrë në zbatim të dispozitave të neni 39 dhe datën e hyrjes kur denoncimi do të fillojë efektet.

Me këtë mirëbesim, nënshkruesit, të autorizuar rregullisht për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Strasburg, më 30 nëntor 1964, në frëngjisht dhe anglisht, të dy tekstet janë njëjloj të besueshëm, në një ekzemplar të vetëm që do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'u komunikojë nga një kopje të vërtetuar konform secilit nga Shtetet nënshkruese dhe aderuese.

ANEKS

Secila nga Palët kontraktuese mund të deklarojë se ajo rezervon të drejtën të bëjë të njohur:

1. se ajo nuk pranon dispozitat e Konventës që trajton ekzekutimin e dënimeve ose zbatimin e plotë të tyre;
2. se ajo pranon vetëm disa nga këto dispozita;
3. se ajo nuk pranon dispozitat e paragrafit 2 të neni 37.

L I G J
Nr.8499, datë 10.6.1999

**PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË KËSHILLIT TË EUROPËS “PËR
TRANSFERIMIN E PERSONAVE TË DËNUAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e
Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet Konventa e Këshillit të Europës “Për transferimin e personave të dënuar” të datës 21.3.1983, me deklaratimet e bëra në këtë ligj.

Neni 2

Bazuar në nenin 3 pika 3, Shqipëria deklaron moszbatimin e procedurave të parashikuara në nenin 9 pika 1 shkronja “a” të kësaj Konvente.

Neni 3

Bazuar në nenin 3 pika 4 “shtetas”, për qëllim të kësaj Konvente, do të kuptohen edhe personat pa shtetësi që kanë banim të përhershëm në Shqipëri, si dhe ata që mbajnë dy shtetësi, kur njëra është shqiptare.

Neni 4

Lidhur me nenin 17 pika 3, Republika e Shqipërisë deklaron se i pranon kërkesat për transferimin e personave të dënuar dhe të dokumenteve shoqëruese, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me një kopje të përkthimit në gjuhën shqipe ose në njërën nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Europës.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2402, datë 29.6.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

KONVENTA

PËR TRANSFERIMIN E PERSONAVE TË DËNUAR

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe shtetet e tjera nënshkruese,
Duke parë se qëllimi i Këshillit të Europës është arritja e një uniteti më të madh ndërmjet anëtarëve të tij;

Duke dashur të zhvillojë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e së drejtës penale;
Duke parë se një bashkëpunim i tillë duhet t'i çojë më tej qëllimet e drejtësisë dhe rehabilitimin shoqëror të personave të dënuar;

Duke parë se këto objektiva kërkojnë që të huajve, të cilëve u është hequr liria si rezultat e kryerjes prej tyre të një vepre penale, duhet t'u jepet mundësia të vuajnë dënimin në shoqërinë e tyre; dhe

Duke parë se ky qëllim mund të arrihet më mirë duke i transferuar ata në vendet e tyre,
Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj konvente:

- a. “dënim” do të thotë çdo dënim apo masë që ka të bëjë me heqjen e lirisë, të vendosur nga një gjykatë për një periudhë kohe të caktuar ose të përcaktuar si rezultat i një vepre penale;
- b. “vendim” është çdo vendim ose urdhër i gjykatës që vendos një dënim;
- c. “shteti dënues” është shteti në të cilin është dhënë dënimi për personin, i cili mund ose është transferuar;
- d. “shteti zbatues” është shteti në të cilin personi i dënuar mund ose është transferuar për të vuajtur dënimin e tij.

Neni 2

Parime të përgjithshme

1. Palët angazhohen t'i ofrojnë njëra-tjetrës masën më të gjerë të bashkëpunimit në lidhje me transferimin e personave të dënuar në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente.
2. Një person i dënuar në territorin e një pale mund të transferohet në territorin e një pale tjetër, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, për të vuajtur dënimin që i është dhënë. Për këtë qëllim ai mund të shprehë interesin e vet tek shteti dënues ose tek shteti zbatues për transferimin e tij në përputhje me këtë Konventë.
3. Transferimi mund të kërkohej nga shteti dënues ose nga shteti zbatues.

Neni 3

Kushte për transferim

1. Në përputhje me këtë Konventë një person i dënuar mund të transferohet vetëm në kushtet e mëposhtme:

- a. nëse ai person është shtetas i shtetit zbatues;
- b. nëse vendimi është i formës së prerë;
- c. nëse në kohën e marrjes së kërkesës për transferim, personi i dënuar ka ende të paktën gjashtë muaj të dënimit për të vuajtur apo nëse dënimi është i papërcaktuar;
- d. nëse për transferimin është dhënë pëlqimi nga personi i dënuar ose kur, duke marrë parasysh moshën ose gjendjen e tij fizike ose mendore dhe, kur njëri prej të dy shteteve e konsideron atë si të nevojshme, nëpërmjet përfaqësuesit ligjor të personit të dënuar;
- e. nëse veprimet apo mosveprimet, në bazë të të cilave është dhënë dënimi, përbëjnë një vepër penale në përputhje me të drejtën e shtetit zbatues ose do të përbënte një vepër penale nëse do të ishte kryer në territorin e tij; dhe
- f. nëse shteti dënues dhe ai zbatues janë dakord me transferimin.

2. Në raste të veçanta, palët mund të bien dakord me një transferim edhe nëse koha që duhet të vuhet nga personi i dënuar është më e shkurtër se ajo e përcaktuar në paragrafin 1.c.

3. Në kohën e nënshkrimit apo të depozitimit të dokumentit të ratifikimit, pranimit, miratimit ose anëtarësimit, çdo shtet mund të bëjë të ditur se ai do të përjashtojë zbatimin e njëres prej procedurave të parashikuara në nenin 9.1.a dhe b. në marrëdhëniet e tij me palët e tjera, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

4. Në çdo kohë çdo shtet mund të përcaktojë, për aq sa ai është i interesuar, termin “shtetas” për qëllimet e kësaj Konvente me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 4

Detyrimi për të dhënë informacion

1. Çdo person i dënuar për të cilin mund të zbatohet kjo Konventë informohet nga shteti dënues mbi lëndën e kësaj Konvente.
2. Nëse personi i dënuar i ka shprehur interes shtetit dënues për t’u transferuar në përputhje me këtë Konventë, ai shtet njofton shtetin zbatues sa më shpejt që të jetë e mundur mbasi vendimi të ketë marrë formë të prerë.
 1. Informacioni përmbledh:
 - a. emrin, datën dhe vendin e lindjes së personit të dënuar;
 - b. nëse ka, adresën në shtetin zbatues;
 - c. përshkrimin e fakteve mbi të cilat është bazuar dënimi;
 - d. natyrën, kohëzgjatjen dhe qëllimin e dënimit.
4. Nëse personi i dënuar i ka shprehur interesin e vet shtetit zbatues, shteti dënues me kërkesë i komunikon atij shteti informacionin e përmendur në paragrafin 3 të mësipërm.
5. Personi i dënuar informohet me shkrim për çdo veprim të ndërmarrë nga shteti dënues ose ai zbatues në përputhje me paragrafin e mësipërm, si edhe për çdo vendim nga çdo shtet mbi kërkesën për transferim.

Neni 5
Kërkesat dhe përgjigjet

1. Kërkesat për transferim dhe përgjigjet bëhen me shkrim.
2. Kërkesat bëhen nga Ministria e Drejtësisë e shtetit kërkues drejtuar Ministrisë së Drejtësisë të shtetit të adresuar. Përgjigjet komunikohen nëpërmjet të njëjtit kanal.
3. Secila palë mund të tregojë që ajo do të përdorë kanale të tjera komunikimi me anë të një deklaratë, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.
4. Shteti i adresuar njofton menjëherë shtetin kërkues për vendimin e tij nëse ai është dakord ose jo me transferimin e kërkuar.

Neni 6
Dokumentet shtesë

1. Shteti administrues i paraqet shtetit dënues, nëse kërkohen prej tij:
 - a. një dokument apo deklaratë që tregon se personi i dënuar është shtetas i atij shteti;
 - b. një kopje e ligjit përkatës të shtetit administrues, i cili parashikon që kryerja apo moskryerja e një veprimi për të cilin është dhënë dënimi në shtetin dënues përbën një vepër penale në pajtim me ligjin e shtetit administrues apo do të përbënte një vepër penale nëse do të ishte kryer në trritorin e tij;
 - c. një deklaratë që të përmbajë informacionin e përmendur në nenin 9.2.
2. Nëse bëhet kërkesë për një transferim, shteti dënues i paraqet dokumentet e mëposhtme shtetit zbatues, nëse njëri prej shteteve ka bërë të ditur se ai nuk është dakord me transferimin:
 - a. një kopje të vërtetuar të vendimit dhe ligjit mbi të cilin ai është bazuar;
 - b. një deklaratë ku të tregohet se ç'pjesë e dënimit është vuajtur, duke përfshirë informacion për ndalimet paragjyqsore, shkurtimet e dënimeve, si edhe për çdo faktor tjetër që ka të bëjë me ekzekutimin e dënimit;
 - c. një deklaratë ku të shprehet pëlqimi për transferimin e përmendur në nenin 3.1.d dhe
 - d. kur është e nevojshme, ndonjë raport mjekësor apo shoqëror për personin e dënuar, informacione për trajtimin e tij në shtetin dënues dhe ndonjë rekomandim për trajtimin e tij të mëtejshëm në shtetin zbatues.
3. Secili shtet mund të kërkojë të pajiset me çfarëdolloj dokumenti ose deklaratë të përmendura në paragrafin 1 ose 2 të mësipërm para se të bëjë kërkesën për transferimin ose para marrjes së vendimit për rënien dakord për transformimin e tij ose jo.

Neni 7
Pëlqimi dhe verifikimi

1. Shteti dënues sigurohet që personi i kërkuar për të dhënë pëlqimin për transferimin në përputhje me nenin 3.1.d e bën këtë me vullnetin e tij dhe me dije të plotë për pasojat e tij. Procedura për dhënien e këtij pëlqimi rregullohet nga ligji i shtetit dënues.
2. Shteti dënues i jep mundësi shtetit zbatues që të verifikojë nëpërmjet një konsulli ose një zyrtari tjetër, për të cilin është rënë dakord nga shteti zbatues, që pëlqimi është dhënë në përputhje me kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 të mësipërm.

Neni 8
Efektet e transferimit për shtetin dënues

1. Marrja në dorëzim i personit të dënuar nga autoritetet e shtetit zbatues sjell si rezultat pezullimin e ekzekutimit të dënimit në shtetin dënues.
2. Shteti dënues nuk mund të ekzekutojë më tej dënimin, nëse shteti zbatues e konsideron ekzekutimin e dënimit si të përfunduar.

Neni 9
Efektet e transferimit për shtetin zbatues

1. Organet kompetente të shtetit zbatues:
 - a. vazhdojnë ekzekutimin e dënimit menjëherë ose nëpërmjet një vendimi gjyqësor ose administrativ, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 10;
 - b. konvertojnë dënimin me anë të një procedure gjyqësore ose administrative në një vendim të atij shteti, duke zëvendësuar kështu sanksionin e dhënë nga shteti dënues me një sanksion të parashikuar nga ligji i shtetit zbatues për të njëjtën veprë penale, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 11.
2. Nëse bëhet kërkesë, shteti zbatues informon shtetin dënues para transferimit të personit të dënuar, për sa i përket procedurës që do të ndiqet.
3. Ekzekutimi i dënimit rregullohet nga ligji i shtetit zbatues dhe vetëm ai shtet është kompetent për të marrë të gjitha vendimet përkatëse.
4. Secili shtet që në përputhje me ligjin e vet kombëtar nuk mund të zbatojë ndonjë nga procedurat e përmendura në pikën 1, për të ekzekutuar masat e dhëna në territorin e një pale tjetër mbi personat të cilët për shkaqe të gjendjes së tyre mendore nuk mund të dënohen për kryerjen e veprës dhe që është i përgatitur për të pritur persona të tjerë për trajtim të mëtejshëm, mund të tregojë procedurat që ai do të ndjekë në raste të tilla, me anë të një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 10
Vazhdimi i ekzekutimit

1. Në rastin e vazhdimit të ekzekutimit, shteti zbatues është i detyruar t'i përmbahet natyrës ligjore dhe kohëzgjatjes së dënimit, siç është përcaktuar në shtetin dënues.
2. Nëse ky dënim nga natyra ose kohëzgjatja nuk përputhet me ligjin e shtetit zbatues ose kur kjo parashikohet nga ligji i tij, ai shtet, me anë të një urdhri gjyqësor ose administrativ, mund të adoptojë sanksionin me dënimin ose masën e parashikuar nga ligji i vet për veprën penale. Për sa i përket natyrës së tij, dënimi ose masa, nëse është e mundur, duhet të korrespondojë me atë të dhënë nga dënimi për t'u ekzekutuar. Për nga natyra ose kohëzgjatja, ai nuk duhet të rëndojë sanksionin e dhënë nga shteti dënues dhe nuk duhet të kalojë maksimumin e parashikuar nga shteti zbatues.

Neni 11
Konvertimi i dënimit

1. Në rastin e konvertimit të dënimit zbatohen procedurat e parashikuara nga ligji i shtetit zbatues. Kur bëhet konvertimi i dënimit, organi kompetent:

- a. duhet t'u përmbahet konstatimeve për faktet kur ato shfaqen shprehimisht ose nënkuptohen nga vendimi i dhënë nga shteti dënues;
- b. nuk mund të konvertojë një dënim me burgim në një dënim me gjobë;
- c. shkurton periudhën e plotë të heqjes së lirisë që vuhet nga personi i dënuar; dhe
- d. nuk e rëndon dënimin e personit të dënuar dhe nuk është i detyruar t'i përmbahet ndonjë minimumi që mund të parashikojë ligji i vendit zbatues për veprën ose veprat e kryera.

2. Nëse procedura e konvertimit kryhet pas transferimit të personit të dënuar, shteti zbatues e mban atë person në izolim ose siguron në ndonjë mënyrë tjetër praninë e tij në shtetin zbatues, derisa të dalë rezultati i procedurës.

Neni 12
Falja, amnistia, zëvendësimi

Secila palë mund të japë fjalë, amnisti ose zëvendësim të dënimit në përputhje me Kushtetutën ose ligjet e tjera.

Neni 13
Rishikimi i vendimit

Vetëm shteti dënues ka të drejtën për të vendosur mbi çdo kërkesë për rishikimin e vendimit.

Neni 14
Përfundimi i ekzekutimit

Shteti zbatues përfundon ekzekutimin e dënimit menjëherë sapo të informohet nga shteti dënues për çdo vendim ose masë si rezultat i të cilit dënimi duhet të përfundojë.

Neni 15
Informacioni për ekzekutimin

Shteti zbatues i jep informacion shtetit dënues në lidhje me ekzekutimin e dënimit:

- a. kur ai e konsideron ekzekutimin e dënimit të përfunduar;
- b. nëse personi i dënuar është arratisur nga izolimi para se të përfundojë ekzekutimin e dënimit; ose
- c. kur shteti dënues kërkon një raport të veçantë.

Neni 16 Tranziti

1. Secila palë në përputhje me ligjin e vet e plotëson kërkesën për kalimin tranzit të një personi të dënuar përmes territorit të tij, nëse një kërkesë e tillë bëhet nga një palë tjetër ose kur ai shtet ka rënë dakord me një palë tjetër ose me një shtet të tretë për transferimin e atij personi.
2. Një palë mund të mos pranojë të lejojë tranzitin:
 - a. nëse personi i dënuar është shtetas i tij, ose
 - b. nëse vepra penale për të cilën është dhënë dënimi nuk përbën vepër penale në përputhje me ligjin e vet.
3. Kërkesat për tranzit dhe përgjigjet komunikohen nëpërmjet kanaleve të përmendura në dispozitat e nenit 5.2 dhe 3.
4. Një palë mund të plotësojë një kërkesë të bërë nga një shtet i tretë për tranzitin përmes territorit të tij të një personi të dënuar, nëse ai shtet ka rënë dakord me një palë tjetër për transferimin nga ose në territorin e vet.
5. Pala, së cilës i është kërkuar të lejojë kalimin tranzit, mund të mbajë personin e dënuar në izolim, vetëm për atë kohë për të cilën kërkohet për të realizuar kalimin tranzit në territorin e tij.
6. Palës, së cilës i kërkohet të lejojë tranzitin, mund t'i kërkohet të japë garanci se personi i dënuar nuk do të persekutohet ose, nëse nuk është parashikuar ndryshe në paragrafin e mësipërm, që nuk do të ndalohet apo do të burgoset në ndonjë mënyrë tjetër në territorin e shtetit tranzit për ndonjë vepër penale të kryer apo dënim të dhënë para largimit nga territori i shtetit dënues.
7. Nuk nevojitet kërkesë për tranzit, nëse transporti bëhet me rrugë ajrore mbi territorin e palës dhe nuk është parashikuar ndonjë ndalim atje. Megjithatë çdo shtet mund të kërkojë me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, miratimit ose anëtarësimit, që ai të njoftohet për çdo tranzit të tillë mbi territorin e vet.

Neni 17 Gjuha dhe shpenzimet

1. Informacioni në përputhje me nenin 4 paragrafi 2-4 jepet në gjuhën e palës së cilës i adresohet ose në njërën nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Europës.
2. Me kufizimet e pikës 3 të mëposhtme nuk nevojitet përkthim për kërkesat e transferimeve ose të dokumenteve shtesë.
3. Secili shtet mund të kërkojë që kërkesat për transferim ose dokumentet shtesë të shoqërohen me një përkthim në gjuhët ose në njërën nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Europës ose në njërën nga gjuhët që ai bën të ditur me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës në momentin e nënshkrimit ose kur të depozitohet instrumentin e ratifikimit, pranimit, miratimit ose anëtarësimit. Në këtë rast ai mund të deklarojë gatishmërinë e vet për të pranuar përkthime në çdo gjuhë tjetër, përveç

gjuhës ose gjuhëve zyrtare të Këshillit të Europës.

4. Përveç kufizimit të parashikuar në nenin 6.2.a, dokumentet e transmetuara në zbatim të kësaj Konvente nuk nevojitet të vërtetohen.

5. Të gjitha shpenzimet e dala si rezultat i zbatimit të kësaj Konvente përballohen nga shteti zbatues, përveç shpenzimeve të dala ekskluzivisht në territorin e shtetit dënues.

Neni 18

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Konventa është e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe shtetet joanëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e saj. Ajo duhet të ratifikohet, pranohet ose miratohet. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit depozitohen tek Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

2. Kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës në të cilën tre shtete anëtare të Këshillit të Europës kanë shprehur pëlqimin e tyre për t'iu nënshkruar Konventës në pajtim me dispozitat e paragrafit 1.

3. Për shtetet nënshkruese që e shprehin pëlqimin e tyre për t'iu nënshtruar Konventës pas këtij afati, Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

Neni 19

Anëtarësimi nga shtetet joanëtare

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës, pasi të konsultohet me shtetet kontraktuese, mund të ftojë çdo shtet që nuk është anëtar i Këshillit dhe që nuk përmendet në nenin 18.1 të anëtarësohet në Konventë, me anë të një vendimi të marrë nga shumica e parashikuar nga neni 20.d të Statutit të Këshillit të Europës dhe me votim unanim të përfaqësuesve të shteteve kontraktuese që kanë të drejtë të marrin pjesë në Komitet.

2. Për çdo shtet që anëtarësohet, Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati prej tre muajsh pas datës së depozitimit të instrumentit të anëtarësimit te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 20

Zbatimi territorial

1. Secili shtet mund të përcaktojë territorin në të cilin zbatohet kjo Konventë në kohën e depozitimit, mirtimit ose anëtarësimit.

2. Me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës në një kohë të mëvonshme, secili shtet mund të zgjerojë zbatimin e kësaj Konvente në çdo territor tjetër të përcaktuar në deklaratë. Në lidhje me këtë territor, Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati prej tre muajsh pas datës së marrjes së një deklarate të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë në përputhje me dy paragrafët e mësipërm për territorin e specifikuar

në të, mund të tërhiqet me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Tërheqja hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati prej tre muajsh pas datës së marrjes së një njoftimi të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 21 **Zbatimi kohor**

Kjo Konventë është e zbatueshme për ekzekutimin e dënimeve të dhëna para ose pas hyrjes së saj në fuqi.

Neni 22 **Marrëdhëniet me Konventat dhe Marrëveshjet e tjera**

1. Kjo Konventë nuk prek të drejtat dhe detyrimet si rezultat i marrëveshjeve për ekstradimin dhe marrëveshjet e tjera mbi bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet penale që parashikojnë transferimin e personave të ndaluar për qëllime ballafaqimi ose deponimi.
2. Nëse dy ose më shumë palë kanë përfunduar një marrëveshje ose traktat për tansferimin e personave të dënuar, apo kanë vendosur në ndonjë mënyrë tjetër marrëdhëniet e tyre për këtë çështje, apo kur kanë ndërmend ta bëjnë këtë në të ardhmen, ata kanë të drejtë të zbatojnë atë marrëveshje ose traktat në vend të kësaj Konvente.
3. Kjo Konventë nuk prek të drejtat e shteteve palë në Konventën Europiane mbi vlefshmërinë ndërkombëtare të vendimeve penale, për të përfunduar marrëveshje bilaterale dhe multilaterale me njëri-tjetrin për çështjet që trajtohen në Konventë, për të plotësuar dispozitat e saj ose për të lehtësuar zbatimin e parimeve të shprehura në të.
4. Nëse një kërkesë për transferim futet në kuadrin e kësaj Konvente dhe të Konventës Europiane mbi Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Vendimeve Penale apo të ndonjë marrëveshjeje ose traktati tjetër për transferimin e personave të dënuar, shteti që bën kërkesën kur e bën atë, tregon se mbi bazën e cilit instrument ai e ka bërë.

Neni 23 **Zgjidhje miqësore**

Komiteti Europian për Problemet e Krimit të Këshillit të Europës mbahet i informuar në lidhje me zbatimin e kësaj Konvente dhe bën çfarëdo që të jetë e nevojshme për të lehtësuar një zgjidhje miqësore për çdo vështirësi që mund të lindë nga zbatimi i saj.

Neni 24 **Shfuqizimi**

1. Secila palë mund të shfuqizojë këtë Konventë në çdo kohë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.
2. Një shfuqizim i tillë hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati prej tre muajsh pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.
3. Siqoqoftë, kjo Konventë vazhdon të zbatohet për ekzekutimin e dënimeve të personave

që janë transferuar në përputhje me dispozitat e Konventës para datës në të cilën ka hyrë në fuqi shfuqizimi.

Neni 25
Njoftimet

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës njofton shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe shtetet joanëtare që kanë qenë pjesëmarrëse në hartimin e kësaj Konvente dhe çdo shtet që është anëtarësuar në këtë Konventë për:

- a. çdo nënshkrim;
- b. depozitimin e çdo instrumenti të ratifikimit, pranimit, miratimit dhe anëtarësimit;
- c. çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në përputhje me nenet 18.2 dhe 3, 19.2 dhe 20.2 dhe 3;
- d. çdo akt tjetër, deklaratë, njoftim ose komunikim që ka të bëjë me Konventën.

L I G J
Nr.8498, datë 10.6.1999

**PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË KËSHILLIT TË EUROPËS “PËR
NDIHMËN E NDËRSJELLË JURIDIKE NË FUSHËN PENALE” DHE
PROTOKOLLIN E SAJ SHITESË**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet Konventa e Këshillit të Europës “Për ndihmën e ndërsjellë juridike në fushën penale” të datës 20 prill 1957 dhe të protokollit të saj shtesë të datës 17 mars 1997 me rezervat dhe deklaratimet e parashikuara në këtë ligj.

Neni 2

Lidhur me Konventën, pala shqiptare shpreh këto rezerva:

1. Sekuestrimi, konfiskimi i sendeve dhe ekzekutimi i kërkesave të tilla do të bëhen vetëm në kushtet e parashikuara në nenin 5 pika 1 shkronja “a” dhe “c”.

Lidhur me Konventën, pala shqiptare deklaron se:

1. në zbatim të nenit 15 pika 6 duhet që një kopje e të gjitha kërkesave për ndihmë juridike, të komunikuar drejtpërdrejt ndërmjet autoriteteve gjyqësore, si dhe të akteve shoqëruese t’i dërgohen, në të njëjtën kohë, edhe Ministrisë së Drejtësisë;

2. lidhur me nenin 16 paragrafi 2, kërkesa dhe aktet, të cilat i bashkëlidhen asaj, duhet të shoqërohen me një përkthim në njërën nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Europës, në rastet kur për këtë nuk ka një marrëveshje të ndryshme reciprociteti;

3. autoritet gjyqësor, në kuptim të nenit 24 të kësaj Konvente, është Ministria e Drejtësisë.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2400, datë 29.6.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

KONVENTA EUROPIANE
E NDIHMËS JURIDIKE NË FUSHËN PENALE

HYRJE

Qeveritë që firmosin këtë Konventë, anëtarë të Këshillit të Europës;
Duke pasur në konsideratë që Këshilli i Europës ka për qëllim realizimin e një lidhjeje më të ngushtë ndërmjet anëtarëve të tij;
Të bindur se miratimi i dispozitave të përgjithshme në kuadrin e ndihmës juridike në fushën penale lejon arritjen e këtij qëllimi;
Duke patur në konsideratë që ndihma juridike është një fushë e lidhur me atë të ekstradimit, fushë e cila ka përbërë objektin e Konventës së datës 13 dhjetor 1957;
Kanë rënë dakord si më poshtë:

Titulli I – Dispozita Të Përgjithshme

Neni 1

1. Palët kontraktuese angazhohen të japin në mënyrë të ndërsjellë, sipas dispozitave të kësaj Konvente, një bashkëpunim sa më të gjërë gjyqësor në çdo rast procedimi që lidhet me krimet në të cilat shtrëngimi është, që nga momenti në të cilin është kërkuar ndihma, kompetencë e autoriteteve gjyqësore të palës kërkuese.
2. Kjo Konventë nuk zbatohet as gjatë ekzekutimit të masës së arrestit dhe të dënimeve dhe as për krimet ushtarake që nuk përbëjnë krime të së drejtës së përgjithshme.

Neni 2

Ndihma juridike mund të refuzohet :

- a) në qoftë se kërkesa i referohet krimeve që pala, së cilës i drejtohet kërkesa i konsideron ose krime politike ose krime që lidhen me krimet politike ose krimet fiskale;
- b) në qoftë se pala, së cilës i drejtohet kërkesa, mendon se ekzekutimi i kërkesës mund të sjellë paragjykim të sovranitetit, të sigurisë, të rendit publik ose të interesave esenciale të vendit të saj.

Titulli II – Letërporositë

Neni 3

1. Pala, së cilës i drejtohet kërkesa, do të ekzekutojë, sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni i vendit të saj, letërporositë që lidhen me një procedim penal që do t'i drejtohen asaj nga autoritetet gjyqësore të palës kërkuese dhe që kanë për objekt përmbushjen e akteve hetimore ose të kalimit të provave materiale që lidhen me veprën penale përkatëse, të fashikujve ose të dokumenteve.

2. Në qoftë se pala kërkuese dëshiron që dëshmitarët ose ekspertët të deponojnë pas një betimi paraprak, ajo duhet të bëjë një kërkesë me shkrim dhe, pala, së cilës i është drejtuar kërkesa, do të verifikojë nëse ligji i saj e lejon një gjë të tillë ose jo.

3. Pala, së cilësi drejtohet kërkesa, nuk mund të transferojë (ose do të kufizohet për të transferuar) kopje të thjeshta ose fotokopje të fashikujve ose të dokumenteve të kërkuara, të cilat janë të pajisura me vërtetim të barazvlefshëm me origjinalin. Megjithatë, në qoftë se pala kërkuese kërkon shprehimisht transferimin e dokumenteve origjinale, një kërkesë e tillë duhet, brenda kufijve të mundshëm, të pranohet.

Neni 4

Në qoftë se pala kërkuese e kërkon shprehimisht, pala, së cilës i drejtohet kërkesa, duhet të njoftojë për datën dhe vendin e ekzekutimit të letërporosisë. Autoritetet dhe personat në çështje mund të ndihmojë gjatë këtij ekzekutimi në qoftë se pala, së cilës i drejtohet kërkesa, do t'ua lejojë.

Neni 5

1. Secila nga palët kontraktuese mundet që, në momentin e firmosjes së kësaj Konvente ose të depozitimit të instrumenteve të ratifikimit ose të pranimi, me deklarin direkt Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të rezervojë mundësinë për të vënë ekzekutimin e letërporosive që kanë për qëllim kontrollimin e sendeve të njërës ose të më shumë kushteve të mëposhtme:

- a) Krimi, i cili motivon letërporosinë duhet të jetë i dënueshëm sipas ligjit të palës kërkuese dhe të palës e cila pranon kërkesën;
- b) krimi, i cili motivon letërporosinë duhet të jetë i tillë që të lejojë ekstradimin në vendin ku drejtohet kërkesa;
- c) ekzekutimi i letërporosive duhet të jetë në përputhje me ligjin e palës së cilës i drejtohet kërkesa.

2. Atëherë kur njëra nga palët kontraktuese ka bërë një deklaratë në kuptim të paragrafit të parë të këtij neni, çdo palë tjetër mund të aplikojë parimin e reciprocitetit.

Neni 6

1. Pala, së cilës i drejtohet kërkesa, mund të shtyjë pranimin e objekteve, fashikujve ose të akteve për të cilat është kërkuar komunikimi, kurdoherë që këta të jenë të nevojshëm për një procedim penal në proces.

2. Objektet, për më tepër edhe origjinalet e fashikujve dhe të dokumenteve, që janë dhënë gjatë komunikimit në ekzekutimin e një letërporosie, do të kthehen nga pala kërkuese menjëherë palës së cilës i drejtohet kërkesa, përveç se kur kjo e fundit do të heqë dorë.

Titulli III

Pranimi i akteve procedurale dhe të masave paraprake gjyqësore, dalja e dëshmitarëve, ekspertëve dhe personave që i nënshtrohen një procesi penal

Neni 7

1. Pala, së cilës i është drejtuar kërkesa, do të procedojë në pranimin e akteve procedurale dhe të masave paraprake gjyqësore, të cilat i janë dërguar për këtë qëllim nga pala kërkuese.

Një pranim i tillë do të realizohet nëpërmjet një transferimi të thjeshtë të aktit dhe të masës paraprake marrësit. Kurdoherë që Pala së cilës i drejtohet kërkesa shprehimisht do të kërkojë, pranimi do të realizohet në njërin nga format që legjislacioni i palës së cilës i drejtohet kërkesa, parashikon për notifikimet të së njëjtës natyrë ose në një formë të veçantë që të jetë në përputhje me legjislacionin përkatës.

2. Prova e pranimi do të bëhet nëpërmjet një dëftese në të cilën është vendosur data dhe është firmosur nga destinatori ose nëpërmjet një deklarate të palës së cilës i drejtohet kërkesa që përcakton faktin, mënyrat dhe datën e pranimi. Njëri ose tjetri nga këto dokumente do të jetë menjëherë i transferueshëm Palës kërkuese. Me kërkesë të kësaj të fundit, Pala së cilës i drejtohet kërkesa duhet të saktësojë nëse pranimi është bërë me ligjin e saj. Nëse pranimi nuk është bërë i mundur, pala, së cilës i është drejtuar kërkesa, duhet t'i bëjë menjëherë të ditur motivin e mospranimi palës kërkuese.

3. Secila nga palët kontraktuese mundet që, në momentin e firmosjes së kësaj Konvente ose të depozitimit të instrumenteve të ratifikimit ose të pranimi, të kërkojë, nëpërmjet një deklarate të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, që letërthirrja për t'u paraqitur në gjyq, personit që i është nënshtuar një procedimi penal dhe që gjendet në territorin e tij duhet t'i transferohet autoriteteve kompetente brenda një afati të caktuar përpara datës së caktuar për t'u paraqitur në gjyq. Ky afat do të jetë i përcaktuar në një deklaratë të caktuar dhe nuk mund t'i kapërcejë 50 ditët.

Për caktimin e një afati të tillë do të kihet parasysh data e paraqitjes në gjyq dhe momenti i transferimit të letërthirrjes.

Neni 8

Dëshmitari apo eksperti që nuk do të respektojë paraqitjen në gjyq sipas një letërthirrjeje, e cila i është dërguar, nuk mund të vihet nën ndonjë masë shtrënguese apo sanksione edhe në qoftë se letërthirrja përmban urdhrat, vetëm në qoftë se ai do të hyjë vullnetarisht në territorin e palës kërkuese dhe ai do të njoftohet sërish në mënyrë të rregullt.

Neni 9

Kompensimet (dëmshpërblimi) që do të derdhen, përveç shpenzimeve të udhëtimit dhe të qëndrimit që pala kërkuese duhet të rimburojë në favor të dëshmitarit apo të ekspertit, duhet të jenë të llogaritura nga vendi i rezidencës së tyre dhe do të likuidohen në një masë të njëjtë me atë të parashikuar nga tarifat dhe rregulloret në fuqi në vendin ku ata duhet të pyeten.

Neni 10

1. Në qoftë se pala kërkuese pretendon se paraqitja vetjake e një dëshmitari apo e një eksperti përpara autoriteteve të saj gjyqësore është veçanërisht e nevojshme, ajo duhet ta përmendi si fakt në kërkesën e pranimit të letërthirrjes dhe pala, së cilës i drejtohet kërkesa, do të ftojë këtë dëshmitar apo ekspert të paraqitet në gjyq.

Pala, së cilës i drejtohet kërkesa, duhet të bëjë të njohur përgjigjen e dëshmitarit apo të ekspertit palës kërkuese.

2. Në rastin e parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni kërkesa ose letërthirrja duhet të përmendi shprehimisht shumën e përafërt të kompensimit (dëmshpërblimit) që duhet të korrespondojë edhe me shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit, të cilat duhet të rimbursohen.

3. Pala, së cilës i është drejtuar kërkesa, me një qëllim të tillë mund t'i japë dëshmitarit apo ekspertit një paradhënie (parapagesë). Kjo do të bëhet e ditur në letërthirrjen dhe të rimbursohet nga pala kërkuese.

Neni 11

Atëherë kur pala kërkuese për të dëshmuar ose ballafaqim kërkon paraqitjen e një personi, i cili është në gjendje burgimi, ky person do të jetë përkohësisht i transferuar në territorin ku do të zhvillohet pyetja, me kusht që ritransferimi i tij duhet të bëhet në afatin e treguar nga pala së cilës i drejtohet kërkesa dhe me rezervën e dispozitave të nenit 12, në atë masë që këto të fundit do të gjejnë zbatim.

Transferimi mund edhe të refuzohet:

a) në qoftë se personi i dënuar nuk do të pranojë;

b) në qoftë se prania e tij është e nevojshme në një procedim penal që po zhvillohet në territorin e palës, së cilës i drejtohet kërkesa;

c) në qoftë se transferimi i tij do të zgjaste më tej gjendjen e tij të burgimit;

d) në qoftë se kërkesa të tjera imperative bëjnë të domosdoshme transferimin e tij në territorin e palës kërkuese.

2. Në rastin e parashikuar në paragrafin e mësipërm dhe me rezervën e dispozitave të nenit 2, kalimi tranzit i personit të dënuar nëpërmjet territorit të një shteti të tretë, pala e kësaj Konvente, dhe bazuar mbi një kërkesë, që korredon të gjitha dokumentet e nevojshme, Ministria e Drejtësisë e palës kërkuese i drejton Ministrisë së Drejtësisë së palës së cilës i drejtohet kërkesa për kalim tranziti.

Secila palë kontraktuese mund të refuzojë kalimin tranzit të shtetasve të vet.

3. Personi i transferuar duhet të qëndrojë në gjendje burgimi në territorin e palës kërkuese dhe, në rast se në territorin e palës së cilës i drejtohet kërkesa e tranzitit, vetëm në qoftë se pala së cilës i drejtohet kërkesa, nuk kërkon që ai të vihet në gjendje lirie.

Neni 12

1. Asnjë dëshmitar apo ekspert, pavarësisht nga kombësia e tij, i cili shfaqet përpara autoriteteve gjyqësore të palës kërkuese, si rrjedhojë e një letërthirrjeje për t'u paraqitur

në gjyq, nuk mund të ndiqet penalisht, të mbahet në gjendje arresti ose t'i nënshtrohet ndonjë mase tjetër shtrënguese për lirinë e tij individuale brenda territorit të palës së cilës i është drejtuar kërkesa, për fakte apo dënime që janë kryer përpara nisjes së tij nga territori i kësaj pale.

2. Asnjë person pavarësisht nga kombësia e tij, i thirrur përpara autoriteteve gjyqësore të palës kërkuese për t'u përgjigjur atje, për fakte për të cilat i është nënshtuar një procedimi penal, mund të ndiqet penalisht, të mbahet në gjendje burgimi ose t'i nënshtrohet masave të tjera shtrënguese të lirisë individuale për fakte dhe dënime që janë kryer përpara nisjes së tij nga territori i palës së cilës i është drejtuar kërkesa dhe që nuk përfshihen në letërthirrje.

3. Imuniteti i parashikuar nga ky nen pushon së funksionuari atëherë kur dëshmitari, eksperti apo individ i cili i është nënshtuar një procedimi penal, duke patur mundësinë e lënies së territorit të palës kërkuese për 15 ditë pasuese pasi paraqitja e tij nuk është më e kërkuar nga autoritetet gjyqësore, edhe në qoftë se ka ngelur në këtë territor ose ka bërë kthimin pasi është lëshuar.

Titulli IV – Kartoteka e gjykatës (zyra e gjendjes gjyqësore)

Neni 13

1. Pala, së cilës i drejtohet kërkesa, do të komunikojë në atë masë në të cilën autoritetet e tyre gjyqësore mundet që nga ana e tyre të mbajnë edhe në një rast tjetër analog, të dhënat e kartotekës së gjykatës ose çfarëdolloj informacioni tjetër që lidhet me ato dhe që autoritetet gjyqësore të njerës nga palët kontraktuese do të kenë kërkuar për nevojat e një procedimi penal.

2. Në raste të ndryshme nga ata të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni do të kihet parasysh kërkesa të tilla në kushtet e parashikuara nga legjislacioni, regulamentet ose nga praktika e palës, së cilës i drejtohet kërkesa.

Titulli V – Procedura

Neni 14

1. Kërkesat e ndihmës gjyqësore duhet të përmbajnë treguesit e mëposhtëm:

- a) autoritetin nga i cili ka ardhur kërkesa,
- b) objektin dhe motivin e kërkesës,
- c) për sa është e mundur, identitetin dhe kombësinë e personit në çështje dhe
- d) në qoftë se është e mundur emrin dhe adresën e marrësit (destinatorit).

2. Letërporositë e parashikuara në nenet 3, 4 dhe 5 do të përmendin gjithashtu, përveç akuzës edhe një paraqitje të përmbledhur të fakteve.

Neni 15

1. Letërporositë, për të cilat nenet 3, 4 dhe 5, si edhe kërkesat e parashikuara në nenin 11, do të drejtohen nga Ministria e Drejtësisë e palës kërkuese tek Ministria e Drejtësisë e Palës, së cilës i është drejtuar kërkesa dhe do të kthehet nëpërmjet të njëjtës rrugë.
2. Në rast urgjence, këto letërporosi mund të dërgohen edhe drejtpërsëdrejti nga autoritetet gjyqësore të palës kërkuese, autoriteteve gjyqësore të palës së cilës i drejtohet kërkesa. Ato duhet të kthehen së bashku me dokumentat që lidhen me ekzekutimin e tyre sipas mënyrës së parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni.
3. Kërkesat, për të cilat paragrafi i parë i nenit 13, mund të dërgohen drejtëpërdrejtë nga autoritetet gjyqësore në zyrën kompetente të palës së cilës i drejtohet kërkesa dhe përgjigjet do të dërgohen nëpërmjet kësaj zyre. Kërkesat, për të cilat paragrafi i dytë i nenit 13, do të dërgohen nga Ministria e Drejtësisë Palës kërkuese Ministrisë së Drejtësisë të palës së cilës i drejtohet kërkesa.
4. Kërkesat për ndihmë juridike, të ndryshme nga ato të parashikuara nga paragrafi i tretë i këtij neni, ose në veçanti kërkesat për hetime paraprake për një proces penal, mund të jenë objekt komunikimi të drejtëpërdrejtë nga autoritetet gjyqësore.
5. Në rastet kur transferimi direkt është i lejueshëm nga kjo Konventë, ajo mund të bëhet nëpërmjet Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (Interpol).
6. Secila palë kontraktuese mundet që, në aktin e firmosjes së kësaj konvente ose në rastin e depozitimit të instrumenteve të ratifikimit ose të pranimit, me deklaratën drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, bën të ditur nëse të gjitha ose disa kërkesa të ndihmës juridike duhet të jenë..... nëpërmjet një rruge të ndryshme nga ajo të parashikuar në këtë nen, dhe të kërkojë që, në bazë të paragrafit të dytë të këtij neni, një kopje të letërporosisë duhet t' komunikohet në të njëjtën kohë Ministrisë së saj të Drejtësisë.
7. Ky nen nuk paragjykon dispozitat lidhur me marrëveshjet (traktatet bilaterale) në fuqi ndërmjet palëve kontraktuese, në të cilat është parashikuar transferimi i drejtëpërdrejtë i kërkesave për ndihmë juridike ndërmjet autoriteteve të palëve.

Neni 16

1. Përkthimi i kërkesave dhe i akteve bashkangjitur me to nuk do të jetë i detyrueshëm, me përjashtim të rasteve të përmendura në dispozitat e paragrafit të dytë të këtij neni.
2. Secila nga palët kontraktuese mundet që, në aktin e firmosjes ose të depozitimit të instrumenteve të ratifikimit ose të pranimit, me deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, duke rezervuar mundësinë për të kërkuar që kërkesat dhe katet e tjera bashkëngjitur duhet të transferohen të shoqëruar nga ajo qoftë nga një përkthim në gjuhën e vet qoftë edhe nga një përkthim në cilëndo nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Europës (frenjisht, anglisht), ose në atë gjuhë që pala do të kërkojë. Palët e tjera mund të aplikojnë parimin e reciprocitetit.
3. Ky nen nuk do të paragjykojë dispozitat që lidhen me përkthimin e kërkesave dhe të akteve që u bashkëngjiten dhe që përmbahen në konventat ose në marrëveshjet në fuqi

ose që do të nënshkruhen ndërmjet dy ose më shumë palëve kontraktuese.

Neni 17

Aktet dhe dokumentet, që transferohen në zbatim të kësaj konvente, do të jenë të përjashtuara nga çdo formalitet legalizimi.

Neni 18

Në qoftë se autoritetet e investuara me një kërkesë për ndihmë juridike janë inkompetente për ta ndjekur, ata do të transferojnë zyrtarisht një kërkesë të tillë autoritetit kompetent të vendit përkatës dhe, atëherë kur kërkesa do të jetë transferuar drejtëpërsëdrejti, do të njoftojnë në të njëjtën rrugë (mënyrë) palën kërkuese.

Neni 19

Çdo refuzim për të dhënë ndihmë juridike duhet të jetë i motivuar.

Neni 20

Përveç dispozitave të nenit 9, ekzekutimi i kërkesave të ndihmës juridike nuk do të bëhet asnjë rimbursim i shpenzimeve me përjashtim të atyre të provokuara nga ekspertët në territorin nga ana e palës së cilës i drejtohet kërkesa dhe nga transferimi i të dënuarve i realizuar në zbatim të nenit 11.

Titulli VI – Denoncimet me qëllim procedimin penal

1. Çdo denoncim nga njëra nga palët kontraktuese e cila synon fillimin e një procedimi penal përpara autoriteteve gjyqësore të një pale tjetër, do të jetë objekt i komunikimeve ndërmjet Ministrive të Drejtësisë. Megjithatë palët kontraktuese mund të përfitojnë nga mundësia që i jepet nga paragrafi i 6 i nenit 15.
2. Pala, së cilës e drejtohet kërkesa, do të komunikojë përfundimin denoncimit dhe atëherë, kur duhet do të transferojë masën paraprake të marrë.
3. Denoncimeve të parashikuara nga paragrafi i parë i këtij neni do të zbatohen dispozitat e nenit 16.

Titulli VII – Shkëmbimi i informacionit lidhur me dënimet

Neni 22

Secila nga palët kontraktuese do të informojë palën e interesuar për vendimet penale dhe të masave përkatëse që i përkasin shtetasve të kësaj pale dhe që kanë qenë objekt për një regjistrim në zyrën e gjendjes gjyqësore. Ministrinë e Drejtësisë të palëve në fjalë do të

shkëmbejnë një informacion të tillë të paktën një herë në vit. Në qoftë se personi nën një çështje është konsideruar shtetas i dy ose më shumë palëve kontraktuese, informacionet do të komunikohen nga secila nga palët e interesuara vetëm nëse një person e tillë nuk do të posedojë kombësinë e palës në territorin e së cilës është dhënë dënimi.

Titulli VIII – Dispozita përfundimtare

Neni 23

1. Secila nga palët kontraktuese mundet që, në momentin e firmosjes së kësaj Konvente ose të depozitimit të instrumenteve të ratifikimit ose të pranimit, të hartojë një rezervim për një ose më shumë dispozita të përcaktuara në këtë Konventë.
2. Secila nga palët kontraktuese që do të ketë formuluar një rezervë do ta revokojë atë menjëherë sapo rrethanat do ta lejojnë atë. Revokimi i rezervave do të bëhet nëpërmjet njoftimit që i drejtohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.
3. Një palë kontraktuese që ka formuluar një rezervë për njërën nga dispozitat e Konventës nuk mund të pretendojë që pala tjetër të aplikojë këtë dispozitë deri në atë masë, që ajo vetë e ka pranuar.

Neni 24

Secila nga palët kontraktuese, në momentin e firmosjes së kësaj konvente, ose të depozitimit të instrumenteve të ratifikimit ose të pranimit, me deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, duhet të tregojë se cilin autoritet ajo konsideron si autoritet gjyqësor për efekte të kësaj konvente.

Neni 25

1. Kjo Konventë do të zbatohet në territorin metropolitan të palëve kontraktuese.
2. Ajo do të aplikohet edhe në Francë, Algjeri përsa i takon territoreve përtej detit si edhe përsa i përket Italisë, territorit të Somalisë nën administrimin italian.
3. Republika Federale e Gjermanisë mund të zgjerojë zbatimin e kësaj Konvente në “Land” e Berlinit nëpërmjet deklaramit direkt tek Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.
4. Përsa i përket Mbretërisë së Vendeve të Ulta, kjo Konventë do të zbatohet në territorin europian të saj. Mbretëria mund ta shtrijë zbatimin e kësaj Konvente në Antillet e Hollandës, në Surinam dhe në Guinenë e Re Holandeze nëpërmjet një deklarate direkte Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.
5. Nëpërmjet një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve kontraktuese, fusha e zbatimit të kësaj konvente mund edhe të shtrihet, sipas kushteve që do të nënshkruhen në këtë marrëveshje, në territorin e njëres palë të ndryshëm nga ato që përmbahen në paragrafin 1,2,3, dhe 4 të këtij neni ku njëra nga palët garanton marrëdhëniet ndërkombëtare.

Neni 26

1. Përveç dispozitave të paragrafit 7 të nenit 15 dhe të paragrafit 3 të nenit 16, kjo Konventë abrogon, përsa i përket territoreve tek të cilat zbatohet, dispozitat që në traktatet, konventat dhe marrëveshjet dypalëshe rregullojnë ndërmjet dy palëve kontraktuese, ndihmën juridike në fushën penale.
2. Megjithatë kjo Konventë nuk do të paragjykojë detyrimet që përmbahen në ndonjë konventë tjetër ndërkombëtare të karakterit dypalëshe ose shumëpalëshe, në të cilat disa klauzola rregullojnë ose do të rregullojnë, në një fushë të përcaktuar, ndihmën juridike lidhur me çështje të caktuara.
3. Palët kontraktuese nuk mund të përfundojnë ndërmjet tyre marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe lidhur me ndihmën juridike përveçse për të kompletuar dispozitat e kësaj konvente ose për të lehtësuar zbatimin e parimeve që përmbahen në të.
4. Në qoftë se, ndërmjet dy ose më shumë palëve kontraktuese, ndihma juridike në fushën penale do të bëhet në bazë të një legjislacioni uniform ose të një regjimi të veçantë që parashikon zbatimin reciprok të masave të ndihmës juridike në territoret tyre përkatëse, këto palë do të kenë mundësinë e rregullimit të marrëdhënieve të tyre të shumta në një fushë të tillë duke u bazuar ekskluzivisht në sisteme të tilla sipas dispozitave të kësaj Konvente. Palët kontraktuese, që përjashtojnë ose do të përjashtojnë nga marrëdhëniet e tyre reciproke zbatimin e kësaj konvente, në përputhje me dispozitave të këtij paragrafi, duhet t'i bëjnë një njoftim Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 27

1. Kjo Konventë do të qëndrojë e hapur për t'u firmosur nga anëtarët e Këshillit të Europës. Ajo do të ratifikohet dhe instrumentet e ratifikimit do të jenë depozituar pranë Sekretarit
2. Konventa do të hyjë në fuqi 90 ditë pas datës së depozitimit të instrumentave të ratifikimit.
3. Përsa i përket çdo shteti firmues të kësaj konvente, që do të kenë ratifikuar kohët e fundit, ajo do të hyjë në fuqi 90 ditë pas depozitimit të instrumentave të saj të ratifikimit.

Neni 28

1. Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës mund të ftojë çdo shtet që nuk është anëtar i Këshillit të aderojë në këtë Konventë. Vendimi për një ftesë të tillë duhet të merret me një marrëveshje unanime të anëtarëve të Këshillit që kanë ratifikuar Konventën.
2. Pranimi do të bëhet nëpërmjet depozitimit, pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit, të një instrumenti pranimi, që do të ketë efekt 90 ditë pas depozitimit të tyre.

Neni 29

Secila nga palët kontraktuese mundet, përsa i takon, të denoncojë këtë konventë duke

iu drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Një denoncim i tillë do të fillojë të veprojë 6 muaj mbas datës së marrjes së njoftimit nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit.

Neni 30

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'i njoftojë Anëtarëve të Këshillit të Europës dhe qeverive të çdo shteti, që ka aderuar në këtë Konventë:

- a) emrat e firmuesve dhe depozitimin e çdo instrumenti të ratifikimit ose të pranimit;
- b) datën e hyrjes në fuqi;
- c) çdo njoftim të marrë në zbatim të dispozitave të paragrafit të parë të nenit 5, të paragrafit 3 të nenit 7, të paragrafit 6 të nenit 15, të paragrafit 2 të nenit 16, të nenit 24, të paragrafit të 3 dhe 4 të nenit 25 dhe të paragrafit 4 të nenit 26;
- d) çdo rezervim të formuluar në zbatim të dispozitave të paragrafit të parë të nenit 23;
- e) revokimin të bërë në zbatim të dispozitave të paragrafit të dytë të nenit 23, të çdo rezerve;
- f) çdo njoftim të denoncimit të marrë në zbatim të dispozitave të nenit 29 dhe datën në të cilën ajo do të veprojë.

Me besim të nënshkruarit kanë firmosur këtë Konventë.

E bërë në Strasburg, me 20 prill 1959, në gjuhën franceze dhe angleze, të dy tekstet kanë të njëjtën vlerë, në një ekzemplar të vetëm, që do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të transmetojë një kopje origjinale qeverive që kanë firmosur dhe kanë aderuar.

DEKLARIME DHE REZERVIME TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “KONVENTËN EUROPIANE TË NDIHMËS JURIDIKE NË FUSHËN PENALE”

REZERVIME

Neni 2

Republika e Shqipërisë do të refuzojë dhënien e ndihmës juridike në fushën penale:

- a) për vepra penale të cilat nuk parashikohen si të tilla nga legjislacioni penal shqiptar në fuqi;
- b) për ato vepra penale të cilat janë në proces hetimi në territorin e Republikës së Shqipërisë ose në një shtet tjetër.

DEKLARIME

Neni 3 paragrafi II

Sipas nenit 360 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë dëshmitari ka detyrimin dhe përgjegjësinë ligjore për të thënë të vërtetën me përjashtim të rasteve kur

dëshmitari është i mitur deri në 14 vjeç.

Sekretari i gjykatës lexon deklaratën e betimit të dëshmitarit “Betohem se do të them të vërtetën të gjithë të vërtetën dhe të mos them asgjë që nuk është e vërtetë”.

Pas kësaj dëshmitari deklaron “Betohem” dhe tregon gjeneralitetet e tij.

Mosrespektimi i paragrafeve 2 dhe 3 sjell pavlefshmërinë e veprimit të kryer.

Neni 8

Personi i thirrur në bazë të letërporosisë, kur paraqitet, nuk mund t’i nënshtrohet kufizimit të lirisë personale për fakte që kanë ndodhur para njoftimit për t’u paraqitur.

Paprekshmëria e parashikuar në paragrafin e mësipërm pushon kur dëshmitari, eksperti apo i pandehuri, duke patur mundësinë nuk është larguar nga territori i shtetit shqiptar, me kalimin e 15 ditëve nga momenti kur prania e tij nuk kërkohet më nga autoriteti gjyqësor ose kur, pasi është larguar është kthyer vullnetarisht.

Neni 9

Shpenzimet e bëra në territorin shqiptar mbulohen nga pala shqiptare, kur nuk ka marrëveshje tjetër.

Neni 11

Republika e Shqipërisë deklaron se ndihma e kërkuar në kuptim të nenit 11 të Konventës nuk mund të jepet.

Neni 16

Republika e Shqipërisë deklaron se do të kërkojë që dokumentet e dërguara për qëllim të kësaj konvente do të shoqërohen me një përkthim të tyre në njërën nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Europës.

Neni 24

Autoritet gjyqësorë, në kuptim të kësaj Konvente, janë Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë, gjykatat dhe prokuroritë.

PROTOKOLLI SHITESË I KONVENTËS EUROPIANE PËR NDIHMËN E NDËRSJELLTË JURIDIKE NË FUSHËN PENALE (ETS NR.99)

Strasburg, 17 mars 1978

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës, nënshkruese të këtij protokollit,

Duke dëshiruar lehtësimin e zbatimit të Konventës Europiane të Këshillit të europës, mbi ndihmën e Ndërsjelltë Juridike në Fushën Penale, e hapur për nënshkrim në Strasburg,

në 20 prill 1959 (e quajtur më poshtë “Konventa”), në fushën e krimeve fiskale;
Duke e konsideruar atë si një shtesë të konsiderueshme të Konventës në disa drejtime,
Ranë dakord si më poshtë:

Kapitulli I

Neni 1

Palët kontraktuese nuk do të ushtrojnë të drejtat e parashikuara në nenin 2.a të Konventës për të refuzuar asistencën vetëm se kërkesa lidhet me një krim i cili për palën e kërkuar konsiderohet një krim fiskal.

Neni 2

1. Në rastin kur një palë kontraktuese ka bërë ekzekutimin e letërporosisë për kërkimin ose konfiskimin e pronësisë me kushtin që krimi i cili motivon letërporosinë është i dënueshëm në bazë të të dy ligjeve, si të palës kërkuese ashtu edhe të palës së kërkuar, ky kusht përmbushet në lidhje me shkeljet fiskale nëse shkelja është e dënueshme në bazë të ligjit të palës kërkuese dhe përputhet me një shkelje të së njëjtës natyre në bazë të ligjit të palës së kërkuar.

2. Kërkesa nuk mund të refuzohet për shkak se ligji i palës së kërkuar nuk parashikon të njëjtën taksë apo tatim doganor ose nuk përmban një taksë, tarifë ose detyrim doganor dhe të njëjtin mënyrë konvertimi siç e parashikon ligji i palës kërkuese.

Kapitulli II

Neni 3

Konventa zbatohet edhe për:

a) Dorëzimin e dokumenteve në lidhje me ekzekutimin e një dënimi, marrjen e një gjobe ose pagesën e shpenzimeve të procesit gjyqësor.

b) Masat që rregullojnë pezullimin e shpalljes së një dënimi ose ekzekutimin e tij, lirimin me kusht, shtyrjen e fillimit të ekzekutimit të një dënimi ose ndërprerjen e një ekzekutimi të tillë.

Kapitulli III

Neni 4

Neni 22 i Konventës plotësohet me tekstin e mëposhtëm, teksti origjinal i nenit 22 të Konventës, bëhet paragrafi 1 dhe dispozitat e përmendura më poshtë bëhen paragrafi 2.

“2. Për më tepër, çdo palë kontraktuese, që ka dhënë informacionin e sipërpërmendur i komunikon palës së interesuar, mbi bazën e kërkesës së kësaj të fundit, për çdo rast të veçantë, një kopje të dënimeve dhe masave në fjalë, si edhe çdo informacion që ka të bëjë

me to, në mënyrë që t'i jepet mundësi asaj për të parë nëse këto bëjnë të domosdoshme marrjen e ndonjë mase në nivel kombëtar. Ky komunikim bëhet ndërmjet Ministrive përkatëse të Drejtësisë.

Kapitulli IV

Neni 5

1. Ky protokoll është i hapur për nënshkrim për shtetet anëtare të Këshillit të Europës që kanë nënshkruar Konventën. Ajo i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose të miratimit depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.
2. Protokollin do të hyjë në fuqi 90 ditë pas datës së depozitimit të tre instrumenteve të ratifikimit, pranimit ose të miratimit.
3. Në rastin e një shteti nënshkrues, i cili ratifikon pranon ose miraton më vonë, protokollin do të hyjë në fuqi 90 ditë mbas datës së depozitimit të instrumenteve të saj të ratifikimit, pranimit ose të miratimit.
4. Një shtet anëtar i Këshillit të Europës nuk mund të ratifikojë, të pranojë ose të miratojë këtë protokoll pa ratifikuar paraprakisht Konventën.

Neni 6

1. Çdo shtet që është pranuar në Konventë mund të pranohet edhe në këtë protokoll pas hyrjes në fuqi të këtij protokollin.
2. Një pranim i tillë do të ketë efekt me depozitimin pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës të një instrumenti pranimi, i cili do të ketë efekt 90 ditë pas datës së depozitimit të tij.

Neni 7

1. Çdo shtet mundet, në kohën e nënshkrimit ose kur depoziton instrumentet e tij të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të miratimit, të përcaktojë territorin ose territoret në të cilat ky protokoll do të zbatohet.
2. Çdo shtet mundet, në kohën e nënshkrimit ose kur depoziton instrumentet e tij të ratifikimit, pranimit të miratimit ose të miratimit, ose në çdo datë tjetër të mëvonshme, me anë të një deklarate të adresuar te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës, të shtrijë efektet e këtij protokollin mbi një ose disa territore të përcaktuara në deklaratë dhe për ato marrëdhënie ndërkombëtare për të cilat ai është përgjegjës, ose në ato për të cilat ai është autorizuar të ndërmarrë.
3. Çdo deklaratë e bërë lidhur me paragrafin e mësipërm mundet që, në çdo territor të përmendur në një deklaratë të tillë, të tërhiqet nëpërmjet një njoftimi të adresuar te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës. Një tërheqje e tillë fillon të ketë efekt 6 muaj pas datës së marrjes së njoftimit nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 8

1. Rezervimet e bëra nga ana e palëve kontraktuese lidhur me ndonjë dispozitë të Konventës do të jenë të zbatueshme edhe për këtë protokoll, përveç kur pala nuk deklaron ndryshe në kohën e nënshkrimit ose kur depoziton instrumentet e saj të ratifikimit, miratimit ose të miratimit. E njëjta gjë do të zbatohet edhe për deklaratat e bëra në bazë të nenit 24 të Konventës.
2. Çdo shtet mundet, që në kohën e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumenteve të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose të miratimit, të deklarojë se rezervon të drejtën:
 - a) të mos pranojë Kapitullin I, ose ta pranojë atë vetëm lidhur me disa krime të caktuara, ose kategori krimesh të referuara në nenin 1 ose që nuk përputhen me letërporositë për kërkim ose konfiskim të pasurisë në lidhje me krimet fiskale;
 - b) të mos pranojë Kapitullin II;
 - c) të mos pranojë Kapitullin III.
3. Çdo palë kontraktuese mund të tërheqë deklaratën e bërë në përputhje me paragrafin e mësipërm me anë të një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, e cila do të jetë efektive nga data e marrjes së njoftimit.
4. Një palë kontraktuese që ka bërë një rezervim ndaj këtij protokollit në lidhje me një parashikim të Konventës ose që ka bërë një rezervim në lidhje me një parashikim të protokollit, nuk mund të kërkojë zbatimin e këtij parashikimi nga një palë tjetër, megjithatë mundet që n.q.s. rezervimi është i pjesshëm ose i kushtëzuar, mund të kërkojë zbatimin e këtij parashikimi për aq sa e ka pranuar vetë ai.
5. Asnjë rezervim tjetër nuk mund të bëhet lidhur me dispozitat e këtij protokollit.

Neni 9

Dispozitat e këtij protokollit nuk paragjykojnë rregullime të mëtejshme të tjera me marrëveshje dypalëshe dhe shumëpalëshe të lidhura ndërmjet palëve kontraktuese, në zbatim të nenit 26 paragrafi 3 të Konventës.

Neni 10

Komiteti European për Problemet e Krimit në Këshillin e Europës do të mbahet i informuar lidhur me zbatimin e këtij protokollit dhe do të bëjë të gjitha përpjekjet për të lehtësuar zbatimin.

Neni 11

1. Çdo palë kontraktuese, mundet përsa lidhet me të, të denoncojë këtë protokoll nëpërmjet një njoftimi të bërë te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.
2. Një denoncim i tillë do të ketë efekt 6 muaj pas datës së marrjes së njoftimit nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.
3. Denoncimi i Konventës passjell automatikisht edhe denoncimin e këtij Protokollit.

Neni 12

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës duhet të njoftojë shtetet anëtare të Këshillit të Europës, si dhe çdo shtet që e ka pranuar Konventën mbi:

- a. çdo nënshkrim të këtij protokoll;
- b. çdo depozitim të instrumenteve të ratifikimit, pranimit, miratimit ose të miratimit;
- c. çdo datë të hyrjes në fuqi të këtij Protokoll në përputhje me nenin 5 dhe 6;
- d. çdo deklaram të marrë lidhur me paragrafet 2 dhe 3 të nenit 7;
- e. çdo deklaram të marrë lidhur me paragrafin 1 të nenit 8
- f. çdo rezervim të bërë në lidhje mesa është parashikuar në paragrafin 2 të neni 8;
- g. tërheqja e çdo rezerve e bërë në përputhje mesa është parashikuar në paragrafin 3 të nenit 8;
- h. çdo njoftim të marrë në përputhje me nenin 11 dhe datën kur denoncimi fillon efektet e tij.

Palët e autorizuara me mirëbesim dhe mirëkuptim e kanë nënshkruar këtë protokoll. Bërë në Strasburg me 17 Mars 1978, në anglisht dhe frëngjisht, të dy tekstet me vlerë të njëjtë, dhe një kopje e të cilave depozitohet në arkivën e Këshillit të Europës. Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të dërgojë kopje të vërtetuara të secilës, shteteve nënshkruese dhe pranuese.

L I G J
Nr.9068, datë 15.5.2003

**PËR RATIFIKIMIN E “KONVENTËS EUROPIANE PËR VLEFSHMËRINË
NDËRKOMBËTARE TË GJYKIMEVE PENALE”**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Konventa europiane për vlefshmërinë ndërkombëtare të gjykrimeve penale”, me rezervat e parashikuara në këtë ligj.

Neni 2

Në përputhje me paragrafin e dytë të nenit 19 të Konventës, Republika e Shqipërisë rezervon të drejtën të kërkojë që kërkesat dhe dokumentet mbështetëse të tyre të shoqërohen me përkthimin e tyre në gjuhën shqipe.

Neni 3

Në përputhje me paragrafin e parë të nenit 61 të Konventës, Republika e Shqipërisë rezervon të drejtën për të refuzuar:

- a) ekzekutimin, nëse vlerëson se vendimi ka lidhje me një vepër penale, fiskale ose fetare (Lidhja I, shkronja “a”);
- b) ekzekutimin e një dënimi për një akt që, sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, është vetëm përgjegjësi e një autoriteti administrativ (Lidhja I, shkronja “b”);
- c) ekzekutimin e një gjykimi penal europian, të cilin autoritetet e shtetit kërkues e kanë dhënë në një datë kur, sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, procedimi penal i veprës penale të dënuar nga gjykimi duhet të ishte parashkruar (Lidhja I shkronja “c”);
- ç) zbatimin e parashikimeve të nenit 8 të Konventës, kur shteti shqiptar ka përgjegjësi origjinale dhe të njohë, në raste të tilla, vetëm njëvlefshmërinë e akteve që ndërpresin ose pezullojnë parashkrimin, të cilat janë kryer në shtetin kërkues (Lidhja I, shkronja “e”).

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3840, datë 17.6.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

**KONVENTA EUROPIANE
MBI VLEFSHMËRINË NDËRKOMBËTARE TË GJYKIMEVE PENALE
HAGË, MË 28.5.1970**

HYRJJE

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës, nënshkruese të kësaj Konvente:
duke marrë në konsideratë që lufta kundër kriminalitetit, e cila po kapërcen gjithmonë
e më tepër kufijtë administrativë të një shteti të vetëm, kërkon në planin ndërkombëtar
përdorimin e mënyrave moderne dhe efikase;
të bindur për nevojën e ndjekjes së një politike penale të përbashkët me qëllim mbrojtjen
e shoqërisë;
të ndërgjegjshëm për nevojën e respektimit të dinjitetit njerëzor dhe nxitjen e rehabilitimit
të autorëve të veprave penale;
duke pasur parasysh se qëllimi i Këshillit të Europës është realizimi i një bashkimi sa më
të ngushtë mes anëtarëve të tij,
kanë rënë dakord si vijon:

Kapitulli I - Përkufizime

Neni 1

Në kuptim të kësaj Konvente:

- a) “Vendim penal european” do të thotë çdo vendim përfundimtar i dhënë nga një gjykatë penale e një shteti palë si rezultat i procedimit penal.
- b) “Vepra penale” përshin, përveç veprave të dënueshme nga legjislacioni penal dhe ato të parashikuara në dispozitat ligjore të listuara në lidhjen II të kësaj Konvente, me kusht që në rastin kur këto dispozita i japin kompetencë një autoriteti administrativ, duhet të ekzistojë mundësia për personin e interesuar ta paraqesë çështjen para një gjykate.
- c) “Dënim” do të thotë vendosje e një sanksioni.
- d) “Sanksion” do të thotë çdo lloj dënimi ose masë tjetër e vendosur shprehimisht ndaj një personi për shkak të kryerjes së një veprë penale dhënë nga një gjykim penal european ose një ordonnance penale.
- e) “Humbje” do të thotë çdo humbje ose pezullim i një të drejte ose çdo ndalim ose humbje e zotësisë.
- f) “Gjykim i bërë në mungesë” do të thotë çdo vendim i konsideruar i tillë sipas nenit 21 paragrafi i dytë.
- g) “Ordonnance penale” do të thotë çdo vendim i dhënë në një shtet tjetër palë dhe i listuar në lidhjen II të kësaj Konvente.

Kapitulli II – Ekzekutimi i gjykimeve penale europiane

SEKSIONI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

A) Kushte të përgjithshme të ekzekutimit

Neni 2

Kjo pjesë zbatohet ndaj:

- a) sanksioneve që përfshijnë heqjen e lirisë;
- b) gjobave ose konfiskimeve;
- c) heqjes ose kufizimit të një ose disa të drejtave.

Neni 3

1. Një shtet palë do të jetë kompetent në rastet dhe sipas kushteve të parashikuara në këtë Konventë për ekzekutimin e sanksioneve të vendosura në një shtet tjetër palë, të cilat janë të ekzekutueshme në këtë të fundit.
2. Kjo kompetencë mund të ushtrohet vetëm pas paraqitjes së një kërkesë nga një shtet tjetër palë.

Neni 4

1. Sanksioni nuk do të ekzekutohet nga një shtet tjetër palë, përveçse kur sipas legjislacionit të tij veprimi, për të cilin është vendosur sanksioni do të përbënte vepër penale, nëse do të ishte kryer në territorin e tij dhe personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni do të ishte i dënueshëm atje.
2. Nëse vendimi trajton dy ose më shumë vepra penale dhe jo të gjitha përmbushin kërkesat e paragrafit të parë, shteti dënues do të specifikojë cilat pjesë të sanksionit zbatohen për veprat penale që përmbushin ato kërkesa.

Neni 5

Shteti dënues mund t'i kërkojë një shtet tjetër palë të ekzekutojë sanksionin vetëm nëse një ose më shumë nga kushtet vijuese janë përmbushur:

- a) nëse personi i dënuar ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm në shtetin tjetër;
- b) nëse ekzekutimi i sanksionit në shtetin tjetër duket se do të sjellë shtimin e mundësive për rehabilitimin social të personit të dënuar;
- c) nëse, në rastin e një sanksioni me heqje të lirisë, sanksioni mund të ekzekutohet duke ndjekur ekzekutimin e një sanksioni tjetër me heqje të lirisë që i dënuari vuan ose duhet të vuajë në këtë shtet;
- d) nëse shteti tjetër është shteti i origjinës së personit të dënuar dhe është deklaruar i gatshëm të marrë përsipër ekzekutimin e këtij sanksioni;

e) nëse konsideron se nuk është në gjendje ta ekzekutojë vetë sanksionin, edhe pse ka bërë kërkesë për ekstradim dhe shteti tjetër ka mundësi.

Neni 6

Ekzekutimi i kërkuar në përputhje me dispozitat e mësipërme nuk mund të refuzohet tërësisht ose pjesërisht, përveç rasteve kur:

- a) ekzekutimi do të ishte në kundërshtim me parimet themelore të rendit juridik të shtetit të kërkuar;
- b) shteti i kërkuar e konsideron veprën penale për të cilin është dhënë dënimi të karakterit politik ose tërësisht ushtarak;
- c) shteti i kërkuar konsideron se ka arsye serioze për të besuar se dënimi është provokuar ose rënduar për arsye race, besimi fetar, kombësie ose bindjeje politike;
- d) ekzekutimi është në kundërshtim me angazhimet ndërkombëtare të shtetit të kërkuar;
- e) vepra është objekt procedimi në shtetin e kërkuar ose kur ky i fundit vendos të fillojë procedimin lidhur me këtë vepër;
- f) autoritetet kompetente të shtetit të kërkuar vendosin të mos procedojnë ose të mbyllin procedimin për këtë vepër;
- g) vepra është kryer jashtë territorit të shtetit të kërkuar;
- h) shteti i kërkuar nuk është në gjendje të ekzekutojë sanksionin;
- i) kërkesa bazohet në nenin 5 shkronja “a” dhe asnjë nga kushtet e tjera të parashikuara në atë dispozitë nuk është përmbushur;
- j) shteti i kërkuar konsideron se shteti kërkuar është vetë në gjendje ta ekzekutojë sanksionin;
- k) mosha e personit të dënuar në kohën e kryerjes së veprës penale ishte e tillë që ai nuk mund të procedohej në shtetin e kërkuar;
- l) sanksioni është parashikuar tashmë sipas legjislacionit të shtetit të kërkuar;
- m) vendimi përcakton heqjen ose kufizimin e një ose më shumë të drejtave.

Neni 7

Kërkesa për ekzekutim nuk do të zbatohet nëse ekzekutimi bie ndesh me parimet e njohura nga dispozitat e seksionit të parë të kapitullit III të kësaj Konvente.

B) Pasojat e transferimit të ekzekutimit

Neni 8

Në funksion të nenit 6 paragrafi i parë dhe rezervën e përmendur në shkronjën “c” të lidhjes I të kësaj Konvente, çdo vepër që ndërpret ose pezullon parashkrimin e përmbushur vlefshmërisht nga autoritetet e shtetit dënues, do të konsiderohet në shtetin e kërkuar sikur të ketë prodhuar të njëjtin efekt për zbatimin e parashkrimit sipas legjislacionit të këtij shteti.

Neni 9

1. Një person i dënuar, i burgosur në shtetin kërkues, që i është dorëzuar shtetit të kërkuar për qëllim të ekzekutimit, nuk do të procedohet, gjykohet, dënohet për shkak të ekzekutimit të një dënimi ose mase sigurimi dhe as do t'i nënshtrohet ndonjë kufizimi tjetër të lirisë vetjake për një veprim të ndryshëm nga ai për të cilin është dhënë vendimi për t'u ekzekutuar, përveçse në rastet kur:

a) Shteti që e ka dorëzuar bie dakord. Për këtë gjë atij do t'i paraqitet një kërkesë, e shoqëruar me të gjitha dokumentet e nevojshme dhe një procesverbal gjyqësor që përmban të gjitha deklaratimet e bëra nga i dënuari. Pëlqimi do të jepet kur vepra penale për të cilën ai është kërkuar është gjithashtu subjekt ekstradimi sipas legjislacionit të shtetit kërkues të ekzekutimit ose kur ekstradimi mund të përjashtohet vetëm për arsye të masës së dënimit.

b) Personi i dënuar ka pasur mundësinë e largimit nga territori i shtetit ku është dorëzuar, por nuk e ka bërë këtë brenda 45 ditëve nga dorëzimi i tij përfundimtar ose nëse është kthyer në këtë territor, pasi është larguar prej tij.

2. Shteti i kërkuar për të ekzekutuar dënimin mundet sidoqoftë të marrë çdo masë të nevojshme për zhvendosjen e personit nga territori i tij ose çdo masë të nevojshme sipas legjislacionit të tij, përfshirë këtu procedimin në mungesë, me qëllim parandalimin e pasojave ligjore të parashkrimit.

Neni 10

1. Ekzekutimi do të rregullohet nga legjislacioni i shtetit të kërkuar dhe vetëm ky shtet do të jetë kompetent për marrjen e vendimeve të duhura që përfshijnë lirimin me kusht.

2. Vetëm shteti kërkues ka të drejtë të vendosë për çdo kërkesë për rishikim të dënimit.

3. Secili nga të dy shtetet mund të ushtrojë të drejtën e amnistisë ose të faljes.

Neni 11

1. Kur shteti dënues kërkon ekzekutimin, ai nuk mund të fillojë ekzekutimin e një sanksioni subjekt i kësaj kërkesë. Shteti dënues mundet sidoqoftë të fillojë ekzekutimin e një sanksioni me heqje të lirisë, kur personi i dënuar është tashmë i burgosur në territorin e atij shteti në momentin e paraqitjes së kërkesës.

2. Shteti kërkues rifiton të drejtën për ekzekutim kur:

a) Tërheq kërkesën e tij, para se shteti i kërkuar ta ketë informuar atë për ndonjë qëllim të tijin për të ndërmarrë veprime për trajtimin e kërkesës.

b) Shteti i kërkuar e informon për refuzimin e tij për të ndërmarrë veprime për trajtimin e kërkesës.

c) Shteti i kërkuar heq dorë në mënyrë të shprehur nga e drejta e tij për ekzekutim. Heqja dorë mund të jetë e vlefshme vetëm nëse të dy shtetet përkatëse bien dakord për këtë

ose nëse ekzekutimi nuk është më i mundur në shtetin e kërkuar. Në rastin e fundit heqja dorë është e detyrueshme, nëse shteti kërkuar ka bërë kërkesë për këtë.

Neni 12

1. Autoritetet kompetente të shtetit të kërkuar duhet t'i japin fund ekzekutimit menjëherë sapo marrin dijeni për çfarëdo falje, amnisti ose rekurs për rishikim ose çdo vendim tjetër që ka për pasojë pushimin e karakterit ekzekutiv të sanksionit. E njëjta gjë do të zbatohet për ekzekutimet e gjobave sa kohë që personi i dënuar i ka paguar gjobën autoriteteve kompetente të shtetit kërkuar.

2. Shteti kërkuar do të informojë pa vonesë shtetin e kërkuar për çdo vendim ose veprim procedural të ndërmarrë në territorin e tij që ka për pasojë parashkrimin e të drejtës për ekzekutim në përputhje me paragrafin e mësipërm.

C. Dispozita të ndryshme

Neni 13

1. Transitimi nëpërmjet territorit të një shteti palë të një personi të burgosur, i cili duhet të transferohet tek një shtet i tretë palë në zbatim të kësaj Konvente, do të akordohet me kërkesën e shtetit në të cilin personi ndodhet i burgosur. Shteti i transitit mund të kërkojë të marrë çdo dokument të nevojshëm para se të marrë vendim lidhur me kërkesën. Personi që transferohet do të qëndrojë në burg në territorin e shtetit të transitit, përveçse kur shteti nga i cili ai transferohet kërkon lirimin e tij.

2. Përveç rasteve kur transferimi kërkohet në përputhje me nenin 34, çdo shtet palë mund të refuzojë transitin:

a) për një nga motivet e përmendura në nenin 6, shkronja “b” dhe “c”;

b) nëse personi në fjalë është shtetas i tij.

3. Nëse përdoret transporti ajror, zbatohen dispozitat vijuese:

a) kur nuk parashikohet ulje e avionit, shteti nga i cili transferohet personi mund të njoftojë shtetin mbi territorin e të cilit do të fluturohet që personi në fjalë po transferohet në zbatim të kësaj Konvente. Në rastin e një uljeje të paparashikuar ky njoftim do të ketë vlerën e kërkesës për arrest të përkohshëm sikurse parashikohet në nenin 32 paragrafi i dytë dhe do të bëhet një kërkesë formale për transitim;

b) kur parashikohet ulje e avionit, do të bëhet një kërkesë formale për transitim.

Neni 14

Shtetet palë nuk kërkojnë nga njëri-tjetri shlyerjen e shpenzimeve që kryhen në zbatim të kësaj Konvente.

SEKSIONI 2 KËRKESA PËR EKZEKUTIM

Neni 15

1. Kërkesat e parashikuara në këtë Konventë do të bëhen me shkrim. Ato dhe të gjitha komunikimet e nevojshme për zbatimin e kësaj Konvente do t'i dërgohen Ministrisë së Drejtësisë së shtetit të kërkuar nga Ministria e Drejtësisë e shtetit kërkues ose, nëse shtetet palë bien dakord, direkt nga autoritetet e shtetit kërkues atyre të shtetit të kërkuar; përgjigjet ndjekin të njëjtën rrugë.
2. Në raste urgjente, kërkesat dhe komunikimet mund të dërgohen përmes Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (Interpol).
3. Çdo shtet palë, me anë të një deklaratë të dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund të njoftojë qëllimin e tij për t'iu shmangur rregullave të komunikimit të përcaktuara në paragrafin e parë të këtij neni.

Neni 16

Kërkesa për ekzekutim do të shoqërohet nga origjinali ose një kopje e vërtetuar e vendimit, ekzekutimi i të cilit kërkohet dhe të gjitha dokumentet e tjera të nevojshme. Origjinali ose një kopje e vërtetuar e të gjithë ose e një pjese të dosjes penale i komunikohet shtetit të kërkuar me kërkesë të këtij të fundit. Autoriteti kompetent i shtetit kërkues vërteton ekzekutimin e sanksionit.

Neni 17

Nëse shteti i kërkuar konsideron që informacioni i dhënë nga shteti kërkues nuk është i mjaftueshëm për t'i dhënë mundësinë atij të zbatojë këtë Konventë, ai kërkon informacion shtesë, duke fiksuar një afat për marrjen e këtij informacioni.

Neni 18

1. Autoritetet e shtetit të kërkuar informojnë pa vonesë ato të shtetit kërkues për veprimet e ndërmarra për trajtimin e kërkesës për ekzekutim.
2. Autoritetet e shtetit të kërkuar i transmetojnë atyre të shtetit kërkues, kur është rasti, një dokument që vërteton ekzekutimin e sanksionit.

Neni 19

1. Nën rezervën e paragrafit të dytë të këtij neni, nuk do të kërkohet asnjë përkthim i kërkesave ose i dokumenteve shtesë.
2. Çdo shtet palë mundet të rezervojë, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose aderimit, me anë të një deklaratë me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të drejtën e tij për të kërkuar që kërkesat dhe dokumentet mbështetëse të shoqërohen me përkthimin e tyre në gjuhën

e tij, në një nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Europës ose në një nga gjuhët që kërkon ai. Shtetet e tjera palë mund të kërkojnë reciprocitet.

3. Kjo dispozitë nuk cenon dispozitat që lidhen me përcaktimin e kërkesave dhe dokumenteve mbështetëse që mund të parashikohen në marrëveshje të tjera tashmë në fuqi ose që mund të lidhen në të ardhmen midis dy ose më shumë shteteve palë.

Neni 20

Materialet shkresore dhe dokumentet e transmetuara në zbatim të kësaj Konvente nuk është e nevojshme të legalizohen.

SEKSIONI 3 GJYKIMET NË MUNGESË DHE ORDONNANCE PENALE

Neni 21

1. Nën rezervën e parashikimeve të ndryshme të bëra në këtë Konventë, ekzekutimi i vendimeve të gjykimeve në mungesë dhe i ordonnance penale u nënshtrohen të njëjtave rregulla sikurse ekzekutimi i vendimeve të tjera gjyqësore.

2. Nën rezervën e parashikimeve të paragrafit të tretë, një vendim në mungesë sipas kësaj Konvente nënkupton çdo vendim të dhënë nga një gjykatë e një shteti palë pas procedimit penal, gjatë shqyrtimit të të cilit personi i dënuar nuk ka qenë personalisht i pranishëm.

3. Pa paragjykuar përmbajtjen e neneve 25 paragrafi i dytë, 26 paragrafi i dytë dhe 29, do të konsiderohet si vendim i marrë në prani të të akuzuarit:

a) çdo vendim i dhënë në mungesë dhe çdo ordonnance penale, që është konfirmuar ose dhënë në shtetin dënues pas kundërshtimit nga personi i dënuar;

b) çdo vendim i marrë në mungesë në apel, nëse apeli për vendimin e gjykatës së shkallës së parë është kërkuar nga personi i dënuar.

Neni 22

Çdo vendim në mungesë dhe çdo ordonnance penale, që nuk është kundërshtuar ose apeluar mund t'i transmetohet menjëherë shtetit të kërkuar me qëllim njoftimin dhe ekzekutimin e mundshëm të tyre.

Neni 23

1. Nëse shteti i kërkuar e konsideron të përshtatshme të ndërmarrë veprime mbi kërkesën për ekzekutimin e një vendimi në mungesë ose të një ordonnance penale, ai do t'ia njoftojë të dënuarit personalisht vendimin e marrë në shtetin kërkuar.

2. Në aktin e njoftimit dërguar të dënuarit do të jepet edhe informacioni se:

a) në përputhje me këtë Konventë është paraqitur një kërkesë për ekzekutim;

b) e vetmja rrugë ankimi e vlefshme është kundërshtimi i parashikuar në nenin 24;

c) kundërshtimi bëhet pranë autoritetit të përcaktuar, pranimi i kundërshtimit është objekt i kushteve të parashikuara në nenin 24 të kësaj Konvente, dhe se personi i dënuar mund

të kërkojë të dëgjohej nga autoritetet e shtetit dënues;
d) nëse nuk bëhet asnjë kundërshtim brenda afatit të përshkruar, vendimi do të konsiderohet i marrë në prani të të akuzuarit në përputhje me këtë Konventë.
3. Një kopje e njoftimit do t'i dërgohet menjëherë autoritetit që ka kërkuar ekzekutimin.

Neni 24

1. Pasi vendimi është njoftuar në përputhje me nenin 23, rruga e vetme e ankimit për të dënuarit është kundërshtimi. Ky kundërshtim do të shqyrtohet sipas zgjedhjes së të dënuarit ose nga gjykata kompetente në shtetin kërkues, ose nga ajo e shtetit të kërkuar. Nëse personi i dënuar nuk shpreh asnjë zgjedhje, kundërshtimi do të shqyrtohet nga gjykata kompetente në shtetin e kërkuar.
2. Në rastet e parashikuara në paragrafin e mësipërm, kundërshtimi do të pranohet nëse ai i është drejtuar autoritetit kompetent të shtetit të kërkuar brenda afatit 30 ditor duke filluar nga data në të cilën është bërë njoftimi. Ky afat do të llogaritet në përputhje me rregullat përkatëse të legjislacionit të shtetit të kërkuar. Autoriteti kompetent i këtij shteti do të njoftojë menjëherë autoritetin që ka bërë kërkesën për ekzekutim.

Neni 25

1. Nëse kundërshtimi shqyrtohet në shtetin kërkues, personi i dënuar duhet të paraqitet në këtë shtet në seancën e fiksuar për shqyrtimin e ri të çështjes. Paraqitja do t'i njoftohet atij personalisht të paktën 21 ditë para seancës. Kjo periudhë mund të shkurtrohet me pëlqimin e të dënuarit. Shqyrtimi i ri do të mbahet para gjykatës që është kompetente në shtetin kërkues dhe sipas procedurës së këtij shteti.
2. Nëse personi i dënuar nuk paraqitet personalisht ose nuk përfaqësohet në përputhje me legjislacionin e shtetit kërkues, gjykata e deklaron kundërshtimin të pakryer dhe vendimi i saj i komunikohet autoritetit kompetent të shtetit të kërkuar. E njëjta procedurë do të ndiqet dhe nëse gjykata e deklaron kundërshtimin të papranueshëm. Në të dyja rastet vendimi në mungesë ose masa penale do të konsiderohet, në përputhje me këtë Konventë, sikur të jetë marrë në praninë e të akuzuarit.
3. Nëse personi i dënuar paraqitet personalisht ose përfaqësohet në përputhje me legjislacionin e shtetit kërkues dhe nëse kundërshtimi deklarohet i pranueshëm, kërkesa për ekzekutim do të konsiderohet sikur të mos jetë bërë.

Neni 26

1. Nëse kundërshtimi shqyrtohet në shtetin e kërkuar, personi i dënuar duhet të paraqitet në atë shtet në seancën e fiksuar për shqyrtimin e ri të çështjes. Njoftimi për paraqitje do t'i bëhet atij personalisht jo më vonë se 21 ditë para seancës së re. Kjo periudhë mund të shkurtrohet me pëlqimin e personit të dënuar. Shqyrtimi i ri do të mbahet para gjykatës që është kompetente në shtetin e kërkuar dhe sipas procedurës së këtij shteti.
2. Nëse personi i dënuar nuk paraqitet personalisht ose nuk përfaqësohet në përputhje

me legjislacionin e shtetit të kërkuar, gjykata e deklaron kundërshtimin të pakryer dhe vendimi i saj i komunikohet autoritetit kompetent të shtetit të kërkuar. E njëjta procedurë do të ndiqet dhe nëse gjykata e deklaron kundërshtimin të papranueshëm. Në të dyja rastet vendimi në mungesë ose masa penale do të konsiderohet, në përputhje me këtë konventë, sikur të jetë marrë në praninë e të akuzuarit.

3. Nëse personi i dënuar paraqitet personalisht ose përfaqësohet në përputhje me legjislacionin e shtetit kërkues dhe nëse kundërshtimi deklarohet i pranueshëm, çështja do të gjykohet sikur të jetë kryer në këtë shtet. Sidoqoftë, çështja nuk mund të shqyrtohet nëse procedimi penal është parashkruar. Vendimi i marrë në shtetin kërkues do të konsiderohet sikur të mos jetë marrë.

4. Të gjitha veprimet lidhur me procedimet ose hetimet paraprake të ndërmarra në shtetin dënues, në përputhje me legjislacionin e tij që është në fuqi kanë të njëjtën vlerë në shtetin e kërkuar, sikur të jenë ndërmarrë nga autoritetet e atij shteti, por ky asimilim nuk i jep atyre fuqi provuese më të madhe, sesa ato kanë në shtetin kërkues.

Neni 27

Për ngritjen e kundërshtimit dhe procedurës që e shoqëron, i dënuari në mungesë ose për një masë penale ka të drejtë t'i vendoset kryesisht një mbrojtës në rastet dhe kushtet e parashikuara nga ligji i shtetit të kërkuar dhe, kur është e nevojshme, të shtetit kërkues.

Neni 28

Çdo vendim gjyqësor i dhënë në përputhje me nenin 26 paragrafi i tretë, si dhe ekzekutimi i tij rregullohet nga legjislacioni i shtetit të kërkuar.

Neni 29

Nëse një person i dënuar në mungesë ose për një masë penale nuk ngre kundërshtim, vendimi do të konsiderohet, në përputhje me këtë Konventë, sikur të jetë marrë në prani të të akuzuarit.

Neni 30

Legjislacionet kombëtare janë të zbatueshme në fushën e rikthimit tërësor, nëse personi i dënuar, për arsye të pavarura nga vullneti i tij, nuk respekton afatet e përcaktuara në nenet 24, 25 dhe 26 ose nuk paraqitet personalisht në seancën e fiksuar për shqyrtimin e ri të çështjes.

SEKSIONI 4 MASA TË PËRKOHSHME

Neni 31

Nëse personi i dënuar është i pranishëm në shtetin kërkues pas marrjes së njoftimit të pranimit të kërkesës së tij për ekzekutimin e një vendimi me heqje të lirisë, ky shtet mundet, nëse e sheh të nevojshme për të siguruar ekzekutimin, ta arrestojë atë me qëllim transferimin e tij sipas parashikimeve të nenit 43.

Neni 32

1. Kur shteti kërkues ka kërkuar ekzekutimin, shteti i kërkuar mund ta arrestojë personin e dënuar kur:
 - a) ligji i shtetit të kërkuar autorizon paraburgimin për këtë vepër penale;
 - b) ekziston rreziku i largimit ose, në rastin e një dënimi në mungesë, rreziku i dëmtimit të provave.
2. Kur shteti kërkues njofton qëllimin e tij për të kërkuar ekzekutimin, shteti i kërkuar mundet, në zbatim të kërkesës së shtetit kërkues, ta arrestojë personin e dënuar, me kusht që të plotësohen kushtet e përcaktuara në paragrafin e mësipërm, shkronjat (a) dhe (b). Kërkesa duhet të përmendë veprën penale që solli dënimin, kohën dhe vendin e kryerjes së saj, si edhe përshkrimin sa më të saktë të personit të dënuar. Ajo duhet të përmbajë gjithashtu një përshkrim të shkurtër të akteve në të cilat bazohet dënimi.

Neni 33

1. Personi i dënuar do të mbahet në burg në përputhje me legjislacionin e shtetit të kërkuar; ky legjislacion përcakton gjithashtu kushtet në të cilat ai mund të lirohet.
2. Personi i burgosur do të lirohet në të gjitha ato raste kur:
 - a) kohëzgjatja e burgimit arrin atë të sanksionit të dhënë me heqje lirie;
 - b) ai është arrestuar në zbatim të nenit 32 paragrafi i dytë dhe shteti i kërkuar nuk arriti të merrte brenda 18 ditëve nga data e arrestimit, kërkesën së bashku me dokumentet e specifikuar në nenin 16.

Neni 34

1. Një person i mbajtur në burg në shtetin e kërkuar, në përputhje me nenin 32, dhe që duhet të paraqitet para gjykatës kompetente të shtetit kërkues në përputhje me nenin 25, si pasojë e kundërshtimit që ai ka ngritur, do të transferohet për këtë qëllim në territorin e shtetit kërkues.
2. Pas transferimit, ky person nuk do të mbahet në burg nga shteti kërkues, nëse janë kushtet e përcaktuara në nenin 33 paragrafi i dytë ose nëse shteti kërkues nuk kërkon ekzekutimin e dënimit të ri. Personi do të kthehet menjëherë në shtetin e kërkuar, përsa kohë që ai nuk është liruar.

Neni 35

1. Një person i thirrur në një gjykatë kompetente të shtetit kërkues si rezultat i kundërshtimit që ai ka ngritur nuk do të procedohet, gjykohet dhe as do të dënohet, përse i përket ekzekutimit të një dënimi ose mase sigurie dhe as do t'i nënshtrohet ndonjë kufizimi tjetër të lirisë vetjake për një arsye çfarëdo që ka lindur para largimit të tij nga territori i shtetit të kërkuar dhe nuk është specifikuar në ftesën për paraqitje, përveçse kur ky person jep pëlqimin shprehimisht me shkrim. Në rastin e parashikuar në paragrafin e parë të nenit 34, një kopje e deklaratës së pëlqimit do t'i transmetohet shtetit prej nga është transferuar personi.
2. Pasojat e parashikuara në paragrafin e mësipërm pushojnë kur personi i ftuar, pasi ka pasur mundësinë që të veprojë, nuk është larguar nga territori e shtetit kërkues brenda 15 ditëve pas datës së dhënies së vendimit që pason seancën në të cilën ai është paraqitur ose, nëse ai është kthyer në atë territor, pasi është larguar prej tij, pa qenë i detyruar për t'u paraqitur sërish.

Neni 36

1. Nëse shteti kërkues ka kërkuar ekzekutimin e një konfiskimi pasurie, shteti i kërkuar mund të procedojë me marrjen e përkohshme të pasurisë në fjalë, me kusht që legjislacioni i tij e parashikon marrjen për raste të ngjashme.
2. Marrja e pasurisë rregullohet nga legjislacioni i shtetit të kërkuar, i cili do të përcaktojë kushtet në të cilat mund të hiqet masa e marrjes së pasurisë.

SEKSIONI 5 EKZEKUTIMI I SANKSIONEVE

A. Përcaktime të përgjithshme

Neni 37

Një sanksion i vendosur në shtetin kërkues nuk do të ekzekutohet në shtetin e kërkuar, përveçse me anë të një vendimi të një gjykate në shtetin e kërkuar. Çdo shtet palë mundet sidoqoftë të ngarkojë autoritete të tjera të marrin vendime të tilla, nëse sanksioni që do të ekzekutohet është vetëm një gjobë ose konfiskim dhe nëse këto vendime janë të apelueshme në një gjykatë.

Neni 38

Çështja shqyrtohet nga gjykata ose nga autoriteti i ngarkuar sipas nenit 37, nëse shteti i kërkuar vëren se ka vend për të ndërmarrë veprime lidhur me kërkesën për ekzekutim.

Neni 39

1. Para se të marrë një vendim mbi kërkesën, gjykata i jep mundësinë personit të dënuar të

shfaqë mendimin e tij, kur ky i fundit e kërkon këtë, përmes paraqitjes së tij personalisht përpara gjykatës ose përmes paraqitjes së një letre rogatore. Dëgjimi personalisht ndodh pas kërkesës së shprehur posaçërisht të vetë personit të dënuar.

2. Gjykata mundet sidoqoftë të vendosë për pranimin e kërkesës për ekzekutim në mungesë të personit që kërkon të paraqitet para gjykatës, nëse ai është i burgosur në shtetin kërkues. Në këto rrethana çdo vendim për zëvendësimin e sanksionit sipas nenit 44 do të shtyhet për sa kohë që personit të dënuar, pas transferimit të tij në shtetin e kërkuar, i është dhënë mundësia për t'u paraqitur para gjykatës.

Neni 40

1. Gjykata ose, në rastet e parashikuara në nenin 37, autoriteti i ngarkuar sipas të njëjtës dispozitë, sigurohet që:

- a) sanksioni, ekzekutimi i të cilit kërkohet është vendosur në një gjykim penal europian;
- b) kërkesat e nenit 4 janë përmbushur;
- c) kushti i parashikuar nga shkronja "a" e nenit 6 nuk është përmbushur ose nuk bie ndesh me ekzekutimin;
- d) ekzekutimi nuk bie ndesh me nenin 7;
- e) në rastin e një dënimi në mungesë ose të një ordonnance penale, kërkesat e seksionit 3 të këtij kapitulli janë përmbushur.

2. Secili shtet palë mund ta ngarkojë gjykatën ose autoritetin e përcaktuar sipas nenit 37 me verifikimin e kushteve të tjera të ekzekutimit të parashikuara në këtë Konventë.

Neni 41

Vendimet gjyqësore të marra në përputhje me këtë seksion sipas kërkesave për ekzekutim dhe ato të marra mbi apelimet ndaj vendimeve të autoriteteve administrative sipas nenit 37, duhet të jenë të apelueshme.

Neni 42

Konstatimet e fakteve janë për shtetin e kërkuar të detyrueshme për sa kohë që ato janë paraqitur në vendim ose për sa kohë ky vendim bazohet heshtazi në to.

B) Dispozita të veçanta për ekzekutimin e sanksioneve me heqje lirie.

Neni 43

Kur personi i dënuar është burgosur në shtetin kërkues, me përjashtim të rastit kur legjislacioni i atij shteti parashikon ndryshe, ai duhet të transferohet në shtetin e kërkuar menjëherë pasi shteti kërkues të jetë njoftuar për pranimin e kërkesës për ekzekutim.

Neni 44

1. Nëse kërkesa për ekzekutim pranohet, gjykata duhet të zëvendësojë sanksionin me heqje lirie të vendosur në shtetin kërkues me një sanksion të parashikuar nga legjislacioni i tij për të njëjtën vepër penale. Ky sanksion mundet, në kufijtë e treguar në paragrafin e dytë, të jetë i një natyre ose kohëzgjatjeje tjetër nga ai i vendosur në shtetin kërkues. Nëse ky sanksion i fundit është më i vogël në minimum, sesa ai që mund të vendoset sipas legjislacionit të shtetit të kërkuar, gjykata nuk është e detyruar të respektojë këtë minimum dhe zbaton një sanksion që i korrespondon sanksionit të vendosur në shtetin kërkues.
2. Në vendosjen e sanksionit, gjykata nuk duhet të rëndojë pozitën penale të personit të dënuar që rezulton nga vendimi i dhënë në shtetin kërkues.
3. Çdo pjesë e sanksionit të vendosur në shtetin kërkues dhe e gjithë periudha e burgimit paraprak të vuajtur nga personi i dënuar pas dënimit do të llogaritet e plotë. E njëjta gjë do të zbatohet përsa i përket burgimit paraprak të vuajtur nga personi i dënuar në shtetin kërkues para dënimit të tij, për aq sa legjislacioni i atij shteti e rregullon këtë llogaritje.
4. Çdo shtet palë mundet në çdo kohë të depozitojë pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës një deklaratë, e cila i jep atij të drejtën, në përputhje me këtë Konventë, të ekzekutojë një sanksion me heqje lirie të të njëjtës natyre me atë të vendosur në shtetin kërkues, edhe pse kohëzgjatja e këtij sanksioni kapërcen maksimumin e parashikuar nga legjislacioni i tij kombëtar për një sanksion të së njëjtës natyre. Sidoqoftë, ky rregull do të zbatohet vetëm për rastet kur legjislacioni kombëtar i këtij shteti e lejon, për të njëjtën vepër penale, vendosjen e një sanksioni që ka të paktën të njëjtën kohëzgjatje sa ai i vendosur në shtetin kërkues, por që është i një natyre më të rëndë. Sanksioni i vendosur sipas këtij paragrafi mund të ekzekutohet, nëse kohëzgjatja dhe qëllimi i tij e kërkojnë kështu, në një institucion penal të caktuar për ekzekutimin e sanksioneve të një natyre tjetër.

C. Dispozita të veçanta për ekzekutimin e gjobave dhe konfiskimeve

Neni 45

1. Nëse kërkesa për ekzekutimin e një gjobe ose konfiskimi të një shume parash pranohet, gjykata ose, autoriteti i ngarkuar sipas nenit 37 konverton shumën në monedhën e shtetit të kërkuar sipas kursit të shkëmbimit në fuqi në momentin e marrjes së vendimit. Ajo përcakton edhe masën e gjobës ose shumën që duhet të konfiskohet, e cila nuk duhet të tejkalojë maksimumin e shumës së fiksuar në legjislacionin e saj për të njëjtën vepër penale ose, në mungesë të maksimumit ligjor, maksimumin e shumës së dhënë zakonisht në shtetin e kërkuar për një vepër të tillë penale.
2. Sidoqoftë, gjykata ose autoriteti i ngarkuar sipas nenit 37 mund t'i përmbahet për shumën e vendosur në shtetin kërkues, dënimit me gjobë ose konfiskimit, kur një sanksion i tillë nuk parashikohet nga legjislacioni i shtetit të kërkuar për të njëjtën vepër penale, por ky legjislacion lejon vendosjen e sanksioneve më të rënda. I njëjti rregullim zbatohet edhe nëse sanksioni i vendosur në shtetin kërkues tejkalon maksimumin e parashikuar në legjislacionin e shtetit të kërkuar për të njëjtën vepër penale, por ky legjislacion lejon vendosjen e sanksioneve më të rënda.

3. Të gjitha lehtësirat e pagimit të dhëna në shtetin kërkues, si përsa i përket afatit, edhe pagimit me këste, do të respektohen në shtetin e kërkuar.

Neni 46

1. Kur kërkesa për ekzekutim përmban konfiskimin e një objekti të veçantë, gjykata ose autoriteti i ngarkuar sipas nenit 37 mund të urdhërojë konfiskimin e atij objekti vetëm nëse ky konfiskim autorizohet nga legjislacioni i shtetit të kërkuar për të njëjtën vepër penale.

2. Sidoqoftë, gjykata ose autoriteti i ngarkuar sipas nenit 37 mund t'i përmbahen konfiskimit të urdhëruar në shtetin kërkues, kur ky sanksion nuk parashikohet në legjislacionin e shtetit të kërkuar për të njëjtën vepër penale, por ky legjislacion lejon vendosjen e sanksioneve më të rënda.

Neni 47

1. Gjjobat e paguara dhe konfiskimet hyjnë në thesarin e shtetit të kërkuar, pa paragjykuar të drejtat e personave të tretë.

2. Objektet e konfiskuara që paraqesin një interes të veçantë, mund t'i kthehen shtetit kërkues me kërkesën e tij.

Neni 48

Nëse ekzekutimi i një gjobe bëhet i pamundur, mund të zbatohet nga një gjykatë e shtetit të kërkuar një sanksion zëvendësues me heqje lirie, nëse legjislacioni i të dy shteteve e parashikon një rast të tillë, përveçse kur shteti kërkues e kufizon kërkesën e tij shprehimisht në ekzekutimin vetëm të gjobës. Nëse gjykata vendos një sanksion zëvendësues me heqje lirie, zbatohen rregullat vijuese:

a) Nëse konvertimi i një gjobe në një sanksion me heqje lirie është parashkuar tashmë në vendimin e dhënë në shtetin kërkues ose direkt në ligjin e atij shteti, gjykata e shtetit të kërkuar përcakton natyrën dhe kohëzgjatjen e këtij sanksioni në përputhje me rregullat e vendosura në legjislacionin e saj. Nëse sanksioni me heqje lirie të parashkuar tashmë në shtetin kërkues është më i vogël sesa minimumi, i cili mund të vendoset sipas legjislacionit të shtetit të kërkuar, gjykata nuk është e detyruar të respektojë këtë minimum dhe vendos një sanksion tjetër korrespondues të sanksionit të parashkuar në shtetin kërkues. Kur gjykata vendos një sanksion, ajo nuk mund të rëndojë pozitën penale të personit të dënuar që rezulton nga vendimi i marrë në shtetin kërkues.

b) Në rastet e tjera, gjykata e shtetit të kërkuar procedon me konvertimin e gjobës sipas legjislacionit të saj, duke respektuar kufijtë e parashkuar nga legjislacioni i shtetit kërkues.

D. Dispozita të veçanta për ekzekutimin e heqjes ose kufizimit të një ose më shumë të drejtave

Neni 49

1. Kur paraqitet një kërkesë për ekzekutimin e heqjes ose kufizimit të një të drejte të vendosur në shtetin kërkues, ajo sjell pasoja vetëm nëse legjislacioni i shtetit të kërkuar lejon vendosjen e heqjes së saj për një vepër të tillë penale.
2. Gjykata që shqyrton çështjen vlerëson dobinë e ekzekutimit të heqjes të së drejtës në territorin e shtetit të saj.

Neni 50

1. Nëse gjykata urdhëron ekzekutimin e heqjes të së drejtës, ajo duhet të përcaktojë kohëzgjatjen brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni i saj, pa kapërcyer ato të vendosura nga vendimi dhënë në shtetin kërkues.
2. Gjykata mund të kufizojë heqjen e së drejtës vetëm për një pjesë të të drejtave për të cilat është vendosur heqja ose pezullimi.

Neni 51

Neni 11 nuk zbatohet për heqjen ose kufizimin e të drejtave.

Neni 52

Shteti i kërkuar ka të drejtë t'i rikthejë personit të dënuar të drejtat nga të cilat ai është privuar, në përputhje me vendimin e marrë në zbatim të këtij seksioni.

KAPITULLI III PASOJAT NDËRKOMBËTARE TË GJYKIMEVE PENALE EUROPIANE

SEKSIONI 1 **NE BIS IN IDEM**

Neni 53

1. Një person, ndaj të cilit është zhvilluar një gjykim penal european, nuk mund të procedohet, gjykohet apo të bëhet objekt ekzekutimi i një sanksioni në një shtet tjetër palë për të njëjtin fakt kur:
 - a) ai është shpallur i pafajshëm;
 - b) sanksioni i vendosur:
 - i) është ekzekutuar plotësisht ose është duke u ekzekutuar;
 - ii) është objekt i një faljeje ose amnistie në tërësinë e tij ose për pjesën e paekzekutuar;
 - iii) nuk mund të ekzekutohet më, pasi është parashkruar;
 - c) gjykata konstaton fajësinë e autorit, por nuk vendos ndonjë sanksion.
2. Sidoqoftë, një shtet palë nuk është i detyruar, përveçse, kur ai vetë ka kërkuar procedimin, të njohë pasojat e “ne bis in idem”, nëse veprimi që i dha shkas gjykimit është drejtuar kundër ndonjë personi, institucioni ose sendi që ka karakter publik në këtë

shtet ose nëse personi objekt i gjykimit kishte një karakter publik në këtë shtet.
3. Gjithashtu, çdo shtet palë në të cilin është kryer veprimi ose është konsideruar i tillë në përputhje me legjislacionin e atij shteti, nuk është i detyruar të njohë pasojat e “ne bis in idem” përveçse, kur ky shtet ka kërkuar procedimin.

Neni 54

Nëse fillohen procedime të reja kundër një personi të gjykuar për të njëjtin fakt në një shtet tjetër palë, çdo periudhë heqje lirie e vuajtur për ekzekutimin e një vendimi do të llogaritet në sanksionin që mund të vendoset.

Neni 55

Ky seksion nuk pengon zbatimin e rregullave kombëtare më të gjera lidhur me pasojat e “ne bis in idem” për gjykimet penal e të huaja.

SEKSIONI 2 MARRJA NË KONSIDERATË

Neni 56

Çdo shtet palë merr masat legislative, që i vlerëson të përshtatshme për t’u dhënë mundësi gjykatave, kur ato japin vendime, për të marrë në konsideratë të gjitha vendimet e mëparshme penale europiane të dhëna për një vepër tjetër penale pas paraqitjes së të akuzuarit, me qëllim që t’i bashkëlidhë atij vendimi të gjitha pasojat ose një pjesë të tyre, të cilat legjislacioni i tij ia bashkëlidh vendimeve të dhëna në territorin e tij. Ai përcakton kushtet në të cilat është dhënë ky vendim.

Neni 57

Çdo shtet palë merr masat legislative që i vlerëson të përshtatshme për të dhënë mundësinë e marrjes në konsideratë të të gjitha vendimeve penale europiane të dhëna pas paraqitjes së të akuzuarit, me qëllim bërjen të zbatueshme të të gjitha ose të një pjesë të heqjeve të zotësive të bashkëlidhura sipas legjislacionit të tij vendimeve të dhëna në territorin e tij. Ai përcakton kushtet në të cilat është dhënë ky vendim.

KAPITULI IV DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 58

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të përfaqësuara në Komitetin e Ministrave të Këshillit të Europës. Ajo mund të ratifikohet ose pranohet. Instrumentet e ratifikimit ose të pranimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit ose të pranimiit.

3. Për shtetet nënshkruese që e ratifikojnë ose e pranojnë këtë Konventë më vonë, ajo do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të tyre të ratifikimit ose të pranimiit.

Neni 59

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Europës mund të ftojë çdo shtet joanëtar të aderohet në këtë Konventë. Rezoluta që përmban këtë ftesë duhet të marrë miratimin unanimit të anëtarëve të Këshillit që kanë ratifikuar këtë Konventë.

2. Aderimi do të kryhet nëpërmjet depozitimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës të një instrumenti aderimi, i cili do të ketë efekt tre muaj pas datës së depozitimit.

Neni 60

1. Çdo shtet palë në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, të pranimiit ose të aderimit, mund të specifikojë territoret në të cilat do të zbatohet kjo Konventë.

2. Çdo shtet palë, gjatë depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, të pranimiit ose të aderimit, ose në një datë të mëvonshme, nëpërmjet një deklarate të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund të shtrijë zbatimin e kësaj Konvente në cilindo territor ose territore të specifikuar në deklaratë, territore për të cilat ai është përgjegjës për marrëdhëniet ndërkombëtare ose për të cilat ai është i autorizuar të lidhë marrëveshje.

3. Çdo deklaratë e bërë në përputhje me paragrafin e mësipërm mund të tërhiqet përsa i përket territoreve të përmendura në atë deklaratë, në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 66 të kësaj Konvente.

Neni 61

1. Çdo shtet palë, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, të pranimiit ose të aderimit, mund të deklarojë përdorimin prej tij të një ose më shumë rezervave të parashikuara në lidhjen I të kësaj Konvente.

2. Çdo shtet palë mund të tërheqë tërësisht ose pjesërisht një rezervë të formuluar nga ai në përputhje me paragrafin e mësipërm, me anë të një deklarate të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, e cila sjell pasoja që nga data e marrjes së saj.

3. Shteti palë që ka bërë një rezervë për një parashikim të kësaj Konvente nuk mund të pretendojë zbatimin e atij parashikimi nga një shtet tjetër; sidoqoftë ai mund të pretendojë, nëse rezerva është e pjesshme ose e kushtëzuar, zbatimin e kësaj dispozite në masën që ai vetë e ka pranuar.

Neni 62

1. Çdo shtet palë mundet në çdo kohë të tregojë, me anë të një deklarate të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, dispozitat ligjore për t'u përfshirë në lidhjen II dhe III të kësaj Konvente.

2. Çdo ndryshim i dispozitave kombëtare të përmendura në lidhjen II ose III duhet t'i njoftohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, nëse ky ndryshim e bën të pasaktë informacionin e dhënë në ato lidhje.

3. Çdo ndryshim i bërë në lidhjen II ose III në zbatim të paragrafit të mësipërm sjell pasoja për çdo shtet palë një muaj pas datës së njoftimit të tyre nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 63

1. Çdo shtet palë duhet t'i japë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, në momentin e depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, të pranimit ose të aderimit, të gjitha informacionet e nevojshme lidhur me sanksionet e zbatueshme në atë shtet dhe ekzekutimin e tyre lidhur me zbatimin e kësaj Konvente.

2. Çdo ndryshim i mëvonshëm që e bën të pasaktë informacionin e dhënë sipas paragrafit të mësipërm duhet t'i njoftohet në të njëjtën mënyrë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 64

1. Kjo Konventë nuk cenon as të drejtat dhe as detyrimet që rrjedhin prej marrëveshjeve të ekstradimit dhe konventave ndërkombëtare shumëpalëshe që përmbajnë fusha specifike, as dispozitat që përmbajnë fushat që janë objekt i kësaj Konvente të përcaktuara në konventa të tjera ekzistuese ndërmjet shteteve palë.

2. Shtetet palë mund të lidhin marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe mes tyre, lidhur me çështjet e rregulluara nga kjo Konventë vetëm për të plotësuar dispozitat e saj ose për të lehtësuar zbatimin e parimeve që përmbahen aty.

3. Sidoqoftë, nëse dy ose më shumë shtete palë kanë vendosur ose janë duke vendosur marrëdhënie ndërmjet tyre mbi bazën e një legjislacioni uniform ose të një regjimi të veçantë, ata do të kenë të drejtë të rregullojnë marrëdhëniet e tyre të ndërsjella të kësaj fushe duke u bazuar ekskluzivisht në këto sisteme, pavarësisht nga dispozitat e kësaj Konvente.

4. Shtetet palë që pushojnë së zbatuari dispozitat e kësaj Konvente lidhur me marrëdhëniet e tyre të ndërsjella në këtë fushë, duhet të njoftojnë për këtë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 65

Komiteti European për çështjet penale i Këshillit të Europës do të ndjekë zbatimin e kësaj Konvente dhe do të bëjë gjithçka të nevojshme për arritjen e zgjidhjeve miqësore të vështirësive që mund të lindin gjatë zbatimit të saj.

Neni 66

1. Kjo Konventë do të mbetet në fuqi për një afat kohor të pacaktuar.

2. Çdo shtet palë, përse i përket asaj, mund ta denoncojë këtë Konventë nëpërmjet një njoftimi të dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

3. Denoncimi do të ketë efekt gjashtë muaj pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 67

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të njoftojë shtetet anëtare të përfaqësuara në Komitetin e Ministrave të Këshillit dhe çdo shtet tjetër, i cili ka aderuar në këtë Konventë për:

- a) çdo nënshkrim;
- b) çdo depozitim të një instrumenti ratifikimi, pranimi ose aderimi;
- c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në përputhje me nenin 58 të saj;
- d) çdo deklaratë të marrë në përputhje me dispozitat e nenit 19 paragrafit të dytë;
- e) çdo deklaratë të marrë në përputhje me dispozitat e nenit 44 paragrafit të katërt;
- f) çdo deklaratë të marrë në përputhje me dispozitat e nenit 60;
- g) çdo rezervë të bërë në përputhje me dispozitat e nenit 61 paragrafi i parë dhe tërheqjen e një rezerve të tillë;
- h) çdo deklaratë të marrë në përputhje me dispozitat e nenit 62 paragrafit të parë dhe çdo njoftim të mëtejshëm të marrë në përputhje me atë dispozitë, paragrafi i dytë;
- i) çdo njoftim të marrë në përputhje me dispozitat e nenit 63 paragrafi i parë dhe çdo njoftim të mëtejshëm të marrë në përputhje me atë dispozitë, paragrafi i dytë;
- j) çdo njoftim përse i përket marrëveshjeve të dyanshme ose të shumanshme të lidhura në përputhje me nenin 64 paragrafi i dytë ose përse i përket legjisllacionit uniform të futur sipas nenit 64 paragrafi i tretë;
- k) çdo njoftim të marrë në përputhje me nenin 66 dhe datën në të cilën bëhet i efektshëm denoncimi.

Neni 68

Kjo Konventë, deklaratat dhe njoftimet e autorizuara prej saj zbatohen vetëm për ekzekutimet e vendimeve të dhëna pas hyrjes në fuqi të Konventës ndërmjet shteteve palë të interesuara.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit të autorizuar rregullisht, kanë nënshkruar këtë Konventë. Bërë në Hagë, më 28 maj 1970, në frëngjisht dhe anglisht, të dyja tekstet njëlloj të vlefshme, në një kopje të vetme, e cila do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'u transmetojë kopje të vërtetuara secilit shtet nënshkrues dhe aderues.

Lidhja I

Çdo shtet palë mund të deklarojë se rezervon të drejtën:

- a) të refuzojë ekzekutimin, nëse konsideron se dënimi përbën një shkelje fiskale ose fetare;
- b) të refuzojë ekzekutimin e një sanksioni për një veprim, i cili sipas legjisllacionit të

- shtetit të kërkuar i përkiste kompetencës ekskluzive të një autoriteti administrativ;
- c) të refuzojë ekzekutimin e një gjykimi penal europian, të cilin autoritetet e shtetit kërkues e kryen në një datë kur, sipas legjislacionit të tij, procedimi penal i veprës penale të dënuar nga gjykimi duhet të ishte parashkruar;
- d) të refuzojë ekzekutimin e sanksioneve të vendosura në mungesë dhe masave penale, ose vetëm të njëjës nga kategoritë e vendimeve;
- e) të refuzojë zbatimin e parashikimeve të nenit 8, kur ky shtet ka një kompetencë origjinale dhe të njohë në raste të tilla vetëm ekuivalencën e akteve që ndërpresin ose pezullojnë parashkrimin, akte që janë kryer në shtetin kërkues;
- f) të pranojë zbatimin e pjesës III përsa i përket njërës nga dy seksionet e saj.

Lidhja II

Lista e shkeljeve të tjera, përveç atyre të klasifikuara si vepra penale nga legjislacioni penal.

Shkeljet (veprat) e mëposhtme konsiderohen si vepra penale:

- Në Francë: Çdo sjellje e paligjshme e sanksionuar si e tillë nga një “contravention de grande voirie”.
- Në RFGJ: Çdo sjellje e paligjshme e sanksionuar si e tillë përmes procedurave të përcaktuara nga Akti mbi Thyerjen e Rregullave (gesetz uber ordnungswidrigkeiten) i 24 majit 1968 (BGBL 1968, I 481).
- Në Itali: Çdo sjellje e paligjshme e sanksionuar si e tillë përmes Aktit nr.317 të 3 marsit 1967.

Lidhja III

Austri – Nenet 460-462 të Kodit të Procedurës Penale.

Danimarkë - Neni 931 i Aktit mbi Administrimin e Drejtësisë.

Francë - 1. Nenet 524-528 të Kodit të Procedurës Penale shtuar me nenet R42-R50; 2. Ordonnance Penale të zbatueshme vetëm në departamentet e Bas-Rhin, Haut-Rhin dhe Mossele.

Gjermani – 1. Nenet 407-412 dhe 413 të Kodit të Procedurës Penale; 2. Nenet 65-66 të Aktit të 24 majit 1968 (BGBL 1968 I, 481).

Itali – 1. Nenet 506-510 të Kodit të Procedurës Penale. 2. Akti i 7 janarit 1929, nr.4 për çështjet fiskale. 3. Nenet 1242-1243 të Kodit të Llundrimit. 4. Vendimi në zbatim të Aktit nr.317 të 3 marsit 1967.

Luksemburg – 1. Akti i 31 korrikut 1924 për organizimin e ordonnances penaleso. 2. Neni 16 i aktit të 14 shkurtit 1955 për trafikun në autostradat publike.

Norvegji – 1. Nenet 287-290 të Aktit për Procedurat gjyqësore në çështjet penale. 2. Neni 31B i Kodit Rrugor të 18 qershorit 1965.

Suedi – Kapitulli 48 i Kodit të Procedurave.

Turqi – Nenet 386 –391 të Kodit të Procedurës Penale dhe të gjitha vendimet sipas të cilave autoritetet administrative vendosin sanksione.

L I G J
Nr.8497, datë 10.6.1999

**PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË KËSHILLIT TË EUROPËS “PËR
TRANSFERIMIN E PROCEDIMEVE NË ÇËSHTJET PENALE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet Konventa e Këshillit të Europës “Për transferimin e procedimeve në çështjet penale”, me deklaratimet dhe rezervimet e bëra në këtë ligj.

Neni 2

Bazuar në nenin 18 paragrafi 2 të Konventës, Republika e Shqipërisë deklaron se kërkesat në çdo dokument tjetër, që lidhet me to, në qoftë se nuk janë paraqitur në njërin nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Europës, duhet të shoqërohen me një përkthim në gjuhën shqipe ose në njërin nga ato gjuhë.

Neni 3

Lidhur me Shtojcën II paragrafi i dytë, për qëllim të kësaj Konvente, “shtetas” do të kuptohen edhe personat pa shtetësi që kanë banim të përhershëm në Shqipëri, si dhe ata që mbajnë dy shtetësi, ku njëra është shqiptare.

Neni 4

Duke ndjekur nenin 41 dhe Shtojcën I të Konventës, Republika e Shqipërisë do të refuzojë procedimet për rastet e shkronjave “a”, “b” dhe “g”.

Neni 5

Republika e Shqipërisë refuzon të zbatojë nenet 22 dhe 23 të Konventës.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2400, datë 29.6.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

**KONVENTA EUROPIANE
MBI TRANSFERIMIN E PROCEDIMEVE NË ÇËSHTJET PENALE**

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës, këtu nënshkruese,
Duke pasur parasysh se qëllimi i Këshillit të Europës është arritja e një uniteti më të madh midis anëtarëve të tij;
Duke dëshiruar të plotësojnë punën që kanë bërë në fushën e të drejtës penale, me synimin e arritjes së sanksioneve me të drejta dhe më frytdhënëse;
Duke e vlerësuar të dobishëm në këtë kuptim sigurimin, me frymën e një mirëbesimi reciprok, të organizimit të procedimeve penale në nivel ndërkombëtar dhe në veçanti, duke shmangur disavantazhet që rezultojnë nga konfliktet e kompetencave,
Kanë rënë dakord si vijon:

**PJESA I
PËRKUFIZIME**

Neni 1

Për qëllimet e kësaj Konvente:

- (a) “vepër penale” përfshin aktet që janë trajtuar nga e drejta penale dhe ato të trajtuara nga dispozitat ligjore të renditura në shtojcën III të kësaj Konvente me kusht që në rastin kur një autoritet administrativ ka kompetencën që të merret me veprën penale, personi i interesuar duhet të ketë të drejtën që çështja e tij të gjykohet nga një gjyq.
- (b) “sanksion” nënkupton çdo ndëshkim ose masë tjetër të pësuar ose të vendosur në lidhje me një vepër penale ose cenim të dispozitave të renditura në shtojcën III.

**PJESA II
KOMPETENCA**

Neni 2

1. Për qëllimet e zbatimit të kësaj Konvente, çdo shtet kontraktues do të ketë kompetencën të ndjekë penalisht sipas ligjit të tij penal çdo vepër penale ndaj së cilës është i zbatueshën ligji i një shteti tjetër kontraktues.
2. Kompetenca dhënë një shteti kontraktues, ekskluzitivisht në bazë të paragrafit 1 të këtij neni, mund të ushtrohet vetëm në pajtim me një kërkesë për procedime të paraqitura nga një shtet tjetër kontraktues.

Neni 3

Çdo shtet kontraktues, duke pasur sipas ligjit të tij kompetencën për të ndjekur penalisht

një vepër penale, për qëllimet e zbatimit të kësaj Konvente, mund të heqë dorë ose të ndërpresë procedimet kundër personit të dyshuar, i cili është duke u ndjekur penalisht ose do të ndiqet për të njëjtën vepër penale, nga një shtet tjetër kontraktues. Duke pasur parasysh nenin 21 paragrafi 2, çdo vendim i tillë, për të ndërprerë ose hequr dorë nga procedimet, do të jetë i përkohshëm deri në një vendim përfundimtar në shtetin tjetër kontraktues.

Neni 4

Shteti i kërkuar do të ndërpresë procedurat gjyqësore, të parashikuara ekskluzivisht në nenin 2, kur sipas tij e drejta për të dënuar i është hequr sipas ligjit të shtetit kërkuar për një arsye përveç asaj që ka të bëjë me afatin, ndaj të cilës zbatohen në veçanti nenet 10(c), 11(f) dhe (g), 22, 23 dhe 26.

Neni 5

Dispozitat e Pjesës III të kësaj Konvente nuk kufizojnë kompetencën që i jepet një shteti të kërkuar prej ligjit të tij të brendshëm për të përkrahur ndjekjeve penale.

PJESA III TRANSFERIMI I PROCEDIMEVE

SEKSIONI I KËRKESA PËR PROCEDIME

Neni 6

1. Kur një person është dyshuar për kryerjen e një vepre penale sipas ligjit të një shteti kontraktues, ky shtet mund t'i kërkojë një shtet tjetër kontraktues që të fillojë procedimet në rastet dhe sipas kushteve të parashikuara në këtë Konventë.
2. Në qoftë se sipas dispozitave të kësaj Konvente një shtet kontraktues mund t'i kërkojë një shtet tjetër kontraktues që të fillojë procedimet, atëhere autoritetet kompetente të shtetit të parë do ta vlerësojnë këtë mundësi.

Neni 7

1. Procedimet nuk mund të nisnin në shtetin e kërkuar në qoftë se vepra penale për të cilën janë kërkuar procedimet nuk do të jetë kryer në territorin e tij dhe kur, sipas këtyre rrethanave, personi i dyshuar nuk do të jetë gjithashtu përgjegjës ndaj sanksionit sipas ligjit të tij.
2. Në qoftë se vepra penale është kryer nga një person me status publik ose kundër një personi, institucioni apo ndonjë gjëje me status të tillë në shtetin kërkuar, në shtetin e kërkuar kjo vepër penale do të konsiderohet sikur të jetë kryer nga një person me status publik ose kundër një personi, institucioni apo ndonjë korresponduesi, në shtetin e fundit, ndaj atij kundër të cilit ajo është kryer.

Neni 8

1. Një shtet kontraktues mund t'i kërkojë një shteti tjetër kontraktues të fillojë procedimet në një nga rastet e mëposhtme:

- (a) në qoftë se personi i dyshuar është banues i përhershëm në shtetin e kërkuar;
- (b) në qoftë se personi i dyshuar është shtetas i shtetit të kërkuar ose nëse ky shtet është shteti i tij i origjinës;
- (c) në qoftë se personi i dyshuar është duke vuajtur ose duhet të vuajë një dënim që përfshin heqjen e lirisë në shtetin e kërkuar;
- (d) në qoftë se procedimet për të njëjtën ose vepra penale të tjera janë ndërmarrë kundër personit të dyshuar në shtetin e kërkuar;
- (e) në qoftë se ai e konsideron që transferimi i procedimeve është i justifikuar në interes të arritjes së të vërtetës dhe në veçanti, që çështjet më të rëndësishme që lidhen me provat janë në shtetin e kërkuar;
- (f) në qoftë se ai e konsideron që detyrimi për zbatimin e një dënimi që mund të jetë dhënë në shtetin e kërkuar ka të ngjarë që të përmirësojë perspektivat për rehabilitimin shoqëror të personit të dënuar;
- (g) në qoftë se ai e konsideron që prania e personit të dyshuar nuk mund të sigurohet në seancat e procedimeve në shtetin kërkues dhe që prania e tij vetjake në këto seanca të procedimeve mund të sigurohet në shtetin e kërkuar;
- (h) në qoftë se ai e konsideron që ai vetë nuk mund të kërkojë zbatimin e një dënimi që mund të jetë dhënë edhe nëpërmjet kerkimit të ekstradimit dhe se shteti i kërkuar mund ta bëjë këtë gjë.

2. Në rastet kur personi i dyshuar ka qenë dënuar pëfundimisht në një shtet kontraktues, ky shtet mund të kërkojë transferimin e procedimeve për një ose disa nga rastet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, vetëm në qoftë se ai vetë nuk mund të kërkojë zbatimin e dënimit, madje edhe duke kërkuar ekstradimin, dhe në qoftë se shteti tjetër kontraktues nuk pranon zbatimin e një vendimi gjyqësor të huaj si një çështje parimi ose refuzon të zbatojë një vendim të tillë.

Neni 9

1. Autoritetet kompetente në shtetin e kërkuar do të shqyrtojnë kërkesën për procedime të bëra në pajtim me nenin paraprirës. Ato do të vendosin në përputhje me ligjin e tyre, se çfarë veprimi do të ndërmarrin si pasojë.

2. Në rastet kur ligji i shtetit të kërkuar parashikon dënimin e një vepre penale nga një autoritet administrativ, ai shtet, sa më shpejt që të jetë e mundur, do të informojë shtetin kërkues në qoftë se shteti i kërkuar nuk do të ketë bërë një deklaratë, sipas paragrafit 3 të këtij neni.

3. Çdo shtet kontraktues, në kohën e nënshkrimit ose të depozitimit të dokumentit të ratifikimit, pranimit ose aderimit ose në ndonjë datë të mëvonshme, nëpërmjet deklaratës adresuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund të tregojë kushtet sipas të cilave ligji i tij i brendshëm lejon dënimin e veprave penale të caktuara nga një autoritet administrativ. Një deklaratë e tillë do të zëvendësojë njoftimin e përmendur në paragrafin 2 të këtij neni.

Neni 10

Shteti i kërkuar nuk do të fillojë veprimet në bazë të kërkesës:

- (a) në qoftë se kërkesa nuk është në përputhje me dispozitat e nenit 6 paragrafi 1 dhe nenit 7 paragrafi 1;
- (b) në qoftë se fillimi i procedimeve është në kundërshtim me dispozitat e nenit 35;
- (c) në qoftë se në datën e kërkesës, afati për procedurat gjyqësore penale ka mbaruar sipas legjislacionit të shtetit të kërkuar.

Neni 11

Përveç se çfarë është parashikuar në nenin 10, shteti i kërkuar nuk mund të refuzojë pranimin e pjeshëm ose të plotë të kërkesës, përveç njërit prej rasteve të përmendura më poshtë:

- (a) në qoftë se ai e konsideron që arsyet mbi të cilat është bazuar kërkesa nuk janë të justifikuara sipas nenit 8;
- (b) në qoftë se personi i dyshuar nuk është banues i përhershëm në shtetin e kërkuar;
- (c) në qoftë se personi i dyshuar nuk është shtetas i shtetit të kërkuar;
- (d) në qoftë se ai e konsideron që krimi për të cilin janë kërkuar procedimet është i një natyre politike, ushtarke apo financiare;
- (e) në qoftë se ai e konsideron se ka arsye thelbësore për të besuar që kërkesa për procedime është motivuar për shkak të racës, besimit, kombësisë ose bindjeve politike;
- (f) në qoftë se ndaj veprës penale është i zbatueshëm ligji i tij dhe në qoftë se në kohën e marrjes së kërkesës, procedimet ishin ndaluar për shkak të kalimit të afatit sipas atij ligji; neni 26 paragrafi 2 nuk do të zbatohet në këtë rast;
- (g) në qoftë se kompetenca e tij është parashikuar ekskluzivisht në nenin 2 dhe në qoftë se në kohën e marrjes së kërkesës, procedimet do të pengohen për shkak të kalimit të afatit sipas ligjit të tij, do të merret parasysh zgjatja e afatit prej gjashtë muajsh sipas kuptimit të nenit 23;
- (h) në qoftë se vepra penale është kryer jashtë territorit të shtetit kërkuar;
- (i) në qoftë se procedurat gjyqësore do të ishin në kundërshtim me angazhimet ndërkombëtare të shtetit të kërkuar;
- (j) në qoftë se procedurat gjyqësore do të ishin në kundërshtim me parimet themelore të sistemit ligjor të shtetit të kërkuar;
- (k) në qoftë se shteti kërkuar ka dhunuar një rregull të procedurës të vendosur në këtë Konventë.

Neni 12

1. Shteti i kërkuar do të tërheqë pranimin e kërkesës, në qoftë se pas këtij pranimi, është bërë e qartë një arsye, e cila parashikohet në nenin 10 të kësaj Konvente, për të mos filluar veprimet në bazë të kërkesës.

2. Shteti i kërkuar mund të tërheqë pranimin e kërkesës:

- (a) në qoftë se bëhet e qartë që prania personale e personit të dyshuar nuk mund të

sigurohet në seancat e procedimeve në atë shtet ose që çdo dënim i cili mund të jetë kryer, nuk mund të kërkohet të zbatohet në atë shtet;

(b) në qoftë se përpara se çështja të jetë paraqitur në gjyq bëhet e qartë një prej arsyeve për refuzim, të përmendur në nenin 11; ose

(c) në raste të tjera, në qoftë se shteti kërkues bie dakord.

SEKSIONI II PROCEDURA E TRANSFERIMIT

Neni 13

1. Të gjitha kërkesat e specifikuar në këtë Konventë do të bëhen me shkrim. Ato dhe të gjithë komunikimet e nevojshme për zbatimin e kësaj Konvente do të dërgohen nga Ministria e Drejtësisë e Shtetit kërkues, në Ministrinë e Drejtësisë së shtetit të kërkuar ose në bazë të marrëveshjes të posaçme reciproke, direkt nga autoritetet e shtetit kërkues tek ato të shtetit të kërkuar, ato do të kthehen nëpërmjet të njëjtit kanal.

2. Në raste urgjente, kërkesat dhe komunikimet mund të dërgohen nëpërmjet Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (INTERPOL).

3. Çdo shtet kontraktues, nëpërmjet deklaratës adresuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës mund të njoftojë qëllimin e tij për të adoptuar, për aq sa është i interesuar, rregullat e transmetimit përveç atyre të vendosura në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 14

Në qoftë se një shtet kontraktues vlerëson që informacioni i dhënë nga një shtet tjetër kontraktues nuk është i mjaftueshëm për t'i mundësuar atij zbatimin e kësaj Konvente, ai do të kërkojë një informacion shtesë të nevojshëm. Ky informacion mund të përcaktojë një datë për marrjen e një informacioni të tillë.

Neni 15

1. Kërkesa për procedime do të shoqërohet nga origjinali ose një kopje e vërtetuar e dosjes penale dhe e të gjitha dokumenteve të tjera të nevojshme. Megjithatë, nëse personi i dyshuar është mbajtur në arrest në pajtim me dispozitat e seksionit V dhe nëse shteti kërkues nuk ka mundësi që të transmetojë këto dokumente në të njëjtën kohë me kërkesën për procedim gjyqësor, atëherë dokumentet mund të dërgohen më vonë.

2. Shteti kërkues, gjithashtu, do të informojë shtetin e kërkuar me shkrim, në lidhje me çdo akt procedural të kryer ose mbi masat e marra në këtë shtet pas transmetimit të kërkesës që ka lidhje me këto procedime. Ky komunikim do të jetë i shoqëruar nga dokumentet përkatëse.

Neni 16

1. Shteti i kërkuar do të komunikojë menjëherë vendimin mbi kërkesën për procedime nga ana e shtetit kërkues.

2. Shteti i kërkuar do të informojë gjithshtu shtetin kërkuar për heqjen dorë nga procedimet ose për vendimet e marra si pasojë e këtyre procedimeve. Shteti kërkuar do t'i transmetohet një kopje e vërtetuar e çdo vendimi të shkruar.

Neni 17

Në qoftë se kompetenca e shtetit të kërkuar është parashikuar ekskluzivisht në nenin 2, ky shtet do të informojë personin e dyshuar në lidhje me kërkesën që i është bërë për procedime, me qëllim që ta lejojë atë të paraqesë qëndrimin e tij mbi çështjen përpara se të ketë marrë një vendim në lidhje me kërkesën.

Neni 18

1. Nuk do të kërkohej asnjë përkthim i dokumenteve, në lidhje me zbatimin e kësaj Konvente, të cilat i nënshtrohen dispozitave të paragrafit 2 të këtij neni.
2. Çdo shtet kontraktues, në kohën e nënshkrimit ose të depozitimit të dokumentit të ratifikimit, pranimit ose aderimit, nëpërmjet deklaratës adresuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund të rezervojë të drejtën të kërkojë që, me përjashtim të kopjes së vendimit të shkruar të përmendur në nenin 16 paragrafi 2, dokumentet në fjalë të jenë shoqëruar nga një përkthim. Shtetet e tjera kontraktuese do të dërgojnë përkthimet në gjuhën kombëtare të shtetit marrës ose në një prej gjuhëve zyrtare të Këshillit të Europës, të cilën do ta përcaktojë shteti marrës. Megjithatë një përcaktim i tillë nuk është i detyrueshëm. Shtetet e tjera kontraktuese mund të kërkojnë reciprocitetin.
3. Ky nen nuk do të paragjykojë ndonjë dispozitë në lidhje me përkthimin e kërkesave dhe dokumenteve ndihmëse që mund të jenë përfshirë në marrëveshje ose rregullime, të cilat janë në fuqi ose që mund të përfundohen midis dy ose më shumë shteteve kontraktuese.

Neni 19

Dokumentet e transmetuara në zbatim të kësaj Konvente nuk nevojitet të njëjtësohen.

Neni 20

Palët kontraktuese nuk do të kërkojnë nga njëra-tjetra kthimin e të hollave për shpenzimet e mundshme që rezultojnë nga zbatimi i kësaj Konvente.

SEKSIONI III PASOJAT E NJË KËRKESE PËR PROCEDIM GJYQËSOR NË SHTETIN KËRKUES

Neni 21

1. Kur shteti kërkuar ka kërkuar procedime, ai nuk mund të ndjekë më penalisht personin e dyshuar për kryerjen e veprës penale për të cilën janë kërkuar këto procedime ose të

kërkojë zbatimin e një vendimi gjyqësor, i cili ka qenë shpallur më parë në atë shtet ndaj tij për atë shkelje. Megjithatë, derisa të merret vendimi i shtetit të kërkuar në lidhje me kërkesën për procedime, shteti kërkuar, do të ketë të drejtën për të ndërmarrë të gjithë hapat në lidhje me ndjekjen penale, pa e çuar çështjen në gjyq ose sipas rastit, duke lejuar autoritetin administrativ të vendosë për çështjen.

2. E drejta për të ndjekur penalisht dhe për ta zbatuar atë do t'i kthehet shtetit kërkuar:
- (a) në qoftë se shteti i kërkuar e njofton atë, në përputhje me nenin 10 mbi vendimin për të mos filluar veprimet në bazë të kërkesës;
 - (b) në qoftë se shteti i kërkuar e njofton atë, në përputhje me nenin 11, mbi vendimin për refuzimin e pranimin të kërkesës;
 - (c) në qoftë se shteti i kërkuar e njofton atë në përputhje me nenin 12 mbi vendimin për tërheqjen e pranimin të kërkesës;
 - (d) në qoftë se shteti i kërkuar e njofton atë mbi vendimin për të mos filluar procedimet ose për t'i pezulluar ato;
 - (e) në qoftë se ai e tërheq kërkesën e tij përpara se shteti i kërkuar ta ketë informuar atë mbi vendimin për fillimin e veprimeve në bazë të kërkesës.

Neni 22

Një kërkesë për procedime, që është bërë në përputhje me dispozitat e kësaj pjese, do të ketë pasojë në shtetin kërkuar në zgjatjen e afatit prej gjashtë muajsh për procedimet.

SEKSIONI IV PASOJAT NË SHETITIN E KËRKUAR NË LIDHJE ME NJË KËRKESË PËR PROCEDIMIN GJYQËSOR

Neni 23

Në qoftë se kompetenca e shtetit të kërkuar është parashikuar ekskluzivisht në nenin 2 afati për procedimet në atë shtet do të zgjasë gjashtë muaj.

Neni 24

1. Në qoftë se procedimet janë bazuar në një ankesë të përbashkët të dy shteteve, ankesa dërguar shtetit kërkuar do të ketë të njëjtën vlerë me atë të dërguar në shtetin e kërkuar.
2. Në qoftë se një ankesë është e nevojshme vetëm në shtetin e kërkuar, ky shtet mund të fillojë procedimet edhe në mungesë të një ankese, në qoftë se personi i cili është autorizuar të paraqesë ankesën nuk ka kundërshtuar brenda një periudhe një mujore nga data e marrjes së njoftimit nga autoriteti kompetent për të drejtën e tij për të kundërshtuar.

Neni 25

Në shtetin e kërkuar sanksioni i zbatueshëm ndaj veprës penale do të jetë ai i parashikuar nga ligji i tij, përveç rastit kur ligji i tij parashikon ndryshe. Në rastet kur kompetenca e

shtetit të kërkuar është parashikuar ekskluzivisht në nenin 2, sanksioni i vendosur në atë shtet nuk do të jetë më i rëndë se ai i parashikuar në ligjin e shtetit kërkuar.

Neni 26

Çdo akt që lidhet me procedimet, të filluara në shtetin kërkuar në përputhje me ligjin dhe rregullat e tij, do të ketë të njëjtën vlerë në shtetin e kërkuar njësoj si të ishte marrë prej autoriteteve të tij, me kusht që përvetësimi i një akti të tillë nuk i jep atij një rëndësi më të madhe se sa ajo që ka në shtetin kërkuar.

Çdo akt, i cili ndërpret afatin dhe që është kryer në mënyrë të vlefshme në shtetin kërkuar, do të ketë të njëjtat pasoja në shtetin e kërkuar dhe anasjelltas.

SEKSIONI V MASAT E PËRKOHSHME NË SHETIN E KËRKUAR

Neni 27

Kur shteti kërkuar bën të ditur qëllimin e tij për të transmetuar një ankesë për procedime, dhe në qoftëse kompetenca e Shtetit të kërkuar do të ishte parashikuar ekskluzivisht në nenin 2, shteti i kërkuar, me kërkesën e shtetit kërkuar dhe sipas kësaj Konvente, mund të mbajë në arrest përkohësisht personin e dyshuar:

a) në qoftë se ligji i shtetit të kërkuar autorizon mbajtjen në arrest për veprën penale, dhe
b) në qoftë se ka arsye për të besuar që personi i dyshuar do të largohet ose do të shkaktojë pengimin e paraqitjes së provave.

2. Kërkesa për arrest të përkohshëm do të përmendë se ekziston një urdhër-arresti ose një urdhër tjetër, që ka të njëjtin efekt, të lëshuar në përputhje me procedurën e vendosur nga ligji i shtetit kërkuar; ai do të njoftojë gjithashtu se çfarë procedimesh gjyqësore do të kërkohen në lidhje me veprën penale, si dhe kur dhe ku një vepër penale e tillë është kryer, si dhe do të përmbajë një përshkrim sa më të saktë të personit të dyshuar. Ai do të përmbajë, gjithashtu, një përshkrim të shkurtë të rrethanave të çështjes.

3. Ankesa për arrest të përkohshëm do të dërgohet direkt nga autoritetet e shtetit kërkuar të përmendura në nenin 13 tek autoritetet korresponduese në shtetin e kërkuar, nëpërmjet postës ose telegramit apo ndonjë mjeti tjetër, që sjell provat me shkrim ose mjeteve të pranuar nga shteti i kërkuar. Shteti kërkuar do të njoftohet menjëherë për rezultatin e kërkesës së tij.

Neni 28

Në bazë të pranimit të një kërkesë për procedime të shoqëruar nga dokumentet e përmendura në nenin 15 paragrafi 1, shteti i kërkuar do të ketë juridiksionin për të zbatuar të gjitha masat e tilla të përkohshme, duke përfshirë mbajtjen në arrest të personit të dyshuar dhe konfiskimin e pasurisë në të njëjtën mënyrë siç mund t'i zbatojë sipas ligjit të tij në rastet kur vepra penale për të cilën janë kërkuar procedimet është kryer në territorin e tij.

Neni 29

1. Masat e përkohshme, të parashikuara në nenet 27 dhe 28, do të rregullohen nga dispozitat e kësaj Konvente dhe ligji i shtetit të kërkuar. Ligji i atij shteti, ose Konventa do të përcaktojnë kushtet mbi të cilat këto masa mund të bëhen të pavlefshme.
2. Këto masa do të shfuqizohen në rastet e përmendura në nenin 21, paragrafi 2.
3. Një person i ndaluar do të lirohet në çdo rast nëse është arrestuar në pajtim me nenin 27 dhe shteti i kërkuar nuk merr kërkesën për procedime brenda 18 ditësh nga data e arrestimit.
4. Një person i ndaluar do të lirohet në çdo rast në qoftë se është arrestuar në pajtim me nenin 27 dhe dokumentet, të cilat do të shoqëronin ankesën për procedim gjyqësor nuk janë marrë nga shteti i kërkuar brenda 15 ditëve nga pranimi i ankesës për procedime.
5. Periudha e ndalimit, e zbatuar në bazë të nenit 27, në asnjë rast nuk do të zgjasë më tepër se 40 ditë.

PJESA IV SHUMËLLOJSHMËRIA E PROCEDIMEVE PENALE

Neni 30

1. Çdo shtet kontraktues, i cili përpara fillimit ose gjatë procedimeve për një vepër penale, të cilën ai e konsideron që nuk është e natyrës politike ose ushtarake, është në dijeni të procedimeve që presin zgjidhje në një shtet tjetër kontraktues kundër të njëjtit person në lidhje me të njëjtën vepër penale, do të vlerësojë nëse mund të heqë dorë ose të ndërpresë procedimet e tij gjyqësore, ose t'i transferojë ato tek shteti tjetër.
2. Në qoftë se ai e gjykon të këshillueshme nga rrethanat për të mos hequr dorë ose pezulluar procedimet e tij gjyqësore, atëherë do të njoftojë për pasojë shtetin tjetër sa më shpejt, përpara dhënies së vendimit në lidhje me këtë çështje.

Neni 31

1. Në mundësinë e përmendur në nenin 30 paragrafi 2, shtetet e interesuara do të përpiqen sa të jetë e mundur të përcaktojnë, pas vlerësimit të rrethanave të përmendura në nenin 8, të cilat do të vazhdojnë të drejtojnë procedimet. Gjatë kësaj procedure konsultimi, shtetet e interesuara, do të shtyjnë për më vonë gjykimin në themel pa qenë të detyruar të zgjasin një shtyrje të tillë, përtej një periudhe 30-ditore nga dërgimi i njoftimit të parashikuar në nenin 30 paragrafi
2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk do të jenë detyruese:
 - (a) në shtetin dërgues të njoftimit të parashikuar në nenin 30 paragrafi 2, në qoftë se gjyqi kryesor ka qenë deklaruar i hapur atje në prani të të akuzuarit përpara nisjes së njoftimit;
 - (b) në Shtetin tek i cili është adresuar njoftimi, në qoftë se gjyqi kryesor ka qenë deklaruar i hapur atje në prani të të akuzuarit përpara marrjes së njoftimit.

Neni 32

Në interes të arritjes së të vërtetës dhe me qëllimin zbatimin e një sanksioni të përshtatshëm, shtetet e interesuara do të shqyrtojnë nëse është e përshtatshme që vetëm njëri prej tyre të kryejë procedime dhe nëse ndodh kështu, të përpiqet të vendosë se cili shtet, atëherë kur:

(a) disa vepra penale materiale dhe cilat klasifikohen në ligjin penal të secilit prej këtyre shteteve i janë atribuar ose një personi të vetëm ose disa personave që kanë vepruar bashkarisht;

(b) një vepër penale e vetme, e cila klasifikohet në ligjin penal të secilit prej atyre Shteteve, iu është atribuar disa personave që kanë vepruar në bashkëveprim.

Neni 33

Të gjitha vendimet e arritura në përputhje me nenin 31 paragrafi 1 dhe 32 do të shkaktojnë ndërmjet shteteve të interesuara, të gjitha pasojat e një transferimi të procedimeve, siç është parashikuar në këtë Konventë. Shteti, i cili heq dorë nga procedimet e tij gjyqësore do të konsiderohet se i ka transferuar ato te shteti tjetër.

Neni 34

Procedura e transferimit e parashikuar në Seksionin II të Pjesës III do të zbatohet për aq sa dispozitat e saj janë në pajtim me ato të përfshira në këtë pjesë.

PJESA V NE BIS IN IDEM

Neni 35

1. Një person, në lidhje me të cilën është dhënë një vendim gjyqësor penal përfundimtar dhe i detyrueshëm, për të njëjtin akt, mund të mos ndiqet penalisht, dënohet ose t'i nënshtrohet një sanksioni në një shtet tjetër kontraktues:

(a) në qoftë se ai është falur;

(b) në qoftë se sanksioni i kërkuar për t'u zbatuar:

(i) ka qenë zbatuar plotësisht ose është duke u zbatuar, ose

(ii) i është nënshtruar faljes ose amnistisë, plotësisht, ose në lidhje me pjesën e pazbatuar, ose

(iii) nuk mund të zbatohet për shkak të kalimit të afatit kohor;

c) në qoftë se gjyqi e ka shpallur fajtor të pandehurin pa kërkuar zbatimin e një sanksioni.

2. Megjithatë, një shtet kontraktues, përderisa nuk ka kërkuar procedime, nuk do të jetë i detyruar të njohë efektin e ne bis in idem në qoftë se akti që shkaktoi gjykimin është drejtuar kundër një personi, institucioni ose ndonjë gjëje me status publik, ose në qoftë se subjekti i gjykimit kishte vetë një status publik në atë shtet.

2. Përveç kësaj, një shtet kontraktues, në të cilin akti është kryer ose konsideruar si i tillë sipas ligjit të atij shteti, nuk është i detyruar të njohë efektin e ne bis in idem, në qoftë se ai nuk ka kërkuar vetë procedimet.

Neni 36

Në qoftë se procedimet e reja gjyqësore janë filluar kundër një personi, i cili në një shtet tjetër kontraktues ka qenë dënuar për të njëjtin akt, atëhere çdo periudhë e heqjes së lirisë e shkaktuar nga dënimi i kërkuar për t'u zbatuar do të zbritet nga sanksioni i cili mund të jepet.

Neni 37

Kjo pjesë nuk do të parandalojë zbatimin e dispozitave të brendshme më të zgjeruara, përsa i përket efektit të ne bis in idem që i bashkëngjitet vendimeve gjyqësore penale të huaja.

PJESA VI DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 38

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrimin ndaj shteteve anëtare të Këshillit të Europës. Ajo do t'i nështrohet ratifikimit ose miratimit. Instrumentet e ratifikimit ose miratimit do të depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.
2. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi pas tre muajsh nga data e depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit ose miratimit.
3. Përsa i përket një shteti nënshkrues, që e ratifikon ose e pranon atë më vonë, Konventa do të hyjë në fuqi pas tre muajsh nga data e depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit ose miratimit.

Neni 39

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës mund të ftojë çdo shtet joanëtar të aderojë në të, me kusht që rezoluta që përmban një ftesë të tillë të marrë miratimin unanim të Anëtarëve të Këshillit që kanë ratifikuar Konventën.
2. Një aderim i tillë do të pasohet nga depozitimi te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës, i instrumentit të aderimit, i cili do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të tij.

Neni 40

1. Çdo shtet kontraktues, në kohën e nënshkrimit apo të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, miratimit ose aderimit, mund të përcaktojë territorin ose territoret tek të cilat do të zbatohet kjo Konventë.
2. Çdo shtet kontraktues, në kohën e nënshkrimit apo të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, miratimit ose aderimit, ose në një datë të mëvonshme, nëpërmjet deklaratës drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund të shtrijë zbatimin e

kësaj Konvente në ndonjë territor ose territore të tjera të përcaktuara në deklaratë për marrëdhëniet ndërkombëtare të cilave ai është përgjegjës ose në emër të cilëve është i autorizuar të veprojë.

3. Çdo deklaratë, e bërë në pajtim me paragrafin e mësipërm, në lidhje me çdo territor të përmendur në një deklaratë të tillë, mund të tërhiqet në përputhje me procedurën e vendosur në nenin 45 të kësaj Konvente.

Neni 41

1. Çdo shtet kontraktues, në kohën e nënshkrimit apo depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, miratimit ose aderimit, mund të deklarojë se ai gëzon të drejtën të bëjë një ose disa nga rezervat e parashikuara në Shtojcën 1 ose të bëjë një deklaratë të parashikuar në Shtojcën 2 të kësaj Konvente.

2. Çdo shtet kontraktues mund të tërheqë plotësisht ose pjesërisht një rezervë ose deklaratë, që është bërë në përputhje me paragrafin e mësipërm, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, e cila do të hyjë në fuqi që nga data e marrjes së saj.

3. Një shtet kontraktues, i cili ka bërë një rezervë në lidhje me ndonjë dispozitë të kësaj Konvente, nuk mund të kërkojë zbatimin e kësaj dispozite nga një Shtet tjetër Kontraktues; megjithatë, në qoftë se rezerva e tij është e pjesshme ose e kushtëzuar, ai mund të kërkojë zbatimin e kësaj dispozite për aq sa ai vetë e ka pranuar atë.

Neni 42

1. Çdo shtet kontraktues, nëpërmjet një deklarate drejtuar në çdo kohë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund të deklarojë dispozitat ligjore që do të përfshihen në Shtojcën III të kësaj Konvente.

2. Çdo ndryshim i dispozitave të brendëshme shtetërore të renditura në Shtojcën III do t'i njoftohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, në qoftë se një ndryshim i tillë e bën të pasaktë informacionin në këtë Shtojcë.

3. Ndryshimet e bëra në Shtojcën III, në zbatim të paragrafeve të mësipërme, do të hyjnë në fuqi në seicilin shtet kontraktues një muaj pas datës së njoftimit të tyre te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 43

1. Kjo Konventë nuk prek as të drejtat dhe angazhimet që rrjedhin nga marrëveshjet mbi ekstradimin dhe konventat ndërkombëtare shumëpalëshe në lidhje me çështje të veçanta, dhe as dispozitat në lidhje me çështje që janë trajtuar në këtë Konventë dhe të cilat janë përfshirë në konventa të tjera ekzistuese ndërmjet shteteve kontraktuese.

2. Shtetet kontraktuese nuk mund të përfundojnë me njëra-tjetrën marrëveshje dypalëshe ose shumpalëshe në lidhje me çështje, që janë trajtuar në këtë Konventë, përveçse me qëllim për të plotësuar dispozitat e saj ose për të lehtësuar zbatimin e parimeve të mishëruara në të.

3. Megjithatë, në qoftë se dy ose më shumë shtete kontraktuese, do të kenë rregulluar marrëdhëniet e tyre në lidhje me këtë çështje, duke u bazuar në një legjislacion të njëjtë

apo në një sistem të posaçëm të krijuar prej tyre, ose nëse do ta bëjnë këtë në të ardhmen, ata do të kenë të drejtën t'i rregullojnë këto marrëdhënie në këtë mënyrë, pavarësisht nga kushtet e kësaj Konvente.

4. Shtetet kontraktuese, duke i dhënë fund zbatimit të kushteve të kësaj Konvente në marrëdhëniet e tyre reciproke në lidhje me këtë çështje, në përputhje me dispozitat e paragrafit të mësipërm, do të njoftojnë për pasojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 44

Komiteti European për Problemet e Krimit i Këshillit të Europës, do të informohet mbi zbatimin e kësaj Konvente dhe do të bëjë çdo gjë që është e nevojshme për të lehtësuar një zgjidhje miqësore të çdo vështirësie që mund të lindte nga zbatimi i saj.

Neni 45

1. Kjo Konventë do të mbesë në fuqi për një kohë të pacaktuar.
2. Çdo shtet kontraktues, për aq sa është i interesuar, mund të denoncojë këtë Konventë me anë të një njoftimi adresuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.
3. Një denoncim i tillë do të hyjë në fuqi gjashtë muaj pas marrjes së një njoftimi të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 46

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të njoftojë shtetet anëtare të Këshillit dhe çdo Shtet, i cili ka aderuar në këtë Konventë në lidhje me:

- a) çdo nënshkrim;
- b) çdo depozitim të një instrumenti ratifikimi, miratimi apo aderimi;
- c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në përputhje me nenin 38;
- d) çdo deklaratë të marrë në pajtim me dispozitat e nenit 9 paragrafi 3;
- e) çdo deklaratë të marrë në pajtim me dispozitat e nenit 13 paragrafi 3;
- f) çdo deklaratë të marrë në pajtim me dispozitat e nenit 18 paragrafi 2;
- g) çdo deklaratë të marrë në pajtim me dispozitat e nenit 40 paragrafi 2 dhe 3;
- h) çdo rezervë ose deklaratë të marrë në pajtim me dispozitat e nenit 41 paragrafi 1;
- i) tërheqjen e çdo rezervë apo deklarate të kryer në pajtim me dispozitat e nenit 41 paragrafi 2;
- j) çdo deklaratë të marrë në pajtim me nenin 42 paragrafi 1, dhe çdo njoftim të mëvonshëm të marrë në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni;
- k) çdo njoftim të marrë në pajtim me dispozitat e nenit 43 paragrafi 4;
- l) çdo njoftim të marrë në pajtim me dispozitat e nenit 45 dhe datën në të cilën denoncimi hyn në fuqi.

Neni 47

Kjo Konventë dhe njoftimet dhe deklaratat e autorizuara sipas saj do të zbatohen

vetëm ndaj veprave penale të kryera pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente dhe për shtet kontraktuese që janë përfshirë në të.

Në prani të nënshkruesve, të autorizuar në mënyrën e duhur, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Strazburg, më 15 Maj 1972, në gjuhën angleze dhe franceze, duke pasur të dy tekstet të njëjtën vlerë, një kopje e së cilës do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'i transmetojë kopjet e vërtetuara secilës prej qeverive nënshkruese dhe aderuese.

SHTOJCA I

Çdo shtet kontraktues mund të deklarojë që ai rezervon të drejtën:

- a) të refuzojë një ankesë për procedime, në qoftë se ai konsideron që vepra penale është thjesht e një natyre fetare;
- b) të refuzojë një ankesë për procedime për një akt sanksioni për të cilin, sipas ligjit të tij, mund të kërkohet të zbatohet vetëm nga një autoritet administrativ;
- c) për të mos pranuar nenin 22;
- d) për të mos pranuar nenin 23;
- e) për të mos pranuar dispozitat e përfshira në fjalinë e dytë të nenit 25 për arsye konstitucionale;
- f) për të mos pranuar dispozitat e vendosura në neni 26 paragrafi 2, aty ku ka kompetencë sipas ligjit të tij;
- g) për të mos zbatuar nenet 30 dhe 31 në lidhje me një akt për të cilin sanksionet, sipas ligjit të tij ose të ndonjë shteti tjetër të interesuar, mund të kërkohen të zbatohen vetëm nga një autoritet administrativ.
- h) për të mos pranuar Pjesën V.

SHTOJCA II

Çdo shtet kontraktues mund të deklarojë që për arsye që rrjedhin nga ligji i tij kushtetues mund të bëjë ose marrë kërkesa për procedime vetëm në rrethanat e përcaktuara në ligjin e tij të brendshëm.

Çdo shtet kontraktues, me anë të një deklarate, mund të përkufizojë për aqsa ka lidhje termin “shtetas” brenda kuptimit të kësaj Konvente.

SHTOJCA III

Lista e veprave penale përveç atyre të trajtuara nga ligji penal

Veprat penale të mëposhtme do të hyjnë në veprat penale sipas ligjit penale:

- Në Francë: çdo sjellje e paligjshme e dënueshme nga një (contravention de grande voirie).
- Në Republikën Federale Gjermane: çdo sjellje e paligjshme e trajtuar sipas procedurës së vendosur në Aktin mbi Dhunimin e Rregullave
- (Gesetz über Ordnungswidrigkeiten i 24 Majit 1968 – BGBl 1968,I, 481).
- Në Itali: çdo sjellje e paligjshme ndaj së cilës zbatohet Akti Nr.317 i 3 marsit 1967

L I G J
Nr.8499, datë 10.6.1999

**PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË KËSHILLIT TË EUROPËS “PËR
TRANSFERIMIN E PERSONAVE TË DËNUAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet Konventa e Këshillit të Europës “Për transferimin e personave të dënuar” të datës 21.3.1983, me deklaratimet e bëra në këtë ligj.

Neni 2

Bazuar në nenin 3 pika 3, Shqipëria deklaron moszbatimin e procedurave të parashikuara në nenin 9 pika 1 shkronja “a” të kësaj Konvente.

Neni 3

Bazuar në nenin 3 pika 4 “shtetas”, për qëllim të kësaj Konvente, do të kuptohen edhe personat pa shtetësi që kanë banim të përhershëm në Shqipëri, si dhe ata që mbajnë dy shtetësi, kur njëra është shqiptare.

Neni 4

Lidhur me nenin 17 pika 3, Republika e Shqipërisë deklaron se i pranon kërkesat për transferimin e personave të dënuar dhe të dokumenteve shoqëruese, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me një kopje të përkthimit në gjuhën shqipe ose në njërën nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Europës.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2402, datë 29.6.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

KONVENTA PËR TRANSFERIMIN E PERSONAVE TË DËNUAR

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe shtetet e tjera nënshkruese,
Duke parë se qëllimi i Këshillit të Europës është arritja e një uniteti më të madh ndërmjet anëtarëve të tij;

Duke dashur të zhvillojë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e së drejtës penale;
Duke parë se një bashkëpunim i tillë duhet t'i çojë më tej qëllimet e drejtësisë dhe rehabilitimin shoqëror të personave të dënuar;

Duke parë se këto objektiva kërkojnë që të huajve, të cilëve u është hequr liria si rezultat e kryerjes prej tyre të një vepre penale, duhet t'u jepet mundësia të vuajnë dënimin në shoqërinë e tyre; dhe

Duke parë se ky qëllim mund të arrihet më mirë duke i transferuar ata në vendet e tyre,
Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1 **Përkufizime**

Për qëllimet e kësaj konvente:

- a. “dënim” do të thotë çdo dënim apo masë që ka të bëjë me heqjen e lirisë, të vendosur nga një gjykatë për një periudhë kohe të caktuar ose të përcaktuar si rezultat i një vepre penale;
- b. “vendim” është çdo vendim ose urdhër i gjykatës që vendos një dënim;
- c. “shteti dënues” është shteti në të cilin është dhënë dënimi për personin, i cili mund ose është transferuar;
- d. “shteti zbatues” është shteti në të cilin personi i dënuar mund ose është transferuar për të vuajtur dënimin e tij.

Neni 2 **Parime të përgjithshme**

1. Palët angazhohen t'i ofrojnë njëra-tjetrës masën më të gjerë të bashkëpunimit në lidhje me transferimin e personave të dënuar në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente.
2. Një person i dënuar në territorin e një pale mund të transferohet në territorin e një pale tjetër, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, për të vuajtur dënimin që i është dhënë. Për këtë qëllim ai mund të shprehë interesin e vet tek shteti dënues ose tek shteti zbatues për transferimin e tij në përputhje me këtë Konventë.
3. Transferimi mund të kërkohet nga shteti dënues ose nga shteti zbatues.

Neni 3 **Kushte për transferim**

1. Në përputhje me këtë Konventë një person i dënuar mund të transferohet vetëm në kushtet e mëposhtme:

- a. nëse ai person është shtetas i shtetit zbatues;
 - b. nëse vendimi është i formës së prerë;
 - c. nëse në kohën e marrjes së kërkesës për transferim, personi i dënuar ka ende të paktën gjashtë muaj të dënimit për të vuajtur apo nëse dënimi është i papërcaktuar;
 - d. nëse për transferimin është dhënë pëlqimi nga personi i dënuar ose kur, duke marrë parasysh moshën ose gjendjen e tij fizike ose mendore dhe, kur njëri prej të dy shteteve e konsideron atë si të nevojshme, nëpërmjet përfaqësuesit ligjor të personit të dënuar;
 - e. nëse veprimet apo mosveprimet, në bazë të të cilave është dhënë dënimi, përbëjnë një vepër penale në përputhje me të drejtën e shtetit zbatues ose do të përbënte një vepër penale nëse do të ishte kryer në territorin e tij; dhe
 - f. nëse shteti dënues dhe ai zbatues janë dakord me transferimin.
2. Në raste të veçanta, palët mund të bien dakord me një transferim edhe nëse koha që duhet të vuhet nga personi i dënuar është më e shkurtër se ajo e përcaktuar në paragrafin 1.c.
3. Në kohën e nënshkrimit apo të depozitimit të dokumentit të ratifikimit, pranimit, miratimit ose anëtarësimit, çdo shtet mund të bëjë të ditur se ai do të përjashtojë zbatimin e njërës prej procedurave të parashikuara në nenin 9.1.a dhe b. në marrëdhëniet e tij me palët e tjera, me anë të një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.
4. Në çdo kohë çdo shtet mund të përcaktojë, për aq sa ai është i interesuar, termin “shtetas” për qëllimet e kësaj Konvente me anë të një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 4

Detyrimi për të dhënë informacion

1. Çdo person i dënuar për të cilin mund të zbatohet kjo Konventë informohet nga shteti dënues mbi lëndën e kësaj Konvente.
2. Nëse personi i dënuar i ka shprehur interes shtetit dënues për t’u transferuar në përputhje me këtë Konventë, ai shtet njofton shtetin zbatues sa më shpejt që të jetë e mundur mbasi vendimi të ketë marrë formë të prerë.
 1. Informacioni përmbledh:
 - a. emrin, datën dhe vendin e lindjes së personit të dënuar;
 - b. nëse ka, adresën në shtetin zbatues;
 - c. përshkrimin e fakteve mbi të cilat është bazuar dënimi;
 - d. natyrën, kohëzgjatjen dhe qëllimin e dënimit.
4. Nëse personi i dënuar i ka shprehur interesin e vet shtetit zbatues, shteti dënues me kërkesë i komunikon atij shteti informacionin e përmendur në paragrafin 3 të mësipërm.
5. Personi i dënuar informohet me shkrim për çdo veprim të ndërmarrë nga shteti dënues ose ai zbatues në përputhje me paragrafin e mësipërm, si edhe për çdo vendim nga çdo shtet mbi kërkesën për transferim.

Neni 5
Kërkesat dhe përgjigjet

1. Kërkesat për transferim dhe përgjigjet bëhen me shkrim.
2. Kërkesat bëhen nga Ministria e Drejtësisë e shtetit kërkues drejtuar Ministrisë së Drejtësisë të shtetit të adresuar. Përgjigjet komunikohen nëpërmjet të njëjtit kanal.
3. Secila palë mund të tregojë që ajo do të përdorë kanale të tjera komunikimi me anë të një deklaratë, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.
4. Shteti i adresuar njofton menjëherë shtetin kërkues për vendimin e tij nëse ai është dakord ose jo me transferimin e kërkuar.

Neni 6
Dokumentet shtesë

1. Shteti administrues i paraqet shtetit dënues, nëse kërkohen prej tij:
 - a. një dokument apo deklaratë që tregon se personi i dënuar është shtetas i atij shteti;
 - b. një kopje e ligjit përkatës të shtetit administrues, i cili parashikon që kryerja apo moskryerja e një veprimi për të cilin është dhënë dënimi në shtetin dënues përbën një vepër penale në pajtim me ligjin e shtetit administrues apo do të përbente një vepër penale nëse do të ishte kryer në trritorin e tij;
 - c. një deklaratë që të përmbajë informacionin e përmendur në nenin 9.2.
2. Nëse bëhet kërkesë për një transferim, shteti dënues i paraqet dokumentet e mëposhtme shtetit zbatues, nëse njëri prej shteteve ka bërë të ditur se ai nuk është dakord me transferimin:
 - a. një kopje të vërtetuar të vendimit dhe ligjit mbi të cilin ai është bazuar;
 - b. një deklaratë ku të tregohet se ç'pjesë e dënimit është vuajtur, duke përfshirë informacion për ndalimet paragjyqsose, shkurtimeve e dënimeve, si edhe për çdo faktor tjetër që ka të bëjë me ekzekutimin e dënimit;
 - c. një deklaratë ku të shprehet pëlqimi për transferimin e përmendur në nenin 3.1.d dhe
 - d. kur është e nevojshme, ndonjë raport mjekësor apo shoqëror për personin e dënuar, informacione për trajtimin e tij në shtetin dënues dhe ndonjë rekomandim për trajtimin e tij të mëtejshëm në shtetin zbatues.
3. Secili shtet mund të kërkojë të pajiset me çfarëdolloj dokumenti ose deklaratë të përmendura në paragrafin 1 ose 2 të mësipërm para se të bëjë kërkesën për transferimin ose para marrjes së vendimit për rënien dakord për transformimin e tij ose jo.

Neni 7
Pëlqimi dhe verifikimi

1. Shteti dënues sigurohet që personi i kërkuar për të dhënë pëlqimin për transferimin në përputhje me nenin 3.1.d e bën këtë me vullnetin e tij dhe me dije të plotë për pasojat e tij. Procedura për dhënien e këtij pëlqimi rregullohet nga ligji i shtetit dënues.
2. Shteti dënues i jep mundësi shtetit zbatues që të verifikojë nëpërmjet një konsulli ose një zyrtari tjetër, për të cilin është rënë dakord nga shteti zbatues, që pëlqimi është dhënë

në përputhje me kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 të mësipërm.

Neni 8

Efektet e transferimit për shtetin dënues

1. Marrja në dorëzim i personit të dënuar nga autoritetet e shtetit zbatues sjell si rezultat pezullimin e ekzekutimit të dënimit në shtetin dënues.
2. Shteti dënues nuk mund të ekzekutojë më tej dënimin, nëse shteti zbatues e konsideron ekzekutimin e dënimit si të përfunduar.

Neni 9

Efektet e transferimit për shtetin zbatues

1. Organet kompetente të shtetit zbatues:
 - a. vazhdojnë ekzekutimin e dënimit menjëherë ose nëpërmjet një vendimi gjykate ose administrativ, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 10;
 - b. konvertojnë dënimin me anë të një procedure gjyqësore ose administrative në një vendim të atij shteti, duke zëvendësuar kështu sanksionin e dhënë nga shteti dënues me një sanksion të parashikuar nga ligji i shtetit zbatues për të njëjtën vepër penale, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 11.
2. Nëse bëhet kërkesë, shteti zbatues informon shtetin dënues para transferimit të personit të dënuar, përta i përket procedurës që do të ndiqet.
3. Ekzekutimi i dënimit rregullohet nga ligji i shtetit zbatues dhe vetëm ai shtet është kompetent për të marrë të gjitha vendimet përkatëse.
4. Secili shtet që në përputhje me ligjin e vet kombëtar nuk mund të zbatojë ndonjë nga procedurat e përmendura në pikën 1, për të ekzekutuar masat e dhëna në territorin e një pale tjetër mbi personat të cilët për shkaqe të gjendjes së tyre mendore nuk mund të dënohen për kryerjen e veprës dhe që është i përgatitur për të pritur persona të tjerë për trajtim të mëtejshëm, mund të tregojë procedurat që ai do të ndjekë në raste të tilla, me anë të një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 10

Vazhdimi i ekzekutimit

1. Në rastin e vazhimit të ekzekutimit, shteti zbatues është i detyruar t'i përmbahet natyrës ligjore dhe kohëzgjatjes së dënimit, siç është përcaktuar në shtetin dënues.
2. Nëse ky dënim nga natyra ose kohëzgjatja nuk përputhet me ligjin e shtetit zbatues ose kur kjo parashikohet nga ligji i tij, ai shtet, me anë të një urdhri gjyqësor ose administrativ, mund të adoptojë sanksionin me dënimin ose masën e parashikuar nga ligji i vet për veprën penale. Përta i përket natyrës së tij, dënimi ose masa, nëse është e mundur, duhet të korrespondojë me atë të dhënë nga dënimi për t'u ekzekutuar. Për nga natyra ose kohëzgjatja, ai nuk duhet të rëndojë sanksionin e dhënë nga shteti dënues dhe nuk duhet të kalojë maksimumin e parashikuar nga shteti zbatues.

Neni 11
Konvertimi i dënimit

1. Në rastin e konvertimit të dënimit zbatohen procedurat e parashikuara nga ligji i shtetit zbatues. Kur bëhet konvertimi i dënimit, organi kompetent:
 - a. duhet t'u përmbahet konstatimeve për faktet kur ato shfaqen shprehimisht ose nënkuptohen nga vendimi i dhënë nga shteti dënues;
 - b. nuk mund të konvertojë një dënim me burgim në një dënim me gjobë;
 - c. shkurton periudhën e plotë të heqjes së lirisë që vuhet nga personi i dënuar; dhe
 - d. nuk e rëndon dënimin e personit të dënuar dhe nuk është i detyruar t'i përmbahet ndonjë minimumi që mund të parashikojë ligji i vendit zbatues për veprën ose veprat e kryera.
2. Nëse procedura e konvertimit kryhet pas transferimit të personit të dënuar, shteti zbatues e mban atë person në izolim ose siguron në ndonjë mënyrë tjetër praninë e tij në shtetin zbatues, derisa të dalë rezultati i procedurës.

Neni 12
Falja, amnistia, zëvendësimi

Secila palë mund të japë fjalë, amnisti ose zëvendësim të dënimit në përputhje me Kushtetutën ose ligjet e tjera.

Neni 13
Rishikimi i vendimit

Vetëm shteti dënues ka të drejtën për të vendosur mbi çdo kërkesë për rishikimin e vendimit.

Neni 14
Përfundimi i ekzekutimit

Shteti zbatues përfundon ekzekutimin e dënimit menjëherë sapo të informohet nga shteti dënues për çdo vendim ose masë si rezultat i të cilit dënimi duhet të përfundojë.

Neni 15
Informacioni për ekzekutimin

- Shteti zbatues i jep informacion shtetit dënues në lidhje me ekzekutimin e dënimit:
- a. kur ai e konsideron ekzekutimin e dënimit të përfunduar;
 - b. nëse personi i dënuar është arratisur nga izolimi para se të përfundojë ekzekutimin e dënimit; ose
 - c. kur shteti dënues kërkon një raport të veçantë.

Neni 16 Tranziti

1. Secila palë në përputhje me ligjin e vet e plotëson kërkesën për kalimin tranzit të një personi të dënuar përmes territorit të tij, nëse një kërkesë e tillë bëhet nga një palë tjetër ose kur ai shtet ka rënë dakord me një palë tjetër ose me një shtet të tretë për transferimin e atij personi.
2. Një palë mund të mos pranojë të lejojë tranzitin:
 - a. nëse personi i dënuar është shtetas i tij, ose
 - b. nëse vepra penale për të cilën është dhënë dënimi nuk përbën veprë penale në përputhje me ligjin e vet.
3. Kërkesat për tranzit dhe përgjigjet komunikohen nëpërmjet kanaleve të përmendura në dispozitat e nenit 5.2 dhe 3.
4. Një palë mund të plotësojë një kërkesë të bërë nga një shtet i tretë për tranzitin përmes territorit të tij të një personi të dënuar, nëse ai shtet ka rënë dakord me një palë tjetër për transferimin nga ose në territorin e vet.
5. Pala, së cilës i është kërkuar të lejojë kalimin tranzit, mund të mbajë personin e dënuar në izolim, vetëm për atë kohë për të cilën kërkohet për të realizuar kalimin tranzit në territorin e tij.
6. Palës, së cilës i kërkohet të lejojë tranzitin, mund t'i kërkohet të japë garanci se personi i dënuar nuk do të persekutohet ose, nëse nuk është parashikuar ndryshe në paragrafin e mësipërm, që nuk do të ndalohet apo do të burgoset në ndonjë mënyrë tjetër në territorin e shtetit tranzit për ndonjë veprë penale të kryer apo dënim të dhënë para largimit nga territori i shtetit dënues.
7. Nuk nevojitet kërkesë për tranzit, nëse transporti bëhet me rrugë ajrore mbi territorin e palës dhe nuk është parashikuar ndonjë ndalim atje. Megjithatë çdo shtet mund të kërkojë me anë të një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, miratimit ose anëtarësimit, që ai të njoftohet për çdo tranzit të tillë mbi territorin e vet.

Neni 17 Gjuha dhe shpenzimet

1. Informacioni në përputhje me nenin 4 paragrafi 2-4 jepet në gjuhën e palës së cilës i adresohet ose në njërën nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Europës.
2. Me kufizimet e pikës 3 të mëposhtme nuk nevojitet përkthim për kërkesat e transferimeve ose të dokumenteve shtesë.
3. Secili shtet mund të kërkojë që kërkesat për transferim ose dokumentet shtesë të shoqërohen me një përkthim në gjuhët ose në njërën nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Europës ose në njërën nga gjuhët që ai bën të ditur me anë të një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës në momentin e nënshkrimit ose kur të depozitohet instrumentin e ratifikimit, pranimit, miratimit ose anëtarësimit. Në këtë rast ai mund të deklarojë gatishmërinë e vet për të pranuar përkthime në çdo gjuhë tjetër, përveç gjuhës ose gjuhëve zyrtare të Këshillit të Europës.

4. Përveç kufizimit të parashikuar në nenin 6.2.a, dokumentet e transmetuara në zbatim të kësaj Konvente nuk nevojitet të vërtetohen.
5. Të gjitha shpenzimet e dala si rezultat i zbatimit të kësaj Konvente përballohen nga shteti zbatues, përveç shpenzimeve të dala ekskluzivisht në territorin e shtetit dënues.

Neni 18

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Konventa është e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe shtetet joanëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e saj. Ajo duhet të ratifikohet, pranohet ose miratohet. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit depozitohen tek Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.
2. Kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës në të cilën tre shtete anëtare të Këshillit të Europës kanë shprehur pëlqimin e tyre për t'iu nënshkruar Konventës në pajtim me dispozitat e paragrafit 1.
3. Për shtetet nënshkruese që e shprehin pëlqimin e tyre për t'iu nënshtruar Konventës pas këtij afati, Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

Neni 19

Anëtarësimi nga shtetet joanëtare

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës, pasi të konsultohet me shtetet kontraktuese, mund të ftojë çdo shtet që nuk është anëtar i Këshillit dhe që nuk përmendet në nenin 18.1 të anëtarësohet në Konventë, me anë të një vendimi të marrë nga shumica e parashikuar nga neni 20.d të Statutit të Këshillit të Europës dhe me votim unanim të përfaqësuesve të shteteve kontraktuese që kanë të drejtë të marrin pjesë në Komitet.
2. Për çdo shtet që anëtarësohet, Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati prej tre muajsh pas datës së depozitimit të instrumentit të anëtarësimit te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 20

Zbatimi territorial

1. Secili shtet mund të përcaktojë territorin në të cilin zbatohet kjo Konventë në kohën e depozitimit, mirtimit ose anëtarësimit.
2. Me anë të një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës në një kohë të mëvonshme, secili shtet mund të zgjerojë zbatimin e kësaj Konvente në çdo territor tjetër të përcaktuar në deklaratë. Në lidhje me këtë territor, Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati prej tre muajsh pas datës së marrjes së një deklaratë të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.
3. Çdo deklaratë e bërë në përputhje me dy paragrafët e mësipërm për territorin e specifikuar në të, mund të tërhiqet me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Tërheqja hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati prej tre muajsh pas datës së marrjes së një njoftimi të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 21
Zbatimi kohor

Kjo Konventë është e zbatueshme për ekzekutimin e dënimeve të dhëna para ose pas hyrjes së saj në fuqi.

Neni 22
Marrëdhëniet me Konventat dhe Marrëveshjet e tjera

1. Kjo Konventë nuk prek të drejtat dhe detyrimet si rezultat i marrëveshjeve për ekstradimin dhe marrëveshjet e tjera mbi bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet penale që parashikojnë transferimin e personave të ndaluar për qëllime ballafaqimi ose deponimi.
2. Nëse dy ose më shumë palë kanë përfunduar një marrëveshje ose traktat për transferimin e personave të dënuar, apo kanë vendosur në ndonjë mënyrë tjetër marrëdhëniet e tyre për këtë çështje, apo kur kanë ndërmend ta bëjnë këtë në të ardhmen, ata kanë të drejtë të zbatojnë atë marrëveshje ose traktat në vend të kësaj Konvente.
3. Kjo Konventë nuk prek të drejtat e shteteve palë në Konventën Europiane mbi vlefshmërinë ndërkombëtare të vendimeve penale, për të përfunduar marrëveshje bilaterale dhe multilaterale me njëri-tjetrin për çështjet që trajtohen në Konventë, për të plotësuar dispozitat e saj ose për të lehtësuar zbatimin e parimeve të shprehura në të.
4. Nëse një kërkesë për transferim futet në kuadrin e kësaj Konvente dhe të Konventës Europiane mbi Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Vendimeve Penale apo të ndonjë marrëveshjeje ose traktati tjetër për transferimin e personave të dënuar, shteti që bën kërkesën kur e bën atë, tregon se mbi bazën e cilit instrument ai e ka bërë.

Neni 23
Zgjidhje miqësore

Komiteti Europian për Problemet e Krimit të Këshillit të Europës mbahet i informuar në lidhje me zbatimin e kësaj Konvente dhe bën çfarëdo që të jetë e nevojshme për të lehtësuar një zgjidhje miqësore për çdo vështirësi që mund të lindë nga zbatimi i saj.

Neni 24
Shfuqizimi

1. Secila palë mund të shfuqizojë këtë Konventë në çdo kohë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.
2. Një shfuqizim i tillë hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas kalimit të një afati prej tre muajsh pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.
3. Siqoqoftë, kjo Konventë vazhdon të zbatohet për ekzekutimin e dënimeve të personave që janë transferuar në përputhje me dispozitat e Konventës para datës në të cilën ka hyrë në fuqi shfuqizimi.

Neni 25
Njoftimet

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës njofton shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe shtetet joanëtare që kanë qenë pjesëmarrëse në hartimin e kësaj Konvente dhe çdo shtet që është anëtarësuar në këtë Konventë për:

- a. çdo nënshkrim;
- b. depozitimin e çdo instrumenti të ratifikimit, pranimit, miratimit dhe anëtarësimit;
- c. çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në përputhje me nenet 18.2 dhe 3, 19.2 dhe 20.2 dhe 3;
- d. çdo akt tjetër, deklaratë, njoftim ose komunikim që ka të bëjë me Konventën.

VENDIM
NR.302, DATË 25.3.2009

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ORGANIZIMIN E FUNKSIONIMIN
E SHËRBIMIT TË PROVËS DHE PËR PËRCAKTIMIN E STANDARDEVE E
TË PROCEDURAVE, PËR MBIKËQYRJEN E EKZEKUTIMIT TË DËNIMEVE
ALTERNATIVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 31/12 të ligjit nr.8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rregullores “Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve e të procedurave, për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT TË PROVËS
DHE PËR PËRCAKTIMIN E STANDARDEVEE PROCEDURAVE PËR
MBIKËQYRJEN E EKZEKUTIMIT TË DËNIMEVE ALTERNATIVE**

TITULLI I

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

NENI 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave lidhur me:

- a) rolin e Shërbimit të Provës në çdo fazë të procedimit penal;
- b) organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës;
- c) statusin e punonjësve të Shërbimit të Provës;
- ç) standardet dhe procedurat e mbikëqyrjes së ekzekutimit të dënimeve alternative;
- d) mënyrën e realizimit të të drejtave të të dënuarve.

Neni 2 Përkufizime

Në kuptim të kësaj rregulloreje:

- a) “I dënuari” është personi, për të cilin gjykata ka vendosur dhënien e një dënimi alternativ sipas ligjit nr.7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- b) “Dënim alternativ” është një prej alternativave të dënimit me burgim të parashikuara në kreun VII të ligjit nr.7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- c) “Shërbimi” është Shërbimi i Provës.
- ç) “I dënuari në provë” nënkupton të dënuarin me masë alternative, për të cilin gjykata ka vendosur plotësimin e një ose disa detyrimeve gjatë një periudhe prove.
- d) “Prokurori” është prokurori i çështjes penale, në të cilën kërkohet asistenca e Shërbimit të Provës ose prokurori i ngarkuar me ekzekutimin e vendimit penal të masës alternative të dhënë ndaj një të dënuari.
- e) Dispozitat, që zbatohen për të dënuarin, zbatohen për aq sa janë të pajtueshme edhe për personin nën hetim dhe të pandehurin. Ndaj personit nën hetim dhe të pandehurit shtrihen edhe të drejtat dhe garancitë që janë parashikuar për të dënuarin.

Neni 3 Parimet e veprimtarisë

1. Veprimtaria e Shërbimit të Provës bazohet mbi parimin e ligjshmërisë, parimin e objektivitetit, si dhe mbi parimin e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.
2. Shërbimi i Provës siguron që në veprimtaritë e tij të mos ketë diskriminim mbi bazën e racës, ngjyrës, gjinisë, lindjes, gjuhës, kombësisë, etnisë apo origjinës sociale, mendimeve politike apo të tjera, fesë, kushteve fizike apo mendore, statusit ekonomik apo çdo statusi tjetër.
3. Shërbimi i Provës gjatë veprimtarisë së tij respekton dinjitetin e personit nën hetim, të pandehurit dhe të të dënuarit.
4. Në veprimtarinë e tij, Shërbimi i Provës përpiqet të zhvillojë ndjenjën e përgjegjësisë së të dënuarit ndaj komunitetit dhe viktimës, si dhe të mbështesë e inkurajojë riintegrimin social të të dënuarit nëpërmjet një qëndrimi korrekt ndaj punës, shtetit ligjor dhe rregullave të ndërveprimit social.

Neni 4 E drejta e ankimit

1. I dënuari ka të drejtën e ankimit administrativ kundër veprimeve të punonjësit të Shërbimit të Provës të caktuar me mbikëqyrjen e tij. Për shqyrtimin e këtij ankimi zbatohen rregullat e Kodit të Procedurës Administrative.
2. I dënuari ka të drejtën e ankimit tek prokurori apo gjykata për aktet e nxjerra nga

shërbimi i provës që kanë të bëjnë me çështje që lidhen me ekzekutimin e vendimit penal të dhënë ndaj tij. Për këto çështje zbatohen rregullat e Kodit të Procedurës Penale.

KREU II ROLI I SHËRBIMIT TË PROVËS

Neni 5

Administrimi dhe kompetenca tokësore e Shërbimit të Provës

1. Shërbimi i Provës është organ shtetëror në varësi të Ministrit të Drejtësisë. Shërbimi i Provës përbëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, si dhe zyrat vendore, të cilat janë të organizuara pranë gjykatave të rretheve gjyqësore.
2. Në rastin e të pandehurve, për të cilët autoriteti procedues ka kërkuar një raport vlerësimi, kompetente është zyra vendore e shërbimit të provës pranë gjykatës ku zhvillohet procedimi.
3. Në rastin e të dënuarve me një masë alternative, kompetente është zyra vendore pranë gjykatës ku i dënuari ka banimin.
4. Në rastin e të dënuarve me burgim që u nënshtrohen programeve rehabilituese apo për të cilët kërkohet nga gjykata kryerja e raporteve përpara lirimit, kompetente është zyra vendore pranë gjykatës ku ndodhet institucioni i ekzekutimit të dënimeve penale.
5. Çdo zyrë e Shërbimit të Provës vepron brenda kompetencës së vet tokësore. Në rast konflikti mbi kompetencën tokësore, çështja zgjidhet nga gjykata që ka dhënë vendimin me kërkesë të prokurorit ose të të dënuarit apo mbrojtësit të tij.

Neni 6

Roli dhe detyrat e Shërbimit të Provës

1. Shërbimi i Provës mbikëqyr dhe mbështet zbatimin e dënimeve alternative me qëllim mbrojtjen e interesave publike dhe parandalimin e kryerjes së veprave penale, asistimin e personit të dënuar gjatë kryerjes së dënimit alternativ në përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve që rrjedhin nga ky dënim, si dhe në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin e tij shoqëror.
2. Shërbimi i Provës bashkëpunon dhe paraqet informacion dhe raporte para prokurorisë dhe gjykatës sipas parashikimeve ligjore.
3. Shërbimi i Provës përcakton metodat e zbatimit të dënimit alternativ në përputhje me parashikimet ligjore. Kur është e nevojshme, Shërbimi i Provës bashkëpunon me institucione shtetërore, qendrore apo lokale, me komunitetin lokal, si dhe me institucione të tjera dhe organizata jofitimprurëse për zbatimin e dënimeve alternative.

TITULLI II ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I SHËRBIMIT TË PROVËS

KREU III ORGANIZIMI I SHËRBIMIT TË PROVËS

Neni 7 **Organizimi i përgjithshëm**

1. Shërbimi i Provës është organi i centralizuar, i cili organizohet dhe funksionon në nivel qendror dhe vendor. Ai përbëhet nga:
 - a) Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës në Ministrinë e Drejtësisë, niveli qendror; dhe
 - b) zyrat vendore pranë gjykatave të shkallës së parë, niveli vendor.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës drejton, organizon dhe kontrollon ekzekutimin e dënimeve alternative, si dhe merr masat përkatëse për zbatimin e kësaj rregulloreje dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore.
3. Zyrat vendore mbikëqyrin dhe mbështesin zbatimin e dënimeve alternative dhe varen administrativisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës.

Neni 8 **Drejtori i Përgjithshëm**

1. Drejtori i Përgjithshëm përgjigjet për drejtimin, bashkërendimin dhe kontrollin e Shërbimit të Provës.
2. Drejtori i Përgjithshëm emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga Ministri i Drejtësisë.

Neni 9 **Përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm**

Drejtori i Përgjithshëm ka këto përgjegjësi:

- a) Drejton, bashkërendon dhe kontrollon veprimtarinë e Shërbimit të Provës.
- b) Merr masat që Shërbimi i Provës të veprojë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përmbushje të detyrave ligjore.
- c) Përgatit dhe nxjerr urdhra, udhëzime të brendshme dhe metodika për trajtimin e çështjeve në kompetencë të Shërbimit të Provës.
- ç) I propozon Ministrin të Drejtësisë emërimin, lirimin dhe shkarkimin e drejtorëve të zyrave vendore të Shërbimit të Provës.
- d) Urdhëron kryerjen e inspektimeve në Shërbimin e Provës
- dh) Emëron, liron dhe shkarkon punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës.
- e) Emëron, liron dhe shkarkon punonjësit e zyrave vendore të Shërbimit të Provës me propozim të drejtorit përkatës të zyrës vendore.

- ë) Organizon dhe ndjek edukimin profesional dhe trajnimin e punonjësve të Shërbimit të Provës.
- f) Ndjek zbatimin e etikës profesionale gjatë veprimtarisë së Shërbimit të Provës.
- g) Përfaqëson Shërbimin e Provës në marrëdhënie me të tretët.
- gj) I raporton Ministrit të Drejtësisë, të paktën një herë në muaj, për veprimtarinë e kryer nga Shërbimi i Provës, duke vënë në dukje mangësitë e mundshme ligjore dhe nevojat për ndryshime përkatëse.
- h) Ushtron përgjegjësi të tjera të përcaktuara në akte ligjore.

Neni 10

Organika dhe struktura e Shërbimit të Provës

1. Struktura dhe organika e Shërbimit të Provës miratohet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë.
2. Organizimi i brendshëm i çdo zyre vendore miratohet nga Ministri i Drejtësisë, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, bazuar në parimin e specialitetit të natyrës së punës dhe të efektivitetit.
3. Zyrat vendore të Shërbimit të Provës përbëhen nga:
 - a) drejtori i zyrës;
 - b) punonjësit e Shërbimit të Provës
4. Drejtori i zyrës vendore emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga Ministri i Drejtësisë me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.
5. Punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës emërohen, lirohen dhe shkarkohen nga Drejtori i Përgjithshëm.
6. Punonjësit e zyrës vendore emërohen, lirohen dhe shkarkohen nga Drejtori i Përgjithshëm me propozim të drejtorit të zyrës vendore.

Neni 11

Burimet financiare

1. Për realizimin e detyrave, Shërbimi i Provës ka buxhetin e vet, si pjesë të veçantë brenda buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë.
2. Shërbimi i Provës ka të drejtë të përdorë të ardhura të tjera që lejohen me ligj.

KREU IV

STATUSI I PUNONJËSIT TË SHËRBIMIT TË PROVËS

Neni 12

Punonjësi i shërbimit të provës

1. Punonjësi i Shërbimit të Provës është personi i ngarkuar me mbikëqyrjen dhe asistimin e të dënuarit në zbatimin e dënimit alternativ, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
2. Në ushtrimin e veprimtarisë së tij, punonjësi i Shërbimit të Provës udhëhiqet nga ndershmëria, paanësia dhe profesionalizmi.

Neni 13
Rregulla të përgjithshme për emërimin

1. Emërohet punonjës i Shërbimit të Provës shtetasi që plotëson këto kushte:
 - a) të jetë shtetas shqiptar;
 - b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
 - c) të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht për të kryer detyrën;
 - ç) të ketë kryer arsimin e lartë në degët psikologji, punë sociale, sociologji ose juridik;
 - d) të gëzojë figurë të pastër morale.dh) të mos jetë i dënuar për kryerjen e një vepre penale me vendim gjyqësor të formës së prerë.
 - e) të ketë aftësi të mira komunikuese dhe organizative.
2. Rekrutimi i punonjësve në Shërbimin e Provës i nënshtrohet parimit të konkurrimit të hapur bazuar në meritat. Konkursi organizohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës. Kandidati fitues emërohet përkohësisht punonjës i Shërbimit të Provës për një periudhë prove 3-mujore.
3. Emërohet drejtor i zyrës vendore i Shërbimit të Provës, personi që, përveç kriterëve të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, plotëson edhe kriteret e mëposhtme:
 - a) të ketë pesë vjet përvojë profesionale në fushën përkatëse, nga të cilat të paktën një vit në pozicion drejtues;
 - b) të mos ketë marrë masa disiplinore gjatë përvojës së tij profesionale;
 - c) të ketë aftësi drejtuese dhe administruese, interpretuese të politikave qeverisëse dhe zbatuese të tyre, planifikuese dhe përbaluese të krizave, si dhe aftësi për të ndërtuar marrëdhënie pozitive me gjykatat, prokurorinë dhe bashkëpunëtorët e Shërbimit të Provës.

Neni 14
Periudha e provës

1. Gjatë periudhës së provës, punonjësi i Shërbimit të Provës është nën kujdesin e një punonjësi të vjetër në detyrë. Veprimtaritë e trajnimit janë të detyrueshme për punonjësin e Shërbimit të Provës në periudhën e provës. Gjatë periudhës së provës, punonjësi në provë ka të njëjtat të drejta dhe detyrime me punonjësit e tjerë të Shërbimit të Provës.
2. Në përfundim të periudhës së provës, punonjësi i vjetër në detyrë mbikëqyrës, së bashku me drejtorin e zyrës vendore përgatishin një raport vlerësimi të punës së kryer nga punonjësi në provë, të cilin ia paraqesin Drejtorit të Përgjithshëm me propozimin konkret.
3. Në përfundim të periudhës së provës, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës vendos:
 - a) emërimin përfundimtar si punonjësi i Shërbimit të Provës;
 - b) lirimimin nga Shërbimi i Provës.

Neni 15
Papajtueshmëritë

1. Punonjësi apo drejtuesi në Shërbimin e Provës nuk mund të kryejë funksione të tjera,

publike apo private, të cilat bien ndesh me detyrat e tij funksionale ligjore.

2. Ai nuk duhet të jetë në marrëdhënie pune ose të kryejë veprimtari të tjera, të cilat paraqesin konflikt interesash me detyrën që ka ose pengojnë përmbushjen e saj.

Neni 16

Përfshirja e punonjësit të Shërbimit të Provës në rastet e konfliktit të interesit

1. Punonjësi i Shërbimit të Provës deklaron të gjitha rastet e rënies së tij në konflikt interesit sipas parashikimeve të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, gjatë detyrave të tij për mbikëqyrjen dhe asistimin e të dënuarit.

2. Veçanërisht, ai është i detyruar të kërkojë heqjen dorë nga mbikëqyrja dhe asistimi i të dënuarit në rastet e konfliktit faktik dhe të vazhdueshëm të interesit me të dënuarin ose me institucionet e kryerjes së dënimit alternativ nga i dënuari.

3. Deklarimi i konfliktit të interesit dhe kërkesa për heqjen dorë i paraqitet për vendim drejtorit të zyrës përkatëse të Shërbimit të Provës. Në rastin e drejtorit të zyrës vendore, aktet i paraqiten për vendim Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës. Përmbajtja e kërkesës dhe e vendimit, në çdo rast, i njoftohet palëve.

Neni 17

Të drejtat dhe detyrat e punonjësit të Shërbimit të Provës

Punonjësit e Shërbimit të Provës gëzojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e punëmarrësit të njohura nga legjislacioni i punës për aq sa ato përputhen me detyrat e tyre funksionale ligjore.

Neni 18

Dokumenti i identifikimit

1. Punonjësi i Shërbimit të Provës ka dokument identifikues, të cilin e paraqet gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij. Dokumenti përdoret vetëm gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të saj.

2. Modeli i dokumentit identifikues miratohet nga Ministri i Drejtësisë me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm.

Neni 19

Trajnimi

1. Shërbimi i Provës organizon kurse trajnimi të detyrueshme për punonjësit, me qëllim aftësimin profesional dhe përsosjen e njohurive në drejtim të kryerjes së detyrave me efektivitet dhe profesionalizëm.

2. Shërbimi i Provës krijon marrëdhënie bashkëpunimi me institucione lokale, publike, shtetërore, private, organizata jofitimprurëse, vendase apo të huaja, për realizimin e detyrimit për trajnim të punonjësve të Shërbimit të Provës.

Neni 20

Lirimi nga detyra e punonjësit të Shërbimit të Provës

Punonjësi i Shërbimit të Provës lirohet nga detyra kur:

- a) jep dorëheqjen;
- b) mbush moshën e pensionit;
- c) nuk kalon me sukses periudhën e provës në punë sipas nenit 14.

KREU V

MASAT DISIPLINORE

Neni 21

Përgjegjësia disiplinore

1. Shkelja e dispozitave të ligjit “Për ekzekutimin e vendimeve penale” , të ndryshuar, të Kodit të Procedurave Administrative, të Kodit të Punës, të Kodit të Etikës ose të kësaj rregulloreje, përbën shkak për përgjegjësi disiplinore.
2. Shkeljet disiplinore klasifikohen në shkelje të lehta, shkelje të rënda dhe shkelje shumë të rënda.
3. Shkelja e rregullave të etikës gjatë orarit zyrtar përbën shkelje të lehtë disiplinore.
4. Shkelja e dispozitave të kësaj rregulloreje dhe e dispozitave ligjore që lidhen me detyrën funksionale përbën shkelje të rëndë disiplinore.
5. Shkelja e dispozitave urdhëruese të kësaj rregulloreje dhe e dispozitave urdhëruese ligjore që sjellin pasoja, si dhe e afateve të përcaktuara për kryerjen e veprimeve përbën shkelje shumë të rëndë disiplinore.
6. Përsëritja e shkeljeve përbën shkelje shumë të rëndë disiplinore.

Neni 22

Llojet e masave disiplinore

1. Masat disiplinore që merren ndaj punonjësve janë si më poshtë:
 - a) vërejtje;
 - b) vërejtje me shkrim;
 - c) vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra;
 - ç) shkarkim nga detyra.
2. Këto masa disiplinore jepen në mënyrë të përshkallëzuar dhe në raport me pasojën që shkelja disiplinore ka shkaktuar.
3. Për shkelje të lehta jepet masa disiplinore e parashikuar në pikën 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c”.
4. Për shkelje të rënda jepet masa disiplinore e parashikuar në pikën 1, shkronja “b” dhe “c”.
5. Për shkelje shumë të rënda jepet masa disiplinore e parashikuar në pikën 1, shkronja “c” dhe “ç”.

Neni 23

Procedura për dhënien e masave disiplinore

1. Masat disiplinore ndaj punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe jepen nga Drejtori i Përgjithshëm.
2. Masat disiplinore ndaj drejtorëve të zyrave vendore jepen nga Ministri i Drejtësisë me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm.
3. Masat disiplinore ndaj punonjësve të zyrës vendore jepen nga Drejtori i Përgjithshëm me propozim të drejtorit të zyrës vendore.
4. Masat disiplinore jepen sipas një procedure që garanton të drejtën për t'u informuar, për t'u dëgjuar, për t'u mbrojtur dhe për t'u ankuar.

TITULLI III

MBIKËQYRJA E EKZEKUTIMIT TË DËNIMEVE ALTERNATIVE

KREU VI

STANDARDET DHE PROCEDURAT E MBIKËQYRJES SË EKZEKUTIMIT TË DËNIMEVE ALTERNATIVE

Neni 24

Kontakti i parë i të dënuarit me Shërbimin e Provës

1. Zyra vendore kompetente vendos kontaktin e parë me të dënuarin brenda pesë ditëve nga dita që merr njoftim për urdhrin e ekzekutimit të prokurorit për vendimin penal gjyqësor që ka caktuar dënimin alternativ.
2. Pas njoftimit të urdhrin të ekzekutimit, drejtori i zyrës vendore të Shërbimit të Provës cakton një ose dy punonjës të Shërbimit të Provës për të vendosur kontaktin e parë me të dënuarin dhe për të mbikëqyrur zbatimin e dënimit alternativ.
3. Punonjësi i caktuar për mbikëqyrjen njofton të dënuarin për datën e kontaktit të parë. Në njoftim tregohet vendi, data dhe ora e kontaktit, si dhe numri i telefonit dhe adresa e Shërbimit të Provës. Ky njoftim kryhet me mjete teknike të përshtatshme që garantojnë njoftimin, si: telefoni, telegrafi, telegrami, faksi apo posta elektronike. Ky njoftim ka vlerë kur i dënuari konfirmon marrjen e tij.
4. Kur i dënuari është i mitur, punonjësi i caktuar me mbikëqyrjen njofton edhe mbrojtësin e të dënuarit, me qëllim dhënien e informacionit për vendndodhjen e zyrës vendore të Shërbimit të Provës, numrin e telefonit dhe emrin e punonjësit të Shërbimit të Provës të ngarkuar me çështjen.
5. Në rast të mungesës së konfirmimit të njoftimit nga i dënuari, punonjësi i caktuar me mbikëqyrjen i drejtohet menjëherë prokurorit të ekzekutimit për të realizuar njoftimin nëpërmjet shërbimeve të policisë gjyqësore. Në këtë rast afati i kontaktit të parë është dy ditë nga data e njoftimit të të dënuarit.
6. Në kontaktin e parë me të dënuarin punonjësi i Shërbimit të Provës verifikon identitetin e tij dhe e informon atë mbi qëllimin dhe objektivat e mbikëqyrjes, arsyet e dhënies së dënimit alternativ nga gjykata dhe pasojat e përmbushjes ose jo të tij.

7. Shërbimi i Provës informon të dënuarin edhe për detyrimin e tij për të respektuar rregullat mirësjelljes, veçanërisht me ato që kanë të bëjnë me shmangien e sjelljeve të dhunshme apo agresive dhe shmangien e përdorimit të gjuhës së papërshtatshme që dëmtojnë punonjësit e Shërbimit të Provës.

8. Punonjësi i Shërbimit të Provës informon të dënuarin mbi të drejtën e tij për t'u ankuar pranë drejtorit të zyrës vendore në rast se ai e konsideron të papërshtatshëm trajtimin e tij gjatë periudhës së mbikëqyrjes.

9. Punonjësi i Shërbimit të Provës i dokumenton këto veprime informuese në procesverbal, i cili nënshkruhet prej tij dhe të dënuarit. Kur i dënuari është i mitur, procesverbali nënshkruhet edhe nga mbrojtësi i tij.

10. Në kontaktin e parë me të dënuarin, punonjësi i Shërbimit të Provës kryen një vlerësim paraprak mbi situatën e të dënuarit, me qëllim hartimin e programit të mbikëqyrjes.

11. Punonjësi i Shërbimit të Provës kryen vlerësimin e personalitetit të të dënuarit në programin e mbikëqyrjes, me qëllim analizimin e:

- a) veprimeve/mosveprimeve penale, rrezikshmërisë shoqërore dhe dëmit të shkaktuar;
- b) situatës familjare, ekonomike dhe sociale dhe qëndrimit të të dënuarit ndaj saj;
- c) të planeve afatshkurtra dhe afatgjata të të dënuarit dhe mënyrave për realizimin e tyre.

12. Nëse nga vlerësimi rezulton se i dënuari është përdorues i pijeve alkoolike apo i substancave narkotike apo psikotrope, punonjësi i Shërbimit të Provës vlerëson llojin e substancave të përdorura, sasinë, masën e përdorimit dhe mënyrat e sigurimit të substancës, periudhën dhe historikun e konsumimit të substancës, si dhe nëse është rasti institucionin ku i dënuari është regjistruar për trajtim. Në përfundim të këtij vlerësimi, punonjësi i Shërbimit të Provës përgatit raportin e vlerësimit dhe njofton prokurorin në përputhje me ligjin.

13. Në përfundim të kontaktit të parë me të dënuarin, punonjësi i Shërbimit të Provës e njofton atë për datën dhe vendin e takimit të ardhshëm.

14. Punonjësi i Shërbimit të Provës, pas kontaktit të parë, regjistron të dënuarin në regjistrin e të dënuarve.

Neni 25

Dosja personale

1. Për çdo të dënuar hapet dosja personale, plotësimi i së cilës fillon që në momentin e vendosjes së kontaktit të parë me të dënuarin dhe vazhdon deri në përfundimin e ekzekutimit të dënimit.

2. Dosja personale përmban:

- a) vendimin penal gjyqësor që cakton dënimin alternativ;
- b) urdhrin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të lëshuar nga prokurori;
- c) raportin e vlerësimit të përgatitur gjatë fazës së hetimeve paraprake për caktimin e dënimit alternativ, nëse ka;
- ç) një fotokopje të dokumentit të identifikimit të të dënuarit;
- d) raportin mjekësor për vlerësimin e kushteve shëndetësore, kur është e nevojshme;
- dh) procesverbalin e kontakteve me të dënuarin;

- e) programin e mbikëqyrjes;
 - ë) raportet e përpiluara nga Shërbimi i Provës dhe të dërguara në gjykatë ose prokurori gjatë periudhës së mbikëqyrjes;
 - f) çdo paralajmërim të dhënë nga prokurori për shkelje të detyrimeve të vendosura nga gjykata gjatë periudhës së mbikëqyrjes;
 - g) një ekstrakt të paralajmërimit të bërë nga prokurori në rastin e shkeljeve të lehta dhe të kryera për herë të parë, nëse ka;
 - gj) raportin përfundimtar të hartuar nga Shërbimi i Provës në përfundim të mbikëqyrjes;
 - h) të dhëna mbi përparimin e të dënuarit gjatë periudhës së mbikëqyrjes, duke përfshirë arsyet për përfundimin e parakohshëm të saj;
 - i) kopje të ankesave të të dënuarit mbi Shërbimin e Provës dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre;
 - j) kopje të ankesës së të dënuarit mbi të dhënat dhe përmbajtjen e dosjes personale;
 - k) urdhrin e caktimit të institucionit të ekzekutimit të masës alternative;
 - l) çdo dokument tjetër në lidhje me të dënuarin që është i nevojshëm për realizimin e mbikëqyrjes.
3. Informacioni i përfshirë në dosjen personale duhet të jetë i besueshëm, objektiv dhe të ketë të bëjë vetëm me çështjet që lidhen me masën apo llojin e dënimit dhe ekzekutimin e tij.
4. Punonjësi i Shërbimit të Provës i caktuar informon të dënuarin mbi të drejtën për t'u njohur me aktet në dosjen personale, si dhe i shpjegon atij përmbajtjen e dosjes.
5. Me përfundimin e kryerjes së dënimit alternativ ose në rast lirimi, dosja arkivohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës.

Neni 26

Regjistrat e Shërbimit të Provës

1. Çdo zyrë vendore e Shërbimit të Provës hap dhe ruan regjistrat e mëposhtëm:
 - a) regjistri themeltar i personave të dënuar;
 - b) regjistri i kërkesë-ankesave;
 - c) regjistri i shkeljeve të planit individual të trajtimit;
 - ç) regjistri i ngjarjeve të rënda;
 - d) regjistri i OJF-ve dhe institucioneve të tjera që ofrojnë këshillim dhe asistencë ose vende pune për të dënuarit me dënim alternativ.
2. Përmbajtja e regjistrave të përmendur në paragrafin 1 përcaktohet me urdhër të Ministrit të Drejtësisë me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.
3. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës krijon regjistrin elektronik, në të cilin regjistron të dhënat e zyrave vendore. Të dhënat e këtij regjistri përditësohen çdo javë.

Neni 27

Shfrytëzimi i të dhënave

1. Të dhënat lidhur me të dënuarin mbahen në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin nr.9887 datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, karakterin

konfidencial të tyre dhe mund të njihen nga Ministri i Drejtësisë, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës, drejtori i zyrës vendore të Shërbimit të Provës, i dënuari, nga çdo autoritet tjetër në përputhje me legjislacionin në fuqi për klasifikimin e akteve dhe për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Dhënia e informacioneve të dosjes personale apo regjistrin lejohet vetëm në rast se këto informacione kanë lidhje me ushtrimin e detyrave të autoritetit që e kërkon atë.

3. Dhënia e informacioneve mbi të dënuarin, institucioneve apo organizatave që sigurojnë për të vende pune apo asistencë sociale, lejohet vetëm në përputhje me funksionet dhe rolin e tyre në zbatimin e dënimit alternativ. Ndalohet dhënia e informacioneve mbi veprën penale dhe personalitetin e të dënuarit pa një pranim të shprehur të tij, me qëllim parandalimin e ndërhyrjeve në jetën e tij private.

4. I dënuari ka të drejtë të kundërshtojë të dhënat dhe përmbajtjen e dosjes së tij personale nëpërmjet një ankese me shkrim drejtuar Drejtorit të Shërbimit të Provës.

Neni 28

Trajtimi i të dënuarit

1. Shërbimi i Provës vlerëson personalitetin e të dënuarit, me qëllim qartësimin e nevojave lidhur me mungesat fizike, afektive ose shoqërore, vullnetit të të dënuarit për punë dhe aftësitë e tij profesionale, të cilat kanë penguar zhvillimin e një jete shoqërore normale të tij. Shërbimi bazuar në këtë vlerësim, si dhe në të dhënat personale, familjare e shoqërore, masën e dënimit, ndërton programin individual të trajtimit të të dënuarit në përputhje me dënimin alternativ përkatës. Ky program duhet të miratohet nga drejtori i zyrës përkatëse vendore.

2. Në takimin e dytë me të dënuarin, punonjësi i Shërbimit të Provës i caktuar i paraqet dhe shpjegon të dënuarit përmbajtjen e programit individual. Programi individual i trajtimit të të dënuarit, diskutohet me të dënuarin. Ky program mund të ndryshohet në varësi të ecurisë së të dënuarit.

3. Programi individual nënshkruhet nga punonjësi i Shërbimit të Provës dhe i dënuari dhe, kur i dënuari është i mitur, edhe nga mbrojtësi i tij. Një kopje e programit individual i dorëzohet të dënuarit dhe mbrojtësit të tij.

4. Programi individual përmban elementet e mëposhtme:

a) pjesa hyrëse, në të cilën tregohen gjeneralitetet, adresa e vendbanimit, vepra penale e kryer, numri i vendimit gjyqësor, dënimi i dhënë, periudha e provës, duke përmendur datat e fillimit dhe të mbarimit të saj, si dhe emri dhe mbiemri i punonjësit të Shërbimit të Provës të caktuar;

b) masat dhe çdo detyrim tjetër të vendosur nga gjykata, si dhe mënyrat e përdorura nga punonjësi i Shërbimit të Provës për të siguruar përmbushjen e këtyre detyrimeve dhe masave.

c) nevojat kriminogjene dhe sociale të personit nën mbikëqyrje, si dhe qëllimet e përcaktuara për përmirësimin e tyre;

ç) rreziku i përsëritjes së veprës penale, rreziku i cenimit të sigurisë publike dhe ai i vetëvrasjes apo vetëdëmtimit;

d) metodat e propozuara të ndërhyrjes për të plotësuar nevojat e identifikuar dhe për të

reduktuar rrezikun;

dh) data, vendi dhe frekuenca e takimeve midis punonjësit të Shërbimit të Provës dhe të dënuarit që do të mbahen gjatë gjithë periudhës së mbikëqyrjes të përcaktuar nga gjykata.

5. Kur gjykata vendos detyrimin e të dënuarit për të marrë pjesë në një program rehabilitimi, programi individual shkurtimisht përshkruan përmbajtjen, kohëzgjatjen dhe mënyrën e kryerjes së tij.

6. Kur gjykata vendos detyrimin e kryerjes së një pune të papaguar në interes publik, plani i mbikëqyrjes përmban përshkrimin e veprimtarive, vendin e punës dhe oraret e saj.

7. Gjatë periudhës së mbikëqyrjes, punonjësi i Shërbimit të Provës përcakton, në çdo takim, se deri në çfarë mase janë realizuar objektivat e planit të mbikëqyrjes.

8. Kur ndodhin ndryshime që mund të ndikojnë tek nevojat dhe rreziqet e identifikuara, plani i mbikëqyrjes mund të rishikohet, nëpërmjet anekseve që i shtohen atij.

9. Në rast rishikimi të planit të mbikëqyrjes, paragrafi 3 zbatohet kur është e përshtatshme.

Neni 29

Asistimi i të dënuarit

1. Në bazë të rezultateve të vlerësimit të personalitetit dhe kontakteve të vazhdueshme me të dënuarin gjatë ekzekutimit të dënimit alternativ, Shërbimi i Provës e ndihmon atë në kapërcimin e vështirësive për riintegrim social. Shërbimi i Provës kontakton me familjen e të dënuarit, persona të tjerë të afërt me të, kryen vëzhgim të mjedisit social të të dënuarit, bashkëpunon me OJF-të dhe shërbimin e ndërmjetësimit me qëllim reduktimin dhe eliminimin e rrezikshmërisë shoqërore të të dënuarit dhe rehabilitimin e tij.

2. Në kryerjen e kësaj veprimtarie, Shërbimi i Provës synon të:

a) reduktojë dhe eliminojë rrezikshmërinë shoqërore të të dënuarit, duke e ndërgjegjësuar atë mbi veprën penale të kryer dhe pasojat e saj;

b) ndërgjegjësojë të dënuarin për rrezikshmërinë dhe rëndësinë e veprës penale, si dhe vetëdisiplinën;

c) hartojë dhe të realizojë programe efektive asistence dhe këshillimi për të dënuarin bazuar në nevojat e identifikuara të tij;

ç) mbështesë të dënuarin me qëllim përmbushjen e nevojave sociale që lidhen me edukimin, trajnimin, punësimin, strehimin e nevoja të tjera të ngjashme;

d) respektojë të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të të dënuarve, dhe të garantojë respektimin e dinjitetit personal të tyre.

Neni 30

Mospërmbushja e kushteve dhe detyrimeve që rrjedhin nga dënimi alternativ

1. Në rast pamundësie të përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve që rrjedhin nga dënimi alternativ, pasi verifikon faktet dhe rrethanat që ndikojnë në pamundësinë e përmbushjes, dhe pas takimit me të dënuarin, Shërbimi i Provës i dërgon menjëherë një raport njoftimi

prokurorisë mbi arsyet e mospërbushjes së detyrimeve nga i dënuari.

2. Shërbimi i Provës i bashkëlidh raportit, sipas rastit, kur është e nevojshme, të dhëna në lidhje me mospërbushjen nga ana e të dënuarit të detyrimeve të vendosura nga gjykata.

3. Raporti përmban edhe një propozim për prokurorin për veprimet që duhen ndërmarrë në përputhje me shkallën e rrezikshmërisë së shkeljes dhe vlerësimin që Shërbimi i Provës i ka bërë rastit.

4. Llojet e propozimit për prokurorin janë:

- a) dhënia e një paralajmërimi në rastet e të miturve ose shkeljeve të kryera për herë të parë;
- b) paraqitja e kërkesës drejtuar gjykatës për të ndryshuar detyrimin, për të shtuar detyrime të tjera, për t'i zëvendësuar ato me dënime të tjera ose për të revokuar pezullimin e kryerjes së dënimit dhe periudhën e dënimit me burgim.

Neni 31

Detyrimi për të hartuar dhe paraqitur raportin

Shërbimi i Provës, me kërkesë të prokurorit ose gjykatës, paraqet një raport vlerësues për personin nën hetim, për të pandehurin ose për të dënuarin në këto raste:

- a) gjatë fazës së hetimeve paraprake;
- b) gjatë gjykimit përpara dhënies së vendimit penal;
- c) gjatë fazës së ekzekutimit të dënimit penal:
 - i) në rastin e mbikëqyrjes së personit të dënuar;
 - ii) në rastin e shqyrtimit të kërkesës për lirim me kusht;
 - iii) në përfundimin para kohe të periudhës së vënies në provë;
 - iv) në përfundim të dënimit alternativ apo në përfundim të përmbushjes së detyrimeve të caktuara.

Neni 32

Raporti i shërbimit të provës

1. Shërbimi i Provës harton raportin vlerësues duke analizuar rrethanat sociale që lidhen me personin nën hetim, të pandehurin apo të dënuarin. Ky raport paraqet një ekspertim të personit nën hetim, të pandehurit apo të dënuarit brenda kompetencave të shërbimit të provës.

2. Në rastin e fazës së hetimeve paraprake dhe të gjykimit, ky raport hartohet nga një punonjës i caktuar nga drejtori i zyrës vendore për këtë qëllim. Në rastet e fazës së ekzekutimit të dënimit penal, raporti hartohet nga punonjësi i caktuar me mbikëqyrjen e të dënuarit.

3. Raporti i vlerësimit paraqet të dhëna që i vijnë në ndihmë prokurorit ose gjykatës në marrjen e vendimit në çdo fazë të procedimit penal, bazuar në informacione të detajuara dhe në analizën e rrethanave, shkaqeve të kryerjes së veprës penale dhe qëndrimeve të tij të paraqitura nga Shërbimi i Provës në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme.

4. Shërbimi i Provës paraqet në raport mendimin e tij për llojin apo masën e dënimit të përshtatshme që duhet marrë në çdo rast individual. Ky mendim jepet në mënyrë objektive dhe të paanshme, pavarësisht qëndrimeve të prokurorisë apo të mbrojtësit.

5. Raporti i vlerësimit paraqitet në formë të përmbledhur, duke shmangur termat e specializuar apo shprehjet që do ta vështirësonin kuptimin e tij.
6. Raporti duhet të përgatitet nga Shërbimi i Provës bazuar në dy a më shumë takime me personin, për të cilin gjykata ose prokurori ka kërkuar raport vlerësimi.
7. Në rast se nevojitet një analizë komplekse dhe tepër e specializuar psikologjike, sociologjike, pedagogjike, mjekësore apo analizë tjetër e ngjashme, zyra vendore i kërkon Drejtorisë së Përgjithshme ekspertizën e duhur për të hartuar raportin e vlerësimit.
8. Punonjësi i Shërbimit të Provës kontakton anëtarë të familjes, persona nga shkolla apo vendi i punës dhe çdo person tjetër që mund të ofrojë informacion të dobishëm për hartimin e raportit të vlerësimit.
9. Nëse personi për të cilin është kërkuar raporti i vlerësimit nuk bashkëpunon, punonjësi i Shërbimit të Provës e përmend refuzimin e bashkëpunimit në raport.
10. Nëse personi për të cilin është kërkuar raporti nuk gjendet, Shërbimi i Provës njofton prokurorin ose gjykatën që ka kërkuar raportin, duke përgatitur një njoftim të posaçëm që tregon faktet e gjetura dhe pamundësinë e hartimit të raportit të vlerësimit.
11. Të dhënat e parashikuara nga paragrafi 9 nënkuptojnë çdo lloj të dhëne, përfshirë edhe punën me Policinë e SHTETIT për të identifikuar personin.

Neni 33

Detyrat e punonjësit të Shërbimit të Provës në lidhje me hartimin e raportit

1. Punonjësi i Shërbimit të Provës i caktuar për të hartuar raportin e vlerësimit:
 - a) cakton menjëherë, por jo më vonë se 3 ditë nga marrja e kërkesës nga gjykata ose prokurori, vendin, datën dhe orën e kontaktit të parë me personin për të cilin është kërkuar raporti i vlerësimit. Kontakti i parë duhet të zhvillohet brenda 5 ditëve nga marrja e kërkesës nga gjykata apo prokurori. Në rastin e të miturve, punonjësi i Shërbimit të Provës përcakton vendin, datën dhe orën e takimit apo takimeve me fëmijën dhe prindërit dhe mbrojtësin ose, nëse është e nevojshme, me njerëz ose institucione, përfaqësuesve të të cilëve iu është besuar mbikëqyrja e fëmijës.
 - b) kontakton çdo person dhe institucion që mund të ofrojë informacion të dobishëm rreth personit në vlerësim, rreth arsimit, punësimit, strehimit, sjelljes, shëndetit, rrethanave të tij shoqërore dhe familjare;
 - c) regjistron, në çdo takim, të dhënat e nevojshme dhe të dobishme për hartimin e raportit të vlerësimit;
 - ç) i propozon drejtorit të zyrës vendore, kur çmohet e nevojshme, të marrë masat e parashikuara nga paragrafi 7, i nenit 32;
 - d) harton raportin e vlerësimit bazuar në informacionin e marrë dhe ia paraqet për shqyrtim dhe nënshkrim drejtorit të zyrës vendore të Shërbimit të Provës;
 - dh) ia dërgon raportin e vlerësimit organit procedues brenda afatit të kërkuar prej tij.

Neni 34

Përmbajtja e raportit të vlerësimit dhe e raportit përfundimtar

1. Raporti i vlerësimit përmban elementet e mëposhtme:

a) Përshkrimin dhe analizën e veprës penale në rastin e raporteve të përgatitura në çdo fazë të procedimit përpara dhënies së dënimit me qëllim vlerësimin e rrezikshmërisë dhe personalitetit.

b) Një përmbledhje të të gjithë informacionit dhe fakteve të rastit të paraqitura në formën e një analize mbi shkakun e kryerjes së kësaj vepre penale të veçantë në këtë kohë.

c) Burimet e informacionit të përdorura opër të përgatitur raportin të paraqitura shprehimisht, duke përfshirë njerëzit e intervistuar dhe dokumentat e konsultuara.

ç) Numrin e takimeve të mbajtura me personat e intervistuar dhe refuzimin e bashkëpunimit apo çdo dyshim mbi saktësinë e informacionit të paraqitur në mënyrë të arsyetuar, si dhe burimet e informacionit mbi të cilat aksesit ka qenë i pamundur.

c) date privind persoana pentru care a fost solicitat;

d) Përshkrimin dhe analizën e autorit të veprës penale, duke përfshirë informacion mbi sfondin e tij social, historinë personale, historinë kriminale dhe reagimet ndaj dënimeve të mëparshme dhe, kur është e nevojshme, arsimimin, punësimin apo trajnimet, strehimin, shëndetin fizik apo mendor, vështirësitë personale, duke përfshirë gjendjen financiare, përdorimin e drogës dhe të alkoolit, qëndrime të përgjithshme shoqërore dhe çdo faktor tjetër që punonjësi i Shërbimit të Provës e konsideron të rëndësishëm.

dh) Rrezikun e përsëritjes së veprave penale prej autorit të veprës penale dhe të dëmit të mundshëm të veprimeve të tij në të ardhmen, si dhe faktorët që mund të ndikojnë ose prekin sjelljen e tij në përgjithësi. Kur është e përshtatshme, raporti përfshin mendime/konsiderata mbi mënyrat e reduktimit apo menaxhimit të rrezikut të përsëritjes apo dëmit.

e) Përfundimet dhe rekomandimet e Shërbimit të Provës për gjykatën ose prokurorinë.

2. Raporti për përfundimin e plotë të periudhës së mbikëqyrjes përmban:

i) gjeneralitetet e të dënuarit;

ii) të dhënat e vendimit gjyqësor penal që ka caktuar masën alternative;

iii) datën e fillimit dhe të përfundimit të masës alternative të dënimit;

iv) arsyen e përfundimit të masës alternative; dhe

v) një paraqitje të ecurisë së përmbushjes së detyrimeve dhe masës alternative të dënimit.

3. Raportet përpilohen sipas modeleve të standardizuara të miratuara nga Ministri i Drejtësisë me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm.

KREU VII MBIKËQYRJA E TË DËNUARVE NË GJYSMËLIRI

Neni 35 Përcaktimi i institucionit

1. Shërbimi i Provës dhe Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve, me urdhër të përbashkët përcaktojnë institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale ku do të vendoset i dënuari në gjysmëliri. Në këtë përcaktim, mbahen parasysh shkakun për të cilin gjykata ka caktuar masën alternative të gjysmëlorisë dhe vendin ku duhet të përmbushë detyrimet personale jashtë burgut.

2. Modeli i urdhrit miratohet nga Ministri i Drejtësisë me propozim të Drejtorëve të Përgjithshëm të Burgjeve dhe Shërbimit të Provës.

Neni 36
Programi

Shërbimi i Provës harton dhe zhvillon një program ditor individual për ekzekutimin e dënimit me gjysmëliri, në përputhje me nenin 28 të kësaj rregulloreje.

Ky program përmban detyrimet e të dënuarit gjatë kohës që ndodhet jashtë institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, duke përcaktuar:

- a) oraret e hyrjes dhe daljes në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale;
- b) personat me të cilët i dënuari lejohet ose ndalohet të mbajë kontakte gjatë kohës së qëndrimit jashtë institucionit;
- c) ambientet e lejuara dhe ato të ndaluara për frekuentim;
- d) kushte të tjera.

KREU VIII
**MBIKËQYRJA E TË DËNUARVE PËR TË CILËT GJYKATA KA VENDOSUR
PEZULLIMIN E EKZEKUTIMIT TË DËNIMIT ME BURGIM DHE VËNIEN
NË PROVË**

Neni 37
Programi

Shërbimi i Provës harton dhe zhvillon një program individual për ekzekutimin e vendimit të gjykatës për pezullimin e dënimit me burgim dhe vënien në provë, ku përcakton të drejtat dhe detyrimet e të dënuarit gjatë ekzekutimit të dënimit në përputhje me nenin 28 të kësaj rregulloreje.

Neni 38
Kontaktet me Shërbimin e Provës

1. Shërbimi i Provës mbikëqyr zbatimin e vendimit me pezullim të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë dhe e informon të dënuarin mbi detyrimin e tij për të mbajtur kontakte me Shërbimin gjatë zbatimit të dënimit.
2. Punonjësi i Shërbimit të Provës përcakton në programin individual numrin, kohëzgjatjen, frekuencën dhe vendin e takimeve me të dënuarin në provë, në përputhje me nenin 28 të kësaj rregulloreje.
3. Kur për arsye objektive, i dënuari në provë nuk mund të jetë i pranishëm në njërin prej takimeve, ai njofton paraprakisht punonjësin e Shërbimit të Provës. Në rast se njoftimi nuk është i mundur, ai paraqitet pranë Shërbimit të Provës brenda tre ditëve nga përfundimi i pengesës dhe justifikon me dokumente mungesën e tij.
4. I dënuari në provë paraqet të dhëna me shkrim mbi arsyet objektive të mungesës, të

cilat përfshihen në dosjen e tij personale.

5. Punonjësi i Shërbimit të Provës i caktuar verifikon arsyet e parashtruara dhe kur çmon që arsyet nuk justifikojnë mungesën, i jep të dënuarit në provë një njoftim me shkrim ku i ribën të ditur pasojat e mospërbushjes së detyrimeve dhe përmend datën e takimit të ardhshëm.

6. Kur shihet që pas dy njoftimeve i dënuari nuk mban kontakte me Shërbimin, punonjësi i Shërbimit të Provës i caktuar njofton drejtorin e zyrës vendore të Shërbimit të Provës, i cili njofton brenda dy ditëve prokurorin.

Neni 39

Detyrimet e të dënuarit në rast ndryshimi të vendbanimit

1. I dënuari në provë njofton paraprakisht me shkrim punonjësin e caktuar me mbëqyrjen e tij për ndryshimin e vendbanimit apo vendqëndrimit me përjashtim të rasteve urgjente kur njoftimi bëhet fillimisht nëpërmjet telefonit dhe më pas me shkrim. Brenda 15 ditëve nga ndryshimi, i dënuari në provë i paraqet punonjësit të caktuar të dhënat e detajuara rreth situatës së re.

2. Në rastin e udhëtimeve që i tejkalojnë 8 ditë, i dënuari në provë informon Shërbimin e Provës për adresën e vendit ku do të qëndrojë, numrin e telefonit dhe ditën e kthimit nga udhëtimi.

3. Nëse vendbanimi apo vendqëndrimi i ri i personit ndodhet në një zonë jashtë kompetencës tokësore të zyrës vendore të Shërbimit të Provës të ngarkuar fillimisht me çështjen, kjo e fundit brenda 3 ditëve i dërgon zyrës vendore të Shërbimit të Provës, në kompetencën tokësore të së cilës gjendet vendbanimi apo vendqëndrimi i ri i të dënuarit, dosjen personale të të dënuarit në provë dhe njofton menjëherë gjykatën që ka dhënë dënimin.

4. Në rastin e ndryshimit të vendit të punës, i dënuari në provë njofton me shkrim Shërbimin e Provës dhe e informon atë për arsyet e ndryshimit, vendin e ri të punës, natyrën dhe veprimtaritë e punës. Brenda 15 ditëve nga ndryshimi i punës, i dënuari në provë i dërgon Shërbimit të Provës dokumentet që vërtetojnë dhe justifikojnë ndryshimin.

Neni 40

Detyrat e punonjësit të Shërbimit të Provës në lidhje me mbështjen e të dënuarit

1. Kur gjykata në vendimin e saj ka caktuar një ose më shumë nga detyrimet e parashikuara në nenin 60 të Kodit Penal, Shërbimi i Provës inkurajon dhe mbështet të dënuarin në përmbushjen e detyrimeve dhe verifikon përmbushjen e tyre.

2. Për këtë qëllim, Shërbimi i Provës identifikon dhe lidh marrëveshje me institucionet lokale që mund të mbështesin përmbushjen e një apo më shumë detyrimeve të vendosura nga gjykata, siç janë Policia e Shtetit, qendrat e arsimimit apo trajnimit, qendrat e punës, institucionet mjekësore apo OJF-të që ofrojnë programe rehabilitimi.

Neni 41

Mbikëqyrja e detyrimit për të ushtruar një veprimtari profesionale ose për të marrë një formim profesional

1. Kur gjykata, sipas nenit 60 pika 1 të Kodit Penal, ka caktuar për të dënuarin detyrimin

për të ushtruar një veprimtari profesionale ose të marrë një arsim ose formim profesional, Shërbimi i Provës merr masat për vendosjen e të dënuarit në formën e përshtatshme të veprimtarisë profesionale apo arsimimit/formimit profesional.

2. Për këtë qëllim, punonjësi i Shërbimit të Provës identifikon qendrat arsimore dhe institucionet e kualifikimit profesional në nivel lokal që organizojnë kurse të tilla.

3. Punonjësi i Shërbimit të Provës i caktuar, kontrollon periodikisht nëse i dënuari në provë i ndjek kurset e arsimimit apo kualifikimit.

4. Nëse vendimi i gjykatës nuk specifikon llojin e veprimtarisë që do të ndiqet nga i dënuari në provë, Shërbimi i Provës përcakton llojin e aktivitetit dhe mënyrën e realizimit të tij.

Neni 42

Mbikëqyrja e përmbushjes së detyrimeve financiare

1. Kur gjykata, sipas nenit 60 pika 2 dhe 3 të Kodit Penal, ka caktuar për të dënuarin detyrimin të paguajë pensionet familjare apo të riparojë dëmin civil të shkaktuar, Shërbimi i Provës, gjatë kontaktit të parë, kërkon informacion mbi vendbanimin, mbi situatën dhe detyrimet financiare, vendin e punës dhe kohëzgjatjen e kontratës së punësimit dhe, kur është rasti, informacion mbi personat në ngarkim të të dënuarit.

2. Shërbimi i Provës i shpjegon të dënuarit që ai duhet të përmbushë detyrimet e vendosura nga gjykata dhe identifikon bashkë me të mënyrën dhe kohën e duhur të përmbushjes së detyrimeve financiare.

3. Shërbimi i Provës kontrollon rregullisht nëse i dënuari në provë i përmbush detyrimet e vendosura nga gjykata dhe i dokumenton rezultatet e kontrollit.

Neni 43

Mbikëqyrja e përmbushjes së detyrimeve të tjera

1. Kur gjykata ka caktuar për të dënuarin detyrimet e parashikuara në nenin 60, pikat 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 ose 12, të Kodit Penal, Shërbimi i Provës bashkëpunon ngushtësisht me institucionet lokale apo entet e tjera publike apo private që mund të asistojnë në mbikëqyrjen e ekzekutimit të detyrimeve.

2. Brenda 3 ditëve nga kontakti i parë, Shërbimi i Provës i dërgon Policisë së Shtetit ose çdo organizatë tjetër apo institucion që mund të asistojë mbikëqyrjen, informacion mbi të dënuarin në provë, duke kërkuar që, në rast mospërmbushjeje të detyrimit, të njoftohet menjëherë.

3. Kur është e nevojshme, Shërbimi i Provës bën vizita pa lajmërim paraprak në banesë ose në vendin e qëndrimit të të dënuarit për të siguruar mbikëqyrjen efektive të detyrimeve nga i dënuari. Nëpërmjet këtyre vizitave, Shërbimi i Provës mbledh edhe faktet, si dhe bashkëpunon me familjen e të dënuarit me qëllim asistimin e personit në përmbushjen e detyrimeve të vendosura.

4. Kur Shërbimi i Provës konstaton që i dënuari në provë ka shkelur një apo më shumë nga detyrimet e caktuara në vendimin e gjykatës, bën një paralajmërim me shkrim dhe i shpjegon verbalisht të dënuarit në provë përmbajtjen e paralajmërimit.

5. Detyrimi konsiderohet i papërbushur kur, pas një paralajmërimi me shkrim, Shërbimi i Provës konstaton që i dënuari në provë rishkel detyrimet e caktuara.

Neni 44

Mbikëqyrja e përbushjes së detyrimit për mjekim apo rehabilitim

1. Kur gjykata, sipas nenit 60 pika 11 e Kodit Penal, ka caktuar për të dënuarin detyrimin e mjekimit ose rehabilitimit në një institucion shëndetësor ose të nënshtrimit në një program trajtimi, mjekësor ose rehabilitues, Shërbimi i Provës identifikon, fillimisht, në nivel lokal, brenda 10 ditëve nga kontakti i parë, qendrën e përshtatshme për përbushjen e këtij detyrimi. Kjo qendër mund të jetë shëndetësore, organizatë, institucion apo ekspert që realizojnë programe rehabilitimi për substancat narkotike, alkoolin apo lloje të tjera programesh rehabilitimi.
2. Punonjësi i Shërbimit të Provës, gjatë takimeve me të dënuarin në provë dhe në lidhje të vazhdueshme me personat e përfshirë në trajtim, kontrollon nëse i dënuari në provë ndjek programet e trajtimit.
3. Me qëllim lehtësimin e përbushjes së detyrimeve, Shërbimi i Provës lidh marrëveshje me qendrat mjekësore, institucionet, organizatat dhe specialistët për rregullimin e procedurave konkrete të bashkëpunimit.
4. Detyrimi i parashikuar në nenin 60, paragrafi 1 pika 11, të Kodit Penal konsiderohet i papërbushur kur i dënuari në provë:
 - a) në mënyrë të paarsyeshme, refuzon përfshirjen në një program trajtimi;
 - b) në mënyrë të pajustificuar, ndërpret programin e trajtimit;
 - c) refuzon t'u nënshtrohet testeve për konsumin e substancave.

KREU IX

MBIKËQYRJA E TË DËNUARVE PËR TË CILËT GJYKATA KA VENDOSUR QËNDRIMIN NË SHTËPI

Neni 45

Programi

Shërbimi i Provës harton dhe zhvillon një program individual për qëndrimin në shtëpi, ku përcakton kushtet dhe detyrimet e personit të dënuar gjatë kryerjes së dënimit, në përputhje me nenin 28 të kësaj rregulloreje.

Neni 46

Mbikëqyrja dhe informimi për ekzekutimin e dënimit me qëndrim në shtëpi

1. Shërbimi i Provës kontakton institucionet lokale, shërbimin social, Policinë e Shtetit dhe çdo ent privat apo publik që mund të asistojë në ekzekutimin e dënimit me qëndrim në shtëpi. Shërbimi i Provës lidh marrëveshje bashkëpunimi me ta me qëllim mbikëqyrjen e të dënuarit.

2. Mbikëqyrja e ekzekutimit të dënimit me qëndrim në shtëpi përfshin vizitat rutinë të lajmëruara dhe ato të palajmëruara në shtëpinë e të dënuarit në provë ose në qendrat e kujdesit ku i dënuari vuan dënimin, si dhe mbajtjen e kontakteve me të dënuarin dhe familjen e tij.

3. Kur gjykata, sipas nenit 59/a paragrafi 2 të Kodit Penal, lejon të dënuarin të largohet nga vendbanimi, Shërbimi i Provës harton programin e mbikëqyrjes në përputhje me masat e përcaktuara nga gjykata për kohën e kaluar jashtë shtëpisë. Shërbimi i Provës mbikëqyr mënyrën e respektimit nga i dënuari të plotësimit të nevojave të domosdoshme familjare të lejuara nga gjykata.

4. Kur Shërbimi i Provës konstaton se kushtet e parashikuara në nenin 59/a paragrafi 1 të Kodit Penal, për të cilat gjykata ka caktuar masën alternative qëndrim në shtëpi nuk ekzistojnë më, raporton menjëherë tek prokurori me qëllim që t'i kërkohet gjykatës revokimi e masës alternative dhe zëvendësimin e saj me një tjetër. Raporti i Shërbimit të Provës përmban, në këtë rast, një propozim konkret për dënimin zëvendësues.

Neni 47

Mospërbushja e kushteve dhe detyrimeve

1. Në rastin kur i dënuari nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga dënimi me qëndrim në shtëpi, Shërbimi i Provës verifikon faktet dhe rrethanat që kanë sjellë mospërbushjen dhe i raporton prokurorit të çështjes me qëllim zbatimin e nenit 62 të Kodit Penal.

2. Kur Shërbimi i Provës çmon që i dënuari nuk ka përmbushur detyrimet si rezultat i pamundësisë objektive, ai i propozon prokurorit ndryshimin e detyrimeve në përputhje me mundësitë dhe nevojat e të dënuarit.

KREU X

MBIKËQYRJA E TË DËNUARVE, PËR TË CILËT GJYKATA KA VENDOSUR PEZULLIMIN E EKZEKUTIMIT TË DËNIMIT ME BURGIM DHE DETYRIMIN PËR KRYERJEN E NJË PUNE ME INTERES PUBLIK

Neni 48

Përcaktimi i llojit dhe vendit të punës

1. Kur gjykata ka caktuar ndaj të dënuarit masën alternative të parashikuar nga neni 63 i Kodit Penal, në favor të interesit publik, Shërbimi i Provës vendos llojin e punës që do të kryhet, vendin ku do të kryhet dhe ditët e javës.

2. Kur gjykata ka caktuar në vendimin e saj kryerjen e një pune në favor të interesit të një shoqate, Shërbimi i Provës përcakton llojin e punës dhe ditët e javës.

3. Në marrjen e këtij vendimi, Shërbimi i Provës vlerëson llojin e veprës penale të kryer, treguesit personalë të të dënuarit, si arsimi, mosha, gjendja shëndetësore, aftësitë profesionale, përvojën e mëparshme të tij dhe kushte të tjera sociale apo familjare të të dënuarit.

4. Shërbimi i provës në caktimin e vendit ku do të kryhet puna me interes publik merr në konsideratë vendbanimin e të dënuarit. Kur brenda territorit të vendbanimit të të dënuarit

nuk ka një institucion të përshtatshëm, Shërbimi i Provës cakton një institucion tjetër të së njëjtës natyrë i cili ndodhet në rrethin më të afërt me vendbanimin e të dënuarit.

Neni 49 **Programi**

1. Pas përcaktimit të institucionit, Shërbimi i Provës harton dhe zhvillon një program për kryerjen e punës me interes publik në përputhje me nenin 28 të kësaj rregulloreje, i cili përmban:

- a) ditët e javës gjatë të cilave do të kryhet puna, oraret për fillimin dhe mbarimin e punës dhe veprimtaritë e përditshme;
- b) mënyrën e takimeve me punonjësin e Shërbimit të Provës;
- c) elemente të tjera të nevojshme.

2. Kur i dënuari është person i mitur, programi ditor duhet të hartohet duke marrë parasysh moshën, interesin më të lartë të fëmijës, nevojat psiko-sociale, duke u konsultuar me prindërit, kujdestarin, mbrojtësin e tij ose persona të tjerë të kërkuar nga i mituri.

3. Shërbimi i Provës lidh marrëveshje me subjektet në të cilin do të kryhet puna me interes publik për përmbushjen e programit. Marrëveshja përcakton programin, punën që do të kryhet, personin përgjegjës të caktuar nga subjektet për të mbikëqyrur realizimin e punës nga i dënuari, si dhe detyrimin e subjekteve për të njoftuar menjëherë Shërbimin e Provës në rastet e mospërmbushjes nga i dënuari të detyrimeve.

4. Shërbimi i Provës shpjegon, tek personi përgjegjës i caktuar për mbikëqyrjen, që është e nevojshme të evidentohen orët e punës mbi baza ditore për të verifikuar nëse orari i punës ditore është respektuar apo jo, si dhe për të informuar rregullisht Shërbimin e Provës mbi nivelin e performancës në punë të të dënuarit.

Neni 50 **Informimi i personit të dënuar për ekzekutimin e dënimit**

1. Para fillimit të punës, Shërbimi i Provës informon të dënuarin për detyrimin e tij për të përmbushur udhëzimet e dhëna nga ky Shërbim dhe ato që rrjedhin nga puna që ai kryen.

2. Shërbimi i Provës informon personin e dënuar për detyrimin e tij për të mbajtur kontakte me të.

Neni 51 **Të drejtat dhe detyrat e të dënuarit**

Gjatë kryerjes së punës i dënuari gëzon të drejta të njëjta me punëmarrësit e tjerë lidhur me mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë, mirëqenien sociale dhe kohëzgjatjen në punë, si dhe ato që rregullojnë marrëdhëniet e punës, me përjashtim të kufizimeve që rrjedhin nga natyra e dënimit dhe përmbushja e detyrimeve të tij.

Neni 52

Mbikëqyrja e ekzekutimit të vendimit

1. Shërbimi i Provës mbikëqyr të dënuarin gjatë ekzekutimit të vendimit për kryerjen e punës në favor të interesit publik a shoqatës.
2. Kur Shërbimi i Provës njoftohet nga subjekti pranë të cilit kryhet puna për mospërbushje të detyrimeve nga i dënuari, atëherë ai e verifikon objektivisht këtë informacion dhe rezultatet e verifikimit ia raporton menjëherë prokurorit.

Neni 53

Pezullimi i ekzekutimit të vendimit për punë me interes publik

1. Në rastet kur i dënuari paraqet tek prokurori kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit për punë me interes publik, ia njofton këtë kërkesë edhe Shërbimit të Provës dhe ky i fundit informon personin përgjegjës të caktuar me mbikëqyrjen e punës.
2. Shërbimi i Provës verifikon shkakun e paraqitur nga i dënuari në kërkesën e tij për pezullim dhe rezultatet e verifikimit ia raporton prokurorit. Në raport, Shërbimi i Provës evidenton edhe nëse kushtet e të dënuarit kanë ndryshuar në atë masë që justifikojnë pezullimin.

Neni 54

Mospërbushja e kushteve dhe detyrimeve

Kur Shërbimi i Provës konstaton se i dënuari nuk kryen punën me interes publik, nuk mban kontakte të rregullta me të apo shkel kushtet apo detyrimet e tjera të caktuara, i raporton prokurorit.

Neni 55

Përfundimi i punës me interes publik

Subjektet pranë të cilave është kryer puna me interes publik, në përfundim të punës, pajisin të dënuarin me një vërtetim mbi orët e punës dhe datat e kryerjes së saj.

KREU XI

MBIKËQYRJA E TË DËNUARVE, PËR TË CILËT GJYKATA KA VENDOSUR LIRIMIN ME KUSHT

Neni 56

Programi

Shërbimi i Provës harton dhe zhvillon një program individual për ekzekutimin e vendimit të lirit me kusht, në përputhje me nenin 28 të kësaj rregulloreje.

Neni 57

Mbikëqyrja e ekzekutimit të vendimit të lirimit me kusht

Shërbimi i Provës mbikëqyr ekzekutimin e vendimit të lirimit me kusht dhe kur është e nevojshme, bashkëpunon me organet e pushtetit vendor dhe me Policinë e Shtetit. Ai informon personin e dënuar për detyrimin e tij për të raportuar rregullisht pranë Shërbimit lidhur me kryerjen e dënimit.

Neni 58

Ndryshimi i vendbanimit

Në rast ndryshimi të vendbanimit, i liruari me kusht njofton paraprakisht Shërbimin e Provës dhe Policinë e Shtetit mbi adresën e re të banimit dhe mbi arsyet e ndryshimit. Në këtë rast, Shërbimi i Provës njofton menjëherë prokurorin dhe Shërbimin e Provës së vendit të banesës së re të të liruarit me kusht.

Neni 59

Ndryshimi i detyrimeve

Në rastin kur i dënuari nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga lirimi me kusht, Shërbimi i Provës, pasi verifikon kushtet dhe rrethanat për mospërmbushjen e tyre, njofton prokurorin e çështjes dhe bën propozime në lidhje me ndryshimin e detyrimeve në përputhje me kushtet dhe nevojat e përshtatshme.

KREU XII

ZBATIMI I AKTEVE NDËRKOMBËTARE NGA SHËRBIMI I PROVËS

Neni 60

Bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë

1. Në rastet kur Shërbimi i Provës çmon se duhen zbatuar rregullat e Konventës Europiane “Për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruuar me kusht” apo sipas rregullave e ndonjë akti tjetër ndërkombëtar të ratifikuara, atëherë njofton dhe bashkëpunon me Ministrinë e Drejtësisë.
2. Procedurat e bashkërendimit të punës me Ministrinë e Drejtësisë përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës.

KREU XIII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 61

Dispozitë kalimtare

1. Ministri i Drejtësisë nxjerr aktet nënligjore në përputhje me parashikimet ligjore, si dhe të

kësaj rregulloreje për vënien në efikasë të Shërbimit të Provës.

2. Deri në plotësimin e numrit të punonjësve të Shërbimit të Provës, Ministri i Drejtësisë ngrë një komision të posaçëm prej 5 vetësh për realizimin e procedurave për emërimin e punonjësve të parë të Shërbimit të Provës. Për punonjësit e parë të rekrutuar zbatohen, për aq sa janë të pajtueshme, rregullat e neneve 13 dhe 14 të kësaj rregulloreje.

3. Deri në krijimin e të gjitha zyrave vendore të Shërbimit të Provës sipas nenit 5 pika 1 të kësaj rregulloreje, Ministri i Drejtësisë përcakton me akt nënligjor vendndodhjen e zyrave vendore të para.

URDHËR
Nr.6325, datë 31.7.2009

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR BASHKËPUNIMIN
E SHËRBIMIT TË PROVËS ME OJF-të DHE SHËRBIMIN E
NDËRMJETËSIMIT”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të paragrafit 2 të nenit 7 të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, dhe të nenit 31/7 të ligjit nr.8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për bashkëpunimin e Shërbimit të Provës me OJF-të dhe Shërbimin e Ndërmjetësisimit”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Enkelejd Alibeaj

**RREGULLORE
PËR BASHKËPUNIMIN E SHËRBIMIT TË PROVËS ME OJF-TË DHE
SHËRBIMIN E NDËRMJETËSIMIT**

KREU 1
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave në lidhje me bashkëpunimin e Shërbimit të Provës me OJF-të dhe Shërbimin e Ndërmjetësisimit për të siguruar:
 - a) Mbikëqyrjen e të dënuarit në përputhje me programin individual të trajtimit;
 - b) Asistencën dhe mbështetjen e të dënuarit për kapërcimin e vështirësive në lidhje me riintegrimin social dhe për përmbushjen e nevojave shoqërore të edukimit, arsimimit, punësimit, strehimit dhe nevojave të tjera të ngjashme;
 - c) Hartimin dhe realizimin e programeve efçente të sjelljes për të dënuarin, bazuar në nevojat e identifikuara të tij, realizimin e programeve dhe veprimtarive në qendra ditore, si dhe të ndërhyrjeve të tjera me ndikim potencial në rehabilitimin e të dënuarit;
 - ç) Vlerësimin e të dënuarve, kur për hartimin e raportit nevojiten analiza të specializuara mbi shëndetin e tyre mendor, abuzimin me substanca alkoolike, narkotike apo psikotrope

ose analiza të tjera të cilat mund të kryhen nga OJF-ja;

d) Sistemimin e të dënuarve të liruar me kusht duke përgatitur dhe ofruar programe të lirim, mundësi strehimi, arsimit, trajnimit dhe punësimi, veprimtari në qendra ditore, programe terapeutike apo të kujdesit dhe çdo ndërhyrje tjetër të nevojshme për rehabilitimin e ish- të dënuarve;

dh) Zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të dëmtuarve nga vepra penale dhe të dënuarve; si dhe

e) Reduktimin dhe parandalimin e kriminalitetit.

2. Çdo zyrë vendore e Shërbimit të Provës ka detyrimin të identifikojë në nivel lokal OJF-të dhe Shërbimin e Ndërmjetësimit të interesuar për bashkëpunim me Shërbimin e Provës dhe të mbajë dhe përditësojë një listë të këtyre institucioneve partnere të mundshme me qëllim kontaktimin e tyre brenda një kohe sa më të shkurtër kurdo që nevojitet bashkëpunimi. Kjo listë e përditësuar i paraqitet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës në fund të çdo muaji.

3. Dispozitat e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.302, datë 25.03.2009 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve dhe procedurave, për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative”, zbatohen, për aq sa janë të pajtueshme, edhe ndaj OJF-ve dhe Shërbimit të Ndërmjetësimit.

Neni 2

Përkufizime

Në kuptim të kësaj rregulloreje:

a) “I dënuari” ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr.302, datë 25.03.2009 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve dhe procedurave, për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative”. Ky term përfshin gjithashtu personin nën hetim dhe të pandehurin.

b) “Letër Referencë” është dokumenti që Shërbimi i Provës i paraqet OJF-së apo Shërbimit të Ndërmjetësimit dhe që përmban një përshkrim të shkurtër të të dënuarit, si më poshtë:

- të dhënat e kontaktit;

- natyrën dhe kohëzgjatjen e dënimit përfshirë dhe detyrimet e vendosura nga gjykata, kur është rasti i tillë;

- të dhëna mbi sfondin social, arsimor dhe profesional;

- gjendjen e tij shëndetësore, mendore dhe fizike duke përfshirë, kur është rasti, edhe varësinë ndaj ndonjë substance;

- të dhënat e kontaktit të të dëmtuarit nga vepra penale, vetëm kur këto janë të mundshme dhe nevojiten për programin e ndërmjetësimit;

- rekomandimin e Shërbimit të Provës në lidhje me llojin e ndërhyrjeve apo veprimtarive që nevojitet të kryhen nga OJF-ja apo Shërbimi i Ndërmjetësimit;

c) “OJF” ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë nga ligji nr. 8788, datë 7.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, i ndryshuar.

ç) "Memorandum bashkëpunimi" është marrëveshja e nënshkruar midis Drejtorisë së Shërbimit të Provës dhe OJF-së ose Shërbimit të Ndërmjetësimit me objekt veprimtaritë e parashikuara nga paragrafi 1 i nenit 1 të kësaj rregulloreje.

d) "Programet e ndërmjetësimit" janë të gjithë programet për ndërmjetësimin midis të dëmtuarit dhe të dënuarit, konsultimet familjare, në grup ose çdo lloj tjetër ndërhyrjeje në kuadër të drejtësisë restauruese me qëllim normalizimin e marrëdhënieve midis tyre;

dh) "Programet e sjelljes kriminale" janë programet e trajtimit/rehabilitimit që përdorin metoda të sjelljes njohëse dhe lloje të tjera të ndërhyrjeve të cilat mund të realizohen përgjatë një periudhe të caktuar kohore ndaj të dënuarit, individualisht ose në grup, me qëllim:

i. reduktimin e sjelljeve agresive duke iu mësuar si të kontrollojnë dhe menaxhojnë zemërimin;

ii. zhvillimin e aftësive të tilla, si zgjidhja e problemeve, ndërgjegjësimi ndaj të dëmtuarit, arsyetimi moral, vetëkontrolli, shmangia e qëndrimeve antisociale dhe ndërveprimi social me qëllim ndryshimin e sjelljes;

iii. reduktimin ose ndalimin e përdorimit të substancave alkoolike, narkotike apo psikotrope;

iv. reduktimin e rrezikut të veprave penale që lidhen me gjendjen e dehur; ose

v. reduktimin e rrezikut të dhunës në familje

e) "Prokurori" ka të njëjtin kuptim me atë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.302, datë 25.03.2009 "Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve dhe procedurave, për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative".

ë) "Qendra ditore" janë qendrat e rehabilitimit të drejtuara nga OJF-të dhe të frekuentuara nga të dënuarit me qëllim përfshirjen e këtyre të fundit në veprimtari që ndikojnë në sjelljen dhe qëndrimet e tyre, si terapitë që lidhen me artin apo muzikën, diskutimet në grup, aktrimi, letërsia, çdo veprimtari artizanale, apo programet e grupit për trajtimin e sjelljes kriminale.

f) "Shërbimi" është Shërbimi i Provës.

g) "Shërbimi i ndërmjetësimit" është struktura e përbërë nga ndërmjetës që ofron ndërmjetësimin midis të dëmtuarit dhe të dënuarit, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9090, datë 26.06.2003 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve".

gj) "Veprimtari e përkohshme" është çdo veprimtari e realizuar nga OJF-të në territorin e Republikës së Shqipërisë për asistencën, mbështetjen ose rehabilitimin e të dënuarve, për një periudhë nga 30 ditë deri në 6 muaj, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.8788, datë 7.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse".

h) "VKM-ja 302/2009" është vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 302 , datë 25.03.2009 "Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve dhe procedurave, për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative".

KREU II RREGULLAT E BASHKËPUNIMIT

Neni 3

Rregulla të përgjithshme për bashkëpunimin

1. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, pasi ka marrë paraprakisht mendimin me shkrim të Ministrit të Drejtësisë, hyn në marrëdhënie bashkëpunimi me OJF-të e regjistruara në regjistrin e hapur sipas pikës “d” të paragrafit 1 të nenit 26 të VKM-së nr. 302/2009, si dhe me Shërbimin e Ndërmjetësimit. Bashkëpunimi bëhet efektiv nën kompetencën territoriale të zyrave vendore të Shërbimit të Provës.
2. Shërbimin i Provës hyn në marrëdhënie bashkëpunimi me OJF-në që:
 - a) Është ligjërisht e regjistruar në Republikën e Shqipërisë;
 - b) Ka një qëllim dhe një objekt veprimtarie që përputhet me parashikimet e paragrafit 1 të nenit 1 të kësaj rregulloreje;
 - c) Është e licencuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit nën kategoritë “Kujdesi shoqëror dhe punësimi”, “Drejtësia dhe ligji” ose “Arsimi”, në përputhje me ligjin nr. 10081, i datës 23.02.2009 “Mbi licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”;
 - ç) Nuk ka shënime për shkelje të detyrimeve të bashkëpunimit në regjistrat e mbajtur nga zyrat vendore të Shërbimit të Provës.
3. Një OJF e huaj, që nuk është e regjistruar dhe nuk ka degë në Republikën e Shqipërisë dhe që është e gatshme të kryejë veprimtari të përkohshme të asistencës, mbështetjes apo rehabilitimit të të dënuarve, mund të hyjë në marrëdhënie bashkëpunimi me zyrën vendore të shërbimit të provës pasi të ketë marrë lejen nga Ministri i Drejtësisë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 8788, datë 7.05.2001 “Për OJF-të”.
4. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës organizon, të paktën një herë në vit, takime të përbashkëta me përfaqësues nga OJF-të dhe Shërbimi i Ndërmjetësimit për diskutimin e çështjeve thelbësore të bashkëpunimit në fushën e ekzekutimit të dënimeve alternative.
5. Shërbimi i Provës, në përzgjedhjen e OJF-së apo Shërbimit të Ndërmjetësimit me të cilin do të bashkëpunojë në çdo rast konkret, kujdeset për shmangien e konfliktit të interesit të këtyre të fundit me të dënuarin, të dëmtuarin dhe vetëshërbimin.
6. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës monitoron veprimtarinë e OJF-ve dhe Shërbimit të Ndërmjetësimit në lidhje me zbatimin e dënimeve alternative dhe përdorimin e mbështetjes financiare të marrë nga shteti për këtë qëllim.
7. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës përfshin, në regjistrin elektronik të mbajtur sipas paragrafit 3 të nenit 26 të VKM-së nr. 302/2009, të dhëna mbi numrin e memorandumeve të nënshkruara, OJF-të apo Shërbimin e Ndërmjetësimit palë në bashkëpunim, listën e OJF-ve që kanë shkelur detyrimet sipas paragrafit 3 të nenit 7 të kësaj rregulloreje dhe mbi programet e njohura si modele të praktikës së mirë të bashkëpunimit.

Neni 4
Parimet e bashkëpunimit

1. Shërbimi i Provës, OJF-të dhe Shërbimi i Ndërmjetësimit në veprimtarinë e tyre udhëhiqen nga parimi i ligjshmërisë.
2. Palët sigurojnë që në veprimtarinë e tyre të mos ketë diskriminim mbi bazën e racës, ngjyrës, gjinisë, lindjes, gjuhës, kombësisë, etnisë apo origjinës sociale, mendimeve politike apo të tjera, fesë, kushteve fizike apo mendore, statusit ekonomik apo çdo statusi tjetër.
3. Palët gjatë veprimtarisë së tyre respektojnë të drejtat dhe liritë themelore, si dhe dinjitetin e të dënuarit dhe të të dëmtuarit.
4. Palët përpiqen të zhvillojnë ndjenjën e përgjegjësisë së të dënuarit ndaj komunitetit dhe të dëmtuarit, si dhe të mbështesin e inkurajojnë riintegrimin social të të dënuarit nëpërmjet një qëndrimi korrekt ndaj punës, shtetit ligjor dhe rregullave të ndërveprimit social.

Neni 5
Forma e bashkëpunimit

1. Bashkëpunimi i Shërbimit të Provës me OJF-të dhe Shërbimin e Ndërmjetësimit realizohet nëpërmjet nënshkrimit të memorandumeve të bashkëpunimit, të cilët kanë si objekt një ose më shumë nga veprimtaritë e parashikuara nga paragrafi 1 i nenit 1 të kësaj rregulloreje dhe mund të zhvillohen ndaj një të dënuari apo një grupi të dënuarish.
2. Memorandumet e bashkëpunimit nënshkruhen për një afat të caktuar dhe hyjnë në fuqi me nënshkrimin nga palët. Kur memorandumi nënshkruhet për një afat më të gjatë se një vit, palët sigurojnë një rishikim periodik të përmbajtjes së tij dhe mbajnë takime të paktën një herë në gjashtë muaj me qëllim vlerësimin e veprimtarive të zhvilluara si dhe, kur çmohet e nevojshme, bëjnë propozime për shtesa apo ndryshime në memorandum.
3. Memorandumet mund të ndryshohen dhe/ose shtohen vetëm me miratimin e palëve. Kur shtesat apo ndryshimet prekin thelbin e procedurave të bashkëpunimit, palët përgatisin dhe nënshkruajnë një memorandum të ri.

Neni 6
Përmbajtja e memorandumeve

1. Memorandumet e bashkëpunimit përmbajnë:
 - a) Palët nënshkruese;
 - b) Zyrën vendore të Shërbimit të Provës që do të ngarkohet me zbatimin e memorandumit;
 - c) Llojin e shërbimit që do të ofrohet nga palët;
 - ç) Kohëzgjatjen e memorandumit;
 - d) Detyrimet e palëve, në veçanti detyrimin në lidhje me raportimin periodik të Shërbimit të Provës dhe të Ministri i Drejtësisë;
 - dh) Mënyrën e shkëmbimit të informacioneve konfidenciale;
 - e) Mënyrën e dokumentimit të shpenzimeve procedurale;

ë) Formën e monitorimit të zbatimit të memorandumit dhe legjislacionit në fuqi për ekzekutimin e dënimit alternativ dhe masat përkatëse në rast mospërbushjeje të rregullt të tij; si dhe

f) Datën dhe nënshkrimin e palëve.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës miraton modelin e standardizuar të memorandumit të bashkëpunimit.

Neni 7

Përfundimi i memorandumit

1. Memorandumi i bashkëpunimit përfundon në situatat e mëposhtme:

a) Me mbarimin e afatit të bashkëpunimit;

b) Me tërheqjen me shkrim nga çdonjëra prej palëve në rast mospërbushjeje nga pala tjetër të detyrimeve të përcaktuara në memorandum;

c) Kur, si rrjedhojë e mungesës së të dënuarve ose të të dëmtuarve apo mungesës së bashkëpunimit nga ana e tyre në kryerjen e veprimtarive të parashikuara në memorandum, palët bien dakord me shkrim që memorandumi nuk mund të ekzekutohet, duke përcaktuar datën e përfundimit të tij; si dhe

ç) Në rast fillimi të çdo veprimtarie që mund të dëmtojë palën tjetër.

2. Në rastet e parashikuara nga paragrafi “b” dhe “ç” i këtij neni, pala që tërhiqet nga memorandumi njofton me shkrim palën tjetër për përfundimin e memorandumit të bashkëpunimit. Çdo tërheqje e tillë i fillon efektet nga data e marrjes së njoftimit nga pala tjetër.

3. Në rast se OJF-ja apo Shërbimi i Ndërmjetësimit qëllimisht nuk përmbush detyrimet e përcaktuara në memorandum ose fillon një veprimtari që mund të dëmtojë Shërbimin e Provës, krahas përfundimit të memorandumit:

a) Zyra vendore e Shërbimit të Provës bën shënimin përkatës në regjistrin e OJF-ve të mbajtur prej saj, ku specifikohet shkelja e detyrimeve;

b) Zyra vendore e Shërbimit që ishte palë në memorandum njofton menjëherë Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës mbi shkeljen e qëllimshme të detyrimeve apo fillimin e veprimtarisë që dëmton shërbimin, me propozimin për ndjekjen e procedurave ligjore për t’i hequr OJF-së përgjithmonë licencën për të ofruar ndonjë nga veprimtaritë e parashikuara nga paragrafi 1 i nenit 1 të kësaj rregulloreje.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës i njofton Ministrit të Drejtësisë përfundimin e memorandumit dhe shkakun e tij.

KREU III

DETYRIMET E PALËVE

Neni 8

Detyrimet e Shërbimit të Provës në raport me OJF-të

1. Kur pas vlerësimit të të dënuarit sipas paragrafit 10 të nenit 24 të VKM-së nr. 302/2009, Shërbimi i Provës identifikon probleme dhe nevoja, për të cilat kërkohet mbështetje nga një OJF, Shërbimi:

- a) Harton një letër referencë dhe identifikon OJF-në e përshtatshme dhe të gatshme për ofrimin e veprimtarisë apo shërbimit që nevojitet;
- b) I dërgon letër referencën OJF-së jo më vonë se 3 ditë pas datës së vlerësimit;
- c) Përfshin në raportin e vlerësimit të përgatitur për prokurorinë apo gjykatën bashkëpunimin me OJF-në dhe rezultatet e tij;
- ç) Përfshin në programin individual të trajtimit bashkëpunimin me OJF-në për ekzekutimin e vendimit të gjykatës, kur është një rast i tillë;
- d) I shpjegon të dënuarit qëllimin e bashkëpunimit duke e informuar rreth llojit të veprimtarisë që do të kryhet nga OJF-ja;
- dh) Komunikon me personin përgjegjës për rastin të caktuar nga OJF-ja për të rënë dakord mbi datën dhe orën, në të cilën i dënuari i shoqëruar nga punonjësi i shërbimit do të paraqiten pranë OJF-së;
- e) Vë në dijeni të dënuarin për rregullat që duhen respektuar në marrëdhëniet me OJF-në dhe detyrimet e tij për të marrë pjesë në veprimtaritë e programuara nga OJF-ja duke i shpjeguar pasojat e mosrespektimit të këtyre rregullave dhe mospërbushjes së këtyre detyrimeve;
- ë) Përcakton në bashkëpunim më mbikëqyrësin, mënyra konkrete të monitorimit të ekzekutimit të dënimit dhe detyrimeve nga i dënuari;
- f) Siguron që llojet e veprimtarive që do të kryhen nga i dënuari, të përcaktuara fillimisht, nuk do të ndryshojnë në një masë të tillë sa të mos përputhen me nevojat dhe aftësitë e personit;
- g) Kryen vizita të rregullta në përputhje me kohën e përcaktuar në letër referencë, si dhe vizita të palajmëruara për të verifikuar nëse i dënuari po i përmbush si duhet detyrimet e tij pranë OJF-së;
- gj) Kontrollon dosjen e mbajtur nga OJF-ja për të dënuarin për të verifikuar nëse informacioni i përfshirë në të është objektiv dhe lidhet vetëm me çështjet dhe veprimtaritë që janë objekt i bashkëpunimit;
- h) Njofton prokurorin, në rast mospërbushjeje të detyrimeve nga i dënuari, pasi të ketë marrë një njoftim të motivuar nga OJF-ja dhe pasi të ketë verifikuar informacionin;
- i) Njofton prokurorin kur çmohet se për arsye objektive i dënuari nuk mund të përmbushë detyrimin dhe dënimi i vendosur nuk mund të ekzekutohet;
- j) Përfshihet aktivisht në zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e veprimtarive të OJF-së me qëllim sigurimin që OJF-ja i përmbush detyrimet e saj dhe shërbimi që i ofrohet të dënuarit është cilësor dhe eficient.

2. Kur Shërbimi i Provës e vlerëson një program të sjelljes kriminale të hartuar dhe realizuar nga një OJF si të suksesshëm dhe të dobishëm, i propozon Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës njohjen e këtij programi me qëllim që të përdoret si shembull i praktikës së mirë nga zyra të tjera vendore të shërbimit dhe nga OJF-të.

Neni 9

Detyrimet e Shërbimit të Provës në raport me Shërbimin e Ndërmjetësimit

1. Kur Shërbimi i Provës nga vlerësimi i të pandehurit çmon se rasti është i përshtatshëm për ndërmjetësim midis të dëmtuarit dhe të dënuarit, ai:

- a) Harton një letër referencë për të dënuarin dhe komunikon me Shërbimin e

Ndërmjetësimi për të siguruar një ndërmjetës të pavarur dhe të paanshëm për zhvillimin e procedurës së ndërmjetësimi;

b) I dërgon Shërbimit të Ndërmjetësimi letër referencën jo më vonë se 3 ditë pas vlerësimit të nevojës për ndërmjetësim;

c) Informon të dënuarin mbi mundësinë që ka për t'i ofruar këshillim dhe mbështetje për të ndërmjetësuar me të dëmtuarin;

ç) Komunikon me personin përgjegjës të caktuar nga Shërbimi i Ndërmjetësimi për të rënë dakord mbi datën dhe orën, në të cilën i dënuari i shoqëruar nga punonjësi i shërbimit do të paraqiten pranë institucionit;

d) Përfshin në raportin e vlerësimit të përgatitur për prokurorinë apo gjykatën bashkëpunimin me Shërbimin e Ndërmjetësimi dhe rezultatet e tij;

dh) Informon gjykatën kur çmohet se për arsye objektive ose subjektive ndërmjetësimi është i pamundur të realizohet;

e) Përfshihet aktivisht në zbatimin dhe monitorimin e veprimtarive të Shërbimit të Ndërmjetësimi që realizohen në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit me qëllim sigurimin që Shërbimi i Ndërmjetësimi i përmbush detyrimet e saj dhe shërbimi që i ofrohet të dënuarit është cilësor dhe eficient.

2. Kur si rrjedhojë e ndërmjetësimi, midis të dënuarit dhe të dëmtuarit është arritur një marrëveshje për zgjidhjen me pajtim të çështjes penale dhe kur kjo nuk bie në kundërshtim me ligjin, Shërbimi i Provës njofton me shkrim prokurorin rreth kësaj marrëveshjeje.

3. Kur si rrjedhojë e ndërmjetësimi, verifikohen rrethanat e zëvendësimit të dëmit të shkaktuar nga vepra penale ose të ndihmës aktive për zhdukjen ose pakësimin e pasojave të saj dhe të normalizimit të marrëdhënieve, por ligji nuk lejon zgjidhjen e çështjes penale me pajtim, Shërbimi i Provës i përshkruan këto rrethana në raportin e vlerësimit.

4. Në rastin e të dënuarve, veçanërisht të atyre që kërkojnë lirim me kusht, shërbimi, identifikon të dëmtuarin dhe shqetësimet e tij të mundshme që lidhen me kthimin e të dënuarit në komunitet dhe parashikon në raportin e vlerësimit dhe në planin individual të trajtimit bashkëpunimin me Shërbimin e Ndërmjetësimi me qëllim normalizimin e marrëdhënieve midis të dënuarit dhe të dëmtuarit.

Neni 10

Detyrimet e OJF-së

1. Në marrëdhënien e bashkëpunimit me Shërbimin e Provës, OJF-ja:

a) Cakton një ose më shumë persona përgjegjës për zbatimin e memorandumit të bashkëpunimit dhe i komunikon shërbimit të dhënat e kontaktit të tyre;

b) Takohet me përfaqësuesin e shërbimit dhe të dënuarin për të diskutuar rreth veprimtarive apo ndërhyrjeve të propozuara për t'u kryer nga OJF-ja;

c) Përgatit, bazuar në letër referencën dhe në takimin me të dënuarin, një plan me shkrim të veprimtarive që do të kryhen, duke përmendur llojin, vendin, kohën e tyre dhe, kur është e nevojshme, specifikon nëse personi do të përfshihet në një program rehabilitimi individual, grupi apo familjar;

- ç) I dërgon kopje të planit të veprimtarive të dënuarit dhe shërbimit;
 - d) Siguron vlerësimin e specializuar, kur për hartimin e raportit të vlerësimit nevojitet një analizë e specializuar të dënuarit dhe ia dërgon përfundimet me shkrim shërbimit brenda afatit për të cilin palët kanë rënë dakord;
 - dh) Realizon në praktikë llojet e veprimtarive, për të cilat palët kanë rënë dakord në kuadër të planit të veprimtarive;
 - e) Harton, realizon, rishikon dhe vlerëson programin në përputhje me planin e veprimtarive në rastin kur i dënuari është përfshirë në një program të sjelljes kriminale;
 - ë) Monitoron në mënyrë të vazhdueshme efektivitetin e zhvillimit të veprimtarive, si dhe performancën e të dënuarit duke informuar me shkrim shërbimin rreth rezultateve të monitorimit dhe, kur e çmon të nevojshme, propozon ndryshimin e planit fillestar të veprimtarive;
 - f) Informon shërbimin mbi çdo mungesë të të dënuarit apo sjellje të tij që do të rrezikonte vazhdimin e veprimtarive dhe ekzekutimin e vendimit gjyqësor;
 - g) I përgjigjet me shkrim çdo kërkesë të shërbimit për informacion mbi një rast të caktuar bashkëpunimi;
 - gj) I dërgon shërbimit një raport përfundimtar për çdo të dënuar duke përshkruar performancën e të dënuarit, progresin e tij, arritjen ose jo të qëllimit të veprimtarisë dhe çdo koment tjetër që mund të çmohet i nevojshëm.
2. Për çdo të dënuar, OJF-ja hap një dosje të veçantë, e cila përfshin:
- a) Memorandumin e bashkëpunimit të nënshkruar me Shërbimin e Provës në lidhje me rastin konkret;
 - b) Një fotokopje të dokumentit të identifikimit të të dënuarit;
 - c) Letër referencën e paraqitur nga Shërbimi i Provës sipas parashikimeve të pikës “b” të paragrafit 1 të nenit 8 të kësaj rregulloreje;
 - ç) Raport mjekësor për vlerësimin e kushteve shëndetësore të të dënuarit, kur është e nevojshme;
 - d) Planin e veprimtarive të hartuar në përputhje me pikën “c” të paragrafit 1 të këtij neni;
 - dh) Përfundimet e vlerësimit të specializuar të realizuar sipas pikës “d” të paragrafit 1 të këtij neni;
 - e) Programin e sjelljes kriminale të hartuar në përputhje me pikën “e” të paragrafit 1 të këtij neni;
 - ë) Aktet informuese drejtuar Shërbimit të Provës në lidhje me rezultatet e monitorimit të realizimit të veprimtarisë së të dënuarit sipas pikës “ë” të paragrafit 1 të këtij neni; si dhe
 - f) Raportin përfundimtar të hartuar mbi të dënuarin në përputhje me pikën “g” të paragrafit 1 të këtij neni.
3. Dosja e mbajtur sipas paragrafit 2 të këtij neni i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës brenda 10 ditëve nga përfundimi i memorandumit, ku dhe arkivohet. OJF-ja mban kopje të dosjes.
4. OJF-ja në veprimtarinë e saj respekton kërkesat e ligjit nr. 9877, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Detyrimet e Shërbimit të Ndërmjetësimit

1. Në marrëdhënien e bashkëpunimit me Shërbimin e Provës, Shërbimi i Ndërmjetësimit:

- a) Depoziton pranë shërbimit listën e ndërmjetësve me gjeneralitetet dhe kontaktet e tyre dhe i rekomandon shërbimit ndërmjetësit e përshtatshëm për rastet konkrete;
- b) Siguron që të gjithë ndërmjetësit që ofrojnë shërbimin e tyre në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit janë të trajnuar në çështje të ndërmjetësimit midis të dëmtuarit dhe të dënuarit dhe të drejtësisë restauruese;
- c) Kryen veprimet e nevojshme për të kontaktuar dhe, kur është e nevojshme, për të takuar, veçmas të dëmtuarin dhe të dënuarin me qëllim përgatitjen e tyre paraprake për seancat e ndërmjetësimit;
- ç) Informon zyrën vendore të shërbimit mbi përputhshmërinë e çdo rasti me programet e ndërmjetësimit;
- d) Siguron që çdo program ndërmjetësimi të zhvillohet në mënyrë të përshtatshme dhe të ndiqet nga ndërmjetësi të aftë për të përgatitur dhe siguruar një takim të qetë dhe të sigurt të të dëmtuarit me të dënuarin;
- dh) Përfshin në programet e ndërmjetësimit edhe prindërit e të dënuarit, kur ky i fundit është i mitur;
- e) Kur është e përshtatshme, përfshin në programet e ndërmjetësimit, anëtarë të komunitetit, familjarë, juristë apo dhe punonjës të shërbimit të provës, me qëllim arritjen e rezultateve në përmirësimin e marrëdhënies midis të dëmtuarit dhe të dënuarit, riparimin e dëmit të shkaktuar dhe parandalimin e kryerjes së veprave të tjera penale;
- ë) Informon shërbimin mbi ecurinë e procesit të ndërmjetësimit në mënyrë periodike;
- f) Zhvillon ndërmjetësimin në mënyrën më të përshtatshme për të dëmtuarin dhe të pandehurin mbështetur në rrethanat e kryerjes së veprës penale, pasojat e saj dhe sjelljen ndërmjet tyre;
- g) Informon shërbimin kur çmon se për arsye objektive apo subjektive procesi i ndërmjetësimit nuk mund të kryhet, duke përshkruar dhe shkaku;
- gj) I përgjigjet me shkrim çdo kërkesë të shërbimit për informacion mbi një rast të caktuar bashkëpunimi;
- h) Siguron që programet e ndërmjetësimit i përshtaten dhe mbajnë parasysh nevojat dhe shqetësimet e të dëmtuarit.

2. Në përfundim të programit të ndërmjetësimit, Shërbimi i Ndërmjetësimit:

- a) I paraqet Shërbimit të Provës një raport rreth zhvillimeve të programit dhe rezultateve të arritura. Në raport përfshihet informacion mbi arritjen ose jo të një marrëveshjeje dhe mbi mundësinë e kërkesës së përfundimit të procedimit penal sipas ligjit;
- b) I paraqet kopje të raportit të ndërmjetësimit të dëmtuarit, të dënuarit dhe çdo personi që ka marrë pjesë në programin e ndërmjetësimit;
- c) Kur është arritur një marrëveshje midis të dënuarit dhe të dëmtuarit, ndjek në vijimësi përmbushjen e marrëveshjes nga ana e të dënuarit dhe i raporton shërbimit mbi përmbushjen ose jo të detyrimeve të marra përsipër nga i dënuari;

3. Shërbimi i Ndërmjetësimit, në veprimtarinë e tij, respekton kërkesat e ligjit nr.9877, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

SHTOJCA II





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMIT TË PROVËS
Zyra Vendore e Shërbimit të Provës _____

Tepër konfidencial
pasi të plotësohet

RAPORT I VLERËSIMIT
për personin nën hetim / të pandehurin

I. Hyrje

Emri dhe mbiemri i personit nën hetim / të pandehurit:

Datëlindja, vendlindja dhe mosha e personit nën hetim / të pandehurit:

Adresa e personit nën hetim / të pandehurit:

Vepra/veprat penale për të cilën/cilat personi është nën hetim/akuzohet:

Gjykata/Prokuroria që ka kërkuar raportin e vlerësimit:

Numri i dosjes penale:

Data e seancës gjyqësore:

Data dhe numri i kërkesës së gjykatës/prokurorisë për raportin e vlerësimit:

Lloji dhe kohëzgjatja e masës/masave të sigurimit, nëse ka:

Emri dhe mbiemri i punonjësit të shërbimit të provës që ka përgatitur raportin:

II. Burimet e informacionit të përdorura për të përgatitur raportin

(personat e intervistuar, numri dhe datat e intervistave të bëra me çdo person, dokumentet e konsultuara, çdo refuzim për të bashkëpunuar apo dyshim mbi saktësinë e informacionit të paraqitur në mënyrë të arsyetuar, çdo burim të informacionit mbi të cilat aksesimi ka qenë i pamundur)

.....
.....
.....

III. Përshkrimi dhe analiza e veprës/veprave penale për të cilën/cilat personi është nën hetim/akuzohet

(përfshirë shkakun/shkaqet për kryerjen e veprës penale, qëndrimin e autorit të veprës penale ndaj veprës së kryer dhe dëmi i shkaktuar viktimës/viktimave, nëse ka)

.....

.....
.....
.....

IV. Përshkrimi dhe analiza e autorit të veprës penale

(përfshirë jetën dhe historinë personale të autorit të veprës penale që ka lidhje me kryerjen e veprës penale)

V. Analiza dhe vlerësimi i rrezikut

(rreziku i përsëritjes së veprave penale prej autorit të veprës penale dhe të dëmit të mundshëm të veprimeve të tij, përfshirë mënyrën e reduktimit apo menaxhimit të rrezikut, nëse ka)

VI. Konkluzione dhe rekomandime

(përfshirë propozimin për marrjen në konsideratë nga gjykata/prokuroria për llojin dhe kohëzgjatjen e masës/dënimit që do jepet duke shpjeguar arsyet se përse një masë/dënim i tillë konsiderohet më i përshtatshmi në këtë rast)

.....
.....
.....
.....

Data e përgatitjes dhe e nënshkrimit të raportit të vlerësimit

.....

Nënshkrimi i punonjësit të shërbimit të provës që përgatiti raportin

.....

Drejtori i zyrës vendore (emri dhe nënshkrimi)

.....

Vula e zyrës vendore të shërbimit të provës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMIT TË PROVËS
Zyra Vendore e Shërbimit të Provës _____

*Tepër konfidencial
pasi të plotësohet*

**RAPORT I VLERËSIMIT
për të dënuarin**

I. Hyrje

Emri dhe mbiemri i të dënuarit:

Datëlindja, vendlindja dhe mosha e të dënuarit:

Adresa e të dënuarit:

Vepra/veprat penale për të cilën/për të cilat është dënuar personi për të cilin hartohet ky raport:

Gjykata/Prokuroria¹ së cilës i dërgohet raporti i vlerësimit:

¹ Rrethoni të duhurën.

Data dhe numri i vendimit përfundimtar:

Lloji dhe kohëzgjatja e dënimit (përfshirë datën e fillimit dhe mbarimit) të dhënë nga gjykata:

Detyrimet e dhëna nga gjykata për të dënuarin (parashikuar nga neni 60 i Kodit Penal), nëse ka:

.....
.....
.....
.....
.....

Periudha e dënimit të vuajtur nga i dënuari deri në datën e raportit (në ditë, muaj, vite)

.....
.....
.....
.....

Qëllimi i raportit
(raporti periodik gjatë mbikëqyrjes/ raport njoftimi në rast shkeljesh të kushteve apo detyrimeve/ shqyrtimi i kërkesës për lirim me kusht/ raport për përfundimin parakohe të periudhës së provës/ raporti përfundimtar në përfundim të dënimit alternativ (ose në përfundim të përmbushjes së detyrimeve):

Data dhe numri i kërkesës për raportin e vlerësimit, nëse ka:

Emri dhe mbiemri i punonjësit të shërbimit të provës që përgatiti raportin:

II. Burimet e informacionit të përdorura për hartimin e raportit

(personat e intervistuar, numri dhe datat e intervistave të bëra me çdo person, dokumentet e konsultuara, çdo refuzim për të bashkëpunuar apo dyshim mbi saktësinë e informacionit të paraqitur në mënyrë të arsyetuar, çdo burim të informacionit mbi të cilat aksesit ka qenë i pamundur)

IV. Përshkrimi dhe analiza e ekzekutimit të vendimit të gjykatës

(përfshirë, sipas rastit, informacionin lidhur me: programin e mbikëqyrjes dhe masat e marra për të adresuar nevojat kriminogjene të të dënuarit; sjellja dhe progresi i bërë nga i dënuari gjatë ekzekutimit të dënimit; përmbushja e detyrimeve dhe e kushteve nga i dënuari; rrethanat e shkeljeve të detyrimeve ose kushteve, nëse ka dhe shpjegimet e dhëna nga i dënuari; qëndrimi i të dënuarit ndaj veprës penale dhe viktimës/viktimave; bashkëpunimi me OJF dhe të tjera në ekzekutimin e vendimit gjyqësor) -----

V. Analizimi dhe vlerësimi i rrezikut

(përfshirë, sipas rastit, informacion mbi: çdo ndryshim të rrezikut të identifikuar në fillim të përsëritjes së veprave penale dhe/ose dëmit të të dënuarit; zgjidhjet praktike që janë përdorur për të menaxhuar dhe reduktuar rreziqet; gjendjen familjare, rrethanat sociale të të dënuarit dhe planet konkrete për riintegrimin e tij social pas lirimit me kusht) -----

VI. Konkluzione dhe rekomandime

(përfshirë propozimin e shërbimit të provës, së bashku me arsyet përkatëse lidhur me veprimin që duhet të marrë prokurori/gjykata, sipas rastit:

- në rast se i dënuari ka bërë progres gjatë ekzekutimit të dënimit:
 - vazhdimi i ekzekutimit të dënimit me të njëjtat kushte, ose
 - përfundimi para kohe i dënimit alternativ.
- në rastin e të miturit ose shkeljeve të para të kushteve apo detyrimeve, paralajmërimi i prokurorit:
ose
- ndryshimin e kushteve dhe detyrimeve të dhëna nga gjykata, kur ka arsye për të besuar se ato nuk janë më të përshtatshme ose nuk mund të përmbushen nga i dënuari,
ose
- në rastin e shkeljeve të rënda apo të përsëritura:
 - detyrime shtesë të vendosura nga gjykata, ose
 - zgjatje të periudhës së provës, ose,
 - zëvendësimin e dënimit alternativ me një tjetër dënim alternativ, ose
- revokimin e plotës apo të pjesshëm të dënimit të pezulluar dhe ekzekutimi i dënimit me burgim). -----

Data e përgatitjes dhe e nënshkrimit të raportit të vlerësimit
.....

Nënshkrimi i punonjësit të Shërbimit të Provës që përgatiti raportin
.....

Drejtori i Zyrës Vendore (emri dhe nënshkrimi)
.....

Vula e Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMIT TË PROVËS
Zyra Vendore e Shërbimit të Provës _____

RAPORT PËRFUNDIMTAR

I. Të dhëna të përgjithshme

Emri i personit të dënuar: _____
Mbiemri _____
Atësia: _____
Amësia : _____
Datëlindja: _____
Vendlindja: _____
Vendbanimi _____
Gjendja Civile _____

II-Numri dhe data e vendimit gjyqësor _____

Lloji i dënimit alternativ _____
Periudha e mbikëqyrjes _____

III- Data e fillimit të dënimit alternativ _____

Data e përfundimit të dënimit alternativ _____

IV- Arsyeja e përfundimit të masës alternative _____

V- Ecuria e përmbushjes së detyrimeve dhe masës alternative të dënimit

VI- Specialisti përgjegjës i Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës

VII- Drejtori i Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës

Vula e Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës

Shembull raport vlerësimi të përgatitur nga Shërbimi i Provës për personin nën hetim / të pandehurin

Shembull raport vlerësimi të përgatitur nga Shërbimi i Provës për të dënuarin



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
SHËRBIMI I PROVËS
ZYRA VENDORE FIER

Tepër konfidencial pasi të plotësohet

RAPORT I VLERËSIMIT
për personin nën hetim / të pandehurin

I. Hyrje

Emri dhe mbiemri i personit nën hetim / të pandehurit:

.....

Datëlindja, vendlindja dhe mosha e personit nën hetim / të pandehurit:

....., Fshati, Sarandë

Adresa e personit nën hetim / të pandehurit:

Fshati, Sarandë

Vepra penale për të cilën personi është nën hetim/akuzohet:

“Vjedhje”, e mbetur në tentativë, nenet 134/1 e 22 të Kodit Penal.

Prokuroria që ka kërkuar raportin e vlerësimit:

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Sarandë

Numri i dosjes penale:

Nr.- 2010.

Data e seancës gjyqësore:

Nuk ka informacion.

Data dhe numri i kërkesës së prokurorisë për raportin e vlerësimit:

Datë 30.03.2010 Nr...../..... Prot.

Lloji dhe kohëzgjatja e masës së sigurimit, nëse ka:

Në gjendje të lirë.

Emri dhe mbiemri i specialistit të Shërbimit të Provës që ka përgatitur raportin:

.....

II. Burimet e informacionit të përdorura për të përgatitur raportin

Intervistë me të pandehurin , datë 16.04.2010, ora 14.00, realizuar në fshatin , Sarandë.

Intervistë me Kryetarin e fshatit z. , datë 16.04.2010, ora 15.00 realizuar në fshatin , Sarandë.

Intervistë me znj. , nëna e të pandehurit, datë 16.04.2010, ora 15.30, realizuar në fshatin , Sarandë.

Intervistë me z. , banorë i fshatit , datë 16.04.2010, ora 16.00, realizuar në fshatin , Sarandë.

Intervistë me të pandehurin , datë 19.05.2010, ora 14.00. realizuar në fshatin , Sarandë.

Nuk është dokumentuar intervista me të dëmtuarin pasi ka pohuar se nuk ka dokument identifikues. Megjithatë, është bërë një bisedë me të ku ai i është përgjigjur disa pyetjeve.

III. Përshkrimi dhe analiza e veprës/veprave penale për të cilën/cilat personi është nën hetim/akuzohet

I pandehuri akuzohet për veprën penale të “vjedhjes”, mbetur në tentativë, veprë kjo e parashikuar nga neni 134/1 dhe 22 i Kodit Penal. I pandehuri akuzohet se ka marrë një shumë parash në vlerën e 60.000 lekëve në stallën e gjedhëve të shtetasit (Sipas vetë të dëmtuarit), e cila ndodhet në fushën që shtrihet poshtë fshatit dhe larg nga zona e banuar. I pandehuri nuk pranon që të ketë marrë lekë tek prona e , megjithatë ai pranon se ka shkuar disa herë atje, pa specifikuar arsyen se përse. I pandehuri është i paqartë lidhur me veprimet që ai kryen gjatë funksionimit të tij të përditshëm. Ai vetëm pohon se e ka akuzuar pa të drejtë. I pandehuri njihet në fshat si një njeri i mbyllur dhe i tërhequr nga shoqëria, por që nuk është problematik për komunitetin.

IV. Përshkrimi dhe analiza e autorit të veprës penale

..... është banor i fshatit , ai jeton me dy prindërit e tij, nëna merr pension, ndërsa babai është i papunë. Familja e të pandehurit në fshatin njihet si e varfër dhe me nivel të ulët ekonomik, social dhe kulturor. Nëna e të pandehurit punon në fshat duke kryer punë të ndryshme, ndërsa babai thuhet se nuk kryen asnjë punë, në fshat ai njihet si një njeri i “mefshët”. Shtëpia ku jeton i pandehuri përbëhet nga një dhomë me blloqe betoni, ku bashkangjitet një korridor dhe kuzhinë e vogël të thurura me fleta alumini. Lagështira dhe ajri i rëndë paraqitet shqetësues për frymëmarrjen.

I pandehuri ka pasur një fëmijëri të qetë sipas nënës së tij, por ai paraqitet jo shumë normal nga pikëpamja psikologjike për moshën që ka. Vihet re një lloj hutimi dhe mungesë përqendrimi nga ana e të pandehurit, për më tepër ai nuk arrin të kuptojë mirë fjalët që i thuhet (një arsye mund të jetë se nuk kupton mirë shqipen, pasi është minoritar grek). I pandehuri është i paarsimuar, ai mundi që të firmosë intervistën vetëm duke ia treguar një nga një se si duhet t'i shkruaj shkronjat e emrit të tij. Në fshat i pandehuri

njihet si një njeri i cili “nuk di”, por që nuk është agresiv, apo keqbërës. Komuniteti e vlerëson të pandehurin si jo problematik për sigurinë e tij.

V. Analiza dhe vlerësimi i rrezikut

I pandehuri është i mbyllur dhe i paqartë si personalitet, por nga ana tjetër nuk ka të dhëna që ky i pandehur ka qenë problem për komunitetin e fshatit, përveç rastit të fundit me Komuniteti i fshatit e ka parë me sy negativ denoncimin që i ka bërë të pandehurit, duke e cilësuar të pandehurin si jo të rrezikshëm dhe denoncuesin e tij si një person “problematic në karakter”. I pandehuri dhe familja e tij janë të varfër, por nuk ka ndodhur që të jenë bërë shqetësim për komunitetin ku jetojnë. ndihmon nënën e tij në punët e ndryshme që ajo bën në fshat, kryesisht pastrime banesash dhe nuk ka pasur ndonjë problem të shkaktuar nga i pandehuri në ndonjë rast. Për sa i përket rrezikut të përsëritjes së veprës penale nga i pandehuri mendojmë se është jo i lartë.

VI. Konkluzione dhe rekomandime

I pandehuri jeton në një familje shumë të varfër, dënimi me burgim i tij do e privoj atë nga mjedisi familjar, do i dobësonte edhe më shumë shprehitë sociale, si kujdesi ndaj vetes, ndërveprimi me bashkëmoshatarët, komunikimi me familjarët, etj. I pandehuri nuk shikohet si i rrezikshëm në komunitetin ku jeton.

Duke vlerësuar gjithë informacionin e grumbulluar për të pandehurin nëse shpallet fajtor nga gjykata për veprën penale të “Vjedhjes”, mbetur në tentativë, mendojmë se mund të aplikohen dënimet alternative të dënimit me burgim, dhe konkretisht neni 63 i Kodit Penal “Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik” për një kohë 100 orë.

Fier, ___ / ___ /2010

Specialisti i Shërbimit të Provës

(emri, mbiemri dhe firma)

Drejtore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
SHËRBIMI I PROVËS
ZYRA VENDORE TIRANË

Rruga "Jordan Misja", Pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda
Tel: +355 4 2 232 852

RAPORT I VLERËSIMIT
për të dënuarin

I. Hyrje

Emri dhe mbiemri i të dënuarit:

.....

Datëlindja, vendlindja dhe mosha e të dënuarit:

.../.../..., 56 vjeç

Lagjja "8 shkurti", Fier

Adresa e të dënuarit:

Lagjja ".....", Fier

Vepra penale për të cilën është dënuar personi:

"Mbajtje, transport të lëndëve narkotike"

Data dhe numri i vendimit përfundimtar:

../.../2000

Nr. Vendimi

Lloji dhe kohëzgjatja e dënimit të dhënë nga gjykata (data e fillimit dhe mbarimit).

15 vite burgim.

12.11.1998.

13.09.2011.

Detyrimet e dhëna nga gjykata për të dënuarin (parashikuar nga neni 60 i Kodit Penal), nëse ka:

Nuk ka.

Periudha e dënimit të vuajtur nga i dënuari deri në datën e raportit (në ditë, muaj, vite)

Ka vuajtur: 13 (trembëdhjetë) vite, 3 (tre) muaj, 7 (shtatë) ditë burgim.
I ka mbetur: 1 (një) vit, 8 (tetë) muaj, 23 (njëzet e tre) ditë burgim.

Qëllimi i raportit:
Shqyrtimi i kërkesës për “*lirim me kusht*”

Gjykata që ka kërkuar raportin e vlerësimit:
Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Data dhe numri i kërkesës për raportin e vlerësimit nëse ka:
Tiranë .././2009
Nr. Akti

Emri dhe mbiemri i specialistit të Shërbimit të Provës që përgatiti raportin:

II. Burimet e informacionit të përdorura për hartimin e raportit

- Dokumentacioni i mundësuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Dokumentacioni i mundësuar nga I.E.V.P-ja “Ali Demi”.
- Intervista e zhvilluar më datë 16.12.2009 me të dënuarin , në I.E.V.P.-në “Ali Demi” Tiranë ku vuan dënimin.
- Intervista e zhvilluar më datë 22.12.2009 me të dënuarin , në I.E.V.P.-në “Ali Demi” Tiranë ku vuan dënimin.
- Intervista e zhvilluar më datë 18.12.2009 në Fier në banesën e të dënuarit me znj. , e cila është nëna e të dënuarit
- Intervista e zhvilluar më datë 18.12.2009 në Fier në banesën e të dënuarit me z. , i cili është vëllai i të dënuarit
- Intervista e zhvilluar më datë 18.12.2009 në Fier në banesën e të dënuarit me znj. , e cila është nusja e xhaxhait të të dënuarit
- Deklaratë e noterizuar më datë 07.10.2009 nga notere me Nr. rep. Nr. kol., që vërteton se shtetasi , pronar i një biznesi privat në fushën e tregtisë, import-eksport me NIPT deklaron se, do të punësojë në aktivitetin e tij privat shtetasin
- Vërtetim datë 07.10.2009, nga z. Kryetar i Njesisë Administrative Nr. Bashkia Fier, për sjelljen në lagje dhe komunitetin ku banon familja e të dënuarit
- Vërtetim datë 08.10.2009, nga z. , Kryetar i Njesisë Administrative Nr. Bashkia Fier që vërteton se z. është i njëjti person me z. , kjo e vërtetuar nga zyra e gjendjes civile.
- Vërtetim datë 11.12.2009 nga z. Kryetar i Njesisë Administrative Nr. 3 Bashkia Fier, që vërteton se , nëna e të dënuarit jeton me familjen e të dënuarit
- Vërtetim datë 11.12.2009, nga z. , Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit Social Fier që vërteton se familja e z. nuk trajtohet me ndihmë ekonomike.

- Vërtetim datë 14.12.2009, nga z. Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Fier që vërteton se znj. bashkëshortja e dhe djali i tyre nuk trajtohen me pagesë papunësie.
- Epikrizë datë 07.10.2009, për pacienten nga Mjeku Kardiolog Dr., kardiolog në spitalin Fier, është nëna e të dënuarit e cila jeton me familjen e të dënuarit.
- Raport mjeko-ligjor datë 07.10.2009, për pacienten nga komisioni i Drejtorisë së Shëndetit Publik Fier.
- Certifikatë personale datë 07.10.2009 për z. nga Zyra e Gjendjes Civile të Njësisë Administrative Nr. 2, Bashkia Fier.
- Certifikatë familjare datë 07.10.2009 për z. nga Zyra e Gjendjes Civile të Njësisë Administrative Nr. 2, Bashkia Fier.

III. Përshkrimi dhe analiza e ekzekutimit të vendimit të gjykatës

..... është dënuar me 15 (pesëmbëdhjetë) vite burgim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin Nr. 307, datë 27.09.2000, akuzuar për veprën penale të "Mbajtjes, transport të lëndëve narkotike".

Nga dënimi i dhënë nga gjykata, ka vuajtur 13 (trembëdhjetë) vite, 3 (tre) muaj, 7 (shtatë) ditë burgim dhe i ka mbetur 1 (një) vit, 8 (tetë) muaj, 23 (njëzet e tre) ditë burgim.

Bazuar në vlerësimet e sjelljes së I.E.V.P.-ve ku i dënuari ka vuajtur dënimin konstatojmë se i dënuari ka sjellje të mirë, ai gjatë periudhës së vuajtjes së dënimit ka shfaqur korrektësi në zbatim të rregullores së I.E.V.P.-së, ka krijuar marrëdhënie të mira me personelin e shërbimit të I.E.V.P.-së dhe me bashkëvuajtësit e tjerë në I.E.V.P.

Gjatë vuajtjes së dënimit është aktivizuar me pune në I.E.V.P. Gjatë intervistës së zhvilluar me të dënuarin shprehet se ndihet i penduar për ngjarjen.

IV. Analizimi dhe vlerësimi i rrezikut

Vlerësimi i rrezikut për të dënuarin është bazuar në:

1. Dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku pasqyrohet vepra penale e kryer nga i dënuari, si dhe dokumentacioni nga I.E.V.P.-ja "Ali Demi" për të dënuarin ku pasqyrohen dinamika e vuajtjes së dënimit dhe vlerësimet e sjelljes për të dënuarin gjatë vuajtjes së dënimit.
2. Në intervistat e zhvilluara nga specialisti i Shërbimit të Provës me të dënuarin, analizimi dhe vlerësimi i veprës penale të kryer nga i dënuari dhe qëndrimi që mban i dënuari ndaj veprës penale të kryer.

3. Në intervistat e zhvilluara nga specialisti i Shërbimit të Provës me familjarë të të dënuarit, analizimi dhe vlerësimi që kanë familjarët për tipin dhe karakterin e të dënuarit si dhe për veprimet e kundërligjshme që ka kryer familjari i tyre, qëndrimi që mbajnë familjarët ndaj veprës penale dhe autorit të veprës penale që është i dënuari, ndihma dhe mbështetja që mund t'i japin familjarët të dënuarit për t'u riintegruar në shoqëri nëse i dënuari fiton "lirim me kusht".

- Rreziku i dëmit:

Rreziku i dëmit i shkaktuar nga vepra penale "Mbajtje, transport të lëndëve narkotike", me kryerjen e veprimeve të kundërligjshme janë cenuar rënde marrëdhëniet juridike të vendosura për ndalimin e transportit dhe mbajtjes së lëndëve narkotike të parashikuara nga legjislacioni penal.

- Rreziku i përsëritjes së veprës penale:

Rreziku i përsëritjes së veprës penale te ky i dënuar ekziston në një nivel të ulët: I dënuari ka vuajtur 13 vite burgim për këtë vepër penale, ai shprehet se kjo i ka shkaktuar një boshllëk të madh në familje, i dënuari është kryefamiljar dhe kërkon që me mbështetjen e familjes të fitojë kohën e humbur.

Nëse fiton lirinë me kusht i dënuari ka siguruar një kontratë punësimi për të punuar dhe siguruar të ardhurat për jetesën e familjes, punësimi ka një ndikim pozitiv tek i dënuari dhe në riintegrimin e tij në shoqëri.

Bazuar në vlerësimet e sjelljes së I.E.V.P.-ve ku i dënuari ka vuajtur dënimin konstatojmë se i dënuari ka sjellje të mirë, ai gjatë periudhës së vuajtjes së dënimit ka shfaqur korrektësi në zbatim të Rregullores së I.E.V.P.-së, ka krijuar marrëdhënie të mira me personelin e shërbimit të I.E.V.P.-së dhe bashkëvuajtësit e tjerë.

Gjate vuajtjes së dënimit në I.E.V.P., i dënuari ka qenë në organikën e të punësuarve në I.E.V.P.

Gjatë intervistës së zhvilluar me të dënuarin shprehet se ndihet i penduar për ngjarjen.

Gjendja psikike dhe emocionale e të dënuarit sipas dokumentacionit të I.E.V.P.-së është

e mirë, por gjatë kohës së vuajtjes së dënimit ka shfaqur disa herë probleme shëndetësore. Për arsye shëndetësore ai ka qene disa herë i shtruar në spitalin e burgut.

....., nëna e të dënuarit banon në shtëpi me, ajo është e sëmurë dhe ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme nga familjarët.

- Kushtet sociale:

Kushtet ekonomike të familjes së të dënuarit janë të vështira, asnjë nga anëtarët

e familjes së të dënuarit nuk është në punë, kjo sipas informacionit të marrë nga i dënuari, familjarët e të dënuarit dhe nga organet e qeverisjes vendore në Fier.

Të ardhurat e familjes janë vetëm pensioni i nënës së të dënuarit prej 11 mijë lekësh. Me punën që do të bëjë do të ndikojë në rritjen e të ardhurave të familjes.

Familjarët e të dënuarit kanë bashkëpunuar me Shërbimin e Provës për hartimin e Raportit të Vlerësimit, çfarë lë të kuptohet se i dënuari ka mbështetjen e familjes dhe të të afërmeve të tjerë për t'u riintegruar në shoqëri.

Nga intervistat e zhvilluara nga specialisti i Shërbimit të Provës i dënuari është treguar bashkëpunues.

V. Konkluzione dhe rekomandime

- I dënuari ka shfaqur pendim për veprën penale për të cilën është dënuar.
- I dënuari ka mbështetjen e familjes që të riintegrohet në shoqëri.
- Kushtet ekonomike të familjes së të dënuarit janë të vështira.
- I dënuari ka siguruar një kontratë pune që të punojë nëse fiton “*lirim me kusht*”.
- Nga intervistat e kryera me të dënuarin ai ka qenë bashkëpunues me specialistin e Shërbimit të Provës.
- Bazuar në dinamikën e vuajtjes së dënimit, i dënuari ka vuajtur 13 (trembëdhjetë) vite, 3 (tre) muaj, 7 (shtatë) ditë burgim, nga dënimi i dhënë nga gjykata prej 15 (pesëmbëdhjetë) vite burgim dhe ka plotësuar afatin ligjore për të kërkuar “liri me kusht”.

Nëse gjykata do të pranojë kërkesën e të dënuarit për “*lirim me kusht*” mendoj se nga analizimi dhe vlerësimi i dokumenteve dhe i faktorëve të lartpërmendur, riintegrimi i të dënuarit në shoqëri është një mundësi e mjaftueshme.

Data e përgatitjes dhe e nënshkrimit të raportit të vlerësimit: 28.12.2009.

Specialisti i Shërbimit të Provës që përgatiti raportin

Drejtori i Zyrës Vendore Tiranë

MANUAL

për aplikimin e alternativave
të dënimit me burgim

“Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) punon për stabilitet, begati dhe demokraci në 56 shtete përmes dialogut politik rreth vlerave të përbashkëta dhe përmes punës praktike që sjell një ndryshim jetëgjatë.”



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri
Sheraton Tirana Hotel & Towers,
Kati i I-rë
Sheshi “Italia”
1010 Tiranë - Shqipëri
www.osce.org/albania

ISBN: 978-92-9235-221-9



9 789292 352219